MONUMENTET 98



DO NOT COPY

në brendësi

QENDRA HISTORIKE
DËSHMI HISTORIKO-KULTURORE
DHE MBIJETESA E TYRE
NË SHOQËRINË NË ZHVILLIM.

DOKUMENTA NGA
KULTURA MATERIALE
PËR FAMILJEN E KASTRIOTËVE

VËSHTRIM MBI FORTIFIKIMET
DHE TRASENË E DRINIT
TË ZI (SHEK.IV-VI)

NJË PUNISHTE PËR PRODHIMIN
E VERËS NË LAGJEN EPISKOPALE
PALEOKRISTIANE TË BYLISIT

etj

DO NOT COPY

MINISTRIA E TURIZMIT KULTURËS RINISË DHE SPORTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

MONUMENTET 98

DO NOT COPY

2008

DO NOT COPY

Redaksia e revistës "Monumentet"

Kryeredaktor
Prof. Dr. Valter Shtylla

Sekretar Koligjumi
Behar Gjoka

Anëtarë
Prof. Dr. Emin Riza
Prof. Dr. GJerak Karaiskaj
Prof. Dr. Luan Përzhita
Sujleman Dashi
Shpresa Prifti

© Instituti i Monumenteve të Kulturës
Botimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës
Tiranë 2010

Kopertina dhe faqosja
Polygraph

Shtypi
"Gurten"



DO NOT COPY

PËRMBAJTJA

6	Qendra historike dëshmi historiko-kulturore dhe mbijetesa e tyre në shoqërinë në zhvillim.
21	Dokumenta nga Kultura Materiale për Familjen e Kastriotëve
31	Vështrim Mbi Fortifikimet Dhe Trasenë E Drinit Të Zi (Shek.Iv-Vi)
41	Një punishte për prodhimin e verës në lagjen episkopale paleokristiane të Bylisit
51	Gjurmë të reja në Via Egnatia
64	Koka e Shën Prodhromit në pikturat murale të kishave të Voskopojës (1725 et 1744)
79	Restaurimi i kishës së Shën Marisënë leusë të përmetit
117	Dy varre monumentalë në rajonin e dibrës
135	Studimi dhe restaurimi i një vazoje prej qelqi të zbuluar në Durrës
143	Studimi i mozaikut te Sarandes
158	Manastir asketësh në shpellën e kaurrit
166	Studimi dhe restaurimi i ikones "DEISIS"
185	Moment restaurimi ne kishen "shën triadha" Berat

DO NOT COPY

CONTENTS

17 Historic Centres as Cultural-Historic Testimony and their survive at the developed society

28 Documents from the Material Culture of Kastriotëve Family

39 Overview on the Drini i Zi fortification and track (IV-VI centuries)

49 Wine Distillery Workshop at the Bylis Episcopal Pre-Christian Quarter

61 New Traces at Egnatia Via

76 Three Discoveries of Saint Prodhrom Head at mural paintings in the churches of Voskopoja (1725 to 1744)

115 Leusi's Church in Përmet

133 Two Monumental Tombs at Dibra Region

142 "The conservation and restauration of the glass discovered in Durrës"

155 Prefrace and study of Saranda mosaic

165 An intersting monument in Koman.

182 Study and Restoring of DEISIS Icon

199 Summary

DO NOT COPY

QENDRA HISTORIKE DËSHMI HISTORIKO-KULTURORE DHE MBIJETESA E TYRE NË SHOQËRINË BASHKËKOHORE

PROF. DR. EMIN RIZA

DO NOT COPY

Qendrat historike, si dëshmi të prekshme historiko-kulturore, me vlera urbanistiko-arkitekturore të shkallëve të ndryshme, krahas monumenteve të veçantë arkitekturorë, janë dukuri krahasimisht e vonë në jetën kulturore shqiptare, që zë fill pas Luftës së Dytë Botërore. Në Shqipëri, këto qendra të veçanta, duke qenë kryesisht, pasqyruese të vendbanimeve të shek. XVIII-XIX, në njësinë thelbësore të këtyre vendbanimeve, shfaqen si një dukuri krahasimisht e hershme, posaçërisht në hapësirën europiane. Me këtë duam të vemë në dukje se vlerësimi i ansambleve, deri në shumësinë e tyre, pra në Qendrat Historike, apo mbarë qytetet e lashtë me vlera, të cilët përgjithësisht i përkasin urbanistikës spontane, në dallim prej planifikimit, e vendosin Shqipërinë në radhën e parë të vendeve me sensibilizim të spikatur për këto vlera.

Në bashkësinë e gjerë të dëshmive të së kaluarës së etnive të ndryshme, krahas gjuhës dhe historisë, një vend të rendësishëm zë trashëgimia materiale dhe veçanërisht ajo ndërtimore. Në këtë të fundit, së pari vëmendja është drejtuar ndaj veprave të veçanta dhe, më pas ndaj bashkësisë së tyre, duke vlerësuar kështu dukurinë urbanistike, si realizim i mënyrës së bashkëjetesës dhe bashkëmarrëdhënive ndërmjet njësive të ndryshme ndërtimore, që formojnë qendrat e banuara.

Koncepti Qendër Historike, i cili tashmë ka fituar qytetarinë ndërkombëtare, vetëm për meritë të UNESCO-s, në Shqipëri rreth viteve 60 të shek. XX, është njohur me sinonimin qytet-muze, me gjasë të huazuar prej përvojës bullgare të fushës. Sot me Qendër historike, konsiderohet një vendbanim qytetar apo fshatar, i cili ruan vlera historiko-kulturore të shkallëve të ndryshme të autenticitetit. Theksimi i parësisë së vlerave historike lidhet natyrshëm me të vërtetën se çdo dëshmi materiale e së kaluarës, krahas vlerave krijuese apo artistike në vetvete, në radhë të parë vlerësohet si dëshmi historike e prekshme e një periudhe të caktuar të një etnie, pra me vlera edhe për historinë e mbarë njerëzimit. Ky i fundit, prej aferive historike-kulturore tepër të dallueshme në fazat e para të zhvillimit njerëzor, eci në rrugën e theksimit të dasive historiko-kulturore dhe në kontekstin e sotëm, natyrshëm po shkon drejt njësimit, apo globalizmit, siç pohohet rëndom. Do të thoshim se edhe për arsye të kësaj dukurie, padyshim objektive, pra vetardhëse natyrshëm, për shumë motive, rriten arsyet për ruajtjen e dëshmive historiko-kulturore të hapësirës urbanistiko-ndërtimore, pra Qendrave historike, për të njohur rrjedhën e rrugëtimit shumëshekullor të njerëzimit, thelbit të çdo kërkimi historik.



Pamje e qëndrës së Beratit

Siç përmendim Shqipëria, besojmë në kuadrin e zgjerimit të konceptit irracional dhe prapavajtës për kohën, atë të autarkisë, edhe në fushën kulturore dhe më ngushtas në atë të trashëgimisë kulturore, tregoi kujdes për këto vlera. Është rasti për të theksuar ndihmesën themelore të arkitektit Gani Strazimiri, i cili që rreth viteve 1960 iu kushtua plotësisht trashëgimisë kulturore të paluajtshme. Në sajë të punës sistematike hulumtuese të G. Strazimirit, Këshilli i Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, me vendim Nr. 172 datë 02.06.1961 shpalli qytete-muze dhe vuri në mbrojtje shtetërore të veçantë qytetet e Gjirokastrës, Beratit, pjesën e vjetër dhe nëntokën e qytetit të Durrësit dhe pazarin e vjetër të qytetit të Krujës. Ky vendim, pa dyshim me vlera madhore kulturore, shënoi një ngjarje të rëndësishme për të ardhmen e monumenteve shqiptarë, pas listës së parë të monumenteve të kulturës në mbrojtje të shtetit të vitit 1948. Vlen të theksohet se në këtë vendim krahas qyteteve të Gjirokastrës dhe Beratit, në cilësinë e qyteteve muze, term i cili më pas ndërkombëtarisht u emërtua Qendër historike, përfshiheshin dhe dy kategori bashkësish monumentesh pazaret dhe nëntoka, e cila ruan objekte arkeologjike të lëvizshme dhe palëvizshme.

Menjëherë pas vënies në mbrojtje të Qendrës historike të Beratit u hartua rregullorja mbi administrimin e saj. Rregullorja bashkëshoqërohej me zonifikimin përkatës. Kjo rregullore, në radhë të parë sepse mbështetej mbi kritere të shëndosha metodike i qëndroi kohës në parimet e saj themelore dhe praktikisht qe pikë referimi për veprimtaritë e mëtejshme në fushën e mbrojtjes së njësive të ndryshme të bashkësive të monumenteve. Qendra historike e Beratit u nda në tri zona sipas vlerave që ruante secila prej tyre.

Zona muze, më e rëndësishmja, ruante monumente të kategorisë së parë dhe të dytë. Zona e mbrojtur, pranë apo më saktë në vazhdim të zonës muze, me vlera më të vogla se zona muze, kryesisht për shkak të humbjes së ndjeshme të autenticitetit të vlerave urbanistiko-arkitekturore, ruan vetëm monumente të kategorisë së parë. Zona e lirë është pjesa tjetër e qytetit, e cila ruan gjithashtu vetëm monumente të kategorisë së parë.

Vetë monumentet në varësi të vlerave, kryesisht tipologjike, arritjeve arkitekturore dhe shkallës së autenticitetit ndahen në dy kategori: të parë dhe të dytë.

Monumentet e kategorisë së parë ruhen në mbarë përbërësit kompozicionalë, formulimin arkitekturor të pamjeve të jashtme dhe të brendshme të teknikës dhe materialeve të ndërtimit. Monumentet e kategorisë së dytë, të cilët ngrihen vetëm në zonën muze, ruhen në volumet e tyre dhe pamjen e jashtme, ndërsa në brendësi, kompozimi dhe trajtimi arkitekturor, mund të ndryshohet në përputhje me kërkesat e jetës së sotme. Rregullorja trajton dhe çështje të restaurimit dhe mirëmbajtjes së monumenteve, administrimit të Qendrës historike, probleme të financimit të ndërhyrjeve restauruese etj. Kjo rregullore, në parimet e saj themelore i qëndroi kohës dhe ajo që vlen të theksohet është se këto parime janë në

DO NOT COPY

DO NOT COPY

përputhje me dokumentet ndërkombëtare të fushës, duke filluar prej kartës së Venecies të vitit 1964, të cilën e nënshkroi dhe përfaqësuesi i delegacionit shqiptar, i cili mori pjesë në këtë Kongres dhe mbarë dokumentat e tjerë ndërkombëtarë mbi çështje të ndryshme të problemit sa të gjerë aq edhe në ecuri të koncepteve metodikë dhe tekniko-ekzekutivë.

Vënia në mbrojtje shtetërore e Qendrave historike të Beratit dhe Gjirokastrës u pasua me veprimtari sistematike për gjurmimin, dokumentimin dhe vënien në mbrojtje të banesave qytetare në cilësinë e monumentit të kulturës. Kriteret themelore në këtë veprimtari hulumtuese dhe përzgjedhëse qenë ata tipologjikë, shkalla e autenticitetit të këtyre veprave, vlerat arkitekturore dhe teknike, vendndodhja etj.

Veprimtaria për rritjen e numrit të Qendrave historike, pas vënies në mbrojtje të dy të parave, pati një farë pauze, për dy arsye bashkëplotësuese, procesit në formim e sipër të kuadrit vlerësues të monumenteve dhe mundësive të pakta financiare për të përballuar këtë veprimtari dhe më tej atë të ndërhyrjeve restauruese për ruajtjen e vlerave të këtyre dëshmive historiko-kulturore.

Në vitin 1970, u vu në mbrojtje shtetërore Qendra historike e qytetit të Korçës, e cila përfshinte pjesë të qytetit të vjetër, kompozuar spontanisht, pazarin e gjerë të qytetit dhe pjesën, krahasimisht të re të qytetit, filluar të ndërtohet rreth mesit të shek. XIX sipas sistemit të njohur të Hipodamit. Në vitin 1976, u vu në mbrojtje zona e banuar brenda mureve rrethues të kalasë së Elbasanit, rindërtim i shek. XV mbi një kastrum romak të rrënuar, Qendër historike kjo me vlera të veçanta. Viti 1980 shënon vënien në mbrojtje të Qendrës historike të Shkodrës dhe Vlorës. Është për t'u theksuar si dukuri e rritjes profesionale të specialistëve shqiptar, të cilët po përvetësonin praktikisht parimin e njohur se çdo periudhë, pavarësisht kohës, përfaqësohet me vlerat e saja dhe ato, qofshin edhe ndërtimore bashkëkohore, duhen vënë në mbrojtje sipas kritereve të njohura.

Në Shkodër u vunë në mbrojtje tre rrugë, duke filluar prej asaj që emërtohej "Dugajet e reja", pra pazari i ri, rruga në lindje të saj si dhe një rrugicë në veri të kësaj të fundit. Në Vlorë, u vu në mbrojtje rruga "Justin Godard", ndërtim i fillimit të shek. XX, në qendër të qytetit. Në vitin 2000, u vu në mbrojtje Qendra historike e Tiranës, ndërsa është përfunduar zonifikimi i Qendrës historike të Durrësit, i cili është në procesin e miratimit në instancat përkatëse.

Ngjarjet e viteve 1990, të cilat prunë zëvendësimin e diktaturës komuniste në Shqipëri, u pasuan me ndryshime, do të thoshim thelbësore në mënyrën e jetesës, sistemin e administrimit të vendit etj. Për t'i paraqitur ngjarjet me vërtetësi, duhet të pohojmë se, sipas nesh, për arsye të synimit për autonomi kulturore, ashtu siç synohej edhe në fusha të tjera, me vetëmbylljen rrënuese për ecurinë e vendit, në fushën e vlerësimit të monumenteve veprimtaria deri në vitet 1990, me përjashtime të përfillshme si rrënimet e monumenteve të kultit në vitin 1967, ka shënuar arritje të prekshme.



Pazari i Shkodrës

DO NOT COPY



Qendra Historike Vlorë

Siç dihet, llojshmëria e monumenteve të kulturës, në grupet e mëdhenj, ndërtime mbrojtëse, kulti, shoqërore dhe banesa, ka ndërndikime të ndryshme lidhur me ndryshimin e formës së drejtimit politiko-shoqëror të vendit. Kështu bashkësia, kryesisht e banesave, në kategorinë Qendër historike, është e lidhur drejtpërdrejt me llojin e drejtimit politiko-shoqëror të vendit. Sistemi demokratik, drejt të cilit po ecet, ka prurë ndryshime të rëndësishme në mënyrën e jetesës dhe në rritjen e mundësive financiare që prej ndryshimeve në banesa deri te ringritja e tyre pas rrënimit tërësor, me kompozim të ri. Në këto rrethana, pronarët, apo përdoruesit e banesave-monument, në Qendrat historike dhe jashtë tyre, shfaqen të pakënaqur me gjendjen, veçanërisht ata që zotërojnë, apo banojnë në monumentet e kategorisë së parë. Një farë lehtësimi financiar për shpenzimet e ndërhyrjeve restauruese dhe turizmi kulturor, ende tepër fillestar dhe për pasojë pa të ardhura financiare të përfillshme, të cilat nuk përmirësojnë gjendjen, tash për tash, do të thoshim problematike për rastin në shqyrtim. Ashtu siç nuk pritej, pas viteve 1990, zbatimi i ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në fushën e trashëgimisë së paluajtshme shfaqet me mangësi të theksuara në zbatimin e tij, siç e tregojnë prektas shtesat e volumeve, ndryshimet në pamjet e jashtme, madje edhe ndërtimet e reja në hapësirat e Qendrave historike. Më tej, në mangësitë e shfaqura në këtë periudhë, e cila emërtohet e tranzicionit, do të theksonim pakësimin, madje të ndjeshëm të ndërhyrjeve restauruese. Në këtë fushë një dukuri tejet negative duhet kundruar riformulimi i sistemit administrativ për vlerësimin e monumenteve me shkëputjen e institucioneve rajonale prej Institutit të Monumenteve dhe më tej me praktikën e zbatimit të punimeve të restaurimit prej ndërmarrjesh ndërtimi, me një punonjës të specializuar të fushës, i cili licensohet.

Në gjendjen e re, madje në shumë plane, gjithë duke iu përmbajtur sa më ngushtas parimeve të vlerësimit të Qendrave historike në përputhje me normat ndërkombëtare, aq më tepër kur tashmë dy qendrat tona më të rëndësishme Berati dhe Gjirokastra, janë cilësuar "Pasuri botërore", është e domosdoshme që të rishikohet qëndrimi kundrejt këtyre vlerave universale. Në bazën e këtij qëndrimi, padyshim do të jetë ruajtja e këtyre vlerave të papërsëritshme historiko-kulturore, duke u përfshirë njëherazi ato në jetën e sotme, në zhvillim e sipër, madje me ritme të shpejta, pa cënuar vlerat për të cilat ato janë

DO NOT COPY

vënë në mbrojtje. Ky synim urdhërues është kushti i patjetërsueshëm për të dekurajuar ndërhyrjet dëmtuese të shkallëve të ndryshme të cilat duhet të zvogëlohen deri në maksimum, në të mirë të jetëgjatësimit të kësaj pasurie me vlera të mirëfillta të dëshmisë autentike historike. Natyrisht që gjithë duke mos cënuar parimet bazë të ligjëruara, praktikisht dhe institucionalisht, ende ruhen hapësira për rishikimin e problematikës komplekse të vlerësimit të Qendrave historike, në mënyrë që të lehtësohet bashkëpërfshirja e këtyre vlerave në jetën e sotme dhe më tej, premisë e patjetërsueshme e ekzistencës së Qendrave historike aspak si relike të së kaluarës. Ruajtja e kompleksëve ndërtimore, kryesisht të banimit, apo Qendrave historike, në funksionin fillestar, apo të tjerë që nuk cënojnë vlerat, është në të vërtetë një sakrificë të cilën e bën shoqëria njerëzore, që prej asaj kohe kur ajo, apo personalitetet kulturorë të saj, shohin te këto vlera dëshmi të papërsëritshme të së kaluarës, pra të historisë së një kombi dhe më gjerë të bashkësisë njerëzore. Për këtë arsye madhore, vështirësitë që bie ky qëndrim, bëhen përherë e më të pranueshme, sepse të kuptueshme, përherë e më tepër prej shtresave të ndryshme të popullsisë duke filluar së pari prej intelektualëve. Me këtë pikëshikim ruajtja e Qendrave historike dhe pasurive kulturore të paluajtshme në përgjithësi, nuk është një çështje që lidhet vetëm me një rreth të ngushtë profesionistësh të fushës së vlerësimit të pasurive kulturore. Vlerësimi i Qendrave historike, bëhet më i efektshëm dhe përherë dhe më pak problematik paralelisht me njohjen e kësaj trashëgimie prej masës në rritje, shtresave përherë dhe më të shumta të qytetarëve, pasardhësve të vërtetë të autorëve të kësaj pasurie, vlerat e së cilës rriten me kalimin e kohës.

Në kushtet e reja politiko-shoqërore në të cilat është përfshirë Shqipëria, për arsye të kuptueshme,



Qendra Historike Gjirokastër

është i nevojshëm një qëndrim do të thoshim disi i përmirësuar, i cili parakupton një interpretim më të thelluar dhe më praktik për ruajtjen e këtyre dëshmive, natyrisht pa cënuar vlerat e papërsëritshme autentike të tyre. Në këtë kontekst, qëndrimi kundrejt vlerave të Qendrave historike, pjesë e pandashme e tërësive të qendrave të banuara qytetare, apo fshatare, duhet parë më në lidhje pikërisht me bashkëjetesën e domosdoshme të tyre në jetën në zhvillim, madje me ritme të shpejta. Bashkëpërputhja maksimalisht e mundimshme ndërmjet trajtimit urbanistiko-arkitekturor të Qendrave historike dhe trajtimit bashkëkohor, në ndryshim të vazhdueshëm,

përbën problemin thelbësor të ruajtjes dhe për pasojë kryerjes së funksionit historiko-dokumentar të këtyre njësive ndërtimore të së kaluarës.

Për të qenë më konkret po ndalemi në disa interpretime disi të ndryshme nga ato të derisotmet, lidhur me kriteret e vlerësimit të këtyre qendrave, natyrisht pa cënuar thelbin e parimeve tashmë të konsoliduara për vlerat kulturore të këtij lloji në mbarë botën dhe të pranuara prej kohësh edhe prej institucioneve të shtetit shqiptar.

Një prej çështjeve të rëndësishme, lidhur me ruajtjen e vlerave të Qendrave historike, apo më saktë të autenticitetit të tyre, është ajo e qëndrimit ndaj eventualitetit të ndërtimeve të reja, apo prishjes së ndërtimeve pa vlera. Ashtu si në përgjithësi edhe në fushat paralele, kodifikimi i qëndrimeve për këtë, pra zgjidhjet e prera, janë problematike, sepse në praktikë shfaqen një mori rastesh, secili prej të cilëve kërkon trajtim të veçantë, në kuadrin e parimeve të përgjithshme. Në rregulloren mbi administrimin e qytetit-muze të Beratit të datës 02.06.1961, në nenin 11 të saj, lidhur me këtë çështje vendosej: "Në zonën muze nuk lejohet asnjë prishje ose ndërtim i ri, pa lejen e Universitetit shtetëror të Tiranës (Instituti i historisë e gjuhësisë)". Ky përcaktim pra, nuk përjashton prishjen, apo ngritjen e ndërtimeve të reja, por vetëm detyron marrjen e lejes prej institucioneve përkatëse. Me riparimet e mëvonshme të rregulloreve të Qendrave historike, në përputhje me ripunimet e ligjit të Trashëgimisë kulturore, në mjaft raste, pati qëndrime të prera për mos ndërtimin e ngrehinave të reja në Qendrat historike. Sot, me përshpejtimin e vrullshëm të mënyrës së jetesës, kjo çështje kërkon domosdoshmërisht një shikim më të thelluar, mbështetur tashmë në parimet e restaurimit dhe përvojën e derisotme. Ne mendojmë se ndalimi i prerë i ndërtimeve të reja është tepër kategorik dhe mund të kompromentojë, madje rëndë, kushtet e jetesës në këto hapësira qytetare, apo fshatare. Kategori të reja ndërtimesh shoqërore i shtohen llojshmërisë së ndërtimeve, disa prej të cilave nuk mund të realizohen në volumet e monumenteve të kategorisë së dytë. Prandaj, mendojmë se në hapësira të lira të Qendrave historike mund të lejohen, si raste të veçanta, ndërtime të reja për shërbime të domosdoshme jetësore. Kuptohet se ndërtimet e reja përsa i përket volumit, trajtimit arkitekturor të jashtëm dhe teknikës së ndërtimit duhet të jenë sa më afër me atë tradicionalen. Lidhur me prishjet e ndërtimeve ekzistuese, në momentin e vënies në mbrojtje të Qendrave historike, shfaqen mjaft shembuj tejet negativë, përgjithësisht ndërtime të viteve të pas Luftës së Dytë Botërore. Kështu përmendim blloqe banime si bashkësi apartamentesh, shkolla, mjedise shoqërore etj., të cilat nuk kanë respektuar aspak mjedisin urbanistiko-arkitekturor përreth, duke cënuar kështu rëndë njësinë kompozicionale pra një prej vlerave kryesore të Qendrave historike. Këto ndërtime shkallërisht duhen rrënuar dhe në vend të tyre të ringrihen ndërtesat pararendëse, shpesh të dokumentuara me fotografi, ose të ngrihen ndërtime të reja në frymën kompozicionale dhe arkitekturoro-teknike të shembujve përreth. Në disa Qendra historike, ndeshen edhe hapësira trojesh ndërtimi boshe, të cilat të mbetura të tilla, për arsye të ndryshme, cënojnë njësinë e ansambleve të Qendrave historike prandaj mendojmë se edhe në këto raste duhet që mbi këto troje të ngrihen ndërtime të reja sipas kritereve të përmendura më sipër, për raste të ngjashme. Brenda së njëjtës temë, ndeshim edhe një shfaqje tjetër, atë të ndërtimeve të rrënuara pjesërisht, apo edhe të themi plotësisht, duke mbetur vetëm themelet. Në vijim të arsyetimit për rastet pararendëse, edhe në këtë rast duhet bërë

DO NOT COPY

DO NOT COPY

rindërtimi sipas kritereve të njohura. Së fundi vjen në përfillje rasti kur në ndërtesa me vlera, para vënies në mbrojtje të Qendrës historike, janë kryer tjetërsime cënuese të vlerave origjinale të veprave në elemente arkitekturorë të pamjeve të jashtme, apo shtesa volumesh të cilët cënojnë rëndë kompozimin origjinal. Në këto raste, duhet që të kryhet ritrajtimi i elementeve arkitekturore të tjetërsuara dhe, sipas rastit të hiqen volumet e shtuara, apo të ritrajtohen ata. Natyrisht rastet e ndërtimeve pa leje të çdo lloj kategorie dhe trajtimi, përbëjnë shkelje dhe marrin zgjidhje në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërtimet bashkëformuese të qendrave historike, përgjithësisht banesa, krahas ndërtimeve të kultit dhe në disa raste dhe fortifikimeve, këta të fundit për arsye të njohura, jashtë funksionit fillestar, vazhdojnë të shfrytëzohen. Përgjithësisht banesat ruajnë të njëjtin funksion, me përjashtime të rralla të shembujve me vlera të spikatura arkitekturore apo historike, pra të lidhura me ngjarje apo figura madhore në rrjedhë të kohës, të kthyer në muze. Në disa raste edhe kisha me vlera të rëndësishme, kryesisht në pikturat murale, për të mos krijuar rrethana për dëmtimin e tyre, kthehen në qendra të vizitueshme, madje në muze të mirëfilltë. Ndërtimet mbrojtëse, përgjithësisht mjaft të rrënuara, krahas mureve rrethues, në gjendje të ndryshme teknike ruajnë edhe ambjente, në gjendje të shfrytëzueshme, pas ndërhyrjesh konservuese. Në këta ambiente mund të ngrihen muze apo lokale shërbimi, duke kryer edhe shtresa të kthyeshme, pa cënuar strukturat origjinale, për të gjallëruar dhe bërë më komod frekuentimin e këtyre ndërtimeve me vlera të veçanta. Krahas, në hapësirat, brenda mureve rrethues, mund të ngrihen me teknika të kthyeshme lokale shërbimi të llojeve të ndryshme, duke u kujdesur që ata të mos dëmtojnë rëndë pamjen e monumentit.

Qendrat historike për vetë karakterin e tyre ruajnë krahas vlerave arkitekturore edhe vlera urbanistike. Këto të fundit shfaqen si në përbërësit kompozicionalë, ashtu edhe në ata të teknikës së ndërtimit me të cilat janë realizuar këta elemente, ndër të cilët, rrugët dhe sheshet përbëjnë dyemërshin kryesor. Kuptohet se struktura urbanistike e Qendrave historike duhet ruajtur në të dy përbërësit e saj, ata kompozicionalë dhe teknikat dhe materialet origjinale me të cilat janë realizuar ndërtimet në këto Qendra. Por edhe në këtë rast paraqiten përjashtime, do të thoshim të detyrueshme dhe të pashmangshme, sepse përndryshe do të kompromentonin cënimin e vlerave të rëndësishme të Qendrave historike. Në disa rrethana, segmente sa më të vogla të rrjetit rrugor mund të pësojnë ndryshime në trasenë e tyre, për shkaqe madhore të shërbimeve zjarrfikëse, apo për të mundësuar lëvizjen më të lehtë të vizitorëve etj. Rikthimi në teknikat tradicionale të shtrimit të rrjetit rugor, të transformuar apo dëmtuar pjesërisht, është gjithashtu i nevojshëm, natyrisht duke përfshirë edhe konservimin e mureve rrethues të hapësirave të objekteve të ndryshëm ndërtimor, bashkëformues të Qendrave historike, portat e jashtme etj.

Qendrat historike në shkallë të ndryshme, sipas llojit të trojeve mbi të cilat ngrihen, fushorë apo kodrinorë, bashkëpërfshijnë edhe bimësi të lartë, apo të ulët të llojeve të ndryshme në lidhje me kushtet rajonale klimaterike. Kjo lloj bimësie është pjesë përbërëse dhe më tej karakterizuese për Qendrat historike me llojin e saj dhe bashkëmarrëdhëniet me elementët e ndryshëm ndërtimor, përbri të cilave ajo bashkëpërfshihet. Për natyrën e saj, bimësia ndryshon krahasimisht shpejt, për të arritur, me shkallë të ndryshme shpejtësie, në vetërrënim. Për ruajtjen e tipareve tradicionale të këtij përbërësi, do të thoshim natyror, megjithëse të kultivuar prej dorës njerëzore,

është e nevojshme që për këtë gjelbërim të tregohet kujdes i vazhduar dhe në rast të humbjes së tij ai të zëvendësohet me të njëjtin lloj, mbjellë në të njëjtin vend. Gjelbërimi i kultivuar i cili shoqëron Qendrat historike në vendin tonë është një shenjë kulture dhe njëherazi dëshmi e saj dhe si i tillë për të duhet treguar e njëjta përkujdesje si për zhvillimet urbanistike dhe ato ndërtimore, në hapësirat në të cilat ato shtrihen.

Qendrat historike, si në Shqipëri ashtu dhe në mbarë botën, kanë problematika të ngjashme mbase deri të njëjta, e vërtetë e cila gjen shprehje të drejtpërdrejtë në parimet për vlerësimin e tyre në rekomandime dhe rregulla ndërkombëtare.

Gjithë duke qenë konsideratat e mësipërme të vërteta, do të thoshim të pandryshueshme në thelbin e tyre, prapëseprapë afëritë në karakteristikat thelbësore nuk duan të thonë njësim i plotë i vlerave të tyre në planet tipologjike, kohorë, ato të shkallës së autenticitetit etj, si në planin e gjerë ndërkombëtar, madje dhe atë kombëtar. Kjo e vërtetë gjen shfaqjen e saj edhe në realitetin shqiptar të bashkësisë së Qendrave historike, të cilat krahas të përbashkëtave thelbësore shfaqin dhe veçanti, madje edhe qartësisht të dallueshme. Këto rrethana kanë bërë të pamjaftueshëm ligjin për Trashëgiminë kulturore si bartës të zgjidhjeve të problemeve të ndryshme që paraqisin këto Qendra. Për këtë arsye çdo Qendër historike vlerësohet dhe administrohet sipas rregulloreve përkatëse, të cilat, gjithë duke qenë në përputhje me ligjin për Trashëgiminë Kulturore, shfaqin veçantitë e çdo qendre dhe zgjidhjet e duhura në përputhje me këto veçanti. Është rasti për të vënë në dukje se hartimi i këtyre dokumentave të rëndësishme teorikë-praktikë, me zbatueshmëri të detyrueshme, parakupton njohjen, madje të thellë, të këtyre vlerave në shumë plane dhe në përputhje me këtë njohje jepen zgjidhjet e duhura për ruajtjen e tyre si dëshmi historiko-kulturore. Ndryshimet e këtyre dokumentave lidhen me thellimin e njohjes së këtyre vlerave, të rejat në konceptet e vlerësimit të monumenteve, si dhe me evolucionin, të themi natyror, të procesit të konsumit kohor të tyre në rrjedhë të kohës, kryesisht për shkak të shfrytëzimit të tyre për funksione të ndryshme të veprimatrive jetësore.

Siç kemi përmendur, Qendrat historike janë ansamble të cilët megjithëse ruajnë vlera të së kaluarës në planet urbanistiko-arkitekturore, banorët e tyre jetojnë në to, duke pranuar edhe një sërë privacionesh, por natyrisht pa tejkaluar disa norma, sepse përndryshe do të ktheheshin në mënyrën mesjetare të jetesës. Prandaj për të zbutur disi mospërputhjet me ndërtimet komode bashkëkohore, Qendrat historike domosdoshmërisht furnizohen me ujë, energji elektrike, pajisen me rrjetin e ujërave të bardha dhe të zeza dhe rrjetin telefonik. Vendosja e këtyre rrjeteve, parakupton cënimin e rrjetit rrugor dhe eventualisht të hapësirave rreth ndërtimeve, si një kërkesë urdhëruese për bashkëpërfshirjen e këtyre qendrave në hapësirën e qytetit si njësi funksionale. Në këto ndërhyrje synohet që cënimet të jenë sa më të vogla, si dhe që në të njëjtët kanale të përfshihen mbarë bartësit e ujërave, apo të rrjetit transmetues, duke u mbuluar këto kanale me të njëjtën teknikë në rrafshin e rrugës në të cilën hapen. Në këto kanale duhen përfshirë edhe tubacionet e rrjetit të ujërave për zjarrfikje. Kuptohet se në Qendrat historike mbi troje ndijshëm të pjerrët dhe për pasojë me rrugë të ngushta, me disnivele të mëdha dhe plot kthesa, madje të forta, pamundësohet kalimi i automjeteve zjarrfikës. Gjithashtu ndërtimi i parkimeve për automjete në këto Qendra përjashtohet, sepse është i pamundur, ndërsa në Qendrat historike mbi troje të rrafshëta, zgjidhja e kësaj kërkese paraqitet prob-

DO NOT COPY

DO NOT COPY

lematike, kryesisht për shkak të nevojës së ndërtimit të hapësirave tepër të mëdha të dyerve. Megjithkëtë, në disa Qendra si Shkodra, portat e jashtme janë të mëdha për të mundësuar hyrjen e qerreve, duke lehtësuar zgjidhjen e problemit.

Qendrat historike, ashtu si përgjithësisht, rrethohen prej një hapësire me madhësi të ndryshme, e cila shërben për të zbutur kalimin prej saj në pjesën, të themi të lirë të qytetit, në kuptimin të pakufizuar prej detyrimesh urbanistiko-arkitekturore. Që me shpalljen e Beratit dhe Gjirokastrës në mbrojtje shtetërore, në cilësinë e qyteteve-muze, në Shqipëri u vu në jetë parimi i ndarjes së këtyre qendrave, ashtu si dhe më pas, në dy njësi përbërëse, zonën-muze dhe zonën e mbrojtur, për arsyet e përmendura më lart. Sot, në praktikën ndërkombëtare zona-muze është emëruar Qendër historike, ndërsa zona e mbrojtur zonë tampon. Kjo terminologji është përvetësuar edhe në Shqipëri, me rastin e paraqitjes së dokumentacionit për shpalljen Pasuri Botërore të Gjirokastrës dhe Beratit. Në zonën e mbrojtur, apo tampon, kriteret e ruajtjes së ansambleve formues të saj janë dukshëm më lejimtarë sesa në Qendrën historike dhe konkretisht ndryshojnë prej një qendre nga një tjetër, sipas shkallës së vlerave urbanistiko-arkitekturore që ato ruajnë. Besojmë se kjo ndarje, tashmë koncepsion i kristalizuar dhe i ndërkombëtarizuar, do t'i qëndrojë kohës me racionalizmin e vet.

Çdo periudhë shfaqet me tiparet e veta në mbarështrimin e qendrave të banuara, qytetare dhe fshatare. Si të tilla ato duhen ruajtur në hapësira të duhura, sa dëshmi treguese, aq edhe racionale, për të mos zënë tej mase pjesë të qendrave të banuara. Duke qenë se procesi i veprimit të Qendrave historike është krahasimisht i vonë, ai ka synuar të vërë në mbrojtje, si në Shqipëri dhe më gjerë, ato Qendra historike që i përkasin kryesisht shek. XVIII-XIX. Kohët e fundit, natyrshëm, është rritur interesimi historiko-kulturor për dëshmi të shek. XX, si për monumente të veçantë, ashtu edhe për Qendra historike, apo zona krahasimisht të gjera, kryesisht në qendra qytetare. Është rasti për të theksuar se ndërsa në qytetet tona, veprimtaria për vënien në mbrojtje të Qendrave historike ka qenë e frutshme, për vendbanimet fshatare, dëshmi të barasvlefshme urbanistiko-arkitekturore të pjesës më të madhe të popullsisë, sa më larg shtyhemi në kohë, nuk është kryer asnjë veprimtari për vënie në mbrojtje bashkësi banimi me shkallë të përfillshme vlerash dhe autenticiteti. Kjo veprimtari duhet që të jetë produktive sa më parë, edhe për arsye se vendbanimet fshatare shqiptare janë gjurmuar, thuajse shterrshëm, gjatë viteve 1974-1978, për vënien në mbrojtje të ndërtimeve fshatare me vlera. Hulumtuesit e zonave përkatëse duhet të veprojnë shpejt, natyrisht sipas programesh të përgatitura dhe udhëhequra prej institucionit kompetent të fushës, Institutit të Monumenteve të Kulturës. Çdo vonesë, apo më keq shpërfillje e kësaj veprimtarie do të kishte pasoja të pariparueshme për historinë e kombit tonë dhe më gjerë.

Shqipëria, sot për vlerat unikale universale, ka në mbrojtje në cilësinë e Pasurisë Botërore pëveç Butrintit edhe dy Qendrat e shquara historike të Beratit dhe Gjirokastrës, të cilat krahasimisht herët janë vënë në mbrojtje, duke iu nënshtruar një veprimtarie sa të gjerë aq edhe sistematike vlerësuese, veçanërisht deri në vitet 1990. Më pas, praktikisht këto qendra si në përgjithësi monumentet e kulturës, pësuan një shkujdesje prej organeve qeveritare, vendore apo qendrore, përgjegjëse për ruajtjen e këtyre vlerave, në planet financiare dhe administrative. Minimizimi i ndërhyrjeve resaturuese u shoqërua krahas dëmtimeve në rritje të vlerave autentike të monumenteve edhe me ndërtime të shumta pa leje, pra në kundërshtim me ligjin, duke prurë pasoja të

rënda dëmtuese të vlerave të këtyre qendrave. Krahas Beratit dhe Gjirokastrës, kjo gjendje qe e njëjtë edhe me Qendra të tjera historike. Themi qe, sepse vitet e fundit vihet re shtimi i përkujdesjeve për Qendrat historike dhe monumentet në përgjithësi, megjithatë pa arritur ende në përmasat dhe nivelin e duhur të cilat i kërkon urdhërueshëm gjendja e këtyre vlerave unikale me ngarkesa shumëvlerëshe historiko-kulturore.

Qendrat historike, ashtu si monumentet e kulturës në përgjithësi, si dëshmi historiko-kulturore janë objekt studimi shumëplanësh. Më konkretisht, ato studiohen në rrafshet urbanistikë, arkitekturorë dhe teknikë, duke synuar karakterizimin e tyre në këta përbërës cilësorë. Krahas, rëndësi të veçantë paraqet studimi i vendosjes në kohë të ndërtimeve, që formojnë Qendrat historike, si faktor i rëndësishëm për karakterizimin e këtyre vlerave lidhur me rrethanat e zhvillimit të shoqërisë në rrjedhë të kohës. Këto studime, i shërbejnë si restaurimit, ashtu dhe karakterizimit të tipareve historiko-shoqërore të periudhës kohore së cilës i përkasin këto vepra. Kështu për Qendrat historike, ashtu si monumentet në përgjithësi, vihen në rolin e tyre themelor të dëshmitarit të historisë së periudhës së cilës i përkasin, duke plotësuar ndijshëm mungesën e dokumentacioneve të kohës për arsye të njohura. Krahas studimeve që i drejtohen rretheve profesioniste, brenda dhe jashtë vendit, të cilat shohin dritën e botimit në monografi dhe revista shkencore, është e domosdoshme që të botohen edhe vepra me karakter popullarizues, të cilat gjithë duke thënë të vërtetat i shmangen argumentimit profesional. Këto vepra kanë vlera shumë të rëndësishme sepse afrojnë qytetarët me këto krijime, duke lehtësuar problematikën e rujatjes së tyre, e cila është vërtetë e tillë për shkak të zhvillimit, madje të vrullshëm të mënyrës së jetesës, e cila pasqyrohet edhe në tiparet e banesave dhe faktorëve që ndikojnë në zhvillimin urbanistik. Botimet në gjuhë të huaja, duke trajtuar edhe aspektin krahasues në hapësirë dhe kohë, paraqesin gjithashtu një fushë të rëndësishme për njohjen e këtyre vlerave, të cilat në disa aspekte i përkasin mbarë kulturës njerëzore, sa të ndryshme aq edhe të njësuar në tiparet themelore për periudha të caktuara historike.

Zhvillimi i shoqërisë njerëzore në dhjetëvjeçarët e fundit, është i lidhur edhe me përmirësimin e kushteve ekonomike. Pasqyrim i këtij realiteti duhet mbajtur edhe rritja, madje e shënuar, e turizmit dhe veçanërisht e atij kulturor, i cili lidhet me vizitat në monumentet në përgjithësi, duke përfshirë dhe Qendrat historike. Përparësitë e turizmit kulturor janë të dukshme në disa drejtime. Së pari, vjen në përputhje e vërteta se vrojtimi në vend i Qendrave historike i jep vizitorit të dhëna dhe ndjesi shumëfish më të mëdha dhe më të sakta sesa çdo botim, apo paraqitje e këtyre vlerave me mjetet e sotme të publikimit masiv. Së dyti, vrojtimi i Qendrave historike, eventualisht qëndrimi edhe një, apo disa ditor në Qendra të rëndësishme është i lidhur me plotësimin e nevojave të përditshme jetësore, të cilat kryhen brenda hapësirave të këtyre Qendrave, duke u mundësuar pronarëve të tyre të ardhura, do të thoshim plotësisht të merituara, duke pasur një sërë privacionesh për shkak të lashtësisë së ndërtimeve në këto hapësira.

Kjo rrethanë e bën më të lehtë pranimin prej pronarëve të një sërë vështirësish që rrjedhin prej ndalimit të ndryshimeve në ndërtimet e Qendrave historike, për pasojë mospërfitimit prej ecurisë së vijueshme për përmirësimin e kushteve të jetesës.

Kultura shqiptare përmbledh natyrshëm krijimtarinë dhe më gjerë vlerat e shumëllojshme të krijuara prej etnosit tonë iliro-arbëror-shqiptar në shekuj. Për arsye të karakterit historik trojet shqip-

DO NOT COPY

tare, në shekuj deri vonë, kanë qenë "troje ngushtimi", siç pohon me të drejtë Prof. Eqerem Çabej. Për këtë arsye një pjesë e përfillshme e krijimtarisë shqiptare në shekuj, ruhet jashtë trojeve të Shqipërisë politike dhe tash së fundi edhe prej Republikës së Kosovës, në hapësirat e Malit të Zi, Maqedonisë dhe Greqisë, gjithashtu në ato të shqiptarëve në Italinë e Jugut. Pjesë e pandarë e pasurisë kulturore të krijuar prej etnosit tonë në shekuj, padyshim që këto vlera duhen identifikuar, dokumentuar, mbrojtur, studiuar dhe botuar. Për arsye të kuptueshme, është e domosdoshme që studiuesit shqiptar dhe kryesisht ata të Shqipërisë, të marrin nismën dhe të vazhdojnë atë sistematikisht për të vlerësuar këtë pasuri unikale, për vetë natyrën e saj, e cila nuk i përket vetëm etnosit tonë, por mbarë njerëzimit, pjesë e të cilit kemi qenë dhe përherë më ngushtas do të jemi. ■

DO NOT COPY

Literatura e Konsultuar

1. A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thoma - "Historia e arkitekturës shqiptare" (maket), Tiranë, 1980.
2. Gani Strazimiri - "Qytetet-muze në R.P. të Shqipërisë, qyteti-muze i Beratit" në "Studime historike", Tiranë, 1964/3
3. Gani Strazimiri - "Gjirokastra dhe vlerat e saj kulturore" në "Monumentet e kulturës në Shqipëri", Tiranë, 1975/1.
4. Emin Riza - "Vështrim mbi urbanistikën e qytetit shqiptar" në "Monumentet", Tiranë, 1977/14.
5. Emin Riza - "Ansamblet ndërtimorë të pazareve dhe restaurimi i tyre" në "Monumentet", Tiranë, 1978, 15-16.
6. Emin Riza - "Qyteti muze i Gjirokastrës", Tiranë, 1980. Ribotuar, Tiranë 2004.
7. Emin Riza - "Qytetet muze dhe vendi i tyre në jetën e sotme" në "Monumentet", Tiranë, 1988, 2 (36)
8. A. Baçe, A. Meksi, E. Riza - "Berati, historia dhe arkitektura", Tiranë, 1988. Botuar në gjuhën frënge, Tiranë, 1996.

Historic Centres as Cultural-Historic Testimony and their survive at the developed society

Prof. Dr. Emin Riza

DO NOT COPY

Historic Centres, as a touchable Cultural-Historic Testimony, with urbanity-architectonic values are a very late occurrence which begins after the Second World War if they are compared with other architectural monuments. These centres in Albania are mainly representatives of settlement which belong to the XVII-XIX centuries.

The Historic Centre concept was known in Albania around the years 1960 as Museum City but in nowadays this concept is well-known internationally because of UNESCO merit. Today the Historic Centre is considered a citizen or rural which preserve historic-cultural values of its authenticity different scales.

Albania shows attention for these values on the heritage and cultural field framework. The help of the architect Gani Strazimiri at field of the real estate cultural heritage was very touchable so because of his work the Council of Ministers of Popular Republic of Albania decide "Museum-Cities for Gjirokastra and Berati; old part and subterranean of Durres City and Kruja Bazaar under special state protection " with the decision Nr. 172 date 02.06.1961. This decision with great cultural values indicate a very important result for the future of the Albanian monuments after the first list of cultural monuments issued on the year 1948 which were under state protection.

Immediately after the state protection of Berat Historic Centre was compile the Administration Rule for this centre together with its areas. This rule was very useful during the years with its essential principles and also was as a referring point for protection of the different types of monuments. Historic Centre of Berat was dividing into 3 areas according to their preserved values.

Museum Area the most important one conserves the monuments of first and second category. Protected Area conserves the fewer assets than Museum Area because of loosing of the authentic urban-architectural values and preserve only first category monuments. Free Area is other part of the city which conserves only first category monuments.

There are two categories of monuments first and second because of their values which are according to their types and their authentic scale.

The first category monuments preserve: the compositional elements, architectural elements of exterior and for interior the technique and building materials.

The second category monuments preserve: their volumes and exterior façade, but for the exterior compositional elements and architectural treatment can be change in accordance with nowadays life aspects.

On the year 1970 the Historic Centre of Korca City was under state protection.

DO NOT COPY



Vlora

On the year 1970 was under protection the inhabited area inside the surrounding walls of Elbasan Castle which is a rebuild of destroyed roman castle.

Different political-sociological systems have different types of culture monuments which are protection religion, social and dwelling buildings. The categories of the dwellings at Historic Centres have direct links with different political systems. The system of nowadays has brought many changes on way of life, growing of financial possibilities and these have brought changes and rebuilt of dwellings-monuments at in or out Historic Centers. The owners there are not satisfy with the condition of their dwellings especially habitants who live at first category type of monuments.

The applying of law for the Protection of Cultural Heritage approved on 1990 was encountered with many problems which were: extending volumes, changes at facades and new buildings at spaces of Historic Centers. Negative phenomenon at this period were change of administrative system of valuation for culture monuments which has destroy the interdependence of regional branches with Institute of Culture Monuments and the other one was work for the restoring of monuments by building unexperienced companies which has at their staff a licensed field specialist.

The concernments state review for the value of these monuments at Historic Centres is needed to reshape in accordance with international standards in the situation when two important Historic Centers of Gjirokastra and Berati are classified as "World Heritage Asset".

Preserving of the Historic Centers and immobile cultural assets in general is a question which is linked with everyone who may it concern, not only by the professionals. Assessments of the Historic Centres is more effectively and less problematic when is growing the knowledge of the people and citizens about their values which are grower by the time passing.

One of the most important questions connected with the preservation of the Historic Centres values is concernments about the new building or destroy the unvalued buildings.

This issue in nowadays is asking for carefully vision by supporting at restoration modern terms and up-to-date experience. We think that the total prohibition of the new buildings can hardly compromise living conditions at these citizen or rural spaces but is very understandable that this new building will be closer to the traditional ones in the light of

DO NOT COPY

their volumes, external architectural treatments and building technique. New building of social categories are supplementary at diversity of constructions category which can not interpose at volumes of second category monuments so for that argument we think at the open spaces of Historic Centers can allowed new constructions for essential living services as special cases. Destroyed of the existing buildings at the moment when Historic Centres are under protection has brought very negative examples for the constructions built after Second World War.

Building plots exist at some Historic Centres and this damage the ensemble of Historic Centres so in this case we think to build new constructions according to the traditional composition the equivalent condition are at the existing buildings which are partially or totally damaged. The last issue is when building is totally disaffected at their facades, architectural elements and volumes, these changes destroy totally the original composition. The treatment in this case must do by removing the added volumes or by retreating.

Unauthorized buildings of each category or treatment are considered as a law violation and must solve according to the law.

Historic Centers has also and the urban values which are present at compositional elements and also at building technique. It is very reasonable that the Urban Structure of Historic Centres must preserve its original materials and compositional elements with which are realized buildings at these centres. Some changes must take place on road system at Historic Centres, but a very few elements of roads must extended for civil services like fireworks or tourist walk, however the biggest part must replace the previous original pavement and conserve spaces, surrounding wall or main doors.



Qendra Historike Gjirokastër

The modern civil life enforcement at Historic Centres the water supply and electric power, sewage system, tap water and telephone lines. Their presence asks for intervention in the road system and at the spaces between traditional buildings also dictates the city conjunction with these functional units.

Protection of the Historic Centres which belong to the centuries XVIII-XIX is finished very late, at our cities but on the valued dwelling place at village areas this process is not ended at all and to eliminate this is more than obligatory to prepare programs by specialists of Institute of Culture Monuments (ICM) for putting them under law protection because they have almost the same urbanity-architecture values if they are compared with citizen centres.

Historic Centres like the culture monuments in

general are object of the Multiplan studies and to be more precise they are on urban, architecture and technique fields. Is necessary for these studies to have popular character because they have the scientist contend and this is found on the published works like monographer, scientific magazines and articles.

Publishing in foreign languages is more than necessary because they are very important for human culture acknowledgements which are so different and also integrated on main characters at different time periods.

Albanian culture is different on juvenilia and values created by our Illyrian-Arberesh-Albanian ethnos during the centuries. Albanian juvenilia is also preserved at the territories outside the Albanian borders like Montenegro, Macedonia, Greece, South Italy and Kosovo Republic so these values must identified, documented, protected, studied and published. This must be the duty of Albanian studiers because they will take the initiative and continuity to valuate these unique movable assets which now belong to the entire humanity because we have been and will be part of it. ■

DO NOT COPY

Dokumenta nga Kultura Materiale për Familjen e Kastriotëve

Prof. Dr. Valter Shtylla

DO NOT COPY



Temën e mëposhtme, rreth familjes së Kastriotëve dhe shenjave që zbulojmë prej tyre, nuk e trajtoj rastësisht, por vetëm pasi për 45 vjet jam i përfshirë në sferën e punonjësve që merren me vlerësimin e monumenteve të kulturës materiale.

Historiani i katedrës apo i shqyrtimeve, gjurmon, studion, seleksionon, interpreton dhe analizon botime, materiale dhe arkiva të ndryshme, të cilat jo gjithmonë shfaqin të vërteta historike përfundimitare. Veç kësaj në këto hulumtime, ka rëndësi esenciale, këndvështrimi i studiuesit, shkalla e synimit për objektivitet dhe kërkime të bazuara në dëshmi, për probleme të ndryshme dhe së fundi përfundimi i konkluzioneve të studiuesit. Kuptohet se faktori më determinant në analizat historike mbetet pa dyshim formimi etno-kulturor i studiuesit. Dhe në këto kushte, kur komuniteti human për arsye të ndryshme, në shumë raste vuan diagnozat e rishikimit të Historisë, ballafaqimi konkret me monumentet e kulturës materiale përballet me dëshmi të vërteta historike, të cilat hedhin poshtë sajimet e pseudoburimeve historike. (fig. 1)

Lidhja e monumentit të kulturës materiale me historinë është organike dhe logjike. Ai është përfaqësuesi i një periudhe historike, i një personazhi historik dhe kështu me ekzistencën e tij, monumenti ia përcjell historinë mbarë brezave. Duke e kuptuar

DO NOT COPY

monumentin si një dëshmi të vërtetë, në vazhdim do të trajtojmë, pikërisht duke u mbështetur në monumente të caktuara, disa objekte të kulturës materiale të lidhura me historinë e familjes së Kastriotëve. Meriton të vihet në dukje dhe të theksohet me forcë fakti që më shtyu të gjurmoj në kërkim të gjurmëve historike të Kastriotëve jashtë Shqipërisë. Në muajin Shkurt 1996 gjatë një vizite në Këshillin e Europës në Strasburg, për të diskutuar rreth problemeve statike në Kalanë e Krujës, studiues nga Valencia e Spanjës, më informuan se në Real Manastirin San Trinidad të qytetit të tyre ndodhen varret e pjesëtarëve të familjes së Kastriotëve, fakt që më zgjoi një interes të veçantë. Dhe në qershor të vitit 2001, me ndihmën e Generalitat Valenciana, m'u mundësua vizita në këtë qytet historik të Spanjës. Burimet e shumta historike dëshmojnë për një lidhje të fuqishme të familjes së Kastriotëve gjatë shekullit të XV me Mbretin napolitan Alfonsi V i Aragonës. Kurora mbretërore e Aragonëve përfshinte dhe Mbretërinë e Valencias. Aragonët me Kastriotët realizuan aleanca të fuqishme ushtarake dhe dihet që Mbreti Ferrante i Napolit i caktoi feude të mëdha familjes së Skënderbeut në Italinë e Jugut.

Pas vdekjes së Skënderbeut në vitin 1468, familja e tij emigroi në Mbretërinë e Napolit, duke u marrë në mbrojtje nga Aragonët. Në vitin 1499, kur nëna mbretëreshës Xhovana bashkë me të bijën shkuan në Valencia tek i vëllai Fernando-Katoliko, ato shoqëroheshin dhe nga Donika, gruaja e Gjergj Kastriot Skënderbeut. Donika në Valencia udhëtoi bashkë me të birin Gjonin, si dhe me një eskortë prej 20 kalorësish.

Gjoni, djali i Donikës dhe i Skënderbeut, ishte martuar me Irenën, vajzën e despotit serb Lazar Brankoviç dhe të Elena Paleologut, vajzën e despotit të Moresë, Tomas. Gjoni me Irenën, që vdiq në vitin 1505, pati shumë djem, të cilët vdiqën në moshë të re, përveç Ferdinandit. Gjoni me njërin nga djemtë e tij, Alfonsin, kanë qenë në Spanjë, ku në vitin 1500 edhe kanë luftuar përkrah spanjollëve e kundër arabëve, në krahinën e Alpanjaros.

Më 23 Gusht 1503 Donika është parë në një pritje me mbretëreshat aragonase në Valencia. Më pas, kur në vitin 1506 ato u kthyen në Napoli nuk shoqëroheshin nga Donika, e cila duket se mbeti në Valencia. Në Valencia ndodhet Manastiri Mbretëror Shën



Trinidad, i ndërtuar në vitin 1445 nga Mbretëresha Aragonase Maria de Castiljo, e cila pas vdekjes në vitin 1458 u varros në portikun e Manastirit (fig. 2). Skulptori i njohur Antoni Dalmau realizoi një vepër mortore monumentale për mbretëreshën. Manastiri 563 vjeçar deri më sot ka pësuar disa rikonstruksione.

Autorët Sales, më 1761, dhe Goerlich në vitin 1998, publikojnë se në kapelën San Migele në veri-lindje të naosit, në fillim të shekullit të XVI-të është varrosur gruaja e Gjon Kastriotit, birit të Mbretit të Shqipërisë, Gjergj Kastrioti, i mbiquajtur si Skanderbeg. Sipër varrit të saj ka qenë vendosur ikona e Shën Mërisë, sot e zhvendosur në kapelën karshi. Kjo ikonë është



sjellë këtu nga Beatriçja e Hungarisë, mike e Irenës, e quajtur nga spanjollët Xhovana, gruaja e Gjon Kastriotit. Në kapelën e San Migelit është gërmuar dhe nuk kanë dalë relike nga varre të hershme. E vërteta se pas vitit 1506 Donika nuk u kthye më në Napoli, të shtyn të mendosh se edhe vetë gruaja e Skënderbeut mund të jetë varrosur në Valencia, bashkë me eskortën historike të saj, e cila mund t'i ketë varret në oborrin e brendshëm-portik të manastirit. Dëshmi e qartë materiale dhe historike nga manastiri është pllaka e varrit e Alfonsit, birit të Gjonit (fig.3). Varri i tij ka qenë tek vendi i korit të kishës, në qoshen veri-perëndimore të naosit, por që pas djegies së kishës, pllaka u zhvendos në kapelën majtas hyrjes së saj. Mbi këtë pllakë mermeri të zi lexohet "Këtu prehet Alfonso, biri i të famshmit Georgo Castroto, mbret i Albanisë, i braktisur nga turqit, fortesë e pamposhtur e krishtërimit, i cili u quajt nga turqit Escardabech dhe i cili për prejardhjen e tij, vlerën dhe madhështinë e shpirtit, krahasohej me mbretin Alesandër të Maqedonisë. Vdiq në moshën 15 vjeç në këtë qytet të Valencias, viti 1503". Duke parë moshën dhe vitin e vdekjes dhe botimet për kishën është e qartë se bëhet fjalë për birin e Gjonit dhe jo të Skënderbeut. Manastiri Mbretëror San Trinidad i Valencias shpreh lidhjen e fuqishme të familjes arbërore të Kastriotëve me dinastinë mbretërore aragonase. Së pari këtu pasqyrohet orientimi europiano-perëndimor i Skënderbeut, si dhe përqafimi i fesë katolike nga ana e tij. Kjo nga njëra anë, më tej, vendvarrimin e një pjese të familjes së Kastriotëve në Manastirin Mbretëror të Valencias, ku prehet edhe vetë Mbretëresha aragonase e shekullit XV Maria de Castiljo, dëshmon konsideratën e lartë të dinastisë spanjolle ndaj Kastriotëve, aq më tepër që varret e Xhovanës dhe Alfonsit ndodhen në naosin e kishës, ndërsa ai i mbretëreshës në portik, ku prehet edhe eskorta kalorsiake e Donika Kastriotit. Aq më tepër, po të dëshmohet se edhe vetë varri i Donikës ndodhet në këtë manastir, ideja bëhet më e besueshme si argument. Edhe interpretimi i përmbajtjes së pllakës së Alfonsit, e cila daton nga viti 1503, përfaqëson vlera historike për Gjergj Kastriot Skënderbeun. Shkrimi fillon me shprehjen "i famshmi Georgo Castroto, Mbreti i Shqiptarëve, pra me superlativën "i famshmi" dhe me titullin "Mbret". Dihet se krejt rastësisht Skënderbeu nuk arriti të shpallej "Mbret" nga ana e Papatit, pasi Papa Piu II nuk mundi të mbërrinte në Shqipëri në vitin 1464 për ta kurorëzuar atë si monark. Epitafi vazhdon "fortesë e pamposhtur e krishtërimit", një cilësim që e vlerëson shumë figurën e Skënderbeut nga ana e Komunitetit Perëndimor. Kjo është një shprehje shpesh e përsëritur, por kur është e gdhendur në një gur të vitit 1503, në zemrën e një kryevepre religjioze aragonase, shprehja fiton vlera të shumëfishta. Pllaka mbyllet me konsideratën për figurën personale të Skënderbeut, madje duke e krahasuar atë me mbretin Aleksandër të Maqedonisë, konsiderata që e nxjerrin në një rrafsh tjetër figurën e tij.

Në qendër të Napolit ndodhet kisha monumen-

DO NOT COPY

DO NOT COPY

tale, Santa Maria la Nova, një nga objektet më të vizitueshme të këtij qyteti historik. (fig.4). Origjina e kësaj kishe vjen nga fundi i shekullit të XIII-të, kur Karli i I Anzhu ndërmori një ndërtim fortifikues në këtë vend. Pas disa dëmtimeve të pësuara gjatë shekujve XV-XVI, në gjendjen e sotme kisha Santa Maria la Nova, përfaqëson një ndërtim pak më të hershëm se tre shekuj, me relike të ruajtura nga shekujt parardhës. Sot kisha është një qendër e rëndësishme e artit dhe e studimeve religjioze italo-mesdhetare. Në portikun e kishës ndodhen një sërë varresh monumentalë, ndërmjet të cilëve spikat ai i Konstantin Kastriotit, djali i Gjonit, nipi i Skënderbeut. (fig. 5).Varri i Konstantinit është një vepër arti në mermer, punuar nga mjeshtri i njohur Jacopo della Pilla. Konstatini, djali i Gjonit, vëllai i Alfonsit të varrosur në Valencia, në moshën 20 vjeçare, në vitin 1497 u shpall Kryepeshkop i Izernias, qytet në veri të Napolit, pranë Molizes. Në pllakën e epitafit kushtuar nga e gjyshja Donika, thuhet: "Konstatin Kastrioti, i varrosur këtu, i cili është prej gjaku e farefisi të kulluar mbreti e perandori dhe fisnik për dëlirësi dokesh, për dinjitet, Kryeprift i Izernias, që vdiq para kohe. Donika Komina, stërgjyshja nga babai, i bëri këtë varr të mrekullueshëm në vitin njëmijë e pesëqind". Këtë objekt Donika e ka realizuar kur tashmë ndodhej e larguar në Valencia. Kisha Santa Maria la Nova përfaqëson një vepër historike dhe arti të veçantë. Në brendësi ajo përmban shumë realizime gdhendjeje në gur me mbishkrime historike nga familje të njohura, mes të cilëve edhe ajo e Argonëve, miq të familjes së Kastriotëve. Në të dy anët e varrit, brenda një kornize është gdhendur një mburojë në formë ovale. Brenda saj shquan shqiponja dy krenare me kurorat mbretërore mbi kokat e shqiponjës. Në mesin e dy kokave është gdhendur ylli me tetë cepa. Në krye, jashtë mburojës lartësohet kurora e kryepeshkopit të Izernias, simboli funksional i Konstantin Kastriotit. Ylli me cepa përfaqëson simbolin e diellit rrezatues dhe numri i cepave nuk duhet të jetë përcaktues. Në varrin e Mbretit të Maqedonisë Filipi II, babai i Aleksandrit, zbuluar në Verxhina pranë Selanikut, vërehen dy simbole. Në zbulimet e narteksit bie në sy ylli me 12 cepa, ndërsa në kutinë e florinjtë të zbuluar në ambientin qendror lexohet një tjetër yll, këtë herë me 16 cepa.



Gjatë mesjetës ishte një fenomen i zakonshëm lid-

DO NOT COPY



hja e krushqive ndërmjet familjeve fisnike nga vende të ndryshme. Herë si rezultat i fqinjësisë së mirë dhe herë si faktor për konsolidimin e pozitave politiko-ushtarake, këto krushqi ishin të shpeshta, sidomos brenda rajonit tonë. Stefan Brankoviçi në verën e 1460-ës erdhi në Shqipëri, ku u martua me Angjelinën, bijën e feudalit të njohur shqiptar Gjergj Arianit Komnen Topia, duke u bërë kështu kunat me Gjergj Kastriot-Skënderbeun.

Skënderbeun e ndihmoi Stefan Brankoviçin, me anën e kontit milanez Francesko Sforca, që të afrohej me perëndimin dhe veçanërisht me Venecian. Motra e madhe e Skënderbeut, Mara, (në disa burime njihet si Maria) u martua me sundimtarin e Malit të Zi Stefan Cërnojeviçin. Qendra e Cernojeviçëve ka qenë qyteti mesjetar i Zhabjakut në Kënetën e Madhe, në veri-perëndim të liqenit të Shkodrës, pranë derdhjes së lumit Moraça në liqen, ku ndodhet fortifikimi sot i njohur si Zhabjaku i Cërnojeviçëve. Në këtë qendër të fortifikuar punime të thella ka kryer Stefan Cërnojeviçi, burri Marës dhe kunati i Skënderbeut. Familja e Cërnojeviçëve ndërtoi një manastir të tipit mauzole për varrimin e pjesëtarëve të familjes. Ky manastir, vepër shpirtërore e Gjergj dhe Aleks Cërnojeviçit, u ndërtua në ishullin e Komit në liqenin e Shkodrës, pranë Zhabjakut. (fig. 6) Ishulli i pabanuar i Komit mund të arrihet me udhëtim në liqen prej Vranjinës. Në qendër të manastirt ndodhet Kisha e Shën Mërisë, ndërtuar ndërmjet viteve 1415-1427. Në brendësi të kishës ndodhen pllakat e varreve të familjes së Cërnojeviçëve. Sa hyn në kishë djathtas janë pllakat mortore të bijve të Stefanit, Aleksej dhe Gjergj.

Ivan Cërnojeviçi, pas vdekjes së babait Stefan, si sundimtar i Malit të Zi, ka zgjedhur mjeshtrit më të mirë nga bregdeti për gdhendjen e pllakës së varrit të nënës së tij Mara. Pllaka me përmasa 60 x 180 cm, me një bordurë anësore të gdhendur, në qendër të saj ka tre lule formë rozete. Tatjana Pejoviç në botimin e vitit 1995 "Manastiret në territorin e Malit të Zi" shprehet " Pllaka e varreve të prindërve të Ivanit, Stefanit dhe gruas së tij zonjës Mara Kastrioti, princeshë shqiptare, motra e Skënderbeut, kanë zbukurime të pasura në gur. Në krye të pllakës është gdhendur një monogramë ku me kujdes mund të lexohet "Kjo është pllaka e zonjës Mara, princesha e Cërna Gora, motra e Georgio Skanderbeg". Në koment të këtij mbishkrimi, kuptohet qartë konsiderata e lartë që gëzonte Gjergj Kastriot Skënderbeu në radhët e princave sllavë e padyshim edhe më gjerë. Nëpër epitafet e varreve lexon gjithmonë emrat e prindërve të të ndjerit dhe duket si një rast unikal - një epitaf me emrin e vëllait.

Kemi të bëjmë me shprehjen e një konsiderate të veçantë, në këtë rast të fisnikëve të njohur malazezë Cërnojeviç ndaj kryetrimit të Arbërisë. Familja e Gjon Kastriotit, përbëhej nga katër djem dhe pesë vajza. Vëllai i madh i Gjergjit (Skënderbeut) Reposhi përfundoi murg në gadishullin e Malit të Shenjtë pranë Selanikut, në manastirin e Hilandarit, ndërtuar në shekullin e XI. Në arkivën e këtij manastiri ruhen dy dokumente që lidhen me emrin e Gjon Kastriotit. Në dokumentin e vitit 1426 thuhet se

DO NOT COPY

"Gjon Kastrioti me katër djemtë e tij Stanishin, Reposhin, Konstantinin dhe Gjergjin i falën Manastirit të Hilandarit katundet e krahinës së Rekës në Dibër, Radostushën dhe Trebishtin. Në dokumentin e dytë të padatuar thuhet se igumeni i Manastirit të Hilandarit i shet Pirgun e Shën Gjergjit Gjon Kastriotit dhe tre djemve të tij Reposhit, Konstantinit dhe Gjergjit për 60 florinj". Ky pirg mban edhe sot emrin "Pirgu i Shqiptarëve".(fig. 7) Studiuesi serb Sreten Petkoviç në librin e tij "Chilandar" të botuar në vitin 1999 thotë se "Kulla e Shqiptarëve u ble nga Gjon Kastrioti dhe djemtë e tij në dekadën e tretë të shekullit të XV-të, për ta përdorur kur ta kërkonin rrethanat". Në këtë mënyrë, një nga studiuesit e njohur serbë të Hilandarit thekson në botimet e tij faktin që një fisnik shqiptar, Gjon Kastrioti, ka blerë një kullë në manastirin e Hilandarit, e cila sot njihet me emrin "Kulla e Shqiptarëve". Për sqarim, Petkoviçi Kullën e Shqiptarëve e vendos jashtë në hyrje të manastirit, pranë kishës së Shën Trinisë, ku ruhen muret e poshtëm të saj deri në lartësinë 5 metra, që kufizojnë një ambient me përmasa 6 x 7 metra. Në anën tjetër shumica e autorëve, Kullën e Shqiptarëve e identifikojnë me Kullën e Shën Gjergjit brenda manastirit, ndërtim i shek. të XIII-të, me rikonstruksion në gjysmën e dytë të shekullit të XVII, në katet e së cilës ndodhet dhe kapela me piktura murale e Shën Gjergjit.

Në librin e tij Petkoviçi përshkruan se në vitet 1430-31 Reposhi, vëllai i të famshmit Skënderbeg, nga familja shqiptare e Kastriotëve u varros në një varr të ndodhur në narteksin e brendshëm të kishës, në murin verior. Shën Gjergji dhe shenjtorët Simeon dhe Sava, bashkë me Virgjëreshën, janë pikturuar në muret sipër për nder të shpirtit të tij. Piktori anonim i afreskut duket i një talenti modest. Sipas studiuesit të njohur kroat Milan Shuflaj mbi varrin e Reposhit, i varrosur në brendësi të objektit kryesor të manastirit të Hilandarit, në kishën e Shën Mërisë, është gdhendur identifikimi historik "Duka i Ilirëve". Pra autorë serb me emër, citojnë Kullën e Shenjtorëve blerë nga princi shqiptar Gjon Kastrioti, si dhe faktin e varrosjes së Reposhit, nga familja e famshme shqiptare e Kastriotëve, në Manastirin e Hilandarit në Malin e Shenjtë. Në përfundim mund të nënvizojmë se të gjithë monumentet e kulturës materiale që përmenden më sipër, të lidhur me emrin e familjes së Kastriotëve, përveç se janë vizituar, por ato njëherësh janë dhe objekt të botimeve të shumta. Ato e vlerësojnë së tepërmi emrin e kësaj familje të njohur shqiptare të shekullit të XV, Gjergj Kastriot - Skënderbeu. Siç dëshmo-



het nga këto monumente Heroi ynë Kombëtar, pati një orientim të qartë europerëndimor dhe ishte merita e tij që edhe fisnikët e tjerë arbërorë pas tij, e lidhën jetën e tyre me perëndimin. Kujtojmë Bazilikën e Frankavilës në Bari, ku prehen Muzakajt, Gravinën pranë Barit ku në kishën e Shën Sofisë, prehet vajza e Vrana Kontit, e lidhur me familjen antike romane Orsini, krahinën e Fanos në veri të Italisë ku kunati i Skënderbeut Konstandin Arianiti, ishte shpallur "Dukë", etj. Monumentet janë në këmbë dhe ato shprehin historinë, prandaj ato duhen studiuar e dokumentuar dhe sigurisht duhet realizuar edhe mundësia e ekspozimit të tyre në Muzetë tona Kombëtare, si një akt që konfirmon rolin e Kastriotëve, e sidomos të Skënderbeut në historinë e kombit shqiptar. ■

DO NOT COPY

Literatura

1. Augustin Sales: Historia del Real Manasterio della SS-md, Trinidad, en Valencia, 1761.
2. Monumentos dela Comunidad Valenciana, Generalitad Valenciana, 1998.
3. D.B. Goerlich: El Real Manasterio dela Santisima Trinidad, Generalitad Valenciana, 1998.
4. Paolo Petta: Despotër të Epirit e Princër të Maqedonisë, Tiranë 2001.
5. Degrand: Kujtime nga Shqipëria e Epërme, Tiranë 2001.
6. Jaho Brahaj: Korona Mbretërore Shqiptare, Tiranë 1998.
7. Tuto Valencia: Editorial Escudo de Oro, S. A 2000.
8. Historia e Popullit Shqiptar: vol. I, Tiranë 2002.
9. Historia e Popullit Shqiptar: vol. I, Tiranë 1967.
10. Kristo Frashëri: Skënderbeu Jeta dhe Vepra, Tiranë 2002.
11. Milan Shuflaj: Serbët dhe Shqiptarët, Tiranë 2002.
12. T. Pejoviç: Manastiri na tllu Crne Gore, Cetinje 1995.
13. Dr. Cedomir Markoviç - Dr Rajko Vujiçiç: The Cultural Monuments of Montenegro, Cetinje 1997.
14. Sreten Petkoviç: Chilandar, Belgrade 1999.
15. Sotiris Kadas: Mount Athos, Athens 1989.
16. Muzaka: Memorie, Tiranë 1996.
17. Dr.Ludvig Von Thalloczy: Vëzhgime iliro-shqiptare, Shkodër 2004.
18. Sunçani Sat: Sremska Mitrovica, Godina VII, Nr 8/1998.
19. Zharko Shçepanoviç: Kratka Istorija Crne Gore: Podgorica,2002.
20. Revista "Monumentet" Tiranë 2003.
21. Valter Shtylla: Figura "Historika Iliro-Shqiptare", Tiranë 2005.
22. Fan S.Noli: Historia e Skënderbeut, Uegen 2004.
23. Marin Barleti: Historia e Skënderbeut, Tiranë 1967.
24. Kasem Biçoku: Për Skënderbeun, Tiranë 2005.

Documents from the Material Culture of Kastriotëve Family

Prof. Dr. Valter Shtylla

DO NOT COPY

Numerous historic sources testify for a powerful connection between Kastriotëve Family and Naples King Alfons V of Aragon during the XV century. Aragon Royal family incorporates the Valencia Kingdom. Aragon Realize with Kastriotët powerful military relations and is known the story of Ferrante King of the Naples who give many lands for the Scanderbeg Family at the South Italy.

After the death of Scanderbeg on the year 1468, his family emigrate at Naples Kingdom, which was under the protection of Aragon. On the year 1499, when mother Queen Joana together with her daughter has gone on Valencia at her brother Fernando-Catholic, and in this trip they were accompanied by Donika, the wife of Gjergj Kastriot Scanderbeg. Donika on Valencia traveled with the family of her son Gjon and was convoyed by escort of 20 knights. Gjon, son of Donika and Scanderbeg, was married with Irena, daughter of the Serbian Despot Lazar Brankoviç and his wife Elena Paleologut, daughter of Tomas, Morea Despot. Gjon with Irena, who died on 1505, has many sons and they died very young except Ferdinand. Gjon with one of his sons Alfons has been on Spain, when on the year 1500 together with Spaniards has fight against Arabs at Alpańaro region.

On August 23, 1503 Donika has been on the expectance with Aragon's queens in Valencia, but they come back to Naples on year 1506 without Donika, because she remains in Valencia. The Royal Monastery of Saint Trinidad is inside Valencia, built on the year 1445 by Aragon Queen Maria de Castijo, who died on 1458 and he was entomb in the Monastery portico. Famous sculptors Anton Dalmau realize a monumental work for the queen. Some reconstructions have occurred at 563 years old monastery.

Authors like Sales, on 1761, and Goerlich on year 1998, issue that: "At San Migele chapel on the south-east of naos, at the beginning of XVI century is entomb the wife of Gjon Kastriotit, son of the Albanian King Gjergj Kastrioti so-called by Turks as Scanderbeg". Saint Mara icon was above her tomb which today is moved at chapel next to Donika's tomb. This icon is brought by Hungarian Beatrice, friend of Irena, wife of Gjon Kastrioti called by Spaniards Johanna. Some excavations are done at San Migelit chapel but no remains from earlier tombs were found. Fact is that the wife of Scanderbeg Donika after the year 1506 do not came back in Naples, so it is reasonable, she was entomb in Valencia, together with her historic escort and their tombs may be are established at courtyard portico of monastery. Clear material testimony is grave of Alfons, the son of Gjon. His

DO NOT COPY

tomb have been at corner of church chorus at the north-west corner of naos, but after devastate by fire of this church the grave was moved at chapel on the left of church entrance. On top of this black marble grave is written "Here rest Alfonso, son of the famous Georgo Castroto, king of Albania, abandoned by Turks, unconquerable fortress of the Christianize, who was called by Turks Escardabeg and who for its genealogy, value and greatness of spirit is compared with King Alesandro of Macedonia. Died 15 aged at the city of Valencia on 1503". It is sure that this epitaph belongs to son of Gjon and no Scanderbeg, if are checked this data: his age, year of death and publications for church. Royal Monastery of San Trinidad on Valencia expresses the strong relations of the Kastriot Arber family with Aragon Royal Dynasty. Here is easy to get to understand the west-European orientation of Scanderbeg and his catholicize. Some of Kastriot family tombs are at Royal Monastery of Valencia here also is and the tomb of Aragon Queen of the XV century Maria de Castijo and this testify high consideration of the Spanish Dynasty against the Kastriotëve family. The tombs of the Joanna and Alfons are at church naos, the queen tomb at the portico, when also rests the knight escort of Donika Kastriotit. This give more values if is presupposed that the tomb of Donika Kastrioti is at this monastery. Interpretation of the Alfons grave which date from the year 1503 represents historic values for Gjergj Kastriot Scanderbeg. Epitaph begins with the expression "famous Georgo Castroto, Albanian King", so with superlative "famous" and title "King". It is well-known that accidentally the Scanderbeg is not crowned "King" by Pop because the Pop Piu II could not arrive in Albania on the years 1464 to crown him as a monarch. Epitaph continue "unbeatable fortes of the Christianize", a prestige which values too much the Scanderbeg image by the Western Community. This is a very used expression but when it is letter on a stone of the year 1503 at the heart of the masterpiece Aragon religious it's develop into multiply values. Grave ends with the consideration for the personal figure of Scanderbeg by compare it with the King of Macedonia, which are estimated as "No Comment" considerations.

Monumental church of Santa Maria la Nova is established at centre of Naples which is one of the most visitant objects of this historic city. Origin of this church comes from the end of XIII century when first Charles of Anzhu undertakes a fortified building at this place. After some damages occurred during the centuries XV-XVI, on nowadays situation at Santa Maria la Nova church represents a type of building earlier than 3 centuries, with relic's conserved from the precursor centuries. Today the church is a very important centre of art and religious Italian-Mediterranean studies. There are some monumental graves at portico of church; one of these tombs belongs to Konstantin Kastrioti, son of Gjon, nephew of Scanderbeg. Konstantin tomb is an art work on marble and for it has work famous master Jacopo Della Pija. Konstantin , son of Gjonit, brother of Alfons was entombed at Valencia, aged 20, but on year 1497 was declare Archbishop of Izernia, city on north of Naples, close to Moliza region. On the epitaph grave dedicated by his grandmother Donika is written: "Konstantin Kastrioti, entombed here, belongs to imperial and kingdom pure blood and noble for dignity, Izernia Archbishop, who died earlier. Donika Komina, great-granddaughter from the father, built this extraordinarily tomb on the year 1500". These tombs Donika have realized when she lives in Valencia.

Santa Maria la Nova represents an art and historic masterpiece of work. Interior church has many

DO NOT COPY

stone-carving realizations with historic inscriptions for famous families and among of them is Aragon family which has friendship with Kastriotëve family. There is an oval mantled which is aboard of the mounting at both sides of the tomb. It has a two heads eagle with kingdom crown above the both heads of eagle chiseling. In the middle of the two heads is an 8 snaggy star chiseling. This star represents symbol of the radiant sun and number of the snnagies will be not determinative. On the lead out of shield is crowning of the Izernia Archbishop, functional symbol of Konstantin Kastrioti. The tomb of King of Macedonia Filipe II, father of Alexander, discovered at Verxhina close to Thessaloniki has 2 symbols. The narthexes discoveries is notable the 12 snaggy star, but on the golden box discovered at central ambient there is another star this time it has 16 snaggies.

Tatjana Pejoviç on the publication of the year 1995"Monasteries on the Montenegro territory" wrote "Graves of the parents of Ivan, Stefan and his wife lady Mara Kastrioti, Albanian princess, sister of Scanderbeg, has rich ornamentals stone-carving". On the top of the grave is a monogram stone-carving when can carefully read "This is the grave of lady Mara, princess of Cërna Gora, sister of Georgio Scanderbeg". This comment of this inscription shows obviously the high considerations which have Gjergj Kastriot Scanderbeg at Slavonic princes. Generally at epitaphs are written the names of the deceased person and it seems a unique case an epitaph with the brother name.

Petkoviç at his book describe: "On the years 1430-31 Reposh, the brother of famous Scanderbeg, from the Albanian family of Kastriotëve was entomb at inner church narthexes at north wall. Saint George and Saints Simeon and Sava, together with Virgin, are painted on the overhead walls to respect his spirit. Fresco anonym painter seems as a modest talent. According to the well-known Croatian studier Milan Shuflaj on the tomb of Reposh, placed in the internal of central object of Hilandar monastery, at Saint Maria Church, is carved historical identification "Illyrian Duke". Serbians well-known authors estimate Saints Tower bought by Albanian prince Gjon Kastrioti and the fact of Reposh entomb, from the famous family of Kastriotëve, at Hilandar Monastery on Saint Mountain. As conclusion we can express that "All the material culture monuments linked with Kastriotëve family which was mentioned above, except the visitation site, they are also objects of many publications. These valuate mostly the name of this well-known Albanian family of XV century, Gjergj Kastriot-Scanderbeg. These monuments are testimony for our National Hero, orientated towards west European point of reference and were his merit for the other Arber nobles to connect their lifes with occident. Here I mentioned the Basilica of Frankavilla in Bari, are entomb Muzakajt, Gravina is close to Bari, at Saint Sophia Church, and there rest daughter of Vrana Konti, who have relations with Orsini antic roman family, positioned at Fano region in north of Italy during the time when brother-in-law of Scanderbeg Konstandin Arianiti, were nominated "Duke". ■

VËSHTRIM MBI FORTIFIKIMET DHE TRASENË E DRINIT TË ZI (SHEK.IV-VI)

LUAN PËRZHITA

DO NOT COPY

Kërkimet e organizuara në pellgun e Drinit të Zi[1], kanë treguar për ndërtimin e një sërë fortifikimesh, të cilat ishin të përhapura në pikat më strategjike përgjatë luginës. Kjo veprimtari është padyshim reflekS i organizimit ushtarak të një sistemi mbrojtës, mjaft efikas të programuar, që vërehet dhe në rajone të tjera, me veçanti strategjike të disa provincave, ku mund të veçojmë ato të rrugës Egnatia[2] , të pellgut të Korçës[3] dhe të rrugës Lissus-Naissus[4] , një degë lidhëse të së cilës mendojmë se përbënte dhe traseja e këtij pellgu (Fig. 1). Ekzistenca e fortifikimeve të vona antike në këtë rajon, mendojmë se paraqet një interes të veçantë pasi pasuron me të dhëna të panjohura më parë historinë antike të këtij pellgu i cili ka shërbyer historikisht si nyje lidhëse komunikuese për zona të ndryshme të Ballkanit.

Prokopi i Çezaresë në veprën e tij De Aedificis" ka regjistruar një sërë ndërtimesh apo rinovimesh të kështjellave, që flet padyshim mbi një veprimtari ndërtimore të epokës paleobizantine, të cilat na paraqiten si pjesë të programit të madh që u kryen nga Justiniani në tërë perandorinë Bizantine. Ai thotë se .. ai [Justiniani], ndërtoj një numër të pafund fortesash ku vendosi garnizone të fuqishëm për t'u bërë ballë armiqve, që janë gati të marrin armët edhe pa patur arsye për këtë[5] .

Nga ana tjetër rezulton se një pjesë e fortifikimeve të rinovuara janë me origjinë romake të vonë dhe në ndonjë rast ato kanë origjinë prehistorike[6] . Ndërsa pjesa më e madhe e tyre paraqitën si kështjella të reja, të thjeshta të ndërtuara në shekullin e VI[7] .

Kështjellat në pellgun e Drinit të Zi janë vendosur

---

[1] Historiku i kërkimeve për këtë rajon fillon me J. Han, Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar, Wien, 1869, f. 93 e më pas nga Jastrebov, Stara Srbija i Albania, Beograd 1904. Kërkime të herë pas hershme janë kryer nga B. Jubani, Plotësime për monumente arkeologjike në Shqipërinë e Veriut, Monumentet 1986, I, f. 141-144 dhe A. Baçe e L. Papajani, Kështjella dhe monumente të tjera në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Monumentet 1983, f. 126-143. Gërmimet sistematike të kryera në Bushat dhe Domaj (Kukës), përfaqësojnë të vetmet qendra të studiuara të këtij areali. Shih; L.Përzhita, Kështjella e Bushatit, Iliria 1986,2, f.187-202; Po ai, Kështjella e vonë antike e Domajve (Ujmisht), Iliria 1995 1-2, f. 267-278. Në vitet 1999-2000 u organizuan ekspedita me karakter përnjohës në fortifikimet e Dibrës dhe Kukësit si në kështjellat e Çepës, Dipjakës, Limjanit, Hoteshit, Gradishtës së Peshkopisë, Gradecit, Volëzes, Bellovës etj, me qëllim rilevimin topografik dhe saktësimin kronologjik kohor të këtyre qendrave. Shih; L.Përzhita, Të dhëna të reja për fortifikime të shek. IV-VI në luginën e Drinit të Zi, Candavia 1, Tiranë 2004, f. 57-80.

[2] N. Ceka, Fortifikimet e vona antike para rrugës Egnatia, Monumentet 7-8, Tiranë 1974, f. 84

[3] Gj. Karaiskaj, P.Leka, Fortifikimet në pellgun e Korçës, Monumentet 7-8, Tiranë 1974, f. 103

[4] L. Përzhita, Kështjella të periudhës antike të vonë përgjatë rrugës Lissus-Naissus, Monumentet 1992-1999, f. 85-112.

[5] Proc. vep,cit., IV, 6.

[6] L. Përzhita, Të dhëna të reja për fortifikime....., f.65-66. Në Gradishtën e Peshkopisë, gjatë survejit të vitit 2000 kemi hasur dy faza ndërtimi të mureve rrethuese. Njëra fazë ndërtimore lidhet me pjesën veriore të fortifikimit muret rrethuese të së cilës teknikisht i përkasin periudhës së hekurit të hershëm, ndërsa faza e dytë është e datuar në shekujt IV-VI.

[7] L. Përzhita, Typologie et chronologie des fortifications de la basse antiquité sur la voie Lissus-Naissus, Studia Albanica, Tirana 2004, f. 107-137.

DO NOT COPY



mbi majat e kodrave me pamje të hapur kundrejt vijave të rëndësishme të komunikacionit. Pozicioni i tyre është zgjedhur me qellim të vështrimit reciprok të një sistemi sinjalizues efikas, siç është shembulli i Limjanit, Dipjakës, Hoteshit (Dibër) etj ,[8]

Nisur nga funksioni i kështjellave i cili padyshim është i shumanshëm mund të veçojmë se disa prej tyre mbronin vijat e qarkullimit kryesor, në pikat dhe qafat malore strategjike, njëkohësisht shërbenin dhe për strehimin e popullatës. Ato, me sa duket reflektojnë më së shumti zgjidhjen e nevojave lokale të mbrojtjes për një zonë të përcaktuar gjeografike, të inkuadruar së bashku me një linjë frontale tashmë të njohur mirë, natyrisht me qëllim ndalimin ose pengimin e

[8] Për kohën e ndërtimit dhe funksionin e kështjellave të Limjanit, Dipjakës dhe Hoteshit, shih: L. Përzhita, Të dhëna të reja.... f.65,67,71.



Bushati



Volesa-Dibra

një inkursioni të mundshëm barbar. Ndërtimi i tyre u kushtëzua nga fillimi i dyndjeve hune, të cilat u kryen për vetëmbrojtje nga popullsia vendase, në situatën e krijuar në prag të dyndjeve të tjera sllave.

Ndërtime të tilla me planimetri të ngjashme, vendosur mbi lartësi mjaft strategjike, me sheshpamje të qartë, janë ndeshur në një numër të konsiderueshëm në tërë gjatësinë që përfshinë Ballkanin Qëndror, si në Mëzinë e Poshtme apo në Veriun e Thrakisë[9] .

Përsa i përket kronologjisë së ndërtimeve të tyre, mendojmë se kërkimet e kryera kanë treguar mbi prezantimin e dy grupeve të mëdha. Natyrisht në grupin e parë, ashtu siç u paraqit dhe materiali i mësipërm, përfshihen dy fortifikime të tipit castrum, Bushati (Kukës) dhe Voleza (Dibër)[10] të ndërtuara në pikat strategjike jo vetëm të rrugëve të kalimit, por dhe në zonat me zhvillim ekonomik. Kështu kështjella e Bushatit[11] ndodhet pikërisht në zonën ku në shekujt II-III ishte krijuar një latifund romak, ndërsa kështjella e Volezës ngrihet mbi fushat pjellore të Kastriotit, si dhe në afërsi të shfrytëzimit të gipsit në Vrënjt (Fig.2).

Kësaj zone i përkasin dhe disa posta kontrolli ushtarake si në Domaj (Kukës), Kala të Dodës, Çepë, Dipjakë, Limjan (Dibër) . Ato ndodhen të vendosura në një terren të theksuar malor, gjithmonë në funksion vëzhgues të aksit rrugor që kalonte në pellgun e Drinit të Zi. Fenomeni i hasur në pellgun e kësaj lugine, siç është rasti i Limjanit dhe Dipjakës (Dibër)[12], vërejmë se është i përhapur dhe në zona të tjera të Shqipërisë verilindore (pellgu i Drinit të Bardhë)[13] , ku dallon ngritja në shekujt III-IV e një rrjeti të gjerë

[9] P. Petrović, Les forteresse de la basse antiquite dans la region du Haut Timak, Starinar 1994-1995, f. 56-66.

[10] L. Përzhita, Të dhëna… f. 62-64. Paraprakisht jemi të mendimit se kështjella e Volesës ka kaluar dy faza ndërtimi; a) shek. III-IV; b) shek. VI. Në fazën e parë (shek. III-IV) ajo ishte me tiparet e një castrumi romak, që shërbente për të kontrolluar rrugën nga e cila bëhej transporti i mineralit të gipsit (Korab), si dhe survejimin e fushave pjellore të Kastriotit, pasi siç dihet këtu kalonte dhe traseja që lidhte Dardaninë me Maqedoninë e II. Ajo me sa duket në këtë periudhë bën pjesë në sistemin fortifikues të pellgut të Drinit të Zi së bashku me Bushatin, ndërsa në fazën e dytë (shek. VI), ky fortifikim u kthye në një qendër kulti, kjo nisur nga gjurmët e një godine paleokristiane e cila është ndërtuar në qendër të vendbanimit. Ky fenomen i shndërrimit të një kështjelle të shekullit III-IV në një qendër kulti dhe administrative në shekullin VI është i ngjashëm me qytezën e Pecës.

[11] L. Përzhita, Kështjella e Bushatit.., f. 187-202.

[12] L. Përzhita, Kukësi-Vështrim arkeologjik, Tiranë 2004, f. 68-69

[13] L. Përzhita, G. Hoxha, Fortifikime të shekujve IV-VI në Dardaninë Perëndimore, Tiranë 2003.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



fig 4

stacionesh. Modele të tilla njihen jo vetëm në provincat e Iliricum-it, por ky fenomen është i përhapur në këtë periudhë dhe në limesin danubian[14] .

Në tablonë e përgjithshme të qendrave të fortifikuara të kësaj faze, të cilat përkojnë në kohë me programin e ndërtimeve dhe rindërtimeve që u kryen nga Justiniani në tërë perandorinë Bizantine, bëjnë pjesë dhe disa kështjella të këtij rajoni. Natyrisht ndërtimet e kësaj periudhe kishin si pikënisje ekzistencën e rëndësishme strategjiko-ushtarake, që kishte fituar ky rajon që në periudhën e vonë romake, tashmë kjo e kushtëzuar dhe nga dyndjet barbare.

Një ndër kështjellat e studiuara të kësaj periudhe, është ajo e Domajve (Ujmisht)[15] e cila ka një pozitë të rëndësishme strategjike në zonën që shtrihet pas Bushatit, nga Qafa e Kolesjanit deri në Skavicë. E parë në raport me kështjellat e ndërtuara me luginën e Drinit të Zi, Domaj bën pjesë në grupin e fortifikimeve të thjeshta, me një kullë, e cila në këtë periudhë shërben si një postë ushtarake. Ndërsa deri tani, nga kërkimet e bëra rezultojnë si ndërtime të reja një sërë kështjellash si Domaj, Çepë, Surroj (Kukës), Hotesh, Bellovë (Dibër) etj., të zbatuara në periudhën e Justinianit, pra në shekullin VI mbas Kr.[16] (Fig. 4) .

Paraprakisht mendojmë se një pjesë e këtyre kështjellave të cilat Prokopi i përfshin në ndërtimet e Justinianit, siç janë ndërtimet e dobëta që vërehen në muret rrethuese të Çepës (Kukës) apo Mlikës (kalaja e Dodës), të shoqëruara përgjithësisht prej një mungese të objekteve arkeologjike ose me pak gjetje qeramike, vegla pune etj., paraqesin në përgjithësi një grup të veçantë, i cili dallon nga ato të shekujt III-IV dhe VI. Në përgjithësi në këtë grup kështjellash mungojnë ambientet e brendshme.

Veçimi i këtyre ndërtimeve, në raport me fortifikimet e tjera, mendojmë paraprakisht se duhet të lidhet me shekullin V, kjo si rezultat i diferencimeve që vërehen si në teknikën e ndërtimit, në krahasim me ato të shekujve III-IV dhe VI, dhe në pamjaftueshmërinë e tyre për të shërbyer si qendra banimi, gjë që vërehet më vonë në fortifikimet e shekullit të VI, ku mund të përmendim Domaj, Hoteshin dhe

[14] P. Petrović, Zidinac, spekulum antique tardif, Starinar, Beograd 1984, f. 127; D. Minić, Gospodin Vir, site antique et medioval. Po aty.., f.149 fig 1.
[15] L. Përzhita, Kështjella e vonë antike..., f. 267-278.
[16] Nisur nga materiali i zbuluar gjatë kërkimeve që janë kryer në këtë rajon është bërë i mundur një klasifikim më i detajuar kronologjik i fortifikimeve. Kështu gërmimet në kalanë e Domajve kanë treguar se shtresa kulturore fillestare mbi të cilën janë ngritur strukturat ndërtimore datohen në shekullin e VI, kjo falë dhe gjetjes së monedhave të perandorit Justinian. Po kështu e njëjta situatë është paraqitur dhe në kështjellat e cekura më lart. Shih: L. Përzhita, Të dhëna...., f.71-73.



fig 5

fazën e dytë të Volezës etj. Shembulli i ndërtimeve të shekullit VI mbas Kr. në pellgun e Drinit të Bardhë i qytezës së Pecës (Kukës)[17], Gradishtës së Bardhocit (Kukës) dhe Domajve, ku në brendësi të tyre janë zbuluar banesa, objekte kishtare etj., tregojnë në vija të përgjithshme se qytetet paleobizantine ishin të ndryshme nga fortifikimet e përmendura më lart (Çepa e Mlika).

Sipas Prokopit të Çezaresë rajoni në fjalë në periudhën e antikitetit të vonë ishte përfshirë në dy provinca, Prevalis dhe Epirus Nova, por kërkimet e mëtejshme arkeologjike të përftuara kohët e fundit, flasin se ky rajon përbënte kufirin perëndimor të Dardanisë dhe Maqedonisë II-të dhe natyrisht ishte pjesë përbërëse e dy provincave të tjera (Praevalis dhe Epirus Nova). Përmendja nga Prokopi e një sërë ndërtimesh apo rinovimesh të kryera në këtë rajon shpjegon me sa duket vlerën e madhe dhe të rëndësishme që luajti kjo zonë në këtë situatë të trazuar[18].

Sipas Hieraklit, në provincën e Epirit të Ri kishte 9 qytete, dy prej të cilave, Lychnidés dhe Deùphrakos[19] bënin pjesë në pellgun e Drinit të Zi. Të njëjtin njoftim kemi dhe nga Prokopi i Çezaresë, i cili përmend ndër qendrat e ndërtuara nga Justiniani në këtë provincë qytetet e mësipërme[20]. Identifikimi i këtyre dy qendrave të mëdha, e me rëndësi për historinë e periudhës së vonë antike nga studimet e kryera bëhet sipas kësaj renditje: Deùphrakos-Dibër dhe Lychnidés-Ohër[21]. Prokopi i Çezaresë, shpreh pa dyshim aktivitetin ndërtimor të epokës paleobizantine të shtrirë si ndër qytetet e mëdha ashtu dhe në zona të tjera, ku u ndërtuan një sërë fortesash rreth qyteteve, rrugëve të komunikacionit, në luginat e lumenjve apo në brendësi të vendit ku gjenden zonat malore. Ekzistenca e këtij pellgu krijonte mundësi që zonat përreth, në antikitetin e vonë të lidheshin jo vetëm me njëra-tjetrën, por dhe me pellgun Adriatik dhe Ballkanin Qendror. Një ndërvarësi e tillë reciproke shprehet mjaft qartë nga Shtatmyller, i cili ka fiksuar ndër rrugët e rëndësishme romake në Shqipëri dhe atë të pellgut të Drinit të Zi[22], nga realizohej komunikimi në mes të provincës Dardane (Ulpjanë), Epirit të Ri (Deyfrakos), dhe Maqedonisë II-të (Lyhnides-Heraclea), e cila shërben njëkohësisht si nyje lidhëse ndërmjet rrugës Egnatia dhe Lissus - Naissus (Fig.5).

Luginat e Drinit, duke shërbyer historikisht si porta të Ultësirës së Adriatikut Jugor[23] në rrugën transballkanike Lissus-Naissus, mbeten gjithmonë damarët kryesorë të lidhjes së kësaj ultësire në Ballkanin Qëndror. Ndërtimi i fortifikimeve në këtë

[17] L. Përzhita, Qyteza dardane në Kodrën e Pecës, Prishtinë 2009.
[18] Procop, De Aedificis, tek, Ilirët dhe Iliria, Tiranë 1965, f.439-441.
[19] Hieroklis Synecdemus, XIII, 653, f.555.
[20] Prokop. De Aedificis, IV, 4, f.440.
[21] V. Popović, L'Albanie pendant la basse Antiquité, "Les Illyriens et les Albanais", Beograd 1988, f.255.
[22] G. Stadtmüller, Forschungen zur albanischen Fruhgeschichte, Wiesbaden 1966, f.225.
[23] B. Jubani, Plotësime për monumente ..., f. 125-155.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

zonë kishte për qëllim kontrollimin e arterit kryesor të rrugës, që lidhte provincën Dardane me Penestët. Ky sistem, përfaqësuar nga Gradishta e Vlashnjës (Kosovë), Morini, Bardhoci, Kalaja e Bushatit, Hisari i Domajve e më tej nga Vila (Kukës) e Kalaja e Dodës, tregon për kalimin e njërës prej degëzimeve më të rëndësishme të kësaj traseje. Rruga futet në këtë luginë nga fshati Piranë (Kosovë) e vazhdon për në Vermicë (Kosovë)[24] kalon qafën e Morinës dhe vendbanimin "Troje" të tij, ruan gjatësinë në drejtim të kodrës së Brakajve (Bardhoc-Kukës). Në afërsi të Gradishtës së Bardhocit ku janë zbuluar gjurmë kalldrëmi të aksit Gabuleo-Theranda, me gjatësi 6 m dhe gjerësi të ruajtur 3 m, nga këtu rruga vazhdon në drejtim të "Polinës" (Bardhoc) deri në kalanë e Pecës. Njëri nga degëzimet e saj i lidhte këto zona me kështjellën e Bushatit e nëpërmjet qafës së Kolesjanit, futej në trevën Peneste. Gjurmët e kësaj traseje i gjejmë në toponimet si "Rruga e Karvaneve" në Morin, "Rruga Pukë" në Bardhoc, "Rruga e Pashës" në Bushat (Kukës) etj. E ndodhur në këtë pozitë gjeografike, kalaja e Bushatit luajti një rol të rëndësishëm për kontrollimin e këtij kyçi komunikues në mes të provincave.

Zbulimi kohët e fundit i disa pjesëve të kësaj traseje përcakton qartë itinerarin e saj në drejtimin Dardani-Maqedoni e II-të, përkatësisht në linjën Therandë-Gabule dhe Bushat (Akrenza)[25] , areal gjeografik ku ndodhet një vendbanim disa hektarësh, i njohur si pronë latifondiste[26] . Më pas rruga vijon në qafën e Kolesianit, në afërsi të kështjellës së Domajve



fig 6

(Ujmisht), në drejtim të qytezës së Vilës dhe Mlikës, në vijën Sllatinë-Venisht (Dibër)[27] , ku dhe u zbuluan disa gjurmë të rrugës antike, të ruajtura në gjatësinë 25m- 30m, me gjerësi 3 m-3,10 m (Fig.6).

Ndërtimi i rrugës ishte realizuar me kalldrëm

---

[24] E.Čerškov, Rimljani na Kosovo i Metohija, Beograd 1969, f.33.

[25] Prokop, De Aedificis, IV, 4, f. 340. Akrenza- fortesë në provincën Dardane. Identifikuar me Bushatin pasi në afërsi të këtij të fundit ndodhet një qendër banimi me emrin Krenzë. Zhvillimi Akrenza-Krenza-Krenxë është i pranueshëm për rregullat e fonetikës historike të gjuhës shqipe. Shih; Sh. Hoxha, Gjurmime toponimike, Tiranë 1998, f. 11.

[26] Në zonën Nangë-Gostil (Kukës) nga gjetjet e shumta arkeologjike veçojmë një mbishkrim latin që flet për lirimin e dy skllevërve. Në këtë pllakë varri përmendet dhe emri ilir Tata. Shih: H. Ceka, S. Anamali, Mbishkrime latine të pabotuara të Shqipërisë, "Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës" 1961, I, f. 104-34

[27] L. Përzhita, Të dhëna..., f. 61

guri të rregullt të punuar, ndërsa gjurmë më të plota u konstatuan në afërsi të Gradishtës së Limjanit (Dibër) me gjatësi 150-170 m, të ngjashme me ato të Venishtit punuar nga një radhë gurësh në formë kalldrëmi, por vërehet dhe nivelimi i saj me dy radhë. Pjesa e trasesë mbi kalldrëm është sheshuar me dhé të ngjeshur mirë. Ajo ndjek me rigorozitet një linjë të drejtë nga fshati Vrënjt për në Gradishtën e Limjanit dhe përfundon në kështjellën e Volezës (Dibër).

Zbulimi i kësaj traseje, rrëzë Korabit, flet me sa duket për një rrugë me karakter tregtaro-ushtarak, e cila duhet të lidhet me shfrytëzimin e pasurive të mëdha të gipsit që ndodhen në këtë zonë. Nga ana ndërtimore vërejmë ndryshime me rrugët e periudhës romake të zbuluara në via Egnatia[28] në Shqipëri dhe në Maqedoni[29] . Rruga e cila u ndërtua në rrëzën e Korabit përfaqëson me sa duket një shfrytëzim të saj vetëm për një periudhë të shkurtër kohore të vitit.

Përveç saj, kërkimet na ofruan disa gjurmë të tjera të një aksi rrugor, i cili ndahet nga rruga e mësipërme në Domaj (Ujmisht) për në Çepë, Mlikë, në të majtë të rrjedhjes së Drinit të Zi për në Hotesh-Viden-Grazhdan (Deyfrakos)[30] . Kështjella e Grazhdanit[31] (Dibër), e cila është ndërtuar në një terren kodrinor, 525-600 m mbi nivelin e detit në mes të dy përrenjve, të Grazhdanit (veriperëndim) dhe të Maqellarës (jugperëndim), të cilët derdhën në lumin Drini i Zi, përfaqëson një ndërtim të shekullit të IV, të periudhës së vonë romake, padyshim më të madhin në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit. Paraqitet në trajtën e një castrumi, me sipërfaqe 34 ha. Muret rrethuese 3,5 m të gjera kanë perimetër afro 3000 m, përforcuar nga 42 kulla të tipave, katrore, drejtkëndore dhe freskore, si dhe tre porta të tipit "propognaculum" fortifikuar nga kulla masive në formë U-je, karakteristikë për një shtrirje kohore, që nuk e kalon shekullin e IV mbas Kr.

Ka një pozitë gjeostrategjike mjaft të rëndësishme në pellgun e Drinit të Zi, veçanërisht për rrugët tregtare-ushtarake që lidhin provincat e Epirit të Ri (Adriatikun), Dardanisë (Kosovë) dhe Maqedonisë II-të (Lyhnides-Heraclea), që realizoheshin nga Via Egnatia dhe Lissus-Naissus gjatë periudhës romake të vonë. Rëndësia e kësaj qendre rritet po të merret parasysh se ajo ndodhet në zonat e brendshme malore larg rrugëve.

Ky aks i dytë rrugor në këtë luginë, me sa duket, lidhet me shfrytëzimin e mermerit të gëlqerëzuar (zona e Muhurit-Dibër)). Gjurmimet e kryera, kanë sqaruar se ndër tiparet më karakteristike të periudhës së vonë antike, është ndërtimi i qytezave dhe kështjellave me planimetri të ndërlikuar ose të thjeshtë, që natyrisht zotëronin pikat më strategjike të arterieve rrugore të këtij pellgu.

Një çështje me rëndësi është, që të shkëpusim nga kjo listë disa emra, të cilët vijnë si remenishencë me toponiminë e ditëve tona, natyrisht mbështetur dhe në argumentin arkeologjik. Ndër fortifikimet e tjera të shekullit të VI në këtë provincë është edhe kështjella e Domajve (Kukës) e cila ndodhet në të kapërcyer të "Qafës së Kshtelit" për në Skavicë. Studimi i këtij fortifikimi tregoi se materiali arkeologjik,

[28] V.Shtylla, Zh.Vinćić, Traseja e Via Egnatias nëpër Shqipëri dhe Maqedoni, Monumentet 1992-1999, f. 51-85; M. Fasolo, La Via Egnatia I, Da Apollonia e Dyrrachium ad Herakleia Lynkestidos, Romë 2003.

[29] L.Përzhita, Kështjella të periudhës antike të vonë përgjatë rrugës Lissus-Naissus.., f.85-112.

[30] L.Përzhita, The cronological value of Procopius's data on Justinian constructions in the Province of Dardania, Kumtesë e mbajtur në IX të International Congress of South-East European Studies (30 August- 3 Septembre), Tirana 2004.

[31] Në vitin 2000-2005 në kalanë e Grazhdanit (Dibër) janë kryer gërmime arkeologjike të drejtuara nga autori i këtij punimi. Për rezultatet e gërmimeve shih, Raportet e gërmimeve të viteve2000-2005, Arkivi i Institutit Arkeologjik Tiranë.

DO NOT COPY

monedhat e perandorit Justinian, ndërtimi i mureve rrethuese etj., e rreshtonin këtë fortesë në ndërtimet e shekullit të VI. Ajo ishte në funksion të trasesë antike të pellgut të Drinit të Zi, e cila shërbente në atë kohë si një nyje lidhëse ndërmjet rrugës Lissus-Naissus dhe rrugës Egnatia[32] .

Prokopi i Çezaresë në ndërtimet e Justinianit përmend një fortesë me emrin "castellum". Sipas prof. E. Çabej zëri "Kështell" lidhet me toponimin "Kshtell" dhe me latinishtën-castellum[33] . Prokopi përmend në këtë periudhë dhe një ndërtim në Macedonia Secunda me emrin Therma[34] . Paraprakisht mendojmë se emri i sotëm Bellovë (Dibër) është një shkurtim i trajtës Bellovodë, sllavizim i shekullit XI i emrit Ujëbardhë ose Ujë termal, i burimit të llixhave të Peshkopisë, i cili ndodhet në distancë mjaft të afërt me fortifikimin. E gjithë zona përreth Llixhave, ruajnë toponimin si "Mali i Bellovës", fshati Bellovë etj., Nisur nga të dhënat e mësipërme mendojmë paraprakisht, që emërtesa Bellovë e sotme është një trajtë lokale me emrin Bellovodë, që me sa duket paraqet trajtën e sllavizuar të emrit Therma të kohës së Prokopit.

Një kështjellë tjetër e rindërtuar nga Justiniani në provincën e Dardanisë është Surikon. Mbi fshatin Surroj (Kukës) ndodhet një fortifikim, që njihet me emrin "Kështjella e Lekës". Nga dokumentacioni historik mësojmë se fshati Surroj shfaqet në vitin 1536 me emrin Surroj i cili mund të jetë pasardhësi i emrit Surikon[35] .

Gjithsesi këto hipoteza kanë të sigurt, në aspektin arkeologjik, përputhjen kohore në mes të periudhës së ndërtimit, pra shekullin e VI dhe të dhënave që janë me origjinë nga burimet historike të kohës. Gjithsesi kjo situatë do të saktësohet më tej nga hulumtimet e reja që do të vijojnë në këtë rajon. ■

[32] L. Përzhita, Kështjella e vona antike e Domajve ..., f. 267-277.
[33] E. Çabej, zëri "Kështell", Studime Gjuhësore I, Prishtinë 1976, f. 281.
[34] Proc. De Aedif, IV,VII.
[35] Proc. vep,cit, IV,4.

DO NOT COPY

Overview on the Drini i Zi fortification and track (IV-VI centuries)

Luan Përzhita

DO NOT COPY

Investigation organized on the Drini i Zi basin has shown some fortifications which were established around at the strategic points of valley. Existence of the antic fortifications on this region, represents a particular interests because give unidentified data for the antic history of this basin which has served as a communication joint for the different regions of Balkan Peninsula. Several of these castles are multifunctional and they serve to protect: main communication lines, strategic mountain necks and points; also they are used for people shelter and for solving the different local protection needs to a particular geographical area with the main idea to stop the barbarian interventions.

According to the buildings time chronology we think that are two main groups. The first one belongs to the castrum types like Bushati (Kukes) and Voleza (Diber) which are built at strategic points of communications and furthermore at the economic developed areas. The Bushat castle is established exactly at the area when on the II-III centuries was a Roman latifund, Voleza castle is built on the fertile lands of Kastriot and close to the gypsum sources at Vrënjt. (Photo 2).

This area has also the military checking point like: Domaj (Kukes), Kala e Dodes, Dipjake, Cepe, Limjan (Dibra). Every single one of these is established at difficult mountain terrain with a focus at the control for the main road of the Drini i Zi basin. The phenomena faced at this basin like Limjan and Dipjaka example is spread also at other areas of northeast Albania (Drini i Bardhe basin) and here is typical building of some stations. These models are not only at Illyricum provinces but also at Danubian limes.

Results of the searches certify as the new buildings the castles of Domaj, Cepe, Surroj (Kukes), Hotesht, Bellove (Diber) which were built at the Justinian era on the VI century after the Christ. (Photo 4). According to the Prokop of Cezare this region on the late antique era is included at two provinces Prevalis and Epirus Nova. Results of the late archeological excavations are a testimony that this region is laid at the border of Western Dardania and Macedonia Second so include the other two provinces (Praevalis and Epirus Nova). Reveal of Prokopi of the some buildings or renovate building at this region shows the great important value of this area.

According to the Hieroklit at the Province of New Epir were 9 cities, 2 of them was named, Lychnides and Deuphrakos which were established at the Drini i Zi basin. The same information gives the Prokop of Cezare, he has declared: among the centers build by Justinian on this province were the two above cities. Identification of these two big centers with

DO NOT COPY

importance for the history of late antic era and according to the studies accomplished is done on this rank: Deuphrakos-Diber and Lychnides-Oher. Existence of this basin creates possibilities for the areas around at the late antiquity to have relation between them and also with Adriatic basin and Central Balkan. One of the most important Roman roads on Albania was the road of Drin i Zi basin, and through this is realized the communication between: Dardan province (Ulpjane), New Epir (Deyfrakos) and Macedonia Second (Lyhnides-Heraclea) at the same time this road serve as the link between road Egnatia and Lissus-Naissus (Photo 5).

Building of the fortifications on this area has the purpose to control the main part of the road which links the Dardan province with Penestet. This system represented by the Gradishta e Vlashnjes (Kosovo), Morini, Bardhoci, Bushat Castle, Hisari i Domajve and further on at Vila (Kukes). Doda Castle shows the track of the most important branching of this road. The road follows the direction of the Pirane village continue at Vermice (Kosovo), bypasses at neck of Morini and at the habitation "Troje" keeps its length at the direction of the Brakajve (Bardhoc-Kukes) hill. Close to the Gradishta of Bardhoci were are discovered the remains of the cobblestone of the axe Gabuleo-Theranda, this road keeps the length 6 meters and 3 meters wide and prolong in the direction of the "Polina" (Bardhoc) up to Peca Castle. One of the branches of this road link the Bushat castle with these areas and between Kolesjani necks, continue at Peneste region. Traces of this track we found at the nicknames like "Caravan Road" at Morina, "Puke Road" at Bardhoc, "Pasha Road" at Bushat Kukes etc. The Bushat castle orientated at this geographical position played an important role for the controlling of this communication link between these provinces.

Lately discovering of the some remaining parts of this track define clearly its itinerary on the direction Dardani-Macedonia Second, Vila and Mlika city, Sllatine-Venisht (Diber) were was discovered some remains of the antic road conserved on the length 25-30 meters, wide 3-3.10 meters (Photo 6).

Discovery of this track at edge of Korab Mountain classify this road at military-trader type which must have links with the utilization of the gypsum sources at this area. This road was used only for a short period of time during the year. The investigations also brought some other tracks of another road axe which is divide from the road above at Domaj (Ujmisht) to the Cepa, Mlika, on the left of the Drini i Zi flow to the Hotesh-Viden-Grazhdan (Deyfrakos), with lot of importance for the military-trader roads which links the provinces of New Epir (Adriatic), Dardania (Kosova), Macedonia Second (Lyhnides-Heraclea) with Via Egnatia and Lissus-Naissus during the late Roman era. This second road axe at this valley possibly is linked with the use of gypsum marble (Muhur-Diber area). Studies completed have clarify that the most characteristic attribute of the late antic era is construction of the small cities and castles with difficult or simple layout which naturally dominate the most strategic points of the road system of this basin. ■

NJË PUNISHTE PËR PRODHIMIN E VERËS NË BYLISI

NICOLAS BEAUDRY
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE LETËRSISË GREKE DHE LATINE
UNIVERSITETI I KEBEKUT NË RIMOUSKI

DO NOT COPY

Rrënojat e Bylisit zënë majën e kodrës së Hekalit, e cila dominon bregun e djathtë të lumit Vjosa, Aoos-i antik, në skajin lindor të vargut të kodrave të Mallakastrës. Qyteti i krijuar në shekullin e IV. para erës sonë ka njohur një zhvillim të shpejtë dhe të rëndësishëm në periudhat helenistike dhe romake, siç e dëshmon sot shtrirja e perimetrit të tij të fortifikuar dhe mbetjet e monumenteve të tij qytetare.

Antikiteti i vonë në Bylis

Si qendër e pavarur episkopale që nga mesi i shek. V, në pjesën e parë të shek VI Bylisi renditej ndërmjet qyteteve më të rëndësishme të Epirit të Ri, pas Dyrrachion (Durrës), Scampis (Elbasan) dhe Apolonisë dhe përpara 6 qyteteve të tjera[1] . Me perëndimin e Apolonisë, Bylisi dhe rajoni i tij njohën një periudhë të fundit zhvillimi, gjë që provohet pikërisht me rikonstruksionet që i janë bërë rrethimeve mbrojtëse dhe me ndërtimin e disa monumenteve fetare dhe civile. Por shekujt V-të dhe VI-të shënojnë, gjithashtu një periudhë tronditjesh (përmbysjesh) të thella në të gjithë gadishullin ballkanik, ndërkohë që sulmet, dyndjet dhe shpërnguljet e popujve të rinj ndiqnin njëri-tjetrin. Pasiguria i dha shkas një përpjekjeje të rëndësishme për fortifikim që u intensifikua në shek. VI[2] . Megjithë këtë përpjekje për t'u mbrojtur, presioni i sllavëve i detyroi banorët e fundit të Bylisit të braktisnin qytetin në fund të shek.VI[3] ; qendra episkopale dhe popullata do të tërhiqeshin drejt Ballshit (Glavenicë), i cili ishte më mirë i pajisur me ujë dhe ku ishte ndërtuar një bazilikë kristiane përpara mesit të shek. VI.

Bylisi nuk u ripushtua asnjëherë, në mos për kohë të shkurtra, për shkak të mungesës së ujit dhe zona ka shërbyer si kullotë për bagëtitë e banorëve të fshatit Hekal, i vendosur në shpatin e kodrës duke filluar nga shek. XIII-të. Bylisi paraqitet pra, sot, si një qytet-fantazmë e Antikitetit të vonë, i ruajtur mjaft mirë dhe me një potencial shkencor, kulturor dhe turistik që mbetet veç të nxirret në pah.

Katedralja dhe lagjja e saj

Peizazhi urban u transformua thellësisht gjatë Antikitetit të vonë kur monumentet e mëdha pub-

[1] Haxhimihali, M., 2004, «Byllis et sa région à la lumière des sources écrites du VIe siècle», in P. Cabanes et J.-L. Lamboley (éd.), L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité IV, Actes du IVe colloque international de Grenoble (10-12 octobre 2002), 463-466, Paris: de Boccard.

[2] Muçaj, S. 1979-1980, «Vendbanime të antikitetit të vonë në krahinën e Mallakastrës», Iliria 9-10, 279-299 ; id., 1990, «Sistemi fortifikues i qytetit të Bylisit në antikitetin e vonë», Iliria 20, 169-200 ; Sodini, J.-P., 2008, «The transformation of cities in late antiquity within the provinces of Macedonia and Epirus», in A. G. Poulter (éd.), The transition to late antiquity, on the Danube and beyond (PBA 141), 311-336, Oxford: Oxford University Press.

[3] Ceka, N., et Muçaj, S., 2005, Byllis: its history and monuments, Tirana: Migjeni.

DO NOT COPY

like helenistike dhe romake, shërbyen në të njëjtën kohë si gurore dhe si themele për ndërtime të reja. Gërmimet e kryera nga Skënder Muçaj për Institutin Arkeologjik të Tiranës (1978 – 1991) kanë paraqitur mbetje të rëndësishme të kësaj periudhe; ato lejojnë tashmë të kuptohen linjat e mëdha të evolucionit të qytetit helenistik dhe romak, kristianizimin e tij dhe zhvillimin e peizazhit të tij urban dhe monumental në Antikitetin e vonë. Publikimi i tyre që përbënte detyrën e parë të Misionit arkeologjik franko-shqiptar të ngritur në 1999 nga Instituti Arkeologjik i Tiranës dhe Shkolla Franceze e Athinës, praktikisht sot ka përfunduar[4].

Të paktën pesë kisha kanë qenë vendosur në hapësirën urbane në shek. V dhe VI, të gjitha bazilikat me tre nefe që kanë ruajtur një pjesë të madhe të kalldrëmeve me mozaik dhe dekorin e tyre të gdhendur. Katedralja (Bazilika B, fig. 1) me pallatin episkopal zë të paktën dy insulae në disnivel të fortë drejt perëndimit. Ajo ka kaluar disa faza zmadhimi, pikërisht shtimin e një ekzonarteksi dhe të tre portikëve të oborrit të brendshëm (në ndërtimet romake), vendosja shkallë-shkallë e volumeve të së cilës kontribuonte në monumentalitetin e fasadës perëndimore. Grupi katedral përfshin gjithashtu hapësira dhe kthina shtesë në faqen jugore të kishës, ku mund të shkohet përmes një rruge lindje-perëndim të trashëguar nga plani urban helenistik dhe e privatizuar: një



Plan i thjeshtuar i grupit katedral dhe i lagjes episkopale, qershor 2006 (i përshtatur nga T. Koželj et M. Wurch-Koželj).

pagëzore, nevojtore, një kopsht i vogël i shtruar me pllaka i pajisur me një cisternë, pastaj, në lartësinë e transeptit dhe absidës, një magazinë e pajisur me enë të mëdha (pithoi).

Pas dyndjeve sllave të viteve 547-548, u ngrit një rrethim i ri mbrojtës nga arkitekti Viktorinos[5] ku kalonte një rrugë veri-jug që ndiqte majën e kodrës; u restaurua vetëm pjesa perëndimore e rrethimit helenistik mbrojtës ç'ka zvogëloi qytetin, intra muros, në një të tretën e vet perëndimore.

Detyra e dytë e Misionit franko-shqiptar, e nisur në vitin 2000, qe rihapja e kantierit në afërsi të kat-

[4] Muçaj, S., et al., à paraître, Byllis I, II (Suppl. BCH), Athènes: École française d'Athènes ; Beaudry, N., Blanc, P., Bonifay, M., Cerova, Y., Chevalier, P., Haxhimihali, M., Hobdari, E., Islami, A., Koželj, T., Muçaj, S., Nallbani, E., Raynaud, M.-P., Savard, M., Sodini, J.-P., Tassignon, I., Vanderheyde, C. et Ďurch-Koželj, M., 2002, « Byllis (Albanie) », Bulletin de correspondance hellénique (BCH) 126.2, 659-684 ; Beaudry, N., Blanc, P., Cerova, Y., Chevalier, P., Haxhimihali, M., Hobdari, E., Islami, A., Koželj, T., Muçaj, S., Nallbani, E., Sodini, J.-P., Tassignon, I., Vanderheyde, C. et Wurch-Koželj, M., 2003, « Byllis (Albanie) », BCH 127.2, 622-639 ; P. Chevalier, N. Beaudry, S. Büttner, Y. Cerova, O. Delouis, M. Haxhimihali, E. Hobdari, A. Islami, T. Koželj, S. Muçaj, E. Nallbani et M. Wurch Koželj, 2004-2005, « Byllis », BCH 128-129.2, 1186-1225 ; P. Chevalier, N. Beaudry, M. Bonifay, Y. Cerova, O. Delouis, M. Haxhimihali, E. Hobdari, A. Islami, T. Koželj, S. Muçaj, E. Nallbani, M. Savard et M. Wurch Koželj, 2006, « Byllis (Albanie) », BCH 130.2, 834-869 ; P. Chevalier, N. Beaudry, A. Berthon, M. Bonifay, Y. Cerova, D. Foy, E. Hobdari, A. Islami, T. Koželj, S. Muçaj, E. Nallbani, M. Savard et M. Wurch Koželj, 2007, «Byllis», BCH 131.2, sous presse ; P. Chevalier, S. Muçaj, N. Beaudry, T. Koželj et M. Wurch-Koželj, 2008, « Byllis (Albanie), campagne 2007 : le quartier épiscopal, la Basilique E et les carrières », Bulletin du Centre d'études médiévales d'Auxerre 12 (2008), p. 63-68

[5] S. Anamali, 1987, «Katër mbishkrime ndërtimi nga Bylisi», Monumentet 33, 62-73; D. Feissel, 1988, « L'architecte Viktôrinos et les fortifications de Justinien dans les provinces balkaniques», Bulletin de la Société nationale des antiquaires de France 1988, 136-146.

DO NOT COPY

edrales. Ky projekt duhet të lejojë studimin e hollësishëm të një kompleksi ekonomik që i bashkohet një grupi episkopal paleokristian; ai do të na japë një portret të ngjyruar të zhvillimit të peshkopatës në hapësirën urbane, pastaj të rënies së gjatë dhe të braktisjes së qytetit nga fundi i shek. VI.

Në gjendjen e fundit të ndërtuar, sektori në jug-lindje të katedrales shpaloset rreth kryqëzimit të dy akseve perpendikulare (fig. 1). I pari që kufizon anekset liturgjike të katedrales, vazhdon deri sa del në rrugën që ecën rrëzë rrethimit mbrojtës të Viktorinos. Aksi i dytë vazhdon nga veriu në jug, më poshtë se rruga e rrethimit mbrojtës. Në pjesën ku takohen akset, oborri i krijuar nga rrafshimi i strukturave të mëparshme ofronte hapësira me destinacion ekonomik dhe rezidencial. Në lindje hyrja për në lagje sigurohej nga një portë e madhe e vendosur mbi katër shtylla; një pjesë dy herë aq hyn gjerësisht në rrugën helenistike, duke formuar një hajat në vazhdim të portës së madhe. Në veri oborri kufizohet nga depo dhe nga një punishte për prodhim vere, që përshkruhet hollësisht më poshtë. Në jug oborri kufizohet nga një ndërtesë dy katëshe; kati përdhes ka 5 dhoma të mëdha të hapura fillimisht nga oborri, prej të cilave njëra ishte e pajisur me një grazhd (për ushqimin e kuajve) dhe një tjetër me një mulli ullinjsh (trapetum). Fasada jugore e ndërtesës ka dhoma me kënd dhe një kuzhinë të madhe e cila është riorganizuar shpesh; kati ishte i destinuar për banim. Nga perëndimi oborri mbyllet me një ndërtesë të vonë dhe një portë në qoshe të saj. Duke pasur një akses të drejtpërdrejtë në rrugën e rrethimit mbrojtës dhe duke qenë i prerë nga kthinat liturgjike, ky oborr lejonte tranzitin e prodhimeve (ushqimeve, mallrave) në magazinat në afërsi, furnizimin me lëndë të parë, shpërndarjen e prodhimit të verës dhe ullirit, si dhe qarkullimin dhe mirëmbajtjen e kafshëve.

Punishtja e verës: prodhimi dhe magazinimi

Heqja e një shtrese gurësh në 2002 tregoi planin e një zgjerimi të vonë drejt lindjes të grupit katedral, përtej korpusit të tij kryesor ku një magazinë (33) zë këndin jug-lindor. Bëhet fjalë për një ndërtesë të madhe N, që shtrihet drejt lindjes deri në një vendkalim të gjerë veri-jugor, dhe gërmimi i së cilës ka filluar në 2007 (fig. 2, 3) . Muret e saj të jashtme në jug, lindje dhe veri-lindje i përkasin të njëjtës fazë ndërtimi, më të vonshme se ajo e korpusit kryesor të grupit katedral. Tre ripunime të njëpasnjëshme përcaktojnë katër hapësira të brendshme: një dhomë orientale (në lindje) N5, e gjatë dhe e ngushtë, ku mund të hyhet nga kopshti L nëpërmjet një porte në murin e tij jugor; një dhomë në jug-perëndim N2 që komunikon me magazinën (33); një dhomë në veri-perëndim N3; një hapësirë e vogël N3A që komunikon me tre pjesët e tjera nëpërmjet dyerve në secilin prej mureve të brendshme. Dyshemetë ishin prej dheu të ngjeshur. Skeleti prej druri i çatisë se ndërtesës mbështetej pjesërisht mbi një shtyllë të fuqishme të ndërtuar në qendër të N2, ndoshta me anën e harqeve.

Shtypëset e rrushit ishin vendosur në dhomën N5 (fig. 2,3)[6]. Shtypësja e parë në këndin jug-lindor të dhomës, u ekspozua në 2007 (fig. 4). Ajo kufizohet nga muret e jashtme dhe nga dy ndarëse të ngushta të shtuara[7] . Fundi përbëhet nga përzierje tjegullash dhe llaçi të bardhë; fundi dhe paretet ishin suvatuar me një llaç ngjyrë rozë, relativisht i trashë, i stukuar me llaç hidraulik më të hollë. Shtypësja derdhet

[6] Afërsisht. 13,36 × 12,60 m ext., duke përjashtuar murin bazë të grupit katedral.
[7] Dimensionet e shtypëses : 1,65 m V-J × 1,45 m L-P, trashësia e ndarëseve të shtuara, afër. 35 cm.

DO NOT COPY



Ndërtesa N drejt veri-lindjes, maj 2008; në planin e përparmë, dhoma N2 (cl. N. Beaudry).



Ndërtesa N dhe oborri drejt veri-lindjes, maj 2008 (cl. N. Beaudry).

në një vaskë gëlqerore në formë trapezi e pajisur në pjesën e saj të ngushtë me një zgavër gjysmësferike, e destinuar fillimisht për të lehtësuar zbrazjen e saj dhe e nevojshme në kontekstin e prodhimit të verës për dekantimin e produktit të shtypur[8] .

Në veri, dy basene të tjera të zbuluara në 2008 që ndajnë mes tyre gjithë gjerësinë e dhomës N 5 (fig. 5). I pari, në këndin veri-lindor të dhomës[9] , është një shtypës i ruajtur mjaft mirë. Ai kufizohet nga muret lindorë dhe veriorë të dhomës dhe nga dy ndarëse të shtuara[10] , të montuara në tokë dhe të lidhura mes tyre me dy blloqe të gdhendura. Blloqe të tjera formojnë një shkallë të jashtme të mbështetur kundrejt paretit jugor (fig. 6). Fundi i saj përbëhet nga përzierje e ngjashme me atë të shtypësit jug-lindor; i njëjti llaç hidraulik mbulon fundin dhe paretet në të gjithë lartësinë e ruajtur të mureve, mbi një përgatitje prej 1-2 cm llaçi ngjyrë rozë. Pjerrësitë e fundit të saj bashkohen drejt qendrës së faqes perëndimore, ku dy imbrices të mbivëna dhe të lidhura me llaç formojnë një rrugëdalje.

Ky kanal derdhej në një basen të dytë që zinte këndin veri-perëndimor të dhomës dhe ishte i destinuar për dekantimin[11] (fig. 6). Ndarësja e tij jugore është e përshtatur me atë të basenit veri-lindor dhe e lidhur me të nën dy blloqet këndore; pra të dyja basenet i përkasin të njëjtit projekt fillestar. Do të vihet re konkaviteti (zgavra) i fortë në planin e murit verior gjatë gjithë gjerësisë së basenit. Rrëzë këtij muri, një zgavër me bazë gjysëmsferike luante të njëjtin rol me atë të vaskës, duke lehtësuar zbrazjen dhe dekantimin e produktit të shtrydhur[12] . Llaçi i basenit është rinovuar (zëvëndësuar) të paktën dy herë. Rrëzë faqes perëndimore pjerrësitë e fundit të basenit shkojnë drejt një rrugëdalje të formuar nga imbrices, që e zbrazte basenin e dytë drejt një të treti N3A.

---

[8] Inv. 3564 : gjat. 1,08 m, gjer. 0,50 - 0,70 m.
[9] 2,65 × 1,90 m brenda., thell. > 0,90 m.
[10] Trash. e ndarëses perënd.: afër. 0,50 m.
[11] 1,60 × 1,20 m bren.; lart. > 0,90 m.
[12] Dia. 0,27 - 0,28 m ; thell. 0,26 m.
[13] Afërs. 1,29 m L - P × 1,85 m V-J, thell. >1,51 m.

DO NOT COPY



Shtypësja jug-lindore e N5 dhe vaska e ripërdorur për dekantim, drejt jugut (cl. N. Beaudry).

Dekantuesi zbrazej përtej murit të brendshëm, në një basen të tretë të vendosur në N3A dhe i gërmuar pjesërisht në 2009 (fig. 7)[13]. Faqet e tij të ndërtuara me gurë dhe tulla, formojnë një grykë të dalë, të mbështetur tek muret lindore dhe veriore të dhomës. Faqet e tij të brendshme dhe parvazi (buza) janë të suvatuara me llaç hidraulik, të zëvendësuar të pak-



Basenet veri-lindorë (shtypësja) dhe veri-perëndimorë (dekantuesi) i N5, drejt veriut, maj 2008 (cl. N. Beaudry).

tën dy herë. Në veri, perëndim dhe jug, tulla të lidhura me llaç formojnë një mur mbajtës që shërbente për të mbajtur një mbulesë druri[14]. Për mirëmbajtjen e basenit ndihmonte një shkallë e brendshme me dy shkallare në këndin jug-perëndimor.

Katër pithoi radhiten kundrejt murit lindor të dhomës N5 midis shtypësave jug-lindor dhe veri-lindor (fig. 3), njëri prej të cilëve u gërmua në 2007; fundi i tij ruante një trashësi të mirë bitumi. Dhomat N2 (fig. 2) dhe N3 ishin depo. N3, gërmimi i së cilës mbetet për t'u plotësuar, ofroi fragmente të të paktën dy pithoi-ve dhe mbulesave të tyre; N 2 kishte të paktën 6 të tilla, tre prej të cilave ishin futur pjesërisht rrëzë murit jugor të dhomës dhe ishin bashkuar me fragmente mbulesash (fig. 8). Të gjitha ruajnë gjurmë të një suvatimi të brendshëm me bitum, por ndryshimet tek brumi, profilet, dekoret (valët, shenjat e gishtave) dhe instalimet të bëjnë të mendosh se kapaciteti fillestar i magazinimit ka pësuar shtesa të njëpasnjëshme; përveç kësaj disa tokëza (kapëse) plumbi dëshmojnë se janë bërë riparime (ndreqje).

[14] Afërs. 1,55 m L - P × 1,90 m V-J.

DO NOT COPY



Basenet veri-lindorë (shtypësja) dhe veri-perëndimorë (dekantuesi) i N5, drejt lindjes, maj 2008 (cl. N. Beaudry).



Basenet e N5-N3A, drejt veriut, maj 2009 (N. Beaudry). Nga e djathta në të majtë : shtypësja (gjatë konsolidimit); dekantuesi (i mbuluar); rezervuari i N3A (gjatë gërmimit).

Një ndenjëse (bankëz) mbështetet në të gjithë gjatësinë e murit të brendshëm lindor të N2 dhe në muret veriorë e jugorë të dhomës në skajet e saj; faqja e sipërme e saj është e suvatuar me një llaç ngjyrë rozë, i ruajtur keq dhe i ndarë me kreshta në tre kompartimente (ndarje) konkave rreth 2 m (fig. 9).

Në kufirin mes hapësirave liturgjike, që i bashkohen katedrales dhe aktiviteteve ekonomike të qendërzuara në oborr (fig. 1), një depo (33) e gërmuar para 1989 përmban, mbetje in situ, të të paktën 16 pithoi-ve të mëdha. Disa prej tyre vazhdojnë të mbajnë gjurmë bitumi, që nxirrej në Selenicë dhe përdorej rëndom në Epir për të suvatuar faqet e brendshme të enëve të destinuara për ujë apo verë[15]. Pjesa më e madhe e tyre janë riparuar me kapëse prej plumbi, gjë që të bën të mendosh për një përdorim të gjatë apo intensiv.

Vlerësimi

Suvatë e shtypëses veri-lindore të N5 u konsoliduan në 2009 nga Agron Islami (Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë), i asistuar nga Ornela Durmishaj, me rastin e fushatës së gërmimeve në 2009 të misionit franko-shqiptar. Basenet e tjera, ndenjësja e N2 dhe pithoi e N2 dhe N5 janë mbuluar në pritje të restaurimit dhe vlerësimit te tyre. Ndërkohë, pithoitë e depos (33) janë objekt i një projekti restaurimi i nisur nga Parku Arkeologjik i Bylisit.

Përveç interesit të tij shkencor, ky kompleks paraqet një potencial të madh vlerash që duhen nxjerrë në pah; mbetjet janë të ruajtura mjaft mirë dhe janë lehtësisht të lexueshme, ato janë të vendosura mirë në rrethin turistik të vizitorëve midis katedrales dhe rrethimit mbrojtës të Viktorinos, dhe janë origjinale në shumë drejtime, qoftë edhe për lidhjen

[15] Y. Cerova, M. Bonifay et C. Capelli, 2005, « Amphores épirotes à corps globulaire du VIe s. découvertes à Byllis (Albanie) », in J. M. Gurt i Esparraguera, J. Buxeda i Garrigos et M. A. Cau Ontiveros (éd.), LRCË I, Late Roman coarsewares, cooking wares and amphorae in the Mediterranean: archaeology and archaeometry (BAR S-1340), 537-546, Oxford: Archaeopress ; S. Morris, 2006, « Illyrica Pix: the exploitation of bitumen in ancient Albania », in L. Bejko et R. Hodges (éd.), New directions in Albanian archaeology: studies presented to Muzafer Korkuti, 94-106, Tirana: International Centre for Albanian Archaeology.



Pithoi afër murit jugor të N2, drejt jug- lindjes, maj 2008 (cl. N. Beaudry).



Detaj (pjesa qendrore) e ndenjëses (bankëz) së N2, drejt lindjes, maj 2007; në plan të dytë, pithoi dhe shtypësja jug-lindore e N5 (cl. N. Beaudry).

e tyre me grupin episkopal. Peshkopi dhe peshkopata konsideroheshin ndër aktorët ekonomikë kryesorë të qyteteve të Antikitetit të vonë, qoftë si konsumatorë, qoftë si pronarë tokash, qoftë si prodhues. Zgjerimi i pronës episkopale në kurriz të hapësirës publike, ndërtimi i godinave të mëdha dhe ngritja e një industrie për prodhimin e verës intra muros janë po ashtu dëshmi të një aktiviteti intensiv të zhvilluar nga peshkopata e Bylisit nën strehën e rrethimit mbrojtës të Viktorinos. Zona që është objekt i këtij studimi ishte zemra ekonomike e pronës episkopale në gjysmën e dytë të shek. VI, e ndarë nga hapësirat liturgjike dhe në kundërshti me fasadën e saj monumentale, por gjithashtu e dallueshme nga prona publike.

Ndërkaq, ndërsa pasiguria po zgjaste, kushtet ekonomike ndryshuan shpejt në Bylis në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. VI. Nëse baseni N3A mundi të qëndronte funksional deri në braktisjen e zonës, dy basenet e vendosur në krye nuk ishin më funksionalë, sepse faqja jugore e basenit veri-perëndimor të N5 u prish dhe grykëderdhja e tij tek N3A u tapos me llaç. As shtypësja jug-lindore e N5 nuk duket të ketë qenë funksionale kur ndërtesa u braktis. Nëse katedralja dhe ndërtesat e tjera kanë pësuar një shkatërrim violent (të dhunshëm), që ndoshta i atribuohet ndonjë kthimi të sllavëve, nuk mundet që ta përgjithësosh këtë skenar madhështisë së sitit. Lagja episkopale duket se ka njohur një rënie (rrënim) të gjatë, ku disa aktivitete, mjedise dhe ndërtesa u lëshuan gradualisht mjaft përpara braktisjes thuajse të plotë të sitit nga fundi i shek. VI apo fillimi i shek. VII. ■

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Wine Distillery Workshop at the Bylis Episcopal Pre-Christian Quarter

Nicolas Beaudry

DO NOT COPY

Bylis ruins are placed at the top of the Hekal hill, which dominate right mound of Vjosa River or ancient Aoos, at east boundary of the Mallakastra hills.

Bylis was among the most important cities of New Epir like Dyrrachion (Durres), Scampis (Elbasan), Apollonia and 6 other cities as independent Episcopal Centre since the middle of V century. Bylis and its region with the collapse of Apollonia, the last finish development period, and this is proved by reconstructions made to protecting walls and building of some civil and religious monuments. During the centuries V and VI happened many ruthless concussions at entire Balkan Peninsula countries and also invasions, attacks and dislodged of many new people follow each other. Lack of confidence gives the important effort for fortification and this became greater at the VI century also during this time Slav pressure, oblige the remain habitants of Bylis to abandonee the city; Episcopal Centre and citizens moved towards Ballsh (Glavenicë), which has plenty water and has built a Christian Basilica before middle of the VI century.

Bylis never re-populated even for short times and for the reason that the water at the area has served as pasture for livestock for Hekal peasants which are established hillside by beginning of XIII century. Bylis in nowadays is represented as phantom-city of the Late Antiquity, conserved at very good conditions and with scientific potential, cultural and touristic potentials which is needed to be valuable.

Urban landscapes change at late Antiquity because big Hellenistic and Roman public monuments serve at the same time as stone-pit or foundations for the new constructions. Excavation done by Skënder Muçaj on behalf of Archeological Institute of Tirana (1978 – 1991) has represented precious remains of this period, they allow understanding of the Hellenistic and Roman cities development, its Christianize and improvement of urban and monumental landscape during late Antiquity. Publication of this result was the first duty of the Archeological Albanian-French mission created by Archeological Institute of Tirana and French School of Athena on 1999.

Removing of a stone coatings on 2002 bring out plan of a later expansion towards the earth of cathedral edifice, beyond the main corpora when a storehouse (33) is placed at south-east corner. Big construction named N, which is oriented towards the east up to the extensive north-south passing which has begun its excavation on 2007 (photo.2, 3). External walls on south, east and north east belong to the same build phase which is oldest than main corpora construction itself. Three successive readjustments precise four internal spaces which are: an

oriental room (on east) N5, long and narrow, when can entered by the garden L by passing to a door at its south wall; a room on the south-west N2 which is communicable with storehouse (33); a room on the north-east N3; a little space N3A which intercommunicate with other three rooms with doors at each inner wall. Floor was by hard pan. Wooden carcass of the roof is held partially on the strong tower raised on the centre N2, and other part on the arches.

Except the scientific interest this complex represent also a great values potential which are needed to be expose; remains are conserved very good and are easily understandable, they places vary good at touristic area of visitors between cathedral and Victorian protective enclosure, and they are original in many directions, also and notwithstanding with Episcopal building. Bishop and episcopate are considered among the main monetary actors of the late Antiquity cities considered as consummators, landholders and manufacturers. Enlargements of the Episcopal property against the public space, building of the great constructions and building of an industry for wine production intra muros are an acknowledgment for an intensive activity conducted by Bylis Episcopal under the cover of protective enwalls of Victorian. Area which is subject matter of this study was economic main center of this Episcopal property on the second half of the VI century, and this from one side is divided by liturgies spaces and they are against of its monumental façade and this on the other side is very noticeable by public property.

In the meantime, uncertainty continues, and economical situations change during the end of VI century. Basin N3A was functional up to quarter abandonment; two other basins were not functional because the south side part of north-west N5 basin collapse and basin inlet was corked with mortar. The south-east pestle N5 was not functional were the building was abandonee. The cathedral and other building has occurred rigorous destroy which may be was attribute to Slav return. Episcopal quarter was under long destruction because some activities stop earlier of total site abandonment which give the impressions too happened during the end of VI century or beginning of VII century. ■

DO NOT COPY

GJURMË TË REJA NË VIA EGNATIA

PROF. DR. ILIR GJIPALI

DO NOT COPY

Itinerari Aulona-Scampis

Fillimi i gjurmimit disavjeçar[2] për vrojtimin pjesë-pjesë të të gjithë segmenteve të Via Egnatia-s nëpërmjet kërkimeve sipërfaqësore, gërmimeve e sondazheve, kishte për qëllim nxjerrjen e të dhënave të reja pas mungesës së kërkimeve për një periudhe të gjatë kohore. Projekti synonte studimin e trashëgimisë arkeologjike dhe historike të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me Via Egnatia-n, përfshirë dhe monumentet e qendrat arkeologjike të të gjitha periudhave. Përfundimi i këtyre kërkimeve në aksin kryesor dhe në degën jugore të Via Egnatia-s në vitin 2005, krijoi mundësinë për të kaluar në fazën e dytë, atë të studimit dhe përgatitjes për botim të rezultateve të kërkimeve në terren.

Materiali që prezantojmë, ka për qëllim të jap në mënyrë të përmbledhur vetëm të dhënat e reja të përfituara në terren për degën jugore të Via Egnatia-s nga pikënisjet Aulona-Apoloni, deri kur ajo takohet me arterien kryesore në Peqin - Elbasan.

Për lehtësi të kërkimit, territori në vrojtim u nda në disa segmente si: Aulona - Apoloni, Apoloni deri në Urën e Kuçit (në Seman) dhe prej këtu, kërkimi vazhdoi nëpërmjet dy linjave: njëra përmes Pllajës së Dumresë deri në Elbasan dhe tjetra duke kaluar rrëzë kodrave të Lushnjës - Thanasaj (në bregun e majtë të Shkumbinit) - Peqin - Elbasan. Për kuptimin e dinamikës së rrugës në funksionimin e saj kohor, ndihmuan ndjeshëm edhe të dhënat hidrografike, gjeomorfologjike e mjedisore të Ultësirës Perëndimore nga Durrësi në Vlorë dhe shtrirjen e saj drejt lindjes në rrjedhjet e mesme të lumenjve Shkumbin, Seman dhe Vjosë. Këto të dhëna ishin të domosdoshme për arsye se territori në fjalë i është nënshtruar ndryshimeve gjeomorfologjike nga antikiteti deri në kohën e sotme[3].

---

[1] Projekti për Via Egnatia i organizuar nga Instituti i Arkeologjisë (IA) dhe Qendra Ndërkombëtare për Arkeologjinë Shqiptare (QNASH), zhvilloi kërkime gjatë viteve 2000-2005, në itinerarët që përshkon kjo rrugë brenda territorit shqiptar.

[2] Anëtarët e grupit drejtues të Projektit të Via Egnatia përveç autorit të këtij shkrimi, ishin M.G. Amore, L. Bejko, dhe Y. Cerova. Gjatë punës në terren kontribuuan gjithashtu arkeologët S. Lela, R. Hasa, M. Haxhimihali, E. Agolli dhe S.Mullai. Pjesë e stafit ishin për çdo vit edhe studentë të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Për kërkimin në terren të Degës Jugore të Via Egnatia (në territorin Ura e Topçiasit - Vlorë) u morën në mënyrë të veçantë I. Gjipali dhe S. Lela, me aksin Elbasan - Durrës, M. G. Amore, L. Bejko e Y. Cerova, ndërsa në segmentin Elbasan - Qafë Thanë, kërkimet u kryen me punën e përbashkët të të gjithë stafit.

[3] E. Fouache, Gj. Gruda, S. Muçaj, P. Nikolli, Recent geomorphological evolution of the deltas of the rivers Seman and Vjosa, Albania, "Earth Surface Processes and Landforms", 26, 2001, f. 793 – 802.

E. Fouache, J-F. Pastre, Ph. Lenhardt, Etudes geographiques. In Chronique des fouilles a'Apolonia d'Illyrie en 1995 (Albanie). Bulletin de Correspodance Hellenique (II) 120, f. 988-993.; A. Baçe, A. Aleksi, Skelat Grykëlumore të Adriatikut gjatë Mesjetës, Monumentet, Nr.I / 1986, f.25; Gj. Karaiskaj, Kalaja e Bashtovës, Monumentet, 5-6, 1973, f. 59; N. Ceka, Pirgu i Myzeqesë, Monumente historike të vendit tonë, f. 68-71, (Instituti i Monumenteve të Kulturës), Tiranë 1978.

DO NOT COPY

në fillim variantin e dhënë nga shumë autorë, sipas të cilit, rruga kalonte në fundin e kodrave të Roskovecit (ky i fundit është konsideruar si stacion i Stefanafanës) e të Kutallisë etj., deri në kalimin e Semanit. Terreni i kontrolluar në të gjithë këtë hapësirë, nuk ofroi të dhëna arkeologjike që mund të lidheshin me periudhën romake apo romake të vonë, prandaj vrojtimi u spostua në fushë pranë kalimit të lumit të sotëm të Semanit nga territori i Novoselës drejt Jagodinës, Sukut, Goriçanit e Hinkës.

Si rezultat, me interes ishin gjetjet arkeologjike në fshatin Novoselë që nga koha e ndërtimit të serave, në një sipërfaqe që llogaritet rreth 3 ha (themele banesash, 0.60 m të trasha, ndërtuar sipas teknikës opus mixtum, gjetja e tullave romake, varre të mbuluara me tjegulla, një furrë për pjekjen e enëve prej balte dhe bashkë me to tuba prej balte, të cilët kishin shërbyer për furnizimin me ujë. Drejtimi i tubacioneve tregonte se furnizimi me ujë bëhej nga kodrat e Dukasit. Të gjitha këto ishin zbuluar në një thellësi rreth 1m. Për të provuar edhe njëherë shtrirjen, intensitetin e përkatësinë kohore të këtyre gjetjeve të evidentuara shumë viteve më parë, u organizua kërkimi sipërfaqësor me shtrirje 150 m (l - p) dhe 200 m (v - j), i cili grumbulloi një material qeramike të datuar në shek. II – IV e.s[8] . Duke u nisur nga këto të dhëna dhe nga distanca me Apoloninë dhe Urën e Kuçit, mendojmë se këtu duhet të kërkojmë stacionin (mutatio) e rrugës që shumë studiues pa u mbështetur në të dhënat arkeologjike ia atribuojnë Roskovecit. Më në veri të Novoselës (ose Novos) në territorin Jagodinë - Sukë i Sipërm u evidentuan disa vende ku bimësia ishte më e dobët, të dallueshme veçanërisht në stinën e pranverës[9] .



Fig. 3. Foto ajrore pranë fshatit Jagodinë ku mendohet se kalon dega jugore e Egnatia-s

Këto konstatime vërtetohen edhe nga një e dhënë tjetër që vjen nga disa foto ajrore të marra nga N. Ceka[10] në territorin e Jagodinës (Fig. 3). Ato prezantojnë një gjurmë shumë të dallueshme nga ndryshimi i ngjyrës së bimësisë, me linjë të gjerë, në formën e një harku të butë pranë Jagodinës, e cila vazhdon nga veriu me një linjë të drejtë duke iu drejtuar fshatit Sukë. Këto gjurmë N. Ceka e lidh me ato të trasesë së degës jugore të Egnatias, e cila përputhet me gjurmët e tjera në Suk të Sipërm dhe Goriçan Xhahil. Në këtë të fundit, fermerë të fshatit gjatë punimeve bujqësore, kishin hasur në një kalldrëm në një thellësi më shumë se 1 m, me drejtim veri-jug nga i cili kishin marrë gurë për ndërtimin e shtëpive. Ata tregonin se kalldrëmi ishte i gjerë dhe i ndërtuar me gurë në dy shtresa. Të vjetrit kishin dëgjuar për ekzistencën e një rruge të vjetër që kalonte pranë fshatit, por nuk e dinin se ku, deri në zbulimin e kalldrëmit. Drejtimi i gjurmëve të konstatuara në Goriçan Xhahil i korrespondonte nga jugu një linje të drejtë që bashkohej

[8] Në anën lindore ku vazhdonin gjetjet, prej banorëve mësuam se ky vend njihej nga të vjetrit me emrin Novo".
[9] Banorët e këtyre fshatrave i shpjegonin ato si gjurmë rruge me kalldrëm që pengon rritjen normale të bimësisë duke krijuar diferencë edhe në ngjyrë.
[10] Fotot janë marrë nga helikopteri në zonën e Jagodinës nga Neritan Ceka të cilin e falënderojmë për vënien e tyre në dispozicionin tonë.

DO NOT COPY

me Sukun e Sipërm dhe Jagodinën. Në anën verilindore të fshatit, mbi kodrën e Malasit, kishte pasur një kishë të vjetër që quhej "Kisha e Malasit". Nga vrojtimi në terren u gjetën mjaft fragmente tullash e tjegullash dhe më pak fragmente enësh të datuara të antikitetit të vonë. Përmendja nga vendasit edhe të një degëzimi nga Suku në Strum, që shkonte drejt lindjes, mund të ketë pasur si orientim lidhjen me Beratin dhe Kalanë e Krotinës (Dimalin).

Pas fshatit Goriçan Xhahil rruga duhet të vazhdonte në perëndim të Goriçan Pasha drejt fshatit Hinkë për të dalë tek Ura e Kuçit ose më në perëndim dhe pas kalimit të lumit të Semanit, dy mundësi diktonte terreni për t'u bashkuar degës kryesore të Via Egnatia: kalimi në anën perëndimore të kodrave të Lushnjës për në Thanasaj e më pas në Peqin dhe varianti i dytë, kalimin nëpërmjet pllajës së Dumresë për të dalë në Peqin ose Elbasan.

• Ura e Kuçit - Lushnjë - Peqin

Nga kërkimet e deritanishme në segmentin Ura e Kuçit-Lushnjë-Thanasaj-Peqin nuk u evidentua ndonjë gjurmë rruge që të lidhej me antikitetin. Të gjitha të dhënat flisnin për rrugë mesjetare.

Kështu në Golem të Madh, të cilin shumë autorë e identifikojnë me një nga stacionet e rrugës Egnatia, të dhënat arkeologjike mungonin, gjë që e bën të vështirë të mendosh se ato janë zhdukur plotësisht. Gjithashtu, Ura e Kasharajt (Fig. 4), që disa studiues e kanë datuar si të periudhës romake rezulton që të jetë e periudhës mesjetare si ajo e Karbunarës. Variantet e shumta që ekzistojnë për rrugët mesjetare si në perëndim të kodrave të Lushnjës, ashtu dhe për ato tërthore që përshkojnë zonën e Darësisë e Dumresë me drejtim për në Peqin dhe Elbasan, nuk japin gjurmë arkeologjike që të lidhen me periudhën antike. Nuk mund të përjashtohet fakti se linja që



Fig. 4. Pamje e Urës në Kasharaj të Lushnjës

kalonte në terrenin natyror në perëndim të kodrave të Lushnjës gjatë stinëve të thata, të jetë përdorur edhe para mesjetës, por të dhënat që njihen deri tani nuk flasin për një rrugë ku të jetë investuar në trase, ura, apo stacione siç ndodh me rrugët romake.

Problem kyç në kërkimet, për degën jugore të Via Egnatias, mbetet vendi i takimit të saj me atë veriore. Territori i kërkimit në lidhje me vendtakimin, duke u mbështetur në të gjitha variantet e propozuara nga autorët që janë marrë me të, përqëndrohet në hapësirën e luginës së Shkumbinit nga Elbasani deri afër derdhjes së Shkumbinit në det, në urën pranë Bashtovës. Vrojtimet në terren në zonën që përfshihet

DO NOT COPY

midis Elbasanit dhe Peqinit nuk dhanë gjurmë për kalim tjetër me urë të lumit të Shkumbinit, përveç Urës së Topçiasit. Prashniker[11] në librin e botuar për kërkim et arkeologjike në Shqipëri e Mal të Zi, duke cituar M. Kaucky, thotë se kanë ekzistuar rrënojat e një ure të vjetër me këmbë të derdhura në Peqin nga ana jugore. Nga kërkimi në vend nuk u konstatua asnjë gjurmë në sipërfaqe që mund të ndihmonte për të vlerësuar përkatësinë kohore si dhe realacionet me këtë rrugë. Gjithashtu, kontrolli i gjithë luginës në krahun e majtë të rrjedhjes së Shkumbinit nga Elbasani në Peqin e deri në Thanasaj nuk dha shenja të ekzistencës së ndonjë traseje rruge antike apo ure[12] .

Në kushtet kur kërkimi në anën perëndimore të kodrave të Lushnjës drejt fshatit Thanasaj (për t'u lidhur më pas me Peqinin) nuk dha gjurmë, ato do t'i kërkonim në anën veriore të luginës së lumit të Semanit, në kalimet për në pllajën e Dumresë. Kalimi më i shkurtër dhe i drejtëpërdrejtë i rrugës që vjen nga fshatrat Goriçan e Hinkë pas kalimit të lumit është ngjitja në Dumre nëpërmjet Thanës ose Sejmenasit për të dalë në Kosovë të Madhe. Mundësi tjetër është kalimi në lindje të të parës, pranë digës së rezervuarit të Thanës për të dalë më pas në Salc Kozare-Vlashuk. Të dy kalimet pasi përshkojnë pllajën e Dumresë, të shpien në Qafën e Belshit dhe Shalës.

• Sejmenas – Kosovë e Madhe – Shalës

Kërkimet në fshatin e Thanës nuk dhanë ndonjë gjurmë arkeologjike, kurse në Sejmenas në vendin e quajtur "Kodra e Sejmenasit" shumë vite më parë nga punimet e ndryshme bujqësore janë zbuluar varre me tjegulla të periudhës romake. Inventari i tyre përmbante enë të ndryshme qeramike, si dhe objekte metalike. Gjetje të tjera janë një pllakë guri e punuar, një pllakë me mbishkrim dhe një furrë për pjekjen e tullave dhe tjegullave, që nuk ruhen.

Në kodrën në lindje të fshatit ndodhen rrënojat e një kishe, e njohur si kisha e Shën Sotirit, ku më parë janë gjetur fragmente enësh qeramike, gurë mokre, si dhe varre. Rruga sipas banorëve të Sejmenasit ka kaluar në lindje të fshatit në Qafën e Sejmenasit dhe më tej në drejtim të veriut përgjatë fundit të kodrave, ka vazhduar pothuajse në vijë të drejtë deri në Kosovë të Madhe. Këtë rrugë ata e quajnë "Rruga e Vlorës".

Edhe në Kosovë ka disa vendgjetje arkeologjike. Brenda fshatit aty ku janë ndërtuar disa pallate banimi, kanë dalë shumë tjegulla, tulla e fragmente qeramike, që vendasit e quanin "Sopi i Hanit" dhe territorin perreth "Kopshti i Hanit". Pranë vatrës së kulturës ka qenë "Karakolli" që ka shërbyer për mbrojtjen e karvaneve. Në anën veriore të Sopit dhe Kopshtit të Hanit ndodhen disa ara që vendasit i quajnë "Vesht e Davidit". Në anën perëndimore të fshatit është gjetur një tubacion prej qeramike që fillonte në lartësinë e "Malit të Breshkës" dhe zbriste drejt trasesë së rrugës. Ruheshin 2 tuba të gjatë 0. 275 m, përfshirë edhe pjesa që futet në tubin tjetër me gjatësi 0. 30 m. Diametri i jashtëm ishte 0. 115m, i brendshmi 0. 095 m. Të gjitha këto të dhëna tërheqin vëmendjen në lidhje me stacionin që duhet t'i korrespondonte distancës nga Novo (Novoselë) në territorin para ose pas kalimit të lumit të Semanit (Apssos). Nga njohja e deritanishme atë mund ta kërkojmë si në Sejmenas ashtu edhe në Kosovën e Madhe. Ekziston edhe mundësia e një zhvendosje të stacionit nga njëri tek tjetri në kohë, por gjurmimi i tyre kërkon investigime të tjera dhe gërmime arkeologjike në të dy pikat.

---

[11] Marrë nga M. Kaucky, Österr. Monatsschr. f.d. Orient XXXXII 1916, f.46, fig.5

[12] M.G. Amore, L. Bejko, Y. Cerova, I. Gjipali, Via Egnatia: Rezultate të vitit 2003, Candavia, 1, 2004, faqe 40.

DO NOT COPY

Për vazhdimin e rrugës nga Kosova në drejtim të Belshit, të dhënat e terrenit tregojnë se ajo kalonte në Fierzë, më pas rruga i drejtohej fshatit Çepë duke kaluar përgjatë një kodre që thirret "Bregu i Shefitit" duke lënë majtas Hardhinë e Butë, ndërsa djathtas Seferanin për të dalë në "qafën e Belshit". Gjithë traseja e kësaj rruge të shtruar me kalldrëm në kohën e krijimit të fermave është e vendosur mbi të vjetrën dhe ruan një gjerësi rreth 5 m duke përshkuar një linjë me ngritje apo zbritje të buta. Nga Kosova është i mundshëm edhe varianti i kalimit të rrugës nga fshati Çërragë, duke ruajtur drejtimin V-J, për tek Hardhia e Butë dhe më tej në fshatin Çepë. Gjatë këtij itinerari rruga kalon pranë liqeneve të Degës, që është midis Çerragës dhe Hardhisë së Butë, në Çepë liqeni i Merhojës dhe në liqenin e Dorbnit.

Duke ndjekur mundësinë e dytë për të kaluar Pllajën e Dumresë, rruga kalonte nga Thana, për në digën e liqenit të Thanës rreth 20 m paralel me të, tek Ura e Plakës (Salc Kozare), në Vlashuk. Nga Vlashuku[13] kalohej në Dragot ku rruga e vjetër përputhej me rrugën ekzistuese. Në fshatin Dragot sipas informacionit të vendasve, kishte të dhëna për gjetje arkeologjike që ishin kryesisht objekte metalike dhe qeramikë. Tek vendi i kishës së Shën Mërisë kishte pasur gjurmë rrënojash të një banimi më të hershëm. Gjithashtu shenja qeramike kishte edhe ne vendin e quajtur Bregu i Gjelit dhe në çezmën e Bakos. Bregu i Gjelit gjendet në anën veriore të Dragotit dhe mendohet të ketë qenë një vendbanim i hershëm.

Traseja e rrugës pas këtij bregu i drejtohet fshatit Kajan. Në vargun e kodrave të Shulloit, rruga e vjetër shmanget nga traseja e re duke ndjekur shpatin e kodrës. Në këtë pjesë rruga ka gjerësinë maksimale prej 8 m. Banorët përmendnin Vreshtin e Shulloit si një zonë me gjetje arkeologjike. Ai gjendet në kurrizin e kodrës pranë së cilës kalonte rruga. Edhe në Kajan në përgjithësi traseja e rrugës së vjetër përputhet me atë të re dhe kjo është arsyeja pse ne nuk mund të shihnim gjurmët e trasesë së vjetër. Vetëm në një rast pas fshatit Kajan dalloheshin gjurmët e kalldrëmit të vjetër brenda trasesë së re të rrugës (Fig. 5) kur ajo kalon drejt V - P duke iu afruar Gradishtës për të dalë në Qafën e Belshit.

Nga Qafa e Belshit, rruga antike devijon nga rruga e sotme Kosovë-Qafë e Belshit, për të vijuar më tej në Shtinth duke kaluar në jug të Sopit të Rokatës dhe më pas në jug të liqenit të Kashtës dhe më tej në lindje të fshatit Shalës. Deri tek vendi i quajtur Sopi i Kopërit, rruga antike duhet të ketë kaluar drejt VL e më pas drejt veriut qarkon kodrat e Blatës në Shalës, duke vijuar përgjatë fundit të Sofrës së Koprit deri në pjesën veriore të saj. Nga Kosova deri në Cërrik rruga ka qenë thirrur "Rruga e Vromit".

• Shalës (Sopi i Kishës) -Ura e Topçiasit

Në anën lindje të Shalësit (rreth 1 km) ndodhet kodra Sopi i Koprit ku janë gjetur mbetje të një vendbanimi të periudhës romake dhe më tej pasi zbret në fushë në anën lindore, ndodhet Sopi i Kishës. Në hapësirën, midis rrëzës së kodrës të Sopit të Koprit dhe Sopit të Kishës, rezulton se kalon rruga antike që vjen nga Qafa e Belshit. Sopi i Kishës ndodhet në një distancë rreth 250 - 300 m në JL të Sofrës së Koprit, në rrugën që të çon nga Shalësi për në fshatin Shtërmen. Vendi ka një ngritje të butë në raport me terrenin përreth, prandaj edhe vendasit e quajnë sop. Mbi sipërfaqe ruhet më mirë një trakt muri me gurë e rreshta tullash me përmasa 2 x 0. 80 m x 0. 70 m që ndodhet në anë të trasesë së rrugës (Fig. 6). Pjesët

[13] Një degëzim i rrugës nga Vlashuku të shpinte edhe në Dëshiran, Grekan, Gjyralë dhe Shalëz por, rezulton të jetë më shumë një rrugë mesjetare

DO NOT COPY

e tjera të rrënojave, ruheshin në nivelin e bazës, siç duket kalimi i rrugës i ka rrafshuar ato. Pas pastrimeve të kryera tek Sopi i Kishës rezultoi se rrënojat përmbanin dy ambiente në anën jugore të murit të emërtuara A dhe B. Në ambientin A (ana jugore e murit) u gjet një pjesë e dyshemesë e shtruar me tulla me përmasa (0. 40 x 0. 45 m). Trashësia e mureve të këtij ambienti varionte 0. 60 - 0. 70 m.

Pastrimi i mëtejshëm në anën veriore dhe lindore të ambienteve A e B nxori mbetje të një hipokausti dhe të një depozite uji, të cilat treguan se i përkisnin një terme.

Terreni përreth zë një hapësirë 2-3 ha me gjetje intensive të qeramikës që i përkisnin periudhës romake. Të njëjtën përmbajtje kishte dhe qeramika e mbledhur në Sofrën e Koprit. Duket se kemi të bëjë me mbetjet e një stacioni të kësaj rruge të pajisur edhe me termë.

Rruga antike ka vijuar pas këtij stacioni në linjë të drejtë deri tek rruga e fermës, që ndodhet në lindje të vendit ku kryqëzohen rrugët që vijnë nga Cërriku, Shalësi, Papëri për të vazhduar në Belik drejt Urës së Gurit në perëndim të fshatit Muriqan, e cila nuk ruhet më. Tek kjo urë bashkohej edhe një degëzim tjetër që vinte nga drejtimi pas Cërrikut fshat, në veri të Cërrikut qytet dhe më pas duke dalë mes fushave, kalonte tek lagjja Lushaj në Shtërmen, në Zallin e Gostimës dhe përmes Gostimës kalonte urën në lumin Devoll pak më në lindje të urës së sotme, ku ruhen gjurmë të një ure të periudhës romake. Kjo ishte urë me qemer dhe dukej se lidhte në antikitet Elbasanin me Beratin.

Një degëzim tjetër kthente para se të dilje në urën e Gostimës majtas, duke lidhur Devollin me Gramshin. Nga Ura e Gurit, rruga kalonte në drejtim të Muriqanit[14] në lindje, duke vazhduar drejt Jagodinës. Në territorin në afërsi të fshatit Belikë deri në Jagodinë, siç rezulton kanë ekzistuar tre ura, pjesë të trasesë së rrugës së vjetër. E para midis Belikës dhe Murriqanit, e dyta brenda Murriqanit dhe e treta në kufirin midis fshatit Jagodinë dhe Murriqanit. E para është ngritur mbi përroin e Verdhores (Trandofiles), ndërsa dy të tjerat mbi degëzimet e përroit të Llixhës.



Fig. 5. Gjurmë të kalldrëmit të vjetër në rrugën Gradisht – Kajan

[14] Në Murriqan vendasit tregonin për prishjen e një trakti mjaft të vjetër rruge kalldrëmi të mbuluar me depozitime mbi 1.5 m, i panjohur për banorët megjithë punimet e përvitshme bujqësore i cili doli rastësisht disa vite më parë dhe më pas u shfrytëzua nga banorët përreth për të marrë gurë për ndërtimin e banesave të tyre. Ata ishin në gjendje të tregonin edhe për konstruksionin e trasesë, të ndërtuar brenda dy mureve të fuqishëm që shërbenin si kufizime anësore, ku hapësira midis tyre mbushej me gurë lumi të mëdhenj e mesatarë duke arritur një gjerësi rreth 3-4 m ose më shumë. Në një nga këto familje ruhej një grumbull i madh gurësh shtufor e gëlqerorë të nxjerrë nga traseja e vjetër që nuk ishin ripërdorur me përmasa 0. 30 x 0. 25 m; 0. 20 x 0. 15 m; 0. 40 x 0. 25 m.

DO NOT COPY



Fig. 6. Rrënojat e termës në Sopin e Kishës në lindje të Shalsit (Elbasan)

Rruga nga Murriqani me drejtim V-L futej në Jagodinë ku u zbuluan mbetjet e një ure të periudhës romake (me një hark), me orientim verilindje-jugperëndim dhe me gjerësi 4.5 m. Ura nuk ruhej e plotë. Këmba jugore ishte shumë e dëmtuar[15], ndërsa ajo veriore ruhej më mirë në tërë gjërësinë dhe me një pjesë të harkut. Përmasat e mbetjeve të këmbëve ishin: -këmba veriore ishte me gjerësi 4. 5 m, gjatësi 1. 9 m dhe lartësi 0. 95 m, ku ruheshin nga harku 12 rreshta me tulla (me përmasa 0. 38 x 0. 22 x 0. 045 m dhe 0. 34 x 0. 22 x 0. 045 m) të lidhura me llaç gëlqere me trashësi 4–6 cm: - këmba jugore me gjerësi 2 m, gjatësi 0. 85 m dhe lartësi 0. 42 m (Fig. 7).

Pas harkut të ndërtuar me tulla, pjesa tjetër e urës vazhdon me gurë të punuar në faqet e jashtme, të përmasave të mëdha e mesatarë 0. 25-0. 45 m, ndërsa në brendësi është mbushur me gurë të papunuar lumor të lidhur me llaç të bollshëm të përzier me gurë të vegjël me përmasa 0. 06-0. 12 m. Pjesa e brendshme e harkut të urës nga armatura është mbushur pothuaj në të gjithë sipërfaqen me një shtresë llaçi.

Pas Urës në Jagodinë gjurmët e rrugës të çojnë në shkollën e Bujqësit, në vendin Molarak brenda fshatit. Edhe këtu kishte dalë një pjesë kalldrëmi me drejtim V-J e zbuluar me rastin e hapjes së një kanali të thellë 2 m. Gurët ishin gurë lumi dhe të palidhur me llaç. Kalldrëmi ishte prishur vetëm në vendin ku u hap kanali dhe në të dy anët e tij ai vazhdonte. Më tej drejtimi i rrugës orientohej drejt Urës së Topçiasit, e më pas përfundonte në Elbasan.

Kërkimi disavjeçar në territorin e degës jugore të Via Egnatia përveç zbulimit të të dhënave të reja arkeologjike në të gjithë segmentet e saj (si gjetjet brenda qytetit të Vlorës, në zonën në perëndim të Akërnisë, në Novoselë (Fier), Jagodinë, Suk i Sipërm e Goriçan Xhahil, në Sejmenas dhe Kosovë të Madhe, në fshatin Çepë (Bregu i Shefitit), Sopi i Koprit e Sopi i Kishës, gjurmët e Urës së Vjetër mbi Devoll, ato të trasesë së rrugës në Kajan, Murriqan, Jagodinë e Bujqëz krijuan një përfytyrim më të plotë e më të detajuar për të dhe nëpërmjet tyre morën përmbajtje edhe shumë zbulime të viteve të mëparshme.

Megjithëse mbeten përsëri segmente e vendgjetje për të hetuar e gërmuar, nisur nga tabloja e krijuar prej gjurmëve të reja të evidentuara në degën jugore të Via Egnatia, bëhet e mundur të ndiqen linjat e përgjithshme të segmenteve të saj nga Vlora në Elbasan:

- Segmenti Aulon – Apoloni, Vlorë – në lindje të Treportit - në perëndim të Akërnisë – Poro Marinaj (Vlorë)- Poro e Fierit-Fiksit-Sllanik (lumi i vdekur)-Shënepremte- Sop dhe mbërrinte në Pojan (Apoloni).
- Segmenti Apoloni – Ura e Kuçit, Apoloni - rrëzë kodrave të Kryegjatës - Radostin -Vadhizë - Zhu-

[15] Pronarët e tokës para pak vitesh e kishin shfrytëzuar për nxjerrjen e gurëve për ndërtimin e banesës.

DO NOT COPY



Fig. 7. Mbetjet e urës romake në Jagodin (Elbasan)

pan - Mbyet - midis Frashërit dhe Verbasit -Novoselë - Jagodinë - Suk i Sipërm - Goriçan Xhahil - Hinkë për tek Ura e Kuçit.

- Segmenti Ura e Kuçit – Qafa e Belshit – Shalës (Sopi i Kishës).

Deri në mbërritjen tek Qafa e Belshit ekzistojnë dy linja:

a) Ura e Kuçit-Sejmenas-Kosovë e Madhe -(Fierzë ose Çëragë) -Hardhi e Butë - Çepë - Qafa e Belshit.

b) Ura e Kuçit - Thanë - Salc Kozare -Vlashuk - Dragot -Kajan -Qafa e Belshit.

Nga Qafa e Belshit rruga ndiqte drejtimin Shtinth - jug të Sopit të Rokatës - jug të Liqenit të Kashtës - lindje të Shalësit (Sopi i Kishës).

- Segmenti Sopi i Kishës – Elbasan, Sopi i Kishës-në afërsi të Cërrikut - Belik - Ura e Gurit -Murriqan -Jagodinë - Bujqës - Ura e Topçiasit -Elbasan. ■

New Traces at Egnatia Via

Ilir Gjipali

DO NOT COPY

Searches for Via Egnatia was organized by Archeologic Institute (AI) and International Centre for Albanian Archeology (ICAA), at the itineraries which accross this road in the Albanian territory.

Many year trace of all segments of Via Egnatia with surface searches, excavations and surveys was done with purpose of the new data for its study by using the newest modern method.

Territories under study was divide in some segments like: Aulona - Apoloni, Apoloni up to Kuçi Bridge (Seman) and from here the research continue with two lines: one from Pllaja e Dumresë up to Elbasan and the other from edge of hills of Lushnja - Thanasaj (left coast of Shkumbini river) - Peqin - Elbasan.

Aulon - Apoloni Segment

Data coming from archeological excavations shows that the life in the cities of (Treport, Vlora), has finished gradually because of track change of Vjosa River and its mouth but the contrary has happened with old Vlora which was developed as a very important urban centre. Here we must search for Aulona as a starting point of Egnatia. Until now the researches to north side of Vlora, shows that there are no any antic road traces but only some part of medieval road between Well of Mezinit and Narta (Photo.2). Track of an antic road is discovered at a north side of Treportit, when lagoons begins and continue inside the swamp before the Zvërnec Monastery. Other traces are discovered at the north part of Narta swamp, at west of Akërnia and new aerodrome after the drainage of that part many years ago. Checking of the area was done with investigations and this give result of ceramic which belong to Roman period. Information collected at right side of Vjosa River, at Poro of Fier city, shows that the road continues in Boçovë-Fiksit- Sllanik (Dead River) - Shënepremte - Sop and finished at Pojan (Apolonia). Archeological material at the west of Akërnia divides the length of segment Vlorë - Apoloni in two parts, approximately the same. Passing of Vjosa through bridge must search at suspend of antic road trace with old river trace.

Apoloni – Kuçi Bridge

South wing of Via Egnatias at antic city of Apollonia, begins at river port of Vjosa, close to village Shtyllas. Antic road follows edge of Kryegjata hills, between Apollonia hills, continue at the end of hills to the Radostinë, in Vadhiza, go after the hills by kepping southeast direction up to Zhupan village. It prolong as a direct line from this village, from soth to east,

DO NOT COPY

at the direction of the hills to the Mbyet village, and here the road overpass Gjanica stream. Following the northeast direction road turns at the direction of Frashër and Verbas, continue at north of the oil platform to the Novosela. Searching in the terrain for continuing of the road towards the Kuçi Bridge, follow the examples given by many authors, which was: road bypasses at the end of Roskovec Hills (considered as Stefanafanës station) and Kutallia etj., up to Seman exceed. Terrain controled at all this area doesn't give archeological data which may be will linked with roman era, so for that reason the survey continue at field close to the nowadays track of Seman River from Novosela terrain toward Jagodina, Sukut, Goriçan and Hinka. Archeological remains at Novosela willage were with importance in a surface around 3 hectare. Archeological material collected after the surface explore which belong the II-IV centuries after Christ prove the period which they belong. Considering these data and the distance between Apollonia and Kuçi Bridge, we think that here in this place we will search the Station (mutatio) of the road wich according to the many reaearches are connected with Roskoveci Station.

Other data are given from air photo taken at Jagodina territory (Photo.3). They represent a very important track because of terrain change colour and shows a wide a smooth archway line close to Jagodina which continue from the north at a direct line at the direction of the Suka willage which are interpreted as traces of Egnatia road. They are similar with other old traces at the higher Suk and Goriçan Xhahil and here during the agricultural works at 1 meter underneath is discovered a stoneroad with direction north-south built with two stone levels. Survey of the possible station previous to bypass of Seman River doesn't give a new information.

Kuçi Bridge - Lushnjë - Peqin

Searches at the segment Kuçi Bridge-Lushnjë-Thanasaj-Peqin gives no road traces which belong to the antiquity. Many authors identify Big Golem, as one of the stations of Egnatia Road, but for this we do not found archeological data which is impossible to erase totally. Kasharajt Bridge (Photo 4), which is dated since Roman Era according to some studiers results as a Medieval Era like Karbunara Bridge. Lack of the datas on this line oriented the survey on the south side of Seman River valley, to surpasses at Dumreja field. The shortest distance and direct road after bypass the river is climbing at Dumreja within Thana or Sejmenas to arrive at Big Kosovo. Other possibility is passing at the east of the first road, close to the barrier of Thana reservoir to the Salc Kozare-Vlashuk, Dragot, Kajan. Both passes finnished at Belshit and Shala Neck.

Sejmenas – Kosovë e Madhe – Shalës

Close to Sejmenas at the place called "Sejmenas Hill" year ago are discoverd tile tombs of roman period and other archeological remains after different agricultural. Road has pased on the east of the village at Sejmenas Neck and continue on the north direction alongside the botom hills up to Great Kosova. This road is colled by habitants "Vlora Road". Also at Kosovo there are some archeological remains. All this datas attrack attention for the station which must correspondent to the distance from Novo (Novoselë) at the territory before or after the bypass at Semanit (Apssos) river so from the datas which are collected up to now we can search it at Sejmenas or at Big Kosovo. There is another possibility of station change position from one place to another but for this are nedded other investigations or archeological excavations at two points. Road passes are used

at two directions like: Kosovë, Fierzë, Hardhi e Butë, Belsh Neck and Thanë, Vlashuk, Dragot, Kajan (Photo.5), Belsh Neck.

Shalës (Sopi i Kishës) -Ura e Topçiasit

Sopi i Kopërit hill is at east of Shalësit (around 1 km) and some remains of an dwelling which belong to roman era and road continue down the field on east side where is Church Sop. On the interspace between foot of Sopi i Kopërit Hill ansd Church Sopi results that passes the antic road which comes from Belshi Neck. Terrain occupy around 2-3 hectare with intensive remains of ceramic which belong to roman periood which is similar with Sofrën e Kopërit collected ceramic. It seems that we have remains of an station of this road which has termal baths. (Photo.6) Road after passes at Cërik Field, continue at Murriqan and after that at direction N-E arrive at Jagodina where are discovered remains of an roman bridgde (with one arch), oriented on the direction northeast-southwest and it has 4.5 metre broadness. Bridge is not preserve totally. (Photo.7). South foot of this bridge is very damaged but the north one it is preseve in entire wideness and at a part of arch. After the bridge in Jagodina traces of the road arrive at Bujqësit school when is discovered a part of cobblestone. The road continue toward the Topçiasi Bridge and finnished at Elbasan.

Base in the new situation created at south wing of Egnatia Road results that it is possible to follow the general lines of its segments from Vlora to Elbasan even that are some other segments which are not excavated and remain undiscovered or are parts which need to be discovered:

Aulon – Apolloni Segment

Vlorë – east of Treport – west of Akërnia – Poro



Marinaj (Vlorë)-

Poro e Fierit-Fiksit-Sllanik (dead river)-Shëneprem-te- Sop and ends at Pojan (Apoloni).

Apoloni – Kuç Bridge Segment

Apoloni – downhill of Kryegjata - Radostin -Vadhizë - Zhupan - Mbyet – between Frashëri and Verbasit -Novoselë - Jagodinë - Suk i Sipërm - Goriçan Xhahil - Hinkë up to Kuçi Bridge.

Kuç Bridge – Belshit Neck– Shalës (Sopi i Kishës) Segment.

Up to the arrival of Belshi Neck exist two lines:

a) Kuç Bridge-Sejmenas -Kosovë e Madhe -(Fierzë ose Çëragë) -Hardhi e Butë - Çepë - Qafa e Belshit.

b) Ura e Kuçit - Thanë - Salc Kozare -Vlashuk - Dragot -Kajan -Qafa e Belshit.

From the Belsh Neck road follow the direction Shtinth –south of Sopit të Rokatës – south of Kashta Lake – east of Shalësit (Sopi i Kishës).

Sopi i Kishës – Elbasan Segment

Sopi i Kishës-close to Cëriku -Belik – Stone Bridge -Murriqan -Jagodinë - Bujqës – Topçias Bridge -Elbasan ■

DO NOT COPY

KOKA E SHËN PRODHROMIT NË PIKTURAT MURALE TË KISHAVE TË VOSKOPOJËS (1725 ET 1744)

JUDITH SORIA

DEPARTAMENTI I STUDIMEVE DHE KËRKIMIT.
INSTITUTI KOMBËTAR I HISTORISË SË ARTIT.

DO NOT COPY

Paraqitjet e skenave të jetës së Pagëzorit shfaqen shumë shpejt në artin bizantin, dhe siç figuron midis shenjtorëve më të adhuruar, paraqitjet e tij janë të shumta, dhe mbetën nën një formë mjaft të qëndrueshme deri në epokat e fundit të artit pasbizantin të shek. XVIII dhe XIX.

Pikturat që na interesojnë, në kuadër të këtij artikulli, gjenden më së shumti në Voskopojë në kishat e Kryeengjëjve, Shën-Nikollës dhe Shën-Thanasit dhe datojnë në shek. XVIII. Voskopoja, si qytet vetëm kristian ka njohur një zhvillim të shpejtë në fund të shek. XVII dhe një rënie po ashtu të shpejtë në fund të shekullit pasues. Ai ishte një qytet i begatë, gjatë disa dekadave të kulmit të saj, me aktivitetit kulturor të rëndësishëm, gjë që duket edhe nga prezenca e një Akademie Filosofie, dhe shumë shpejt e një Shtypshkronje të vetën. Ajo ka qenë subjekt i shkrimeve të shumta, historia e saj e shkurtër dhe tragjike ka magjepsur udhëtarët e shekullit të XIX. Siç e vëren Max Demeter Peyfuss, literatura për Voskopojën sjell në mënyrë të dukshme gjurmë të vetëdijes nacionaliste të autorëve (grekë, shqiptarë, rumunë), të cilët jo gjithmonë kanë qenë historianë. Studimi më i fundit i Max Demeter Peyfuss përsa i përket shtypshkronjës së Voskopojës e rimerr historinë e qytetit duke zgjedhur atë që i përket legjendës dhe asaj që është e dokumentuar[1] .

Duket që kulti i Pararendësit është i rëndësishëm në Voskopojë. Manastiri i ndërtuar në shek. XVII, në kodrinat e qytetit në fakt i është dedikuar këtij shenjti. Një cikël i jetës së tij është pikturuar në tre nga katër kishat e qytetit, pikturat e të cilave janë ruajtur. Një kishëz i është kushtuar Shën-Gjergjit të Shipskës. Gustav Weigand në fund të shek. XIX shkruan një studim të gjerë për arumunët në Ballkan. Voskopoja, qendra shkencore e shek. XVIII, duke qenë në pjesën më të madhe e populluar nga arumunët, ai i kushton një kapitull të vogël prej 10 faqesh, në formën e një tregimi udhëtimi, në të cilin përmend shkurtimisht kishat[2] . Gjithashtu ai përshkruan aty një gravurë që daton Vienë 1767 dhe që paraqet Virgjëreshën dhe Shenjtin Gjon-Pagëzori me 17 skenat e jetës së tij, që qëndron mbi paraqitjen e Manastirit të Prodhromit dhe qytetit të Voskopojës[3] . Gjithsesi mund të zvogëlohet rëndësia e Shenjtit për qytetin e Voskopojës, nëse fatkeqësisht nuk njihen skenat e jetës së

[1] M.D.Peyfuss, Die Druckerei von Moschopolis, 1731-1769, Vienne, 1989. Një pjesë e rëndësishme e librit i kushtohet historiografisë dhe burimeve.
[2] G.Weigand, Die Aromunen, Ethographisch – phililogisch – historische Unterschungen über das Volk der sogennanten Makedo – Romanen oder Zinzaren, Leipzig, 1895.
[3] M.D.Peyfuss, op. cit. p. 18.

DO NOT COPY



Cikli i Pararendësit në kishën e Kryeengjëjve –Voskopojë



Arrestimi dhe varrimi i shenjtit Joan-Pagëzor, kisha e Kryeengjëjve

Pararendësve, paraqitur në këtë gravurë. Megjithatë, midis publikimeve të Shtypshkronjës së qytetit, nuk është ruajtur asnjë publikim kushtuar këtij profeti.

Interieri i Kishës së Kryeengjëjve është pikturuar nga një studio anonime më 1725. Kupola e seksionit të tretë të nefit verior të kishës së Shën - Mëhillit është zbukuruar nga një portret i Gjon-Pagëzorit dhe skenave të jetës së tij (fig, 1-4). Bëhet fjalë për ciklin më të shkurtër prej të treve, por të paktën të ruajtur mirë. Shenjti paraqitet bust, me krahë, sipas ikonografisë bizantine të Engjëllit të shkretëtirës; mjekra e tij është me bukla, flokët e gjatë dhe të shprishur. Ai mban një phylactère (letra apo pergameni në të cilin është shkruar teksti që mban shenjti në dorë) me mbishkrimin «Μετανείτε: ἤγγικε γὰρ η βασιλεία των οὐρανων», (Pendohuni, sepse mbretëria e Qiejve është afër - Mateu, 3,2). Skenat e ciklit zënë vend në pjesën e brendshme të kupolës, rreth portretit dhe nuk duket se respektojnë rendin kronologjik. Në përëndim, Jezusi i afrohet Prodhromit për t'u pagëzuar; shenjti Joan shoqërohet nga Andrea dhe Jean dhe Krishti gjithashtu nga dy apostuj, prej të cilëve njëri është Shën-Pjetri që njihet me mjekrën e shkurtër dhe të bardhë. Në veri paraqitet arrestimi tij, (fig. 2) dhe midis këtyre dy skenave Pararendësi shfaqet fëmijë, i shoqëruar në shkretëtirë nga engjëlli. Së fundi në një të katërtën jug-lindore të kupolës ai varroset nga dy dishepujt e tij (fig. 2) përpara se të na paraqitet një zbulim (fig. 3), pastaj një i dytë i kokës (fig. 4). Nga ana tjetër, prerja e kokës është pikturuar jashtë këtij cikli, në regjistrin median, që jep paraqitjen e martirëve të shenjtë, në nefin jugor të seksionit të katërt (fig. 5). Ajo nuk është ruajtur mirë dhe pjesa e djathtë e figurës nuk lexohet. Megjithatë, shihet xhelati të ngrejë lart kordhën për të marrë vrull, dhe shenjti në gjunjë, që mund të njihet nga rrobat e

[4] David Selenica është njohur si një nga përfaqësuesit kryesorë të lëvizjes së «imituesve të Panselinos», për të rimarrë termin e Manolis Chatzidakis. Një numër i vogël piktorësh që u ushtruan në Malin Athos zgjodhën si model pikturat e Prôtaton në Karies, që i atribuohen Manuel Panselinos. Denys de Fourna, autor i manualit të famshëm të piktorit, shpreh në hyrjen e punimit të tij si dhe në udhëzimet që i jep të rinjve që mendojnë se do të bëhen piktorë, këtë admirim për artistin mitik. Nga këta piktorë të shihen sidomos, Xyngopoulos, Σχεδίασμα ἱστορίας τῆς θρησκευτικῆς ζωγραφικῆς μετὰ τὴν Ἅλωσιν, Athènes 1957, p. 313-331 ; M. Chatzidakis, Ἕλληνες ζωγράφοι μετὰ τὴν Ἅλωση (1450-1830), Athinë 1987, p. 105-113; E.N. Tsigaridas, « Οἱ τοιχογραφίες τοῦ ναοῦ τῆς Νέας Παναγίας Θεσσαλονίκης καὶ τὸ κίνημα ἐπιστροφῆς τοῦ 18ου αἰώνα στὴν παράδοση τῆς τέχνης τῆς "Μακεδονικῆς Σχολῆς" », ΚΖ' Δημήτρια, ΣΤ' Επιστημονικό Συμπόσιο Χριστιανική Θεσσαλονίκη: Οθωμανική Περίοδος 1430-1912, II, Thessalonique 1994, p. 315-368.

DO NOT COPY



Varrimi dhe zbulimi i parë i kokës së Pararendësit, kisha e Kryeengjëjve



Zbulimi i tretë i kokës së Pararendësit, kisha e Kryeengjëjve

tij dhe flokët karakteristikë. Nga Salome, nuk shihen veçse këmbët dhe krahët, në të cilat ajo mban pjatën për të pritur kokën e martirit.

Kisha e Shën-Nikollës është pa dyshim më e famshmja në Voskopojë. E hapur sërishmi për besimtarët ajo është lehtësisht më e arritshmja dhe që banorët dhe vizitorët e qytetit njohin më së miri. Kisha, gjithashtu njihet nga historianët e artit dhe amatorët sepse ajo është pikturuar nga David Selenica[4] , piktor me njëfarë fame që ka pikturuar kishën e Panagia të Selanikut dhe Shën Prodhromit në Kostur. Ai ka punuar gjithashtu në Malin Athos, ku sigurisht ka njohur Denys de Fourna, autori i manualit të piktorit[5] . Pagëzimi i Krishtit është pikturuar në nefin verior mbi kubenë e seksionit të katërt dhe në marrëdhënie me këtë episod, sipër në regjistrin median që në kishat e Voskopojës i kushtohet paraqitjes së martirëve, duket tregimi i pasionit të Shën Prodhromit. Cikli përmban predikimin e tij përpara Herodit, qëndrimin e tij në burg, prerjen e kokës dhe Salomenë që mban një pjatë për të pritur kokën e tij. Në murin perëndimor të seksionit, në këndet anësore, vajza e re hyn në pallat duke mbajtur mbi kokën e saj pjatën që Herodiade shtrin duart për t'ia marrë (fig. 6). Prapa kësaj të fundit, Herodi është ulur në tryezë me dy të ftuar të tjerë.

Kisha e Shën-Thanasit është pikturuar nga vëllezërit Thanas dhe Kostandin Zografi në 1744[6] . Kapela jug-perëndimore i dedikohet Pararendësit. Ai shfaqet bust, në kupolë (fig. 7). Ai mban tunikën prej lëkurë deveje, nën imation e tij (pallto antike që mbahet nga personazhet biblike) dhe ashtu si në Kishën e Kryeengjëjve, ai është me krahë, bekon me njërën dorë dhe me tjetrën mban rrotullamën ϵ letrës së hapur me mbishkrimin e zakonshëm që vjen nga ungjilli i Mateut. Ai ka pamjen hijerëndë të asketëve.

[5] Publikimi i parë i manualit, i gjetur në Malin Athos në shek. XIX u bë në frëngjisht: Denys de Fourna, éd. M. Didron, Manuel d'iconographie chrétienne grecque et latine, i përkthyer nga dorëshkrimi bizantin Le Guide de la peinture nga Dr. Paul Durand, Paris 1845. Ai u publikua për herë të parë në greqisht në 1909 nga A. Papadopoulos-Kreameus, Denys de Fourna, éd. A. Papadopoulos-Kérameus, Ἑρμηνεία τῆς ζωγραφικῆς τέχνης καὶ αἱ κυρίαι αὐτῆς ἀνέκδοτοι πηγαί, ἐκδιδομένη μετὰ προλόγου νῦν τὸ πρῶτον πλήρης κατὰ τὸ πρωτοτύπον αὐτῆς κειμένον ; Mbi veprën e pikturuar dhe manualin e piktorit të shihet G. Kakavas, « Η ζωή και το έργο του Διονυσίου του εκ Φουρνά : Από το μύθο στην πραγματικότητα», in Διονύσιος ο εκ Φουρνά και το έργο του, Athinë 2003, p. 165-176, dhe gjithashtu, Dionysios of Fourna (c. 1670-c. 1745): Artistic Creation and Literary Description, Leiden 2008.

[6] Për këtë kishë, të shihet Sixtine des Balkans, nën drejtimin e M. Durand, Paris, 2008, dhe bibliografia e pasur.

DO NOT COPY



Prerja e kokës së shenjtit Joan-Pagëzor, kisha e Kryeengjëjve

Në dritaren e rrumbullakët perëndimore janë pikturuar gostia e Herodit dhe prerja e kokës së Pararendësit. Në të majtë të figurës, Herodi, me veshje perandori, zotëron banketin e tij, 3 mysafirë janë në tryezë me të. Në të djathtë, trupi i Shën Joanit rri shtirë përtokë, nën xhelatin që rregullon shpatën në mill. Midis të dyja grupeve, Salome ecën përpara drejt tryezës me një tabaka që e mban sipër kokës së saj. Pozicioni i saj shtrembër, me shpinën e harkuar dhe shpatullat prapa na bën të mendojmë se ajo po vallëzon. Herodiade nuk paraqitet. Christofer Walter e lidh këtë model me traditën strikte bizantine[7] . Për këtë ai jep shembuj të shek. XIV që shfaqen që në shek. XII dhe përjashton influencën perëndimore që autorë të tjerë kishin nuhatur[8]. Shembujt më të vonë, të dhëna nga kërkuesi, datojnë në gjysmën e dytë të shek. XVII[9] . Mund të shtrihet edhe pak kohëzgjatja e jetës së këtij modeli, pasi këtu e gjen shumë pak të ndryshuar.

Skenat e tjera janë të pikturuara në faqet e pjerrëta të kupolës; njoftimi i Zacharie për lindjen e Joanit, lindja, profeti duke predikuar në shkretëtirë. Pikërisht në faqen e pjerrët veri-lindore të kupolës është pikturuar lindja e Joanit (fig. 8). Elisabeta është e ulur në shtratin e saj, me këmbët që i duken nën një mbulesë. Gratë i sjellin asaj dhurata dhe ushqim, dhe njëra prej tyre që qëndron pas saj në kokën e shtratit, i bën fresk. Skena është shumë afër lindjes së Krishtit, e pikturuar në të njëjtën kishë, në kubenë e altarit[10] . Shtrati është vendosur në të njëjtin tip nikeje, nëna është në të njëjtin pozicion me një krah të shtirë drejt dhuratave ushqimore që i sjellin shërbyeset. Duket madje që ky grup shërbyesesh të jetë i njëjti dhe në çdo rast është shumë afër. Zacharie duke shkruar emrin e fëmijës së tij është i vetmi element,

[7] C. Walter, «Salome and the Head of Saint John the Baptist », Revista e Studimeve Armene 23, Paris 1992, p. 509-523, rimarrë në Walter, C., Pictures as Language, How the Byzantines Exploited Them, London, 2000, p. 322-343.

[8] Veçanërisht S. Papadaki-Oekland, « Ê Kera tês Kristas », Archaiologikon Deltion 22, 1967, fq. 96.

[9] Bëhet fjalë për një ikonë të Manastirit të Lesnovos, që daton 1626, aktualisht në Muzeun maqedonas të Shkupit, një pikturë murale e kapelës së pllakës së varrit të Rozen afër Melnik e vitit 1662, të gjitha të cituara nga Christopher Walter, në C. Walter, art. cit.

[10] Në Shën-Gjergj të Shipskës p.sh, lindja e Virgjëreshës, pikturuar në murin verior të seksionit perëndimor, është përballë lindjes së Pararendësit, që figuron në murin jugor të të njëjtit seksion, dhe që është skena e vetme e ciklit të jetës së martirit të parë që paraqitet në kupolën kushtuar shenjtit. Vendosja ballë për ballë e këtyre dy lindjeve është e shpeshtë në kishat pasbizantine.

DO NOT COPY

jashtë konteksit, që diferencon lindjen e Krishtit nga ajo e Shën Prodhromit dhe formon një kontrast me aspektin laik të skenës.

Së fundi në faqen e pjerrët jug-perëndimore paraqitet zbulimi i kokës së Shën Prodhromit (fig. 9). Nëse shembujt e ruajtur janë relativisht të rrallë në periudhën bizantine, skena shfaqet më shpesh në periudhën pasbizantine dhe ndodhet në dy nga ciklet voskopojare. Koka e atij që shpesh cilësohet i fundit i profetëve dhe i pari i martirëve, u zhduk në fakt pas prerjes së saj në pallatin e Herodit dhe u varros vetëm trupi. Relikja e kokës së shenjtit u rigjet, apo u zbulua më vonë. Në vazhdën e peripecive relativisht konfuze nga burimet kontradiktore të periudhave të ndryshme, koka humbi përsëri dhe u rigjet dy herë. Përpara se të merremi me ikonografinë e këtyre mrekullive dhe veçantitë e shembujve në Voskopojë, duket i nevojshëm një kthim i shpejtë tek burimet e ndryshme që kanë të bëjnë me këto ngjarje.

Tekste të shumtë japin zhvillimin e zbulimeve të ndryshme, apo zbulimet e kokës së Prodhromit të hutuar në Pallatin e Herodit. Megjithatë, burimet divergojnë në pika të shumta. Sozomenus, në L'historia ecclesiastica[11] tregon se si koka është zbuluar në kohën e perandorit Valens, (364-378), tek Maqedonasit, që ruajnë reliken dhe se si ajo është transferuar në bazilikën e ndërtuar për të afër Konstandinopojës në kohën e pasardhësit të tij Theodose. Atëherë shenjtorja Matrone, një virgjëreshë e shenjtë e Maqedonasve, i kundërvihet këtij transferimi.

Tradita liturgjike i përmbahet versionit të Dionysius Exiguus[12] , i cili përmend që dy murgj në peligrinazhin e tyre në Jeruzalem patën informatë, për vendin ku gjendej koka, nga vetë Gjon Pagëzori në



Shenjti Joan-Pagëzori i burgosur dhe prerja e kokës në kishën e Shën -Nikollës Voskopojë

një ëndërr. Në kthim me reliken, ata takojnë një poçar nga Emese që po linte qytetin për shkak të vështirësive. Murgjit i japin atij kokën për t'a mbajtur. I nxitur nga vetë Gjon-Pagëzori, poçari arratiset me kokën dhe rikthehet në Emese. Relikja kalon nga dora në dorë dhe humbet përsëri. Atëherë arrin zbulimi i dytë[13]. Gjon-Pagëzori tregon përsëri vendndodhjen e kokës së tij, këtë herë një arkimandriti të quajtur Marcellus, i cili informon Uranius, peshkopin e Emeses. Koka rigjendet në shpellën e eremitit arian Eustathe.

Ky tregim i Dionysius është parë në sinakser (libër liturgjik që përmban një përmbledhje të jetës së shenjtëve) në datën e përkujtimit të dy zbulimeve të para nga Symeon le Metaphraste, i cili shton që zbulimi i dytë ka ndodhur nën mbretërimin e Valentinianit III (425-450) dhe Marcianit (450-457). Relikja zhduket përsëri. Ajo zbulohet në Comana në një pjatë argjendi dhe jo në tokë si gjatë zbulimit të mëparshëm. Kjo është treguar në sinakser, më datë 25 maj, datë e përkujtimit të zbulimit të tretë. Atëherë koka është

[11] Historia ecclesiastica, IV 21, PG 67, 1481-1486
[12] In primam inventionem pretiosi capitis, (BHG 839), PL 67, 419-424.
[13] In secondam inventionem pretioso capitis, (BHG 840), PL 67, 423-432.

DO NOT COPY



Kupola me Pararendësin në kishën e Shën-Thanasit – Voskopojë

mbartur deri në Konstandinopojë, ku aty pritet nga perandori, patriarku dhe populli

Zbulimet e kokës së Shën Prodhromit përmenden në shenjtografinë (degë e historisë fetare që trajton jetën dhe kultin e shenjtorëve) e shenjtores Matrone nga Symeon le Metaphraste[14] dhe nga një tekst anonim[15] . Këto dy tekste japin versione shumë të ngjashme. Matrone është një grua e re e martuar me Perge. Ajo shkon në Konstandinopojë dhe bëhet murgeshë kundër pëlqimit të së shoqit. Për të shmangur që ai t'a kërkojë dhe t'a marrë nga manastiri, ku ajo dëshiron të futet dhe pasi ka parë një ëndërr që i tregon asaj rrugën që duhet të ndjekë, ajo merr një rrobë murgeshe dhe një emër mashkulli, Babylas. Pas disa ëndrrave dhe peripecive, ajo transferohet në një manastir në Emese. Atëherë ajo gjendet e përfshirë në zbulimin e kokës së Shën Prodhromit, sepse sipas biografit, duhet, që një fuqi dhe sjellje e tillë të nënvizohen nga një mrekulli. Një fermer kishte dalluar një zjarr që digjej prej disa ditësh dhe duke dyshuar për një shenjë që vetë ai nuk mund t'a interpretonte, shkon të takojë peshkopin Uranius. Ky i fundit duke kuptuar se është përballë një misteri, shkon menjëherë në vend i shoqëruar nga kleri i tij. Ai kërkon që të gërmohet toka dhe atëherë zbulohet një poç që mbante kokën e Prodhromit. Atëherë mbahet një procesion i madh, në të cilin u bashkuan murgjit dhe murgeshat e manastireve përreth. Relikja prodhon një vaj të parfumuar, si për të konfirmuar zbulimin, saktëson biografi, dhe besnikët avancojnë drejt saj me qëllim që të marrin dhe bekohen nga ajo. Gjithashtu, fatlumja Matrone shkon edhe ajo të marrë nga ky vaj dhe atëherë fillon të prodhojë pavarësisht saj dhe t'a shpërndajë rreth vetes. Ky burim nuk përshtatet me l'Historia ecclesiastica, as me tregimin e Dyonisius, megjithëse disa vende, personazhe apo homonime gjenden në versionet e ndryshme.

Nga pasaktësia e këtij tregimi rrjedh njëfarë konfuzioni në ikonografinë e këtij subjekti. Në kishat që na interesojnë, ky konfuzion është i ndjeshëm.

Në ciklin e vogël të kupolës veriore të seksionit të katërt të Kishës së Kryeengjëjve, njëfarë rëndësie i është dhënë episodeve pasuese të vdekjes së shenjtit - siç e kemi parë, skena e prerjes së kokës paraqitet mënjanë. Nga të gjashtë episodet e paraqitur rreth kupolës, tre prej tyre zhvillohen rreth kufomës së shenjtit. Dy zbulimet janë paraqitur pas vënies së kufomës në varr nga dishepujt e Pararendësit. Në fillim shihen dy burra në tunikë, të cilët mbajnë palltot e tyre rrotull shpatullave, nga të dyja anët e një hauzi të vogël të artë (fig. 3-4). Ai i anës së djathtë paraqet me dy duart e tij reliken e zbukuruar që gjendet në hauz dhe tjetri që ka drejtuar duart andej për ta kapur. Mbishkrimi thotë « πρώτη εὕρεσις του Προδρόμου»

[14] PG 116, 933-936.

[15] BHG 1221, në përkthimin anglisht në J. Featherstone, C. Mango, «Life of Saint Matrona of Perge», A. Talbot, Holy Women of Byzantium, Ten Saint's Lives in English Translation, Washington, 1996, p. 13-64

DO NOT COPY

(zbulimi i parë [i kokës së shenjtë] të Prodhromit). Në skenën që pason, tre burra janë vendosur rreth një sarkofagu (fig. 4). Në plan të parë, një burrë i veshur me rroba peshkopi mban në duar kokën e zbukuruar të shenjtit Joan. Prapa tij qëndrojnë dy burra, njëri prej të cilëve shtrin duart drejt relikes. Këtë herë lexohet : «Ἡ τρίτη εὕρεσις του Προδρόμου» (zbulimi i tretë i [kokës së shenjtë] të Prodhromit. Përsëritja e sarkofagut (varrosja e trupit dhe zbulimi i tretë) të cilave mund t'u shtosh paraqitjen e shenjtit të burgosur (fig. 2), birucën e cila paraqitet me forma dhe ngjyra të ngjashme me varrin (katërkëndësh me mermer gri) si dhe përsëritja e kompozimit me dy burrat në të dy anët e këtij sarkofagu, nënvizon aspektin përsëritës të këtyre ngjarjeve dhe edhe pse ende mbi supet e tij, vetëm koka e Lajmëtarit që ngrihej mbi aureolën e vet, duket nga e çara e burgut. Pra kjo skenë e vogël i sjell tashmë ndërmend reliken spektatorit.

Në këndin jugperëndimor të kupolës së kapelës së Shën Gjon-Pagëzorit të Kishës së Shën-Thanasit, shihen dy murgj të gjunjëzuar, të përkulur sipër kokës së vendosur midis tyre në një lloj poçeje, që duket sikur e kanë nxjerrë nga një vrimë; ngjyra rozë e enës bën të mendojmë për një poçe balte (fig. 9). Mbishkrimi nuk jep aspak detaje mbi zbulimin në të cilin thuhet :«Ἡ εὕρεσις της τιμίας κεφαλης του Προδρόμου» (zbulimi i kokës së shenjtë të Prodhromit).

Një ikonë e periudhës paleologe e ruajtur në Lavra[16] dhe që mbledh të treja shpikjet e njëpasnjëshme në të njëjtin panel ka frymëzuar Manolis Chatzidakis që elementë të pandryshueshëm do t'a ndihmonin të



Lindja e shenjtit Joan, kisha Shën-Thanasit

identifikonte se cilit episod i referohet saktësisht një prezantim i zbulimit të kokës. Në regjistrin e sipërm në të majtë, dy murgj janë duke nxjerrë nga toka kokën që qëndron në një pjatë. Skena zhvillohet përpara një pallati dhe prapa shihet një burrë duke ikur me një çantë në dorë - poçari i Emeses. Në të djathtë, një murg dhe një peshkop rrinë përpara një shpelle, në brendësi të së cilës mund të shihet koka në një poç balte. Pas shpellës, ortodoksët ndjekin Eustathe, një eremit që shfaq herezinë e Arius duke i bërë të tijat mrekullitë e prodhuara nga relikja. Pjesa e poshtme e ikonës zihet nga paraqitja e zbulimit të tretë[17], që më shumë duket si adhurim i relikes dhe mbartja e saj për në Konstandinopojë. Koka, e zbukuruar dhe me përmasa joproporcionale është e vendosur në qendër të kompozimit të pasur me personazhe. Në të djathtë të figurës janë paraqitur patriarku Ignatos, Perandori

[16] M. Chatzidakis, «Një ikonë me tre zbulimet e kokës së Prodhromit në Lavra », Cahiers Archéologiques 36, 1988, p. 85-97.

[17] Megjithatë edhe në epokën bizantine, ikonografia e zbulimeve të ndryshme nuk është e qartë dhe konstantet e vendosura nga M. Chatzidakis nuk janë kaq evidente. Të shihet C. Walter «The Invention of John the Baptist's Head in the Wall-Calendar at Gracanica. Its Place in Byzantine Iconographical Tradition», Zbornik za likovne umetnosti 16, 1980, p. 71-83; të shihet gjithashtu ribotimi i këtij artikulli, me korrigjimet dhe shtesat në Walter, C., Pictures as Language, How the Byzantines Exploited Them, London, 2000, p. 301-320. Angeliki Katsioti vëren që sarkofagu nuk është paraqitur asnjëherë në periudhën bizantine. A. Katsioti, Οι σκηνές της ζωής και ο εικονογραφικός κύκλος του Αγίου Ιωάννη Προδρόμου στη βυζαντινή τέχνη, Athènes 1998, p. 165. Megjithatë çështja është e vështirë për t'u zgjidhur; pikturat, ikonat apo dekoracionet murale që janë të njohura për ne shpesh i përkasin menologëve. Mirëpo në një nga dy datat që kremtohen zbulimet, 24 shkurti për dy të parat dhe 25 maji për të tretën, ato në fakt janë risjellë nga njëri apo tjetri prezantim dhe një imazh shërben për të prezantuar tërësisht zbulimet e ndryshme.

DO NOT COPY

Michel III, një funksionar i lartë dhe dy psalltë. Nga ana tjetër qëndrojnë psalltët. Kështu për Manolis Chatzidakis, motivi i një sarkofagu të hapur dhe i dy murgjëve do të ishin tipari i veçantë i zbulimit të parë. E dyta do të dallohej nga prezenca e kokës së Pararendësit në një qyp, në referencë me hajdutin, poçarin e Emesës, që e transportoi në këtë enë. Së fundi ai është i mendimit që atje ku shfaqen dy kërkuesit laikë (duke iu referuar teksteve burimore dhe disa paraqitjeve), bëhet fjalë për paraqitjen e kodifikuar të zbulimit të tretë. Nga ana tjetër, ai vëren një konfuzion më të thellë në trajtimin e subjektit në periudhën pasbizantine. Ai citon shembullin e dy pikturave murale të Malit Athos të shek. XVI, ku legjendat duken se nuk përputhen me skenën e paraqitur. Në fillim bëhet fjalë për një pikturë të kapelës së Shën Gjonit, në krah të sallës së ngrënies të manastirit Stavronikita, që daton 1546[18] . Në të njëjtën vreshtë, varrimi i Pararendësit nga dishepujt e tij paraqitet në plan të parë dhe pas saj midis dy maleve që ndajnë dy skenat, duken dy laikë nga të dyja anët e një pjate përpara një shpelle. Mbishkrimi thotë :« Η ενταφιασμος και η εύρεσις », (varrimi dhe zbulimi), pa më shumë sqarime për zbulimin për të cilin bëhet fjalë. Megjithatë për Manolis Chatzidakis, të dy laikët si dhe poçi prej metali nënshkruajnë zbulimin e tretë. Shembulli i dytë ndjek prej disa vitesh të parin dhe i adoptohet këtij kompozimi. Vetëm mbishkrimi dallon pak dhe më saktë thotë: « Ἡ πρώτη εὕρεσις της τιμίας κεφαλης του Προδρόμου» (zbulimi i parë i kokës së shenjtë të Prodhromit). Nga burimet, shpella është vendi i zbulimit të dytë – shpella e eremitit – dhe duket se është vendi i privilegjuar për paraqitjen e këtij zbulimi nga piktorët, kur saktësohet ajo që nuk është



Zbulimi i kokës, kisha e Shën -Thanasit

rasti më i shpeshtë në menologët muralë (kalendar i martirëve të kishës greke), ku zbulimi i dytë është frymëzuar nga prania e një murgu dhe një peshkopi (Marcellus dhe Uranius), të cilët rrethojnë një qyp në të cilin qëndron koka[19] . Duket që ky piktor i dytë, duke rimarrë skemën e autorit të pikturës së Stavronikitës, që është pa dyshim Theophane le Cretois, ka bërë një gabim duke ia atribuar ikonografinë që ai zgjidhte asaj të zbulimit të parë[20] .

Një ikonë e shekullit në vazhdim e manastirit Dochiariou, që daton 1696 paraqet shenjtin në këmbë, të rrethuar nga skenat e jetës së tij. Në këmbët e tij është vendosur një kupë në të cilën qëndron koka, duke iu referuar prerjes së kokës dhe zbulimeve të relikes[21] . Midis episodeve të jetës së tij, varrimi nga dishepujt e tij paraqitet poshtë në të majtë dhe dy zbulimet sipër mbi anën e djathtë. E para që mban mbishkrimin "« Ἡ Α' εὕρεσις », (zbulimi i parë) tregon një murg dhe një peshkop me një temjanicë përpara një ndërtese. Koka ndodhet në një kupë – i njëjti

[18] M. Chatzidakis, art. cit. fig. 7.
[19] Është rasti i menologut mural të Graçanicës dhe atij të kapelës se Shenjtorit Demeter të manastirit Vatopédi
[20] Chatzidakis, art. cit, p. 93.

DO NOT COPY

si në figurën qendrore - i vendosur në tokë. Vreshta nga sipër "« Ἡ Β' εὕρεσις » (zbulimi i dytë) tregon dy murgj në gjunjë, në të dyja anët e enës - gjithmonë e njëjta - përpara një shpelle.

Denys de Fourna, autor i shek. XVIII i manualit të piktorit jep një udhëzim të saktë për secilën nga zbulimet[22] . As piktura e Kishës së Kryeengjëjve, as ajo e Shën-Thanasit nuk i korrespondojnë këtyre përshkrimeve. Skenat e librit me sa duket janë shkruar sipas ikonës së Lavra e publikuar nga Manolis Chatzidakis [23]. Ky i fundit kishte hedhur hipotezën në lidhje me këtë që duket se konfirmohet nga publikimi i fundit i një ikone, nga dora e Denys dhe që daton 1711[24] . Bëhet fjalë për një ikonë ku Shën Prodhromi shfaqet në këmbë, i rrethuar nga skenat e jetës së tij. Këtu janë paraqitur të treja zbulimet e kokës së tij. Dy të parat i korrespondojnë pikë për pikë asaj të ikonës së shek. XIV, e përshkruar më lart. Personazhet janë të njëjtë dhe ndodhen në të njëjtat pozicone, peizazhet janë identikë, pra duket qartë që Denys e njihte këtë ikonë. Nga ana tjetër për të risjellë zbulimin e tretë, ai ka zgjedhur këtu të paraqesë një murg vetëm në këmbë që ia ka kthyer shpinën hyrjes së një shpelle në anë të së cilës ndodhet një pemë. Në shpellë duket poçja me kokën e shenjtit. Pra kjo ikonografi ndryshon (lirohet) nga modeli dhe është gjithashtu e pavarur nga shënimet që murgu do të japë në librin që ai do të shkruajë disa vite më vonë rreth 1728 – 1734. Përveç kësaj, burimi i një paraqitjeje të tillë është i errët dhe kontraston me paraqitjet e shumta të zbulimit të kokës së Shën Prodhromit, të cilat në periudhën pasbizantine mbështeten mbi ikonografinë e këtij zbulimi të tretë ashtu siç ai shfaqet në ikonën e Lavra dhe në vazhdim në librin e Denys. Më shumë, në këto rastet e fundit bëhet fjalë për paraqitjen e mbartjes dhe adhurimit të relikes, siç është vënë re më parë. Këtë ikonografi mund ta shohim në shek. XVI në Meteores, në veçanti mbi një ikonë të zbulimit të tretë, vrasjes me gurë të Shën Etienne në 1522[25] , në pikturën murale të kapelës veriore të manastirit Philanthropos[26] dhe në fund të shek XVIII në manastirin Gregoriou në Malin Athos[27] . Christopher Walter vëren se piktorët bizantinë ndjekin gati gjithmonë të njëjtën ikonografi ku dy personazhet përdorin vegla, kazmë apo lopatë për të nxjerrë reliken nga toka[28] . Konstatohet se në pikturat e vendeve të Ballkanit perëndimor në periudhën pasbizantine, veglat e përdorura nga kërkuesit në paraqitjet e mëparshme janë zhdukur[29] .

Dy episodet e pikturuara në Kishën e Kryeengjëjve në Voskopojë duket se kombinojnë elementë të zbulimeve të ndryshme. Paraqitjet e vendosjes në varr dhe të "zbulimit të parë" janë afër pikturës së manastirit të Stavronikita, përjashtuar shpella, që nuk është

---

[21] The Treasures of Mount Athos, catalogue d'exposition, Thessalonique 1997, fig. 2.105.

[22] Denys de Fourna, éd. A. Papadopoulos-Kérameus, Ἑρμηνεία τῆς ζωγραφικῆς τέχνης καὶ αἱ κυρίαι αὐτῆς ἀνέκδοτοι πηγαί, ἐκδιδομένη μετὰ προλόγου νῦν τὸ πρῶτον πλήρης κατὰ τὸ πρωτοτύπον αὐτῆς κειμένον, p. 177-178.

[23] M. Chatzidakis, art. cit., p. 94-95.

[24] G. Kakavas, Dionysios of Fourna (c. 1670-c. 1745): Artistic Creation and Literary Description, Leiden 2008, fig. 188, 199, 200 et 201.

[25] M. Chatzidakis, D. Sofianos, Το Μεγάλο Μετέωρου. Ιστορία και Τέχνη, Athènes 1990, p. 201.

[26] P.Votokopoulos, Οι εικόνες μηνολογίου του Μεγαλου Μετεώρου. Ευρόσυνον, Αφιέρωμα στον Μανόλη Χατζηδάκη Ι, Athènes 1991, fig. 38, cité par A. Katsioti, Οι σκηνές της ζωής και ο εικονογραφικός κύκλος του Αγίου Ιωάννη Προδρόμου στη βυζαντινή τέχνη, Athènes 1998, p. 169.

[27] Zias, N., Kadas, S., The Holy Monastery of Saint Gregorios, The Wall Painting in the Katholikon, Mont Athos, 1998, p. 67-68. Nuk është dhënë riprodhim i imazhit, por përshkrimi i autorit risjell me siguri shpikjen e tretë dhe ikonografinë e ikonës së Lavra.

[28] C. Walter, art. cit. p. 302.

[29] Këto vegla shihen akoma në ikonat ruse post-bizantine. Shihet vecanërisht në ikonën kalendarike të muajit shkurt të shek. XVII e ruajtur në Pallatin e Vogël në Paris.

DO NOT COPY

paraqitur në Voskopojë. Protagonistët që duken se janë murgj frymëzojnë zbulimin e parë, kupa prej metali të tretën, sipas burimeve dhe sipas Manolis Chatzidakis. Megjithatë në shembujt e mëparshëm është vënë re që kjo enë shpesh prej metali, shfaqet shpesh cilido qoftë zbulimi i paraqitur. Përveç kësaj është pikërisht në një pjatë të ngjashme që Salome pret kokën, pikturuar në të njëjtën kishë dhe në shembujt e shumtë, dhe është gjithashtu në një pjatë apo hauz prej metali të praruar ku qëndron relikja në ikonat ku shenjti shfaqet në këmbë me kokën në këmbët e tij[30] . Përsa i përket zbulimit të tretë pikturuar në të njëjtën kupolë, prania e peshkopit të kujton më shumë zbulimin e dytë, ndërsa sarkofagu të parën. Asgjë nuk të kujton këtu zbulimin e tretë ashtu siç ai shfaqet zakonisht brenda apo përpara një kishe në prani të personave të shumtë, apo siç paraqitet në ikonën e Denys de Fourna. Pra nuk duket se ka referenca historike në zbulimet e relikes, por një risjellje të numrit dhe përsëritjes së tyre - këtu janë paraqitur vetëm dy zbulime, por rëndësia që i jepet kufomës dhe relikes, si dhe aspekti përsëritës nuk janë më të qartë - në atë që ajo ka të mbinatyrshme apo magjike[31] . Komentuesit heqin paralele midis prerjes së kokës së shenjtit dhe vdekjes së Krishtit në kryq, midis zbulimit të kokës dhe ringjalljes[32] . Paraqitja në imazhe të shumta e një ene që risjell kupën për të mbajtur reliken na kujton gjithashtu përshëndetjen e duruar të sakrificës së Krishtit[33] . Një imazh i zbulimit të relikes ngjan me një imazh të shëlbimit.

Në Shën-Thanas, të dy murgjit të kujtojnë zbulimin e parë dhe koka e vendosur në poçen në tokë të dytën, vetëm se relikja nuk gjendet në një shpellë, gjë që mund t'i korrespondonte përmbajtjes së versionit në shenjtografinë e Shenjtores Matronë, ku na thuhet që toka është gërmuar[34] . Një tregues tjetër për të identifikuar shpikjen së cilës piktorët e Shën-Thanasit kanë dashur t'i referohen është prania e Shenjtores Matrone në regjistrin e poshtëm, në këndin perëndimor të murit, pikërisht nën faqen e pjerrët ku duket kjo skenë. Në fakt nga tregimet shenjtografike, shenjtorja është e lidhur me zbulimin e dytë, që ndodhi në Emese, në prani të peshkopit Uranius. Në Shën-Thanas, si në kishat e tjera të qytetit, programi ikonografik vë në marrëdhënie regjistrin e dekorimit të poshtëm, që përmban shenjtët në këmbë dhe regjistrin median, ku janë paraqitur skenat e martirëve të vetë këtyre shenjtëve. Gjithashtu një pjesë e madhe e personazheve që i japin ritëm pjesës së poshtme të faqeve të kishës paraqiten përsëri sipër. Rrotull nefit, shenjtët shfaqen në mënyrë hierarkike dhe në grupe, siç është e zakonshme në kishat bizantine. Kështu shenjtorët luftëtarë janë paraqitur pranë e pranë, si shenjtorët anargyre (shenjtët shërues në kishën bizantine) dhe po këto shenjtorë shfaqen përsëri në regjistrin median, të famshëm si

---

[30] Shembulli më i vjetër i këtij tipi është ikona e Manastirit Sainte-Catherine të Malit Sinai, që daton shek. XII, të shihet G. dhe M. Sotiriou, Icônes du Mont Sinaï, Athènes,1956, I, pl. 86.

[31] Mbi dimesionin e përsëritjes së një motivi, të shihet p.sh H. Maguire, Byzantine Magic, Washington 1995.

[32] Athanase Semoglou citon një menolog perandorak të manastirit athonite të Koutloumous që daton fundin e shek XI apo fillimin e shek. XII, me sa duket i kopjuar mbi një monolog tjetër të shek. XI, diskutimi i së cilës fillon nga paralelizmi dhe afërsitë simbolike midis Lindjes dhe Vdekjes së krishtit dhe atyre të Pararendësit. Është vendosur një lidhje midis ringjalljes së Krishtit dhe zbulimit të relikes së shenjtit. A. Semoglou, « Tre zbulimet e kokës së shenjtit Joan-Pagëzori», Cahiers Balkaniques 27, p. 25-37.

[33] Në ikonat ruse, Pararendësi mban shpesh Krishtin fëmijë në një kupë, në vend të kokës që shihet në ikonat bizantine. Në ikonat e shek. XVII, kjo ikonografi, e çiftuar në një prezantim të kopshtit qiellor evokon Shëlbimin e duruar të sakrificës së Krishtit, lajmëruar nga ai i Pararendësit. Të shihet p.sh një ikonë moskovite e fundit të shek. XVII në Les Icônes russes du XIV eau XVIIe siècles, Exposition 1954-55, Galerie Paul Ambroise, Paris 1954, pl. XV.

[34] Të shihen shënimet 13 dhe 14.

DO NOT COPY

martirë. Kjo vendosje që lidh një portret të shenjtit me një skenë tregimtare, na fton të mendojmë që ky afrim midis zbulimit të kokës së Pararendësit dhe shenjtores nuk është i rastit. Fakti që kjo shenjtore paraqitet rrallë e përforcon këtë hipotezë. Origjinaliteti i kësaj paraqitjeje të zbulimit të kokës së Shën Prodhromit, qëndron në prezencën e shenjtores në regjistrin e poshtëm. Në fakt, megjithëse burimet e bashkojnë atë me zbulimin e kokës së shenjtit Gjon-Pagëzor, artistët dhe ikonografët mesa duket nuk e kanë paraqitur ose e kanë paraqitur rrallë atë në ikonat apo pikturat murale që i kushtohen këtij episodi. Megjithatë Pavle Mijovic, kur publikoi imazhin e menologut mural të Graçanicës, kushtuar kësaj mrekullie, pa aty një peshkop dhe një grua të mbledhur rreth relikes së gjetur në një qyp[35] . Atëherë atij iu duk e qartë se kjo grua duhet të ishte shenjtorja Matrone. Christopher Walter në artikullin e tij mbi ikonografinë e kësaj skene[36] , pohon se nëse bëhet fjalë për një grua, ajo nuk mund të jetë veçse Matrone, por megjithatë ai nuk vendosi për t'a identifikuar këtë personazh me një figurë femërore. Në tezën e saj mbi paraqitjet e jetës së Shën Prodhromit në artin bizantin, Angeliki Katsioti rivjen mbi këtë çështje dhe tregon për një vepër ruse të shek. XVII, një ikonë kalendarike e muajit shkurt, ikonografia e së cilës, shkruan-ajo, i mbetet besnike pa dyshim traditës bizantine. Mirëpo në pjesën kushtuar 24 shkurtit, festës së zbulimit të parë dhe të dytë, një murg është paraqitur i shoqëruar nga një femër që duhet në mënyrë të qartë, gjithmonë sipas saj, të identifikohet me Matrone[37] . Ne pra mund të shohim në këtë ikonë një precedent, sigurisht rus dhe i largët gjeografikisht nga i yni, por relativisht afër në kohë, bashkimin e shenjtores Matrone me prezantimin e mrekullisë së zbulimit të kokës së Shën Gjon Pagëzorit.

Kjo analizë e shkurtër e prezantimit të zbulimeve të kokës së Shën Prodhromit në Voskopojë, na bën të kuptojmë konfuzionin e periudhave të ndryshme të këtij zbulimi, ikonografia e të cilave jo gjithmonë korrespondon me burimet, as me legjendën që i jepet imazhit. Kërkime më të thelluara do të meritonin të kryheshin, nga njëra anë përsa i përket afrimit të shenjtores Matrone me këtë mrekulli të Pararendësit, shembuj të tjerë të së cilës duhen zbuluar, dhe nga ana tjetër prezantimit të përshëndetjes dhe shëlbimit nga vetë kjo mrekulli. Christopher Walter në artikullin e tij mbi ikonografinë e këtij subjekti nxjerr hipotezën e një cikli të zbulimit të kësaj relikeje në artin bizantin, duke u mbështetur në shembujt e rrallë ruajtur të veçuar. Kjo hipotezë duket se është konfirmuar nga publikimi i ikonës së Lavra nga Manolis Chatzidakis, siç e tregon tashmë Angeliki Katsioti në punimin e saj mbi ikonografinë e shenjtit. Duket që prania e fortë e këtyre cikleve në periudhën pasbizantine shkojnë në të njëjtin drejtim dhe duhen parë si mbijetesa të periudhës bizantine më shumë sesa si risi të vona. ■

---

[35] P. Mijović, Menolog, istorijsko-umetnička istraživanja, Belgrade 1973, p. 299.

[36] C. Walter, «Zbulimi i kokës së Gjon-Pagëzorit në kalendarin-mural të Graçanicës. Vendi i tij në traditën ikonografike bizantine», Zbornik za likovne umetnosti 16, 1980, p. 71-83 ; të shihet gjithashtu ribotimi i këtij artikulli në Walter, C., Pictures as Language, How the Byzantines Exploited Them, London 2000, p. 301-320.

[37] A. Katsioti, op. cit., p. 167. Fatkeqësisht nuk kemi mundur të gjejmë riprodhim të kësaj ikone.

DO NOT COPY

Three Discoveries of Saint Prodhrom Head at mural paintings in the churches of Voskopoja (1725 to 1744)

Judith Soria

DO NOT COPY

Presence of the life of John Baptiste Precusor are exposed near the beginning at Byzantine Art and it is ordinary between adorer saints its represences which are numerous and they remain at a very strong form up to the last era of post Byzantine Art which belong to the centuries XVIII and XIX.

Paintngs in our focus in the structure of this article are present at Voskopoja at the Saint Nicola and Saint Athanas churches which belongs to the XVIII century. Voskopoja, as a unique Christian City has passed a fast increase and falling development during the XIX century. It was a rich city during some decades with important cultural activity, printing-house and Phylosophy Academy. It was mentioned during many descriptions by travellers of XIX century. Authors (Romanian, Albanian, Greeks) of literature for Voskopoja have their nationalist tendencies as this was mentioned by Max Demeter Peyfuss, and they were not historians. Max Demeter Peyfuss last study for the Voskopoja printing-house retake into consideration the city story by chosing the between legends and documentations.

Precursor cult was very important in Voskopoja. Monastery constructed during the XVII century, on top of the city hills is dedicated to this saint. Part of his life is painted at three of four churches of the city and these are preserved. Small church is dedicated to Shipska Saint-George. Gustav Weigand at the end of XIX century write an enourmous study for aromanian in Balkan and Voskopoja have many of them. He dedicates a chapter about 10 pages in a travel description format when most important part of it belongs to the churches. He describe an engraving which keeps a date, Vienna 1767 and represents Virgin and John Baptiste Precursor at its 17 life, acts which stands on the showing of Prodhrom Monastery and Voskopoja City. The importance of this saint for the city of Voskopoja may be reduced if, unfortunately aren't known the life acts presented at this engraving. No publication dedicated to this Saint has arrived in the present day, in the middle of publications finished from this printing-house.

Archangel Church internal is painted by an anonymous studio on 1725. Cupola of the third section of the north nave at Saint-Mëh illit church is decorated with a John Baptiste Precusor portrait and his life acts wich is extant very well. Saint is presented torso, with arms, according to the Byzantine iconography of desert's Angel; its beard is ringleted, ragged long hair. He keeps a phylactère (paper or parchment when is text scripture stands at Saints's hand) with inscription «Μετανείτε: ἠγγικε γὰρ η βασιλεία των

DO NOT COPY

οὐρανων», (Repent because kingdom of the Skyes is close - Mateu, 3, 2). This scenes are placed at internal part of cupola and do not respect chronological around the portrait. Jesus on the west arrive at Prodhrom baptize; saint Johan is be present at Andrea and Jean; Christ is also attended by two apostles, one of them is Saint-Piter with its well-known short and white beard. North part of it represents his detention and between these two scenes Precursor is presented as a child acompained in desert by angel. He was entombment by his two disciples at south-east quarter part of cupola. On the other side the decapitation is painted out of this part, because on median register are showed sacred saints presences on south nave of fourth section. The painting is not in good condition and the right side is impossible to read but is clear the headsmen with sabre up to be rashly, saint stands on his knees and its recognizition is possible by his characteristic hairs or clothes. Feet and hands of Salome are clear because she hold the cumbal to take hold of the martir's head.

Saint-Thanasi church is painted by Thanas and Kostandin Zografi brothers during 1744 year. South-west chapel is dedicated to John Baptiste Precusor. His is presented in torso position at cupola. He hold its tunic with camelskin, under his imatio (antic sack which is holded by scripture characters) and is similar to Archangel Church, he has wings, bless with one hand and with the other holds the roll leter which has usuasl inscription and its come from Mateu gospel.

Discoveries of Saint Prodhrom head are mentioned in saintography (branch of religious history which treate the life and saints cult) of the holly Matrone by Symeon le Metaphraste and anonime text which gives similar versions to each other. Matrone was a lady married with Perge. She go in Konstandinople and became conventual against approval of her husband. She take conventual clothes and male name, Babylas, after she has seen a dream which explain to her the road to be pursued and also she like to keep away from inquires of her husband and his wish take out her from the monastery when she like to shelter. After some dreams and vicissitudes she moves out to a monastery in Emese. She has participate in discovery of the Saint Prodhrom Head, because according to the biographer is obligatory to have a confident supremacy and performance to accomplish a miracle. Anonymous farmer has noticed flames burning for several days and he has uncertainty for an unexplained sign by himself, so he went to Uranius bishop. Uranius has gone urgently with his clergyman at this place because he has understood right away the presence of a mystery happening. Uranius bishop ordered to excavate the place and after that was find out a pot with head of Prodhrom inside. An enormous procession was held with participance of monks and convenctuals of monasteries in the region of this place. Pot begins to grind perfume oil to confirm discovery and believers move forward in the direction of pot with plan to acquire oil and to consecrate from it. Furthermore the lucky Matrone goes to take this oil and begin to produce oil regardless her and in addition she distribute oil around herself. This data sources are not in harmony neither with l'Historia ecclesiastica, nor with Dyonisius narratives, but in some countries some personages, homonyms and places are founded in dissimilar versions.

Sain-Thanas church bring to mind, first discovery of two monks and the head inside the pot which was under the ground the second one, but the pot is not founded in cave which in this case correspond to the contend of saintography Matrone holiness version, when is described the spud. Another evidence of identification for the discovery which is refered

DO NOT COPY

by painters of Saint-Thanas is attendance of Matrone holiness at base register in the west corner of the wall, exactly at the slopy face where is painted this scene. Saintography narrations give you an idea about the connection for the second unearthing which happened at Emese in attendance of the Uranius Bishop with godliness. Saint-Thanas church like the other churches of the city, iconographic program put in relations the median register where are correspond to martir scenes of these saints with the base register where saints are perpendicular. Personages who give rhythm base faces of the part at church wall are positioned on top of it. Around nave the saints are situated in hierarchy order and in groups as is common at Byzantine churches. Warrior saints are placed together with each other like anargyre saints (sanatory saints at byzantine church) and the same saints are presented as famoused martirs at median register. This order which link a saint portrait with a narrator scene encourage us to believe that this approach between discovery of the Precursor head and holiness is not a coincidence and the fact in which this sanctity was shown extraordinary confirms these hypothesiss. Presence of the saintness at base register confirms originality of the Saint Prodhrom head discovery. Artists and iconographs have presented exceptionally or not at all the discovery of Saint John-Baptiste head at their icon or mural paintings which are dedicated to this event. Pavle Mijovic, when published pictures of mural menologut of Graçanica, dedicated this miracle, has saw a Bishop and a woman congregated around the relic placed in a pot, however for that time he was sure for the woman, she was Matrone holiness. Christopher Walter at his article for the iconography of this scene predicate that; if it is a women, she must be by sure Matrone; but he decide to do not identified this personage with a feminine image. Angeliki Katsioti at her hypothesis for the presence of th Saint Prodhromi life at Byzantine art, eventuate at this case and shows a Russian art work which belong to the XVII century; a calendarian icon of a February; and its icon as she wrote belong authentic to Byzantine tradition. Feast dedicated to 24 February, celebration for the first and second discovery, a monk is presented attended with a visibly woman and according to her is recognized with Matrone. This icon shows a precession, Russian by sure which is far away geographically but relatively very close timely, combination of Matrone holiness with the presantion of the Saint John Baptiste Precursor head discovery.

This short survey presentation for the discoveries of the Saint Prodhrom Head at Voskopoja, became understandable confusion of different periods of this discovery, because iconography do not always correspond neither with the sources nor with the legend which is known to image. Investigative researches shoud done form one side for the approaching of Matrone holiness with this miracle of Precursor (other examples of her must discovered) and from the other side for the presentation and salvation by this miracle itself. Christopher Walter at his article for the iconography of this subject recreates the hypothesis of a discovery cycle for this historical object at Byzantine Art by relies at rare examples conserve separately. This hypothese is confirmed with publication of the Lavra Icon by Manolis Chatzidakis, as it is written at Angeliki Katsioti work which belongs to the Saint Iconography. The strong presence of these cycles at post Byzantine era follows the same direction and they must analize more as survivals of Byzantine epoch than an innovation of these days. ■

RESTAURIMI I KISHËS SË SHËN MARISË NË LEUSË TË PËRMETIT

PROF. DR. PIRRO THOMO

DO NOT COPY

OBJEKTI I STUDIMIT

Objekt i këtij studimi është restaurimi i kishës së shën Marisë në fshatin Leusë të Përmetit.

Kisha e Shën Marisë së Leusës kishte pësuar dëmtime serioze të strukturave konstruktive, të cilat ia kishin ulur në mënyrë të ndjeshme aftësinë mbajtëse të saj, duke arritur deri në kufijtë e gjendjes rrezik shembjeje të pjesshme ose tërësore. Duke e vlerësuar këtë gjendje Kryesia e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërise shtroi kërkesën për studimin dhe projektin e restaurimit të kishës*.

Projekti i restaurimit dhe konsolidimit u krye në dy faza. Faza e parë përmbante studimin historiko-arkitektonik të monumentit, dokumentimin grafik e fotografik të objektit, dokumentimin sa më të plotë të dëmtimeve të dukshme të tij, zbulimin e shkaqeve kryesore të dëmtimit, si dhe analizën e aftësisë mbajtëse të konstruksionit. Në bazë të tyre, u propozuan ndërhyrjet për eliminimin e dëmtimeve dhe



Pamja veriore e kishës



Pamja lindore e kishës

DO NOT COPY

konsolidimin e monumentit. Në këtë kuadër hyn dhe kërkesa për kryerjen e një studimi gjeoteknik, meqenëse që në autopsinë e parë në monument, u gjykua se terreni ku mbështetet kisha paraqiste probleme serioze.

Mbas miratimit në parim të propozimeve nga instancat përkatëse dhe plotësimit të dokumentacionit me të dhënat e reja, që u përfituan nga vrojtimi më i plotë i objektit dhe duke patur parasysh studimin gjeoteknik, u kalua në hartimin e fazës së dytë të projektit. Qëllimi i kësaj faze ishte të detajonte ndërhyrjet restauruese të propozuara në nivelin e projektit të zbatimit dhe të jepte mbështetjen financiare dhe llogaritëse të tyre.

I. Analiza E Gjendjes Ekzistuese Të Monumentit

1. Studimi Historiko - Arkitektonik

Kisha e Shën Marisë ndodhet në të hyrë të fshatit nga rruga që lidh Përmetin me Leusën, rreth 1/2 orë në këmbë nga Përmeti. Ngrihet në anën verilindore të fshatit, mbi një shesh të pyllëzuar dendur dhe në një pozitë piktoreske, prej nga hapet një pamje e gjerë e luginës së lumit të Vjosës.

Leusa është një nga fshatrat më të zhvilluar të rrethit të Përmetit, si përsa i përket nivelit kulturor dhe ekonomik, ashtu dhe arritjeve në planin urbanistik dhe arkitektonik. Ka një strukturë urbanistike të dendur, e cila përshkohet nga rrugë të shtruara me kalldrëm, të kufizuara nga banesat ose nga muret rrethuese të tyre. Banesat në shumicën e tyre i përkasin tipit të ri banesës fshatare, i cili pati një përhapje të gjerë në shumë fshatra të Shqipërisë Juglindore dhe Jugore gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX. Ato janë kryesisht dykatëshe, të ndërtuara me gurë dhe me vlera konstruktive e arkitektonike.

Si pasqyrim i këtij zhvillimi të përgjithshëm të fshatit është dhe ndërtimi i kishës së Shën Marisë, një monument jo vetëm me përmasa të mëdha, por dhe me vlera të veçanta arkitektonike dhe artistike, si të pikturës murale, ashtu dhe të objekteve të tjera të interierit të gdhendura në dru, si ikonostasi, froni peshkopal, amvoni etj.

Mbishkrimi i pikturuar mbi portën e hyrjes nga ana veriore na jep disa të dhëna historike me interes. Ai bën fjalë për ndërtimin dhe pikturimin e kishës me kontributin e të krishterëve të fshatit, në kohën e episkopimit të Mitropolitit të Korçës dhe të Përmetit Z. Joasaf. Piktorët kanë qenë Mihali, Jorgua dhe Jorgua nga Hionadhi, të cilët e pikturuan më 18 Prill 1812.

Megjithëse në mbishkrim thuhet se kisha është «ndërtuar nga themelet» në vitin 1812, siç është e zakonshme në mbishkrimet e këtij karakteri, të dhëna të tjera na bëjnë që ta marrim me rezervë këtë datë përsa i përket ndërtimit. Një mbishkrim tjetër, i cili gjendej në kornizën e argjendtë të ikonës së Shën Marisë që mban datën 1764 (shih: Th. Popa, «Mbishkrime të kishave në Shqipëri», Tiranë 1998, mbishkr. 408, 369). Ky fakt na shtyn të bëjmë këto supozime: a) ose kisha është ndërtuar më parë, duke patur si kufi të fundit kohor vitin 1764, b) ose në vitin 1812



Pamja lindore e kishës

DO NOT COPY



Pamja e hajatit të kishës

është bërë rindërtimi i kishës ekzistuese mbi themelet e një kishe më të vjetër, c) ose në vitin 1812 është bërë ndonjë meremetim i rëndësishëm i kishës.

1.1. Oborri i kishës

Sheshi ku ngrihet kisha ka një formë të çrregullt në plan që i afrohet më tepër trapezit, i rrethuar nga të gjitha anët me mure. Nga dy anë, perëndimi dhe jugu, kufizohet nga rrugët e fshatit, ndërsa nga anët lindore dhe veriore respektivisht nga përroi i Leusës dhe nga një përrua malor që derdhet në të parin. Terreni ka një rënie të theksuar në drejtimin jugperëndim-verilindje. Në anën jugperëndimore të kishës terreni është sistemuar në formë tarracash, të cilat mbështeten mbi një mur mbajtës të ndërtuar fare pranë kishës. Nga ana lindore dhe veriore terreni ka një thyerje të menjëhershme që bie në përrenjtë që e kufizojnë.

Hyrja për në oborr bëhet në qoshen jugperëndimore të tij, drejtpërdrejtë nga rruga e fshatit. Prej andej një rrugicë e shtruar me plloça guri që përfundon me shkallë të harkuara, të çon në hajatin e kishës, prej nga bëhet hyrja për në kishë. Oborri i kishës ka shërbyer njëkohësisht dhe si varrezë. Territori është i pyllëzuar dendur, por me drurë të çrregullt, nga të cilët bëjnë përjashtim selvijat, që lartësohen në anën jugperëndimore të oborrit.

1.2.- Analiza tipologjike dhe morfologjike e kishës

Kisha e Shën Marisë përbëhet nga naosi, narteksi në anën perëndimore dhe hajati, i cili zhvillohet gjatë gjithë pamjes veriore. Në qoshen veriperëndimore të narteksit lartësohet kambanorja, ndërsa në anën juglindore është ndërtuar një aneks me bodrum, që shërben si qimitër.

Naosi i përket tipit bazilikal trenefësh me kupolë. Dy radhë kolonash guri, me nga katër kolona secila, ndajnë nefet, nga të cilët nefi qendror është me i gjerë dhe më i lartë. Çifti lindor i kolonave, ku mbështetet ikonostasi prej druri që ndan ambientin e altarit, ka seksion katror, ndërsa kolonat e tjera kanë seksion rrethor.

Kolonat lidhen ndërmjet tyre në të dy drejtimet, si dhe me muret perimtrale me harqe, duke krijuar kështu një numër të madh bërthamash drejt-

DO NOT COPY



Pamje e brendshme e naosit

këndëshe në nefin qendror dhe katrore në nefet anësore. Bërthamat e nefit qendror mbulohen me qemere cilindrike, me formuese lindje-perëndim, ndërsa ato të nefeve anësore me kësula sferike. Në pjesen qendrore ngrihet kupola mbi një tambur të lartë.

Naosi komunikon me narteksin nëpërmjet një porte në mes të murit ndarës dhe dritareve anash saj, në nivelin e poshtëm, dhe tre hapësirave të harkuara, në nivelin e sipërm. Ka hyrje gjithashtu nga oborri me anë të një porte të hapur në murin perëndimor.

Dyshemeja e narteksit, e shtruar pjesërisht me dërrasa dhe pjesërisht me pllaka guri, është më e ngritur në krahasim me atë të naosit. Dy radhë kolonash druri, që krijojnë edhe këtu një lloj ndarjeje në tre nefe, mbajnë konstruksionin e çatisë. Kjo ndarje theksohet sidomos në mbulesën e narteksit, pjesa qendrore e të cilit përmban një tavan druri tepër të dekoruar.

Në anën jugore janë vendosur shkallë prej druri që të ngjiten në jinekonit. Jinekoniti del në formë ballkoni të brendshëm, pjesërisht në naos dhe, pjesërisht në narteks. Nga ana e naosit dalja e ballkonit maskohet me strukturë çatmaje me suva të pikturuar, ndërsa



Pamja e hyrjes veriore e kishës

parapeti në pjesën e sipërme mbyllet me kafazlie, ashtu si dhe dritaret e nivelit të poshtëm.

Hajati i vendosur në pjesën veriore, një orientim ky jo shumë i zakonshëm për këtë element, është i detyruar nga pozicioni i kishës në lidhje me terrenin. Në murin lindor përmban një nike në formë apside. Hajati është i hapur në pjesën ballore me një harkadë të gurtë mbi kolona të ulta prej guri, të cilat ngrihen mbi një parapet me mur guri. Mbulohet nga një çati njëujëse, më e ulët nga ajo e kishës dhe është e shtru-



Pamje e brendshme e jinekonitit

ar me pllaka guri me forma të rregullta kuadratike.

Kambanorja ka formën e një muri masiv, i cili përmban në pjesën e sipërme kamaren për vendosjen e kambanës.

1.3.- Trajtimi arkitektonik e dekorativ

Ndarja në bërthama të veçanta dhe mbulesa e shumëllojshme e tyre i japin hapësirës së brendshme një karakter aspak monoton, por të larmishëm, e cila kalon gradualisht nga nefet anësore në nefin qendror më të lartë dhe arrin shpërthimin vertikal në kupolën qendrore mbi një tambur të lartë. Kjo hapësirë nuk mbyllet vetëm në naos, por nëpërmjet hapësirave të shumta dhe jinekonitit shpërndahet edhe në narteks, ku ruan të njëjtin karakter të larmishëm, ndonëse e shprehur me mjete të tjera arkitektonike. Pikturat murale që veshin gjithë sipërfaqen e muraturës e fuqizojnë edhe më tepër ndjenjën e hapësirës së brendshme.

Naosi ndriçohet nga dritare të mëdha, të hapura në pjesën e sipërme të muraturës veriore dhe jugore. Po kështu edhe narteksi merr dritë nga dritare të hapura në murin verior, jugor dhe perëndimor. Dyshemeja e naosit është e shtruar me pllaka guri të parregullta. Në nefin qendror, poshtë kupolës, si dhe në pjesët qendrore të nefeve anësore janë ndërtuar rozeta dekorative.

Elemente të rendësishme të trajtimit dekorativ të interierit janë dhe pajisjet e tij: ikonostasi, froni peshkopal, amvoni, karriket etj., të cilat janë të një cilësie shumë të lartë artistike dhe numrohen ndër kryeveprat e gdhendjeve në dru.

Përkujdesja dekorative nuk ka munguar dhe në narteks, ku tavani në pjesën qendrore përmban ngarkesën më të madhe dekorative. Ai është ndërtuar me dërrasa të pikturuara me motive kryesisht gjeometrike. Në qendër të tavanit është vendosur një rozetë gjashtëkëndëshe, e thelluar në formë kubeje, e cila përfundon me një dërrasë gjithashtu gjashtëkëndëshe, ku është përfytyruar Krishti Pantokrator, ndërsa në dërrasat e kubesë janë pikturuar figura shenjtorësh. Pjesët anësore të tavanit të nefit qendror, të ndërtuara me strukturë çatmaje që fshehin konstruksionin e çatisë, janë të pikturuara me motive të thjeshta gjeometrike, për të mos kontrastuar me tavanin prej druri. Nefet anësore të narteksit përmbajnë gjurmë tavani të thjeshtë druri.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Pamje e brendshme e narteksit



Pamje e tavanit të narteksit



Dekoracioni i tamburit

Elementet dekorative prej druri plotësohen me portën e hyrjes të naosit, pjesa e mbetur e së cilës dëshmon për rëndësinë që i kanë kushtuar ndërtuesit e kishës përpunimit dekorativ, për të cilën duket se janë thirur mjeshtrat më të mirë.

Ndryshe nga interieri, i cili shfaq një larmi në zgjidhjen konstruktive dhe në trajtimin arkitektonik e dekorativ, pamjet e jashtme kanë një formulim më të thjeshtë e të përmbajtur. Çatia dyujëse me dy prerje në anën lindore e perëndimore, thuajse e fsheh strukturën e brendshme, duke theksuar së tepërmi shtrirjen bazilikale të saj. Tamburi i kupolës që ngrihet në pjesën qendrore është i vetmi element theksimi vertikal që tenton të thyejë masën uniforme të çatisë.

Në pamjet e jashtme, ndonëse të thjeshta dhe me elemente të pakta dekorative, ndjehet përpjekja për një përkujdesje në trajtimin e tyre. Kjo është realizuar nëpërmjet diferencimit të përbërësve të ndryshëm kompozicionalë, përpunimit të kujdesshëm

DO NOT COPY



Dekoracioni i tamburit (detaj)

të muraturës, si dhe me ato pak detaje dekorative të përdorura. Kështu në pamjen kryesore nga veriu, nga volumi i kishës shkëputet hajati, i cili me trajtimin e tij të pasur arkitektonik, me një harkadë të hapur në ballë, ndihmon në krijimin e një kompozimi volumor më dinamik. Në pamjen lindore, apsida shumëfaqëshe, diferencohet nga masa tjetër e muraturës së gurtë jo vetëm nga dalja e saj, por dhe nga teknika e ndryshme e ndërtimit, duke e punuar atë me gurë të latuar e të rregullt, me fugatura të holla llaçi, ndërsa pamja perëndimore fiton një theksim vertikal nëpërmjet ngritjes së kambanores së lartë. Ndër elementët dekorativë veçohet përpunimi i portës së hyrjes së naosit, e cila është e qarkuar me një kornizë guri të gdhendur, sipër së cilës është ndërtuar një harkadë treshe e verbër, që përmban të pikturuar skenën e Fjetjes së Shën Marisë. Ndryshe nga muratura e gurtë dhe e zhveshur e kishës, tamburi i kupolës është i suvatuar me llaç të kuqërremtë dhe përmban në brezin e sipërm, sipër dritareve, pjata të emaluara me motive antropomorfe, zoomorfe dhe gjeometrike, të përmasave të mëdha të alternuara me të vogla, nga të cilat kanë mbetur disa ekzemplarë.

1.4.- Analiza konstruktive e ndërtesës

Themelet - Sondazhet e kryera në rrëzë të muraturës në anën lindore dhe atë perëndimore treguan se thellësia e themeleve nga niveli i terrenit është 1,30 m. Ndërtimi i tyre është me gurë të një cilësie të mirë. Gjerësia e themeleve është të paktën 0,90 m aq sa është dhe gjerësia e mureve, meqenëse në anën e jashtme nuk ka zgjerim.

Muratura - Është e një cilësie të mirë, e ndërtuar me gurë të punuar në anën e jashtme dhe e lidhur me llaç gëlqereje. Gjerësia e mureve është 0. 90 m dhe është e njëjtë në të gjithë ndërtesën. Muratura është e ndërtuar me dy faqe të punuara me kujdes, ndërsa në mes është e mbushur me copa guri e llaç. Në intervale të caktuara në lartësi përforcohet me breza druri. Ato janë të fshehura në muraturë në pamjet e jashtme, ndërsa nga brenda dalin në sipërfaqen e muraturës, por mbulohen nga suvatimi, siç duket nga rënia e një fragmenti të pikturës murale në murin jugor. Muret ndërpresin vazhdueshmërinë e tyre në lartësinë 6. 30-7. 10 m nga hapësirat e dritareve me gjerësi 0. 55-0. 60 m. Arkitrau prej guri i dritareve mbahet nga dy gurë të gdhendur të nxjerra konsol, të cilat e zvogëlojnë hapësirën e dritareve në pjesën

DO NOT COPY

e sipërme dhe e bëjnë më të rrjedhshme shkarkimin e ngarkesave në pjesët e plota të muraturës. Qoshet janë të punuara me gurë të mëdhenj e të latuar. Muratura përfundon në pjesën e sipërme të saj me një kornizë guri të gdhendur. Elementet e kurbëzuara: harqet, qemeret, kalotat sferike dhe tirantat.

Siç e vumë në dukje më lart, hapësira e naosit ndahet nga një rrjetë harqesh, që lidhin kolonat ndërmjet tyre dhe me muret perimetrale, duke krijuar një sërë bërthamash, të cilat në nefin qendror mbulohen me qemerë cilindrike, ndërsa në nefet anësore me kalota sferike. Në pjesën qendrore të nefit qendror ngrihet kupola mbi një tambur të lartë. Sistemi konstruktiv bazohet në kriteret e njohura të kishave bizantine, të cilat konsistojnë në anullimin dhe shkarkimin e ngarkesave brenda ndërtesës. Shtytjet horizontale të harqeve pjesërisht ekuilibrohen reciprokisht nga njëra tjetra dhe pjesërisht thithen nga tiranta druri, të vendosura në nivelin e thembrave të harqeve dhe qemereve në të dy drejtimet, gjatësor dhe tërthor.

2. Rilevimi i Monumentit

Rilevimi i monumentit është bërë i kombinuar: me mjete topografike dhe me metoda klasike arkitektonike. Rilevimi topografik është bërë për genplanin, d.m.th. për përcaktimin e reliefit të territorit të kishës, konfiguracionit të tij, lidhjes me objektet e tjera përreth, me rrugët e fshatit dhe përrenjtë që e kufizojnë, si dhe për përcaktimin e kuotave relative të pikave karakteristike të kishës.

Rilevimi arkitektonik është bërë me mjetet e zakonshme, metër, nivel uji, plumbçe etj., dhe duke përdorur sistemin e trekëndëshave. Meqenëse monumenti paraqiste probleme të rëndësishme të gjendjes statike, që shfaqen në deformime, çedime, çarje dhe inklinime të elementëve arkitektonike e konstruktive, u krye një numër i madh planimetrish e



Pamje e shkallës së hyrjes

prerjesh në kuota e plane të ndryshme për të pasur mundësinë e ndjekjes se dëmtimeve, vendeve ku ato janë shfaqur dhe përcaktimit të rrezikshmërisë së tyre. Nga ana tjetër deformacionet dhe inklinimet që ka pësuar kisha e bënte të pamundur matjen e saktë të saj, pa patur pika të njëjta ose një plan të vetëm referimi. Për këtë qëllim për matjet e brendshme u morr një plan horizontal arbitrar dhe që andej u kryen të gjitha matjet në lartësi. Në këtë mënyrë u krijua mundësia për të përcaktuar inklinimin e dyshemesë si dhe pozicionet e vërteta në lartësi të strukturave të ndryshme konstruktive dhe raporteve ndërmjet tyre. Shmangiet nga vertikaliteti i muraturës dhe i kolonave janë përcaktuar me plumbçe muratori.

Matjet e jashtme janë bërë duke u nisur nga kuotat e pikave topografike në bazën e objektit. Në këtë mënyrë u bë e mundur lidhja e objektit me terrenin rrethues dhe njëkohësisht vendosja e lidhjeve ndërmjet matjeve të brendshme dhe atyre të jashtme.

Përpunimi i rilevimit është bërë me kompjuter me programin AUTOCAD. Kjo metodë na dha mundësinë e kontrollit të saktësisë se matjeve, nevojën për plotësime të mëtejshme dhe mundësinë e azhornimit dhe plotësimit të rilevimit me të dhënat



Çarje në dysheme



Çarje në muraturë

e reja që do të dilnin gjatë hapjes së objektit dhe kryerjes së punimeve.

3.- Gjendja e Monumentit.

Patologjia e Ndërtesës

Monumenti paraqiste dëmtime serioze të strukturës mbajtëse, madje disa elemente konstruktive kishin dalë jashtë funksionit që ato duhet të kryenin. Kjo gjë e kishte shpënë monumentin në gjendjen rrezik shembjeje të pjesshme ose tërësore, jo vetëm në rastin e ndërhyrjes se forcave madhore, si lëkundjet sizmike, por edhe nga lënia për një kohë të gjatë në këtë gjendje, meqenëse shkalla e dëmtimeve rritej vazhdimisht dhe do të çonte në prishjen e ekuilibrit statik në të cilën ndodhej ndërtesa.

Dëmtimet në monument sipas elementeve konstruktive ishin si më poshtë:

3.1. Dyshemeja

Dyshemeja, e cila përbën bazën mbi të cilën ngrihet i gjithë konstruksioni dhe pasqyron gjithashtu dhe dëmtimet në bazamentin e ndërtesës paraqiste këto dëmtime:

- Cedime jouniforme.- Vëreheshin inklinime nga plani horizontal në drejtimin lindje - perëndim (12 cm.) dhe jug - veri (10-20 cm.).
- Fisura (çarje).- Çarja me e ndjeshme kalonte nëpër aksin gjatësor të ndërtesës, ndërsa çarjet e tjera në drejtimin tërthor ishin përqendruar kryesisht në anën perëndimore dhe veriore të naosit.

3.2. Muret:

- Inklinime. Qoshet e muraturës kishin një shmangie të lehtë nga vertikaliteti që shkonte maksimale 5 cm në qoshen verilindore në drejtimin verior. Qoshet jugperëndimore dhe veriperëndimore kishin një inklinim drejt veriperëndimit, në masen 1-2 cm.
- Deformime. Vërehej një fryrje (hapje) e ndërtesës në pjesën qendrore të drejtimit gjatësor, e cila arrinte në 7 cm.
- Çarje. Çarje, ndonëse jo shumë të rëndësishme, vëreheshin në të gjitha muret, të cilat arrinin nga çarjet kapilare, në çarje me gjerësi 1. 5 cm. Çarjet me të medha vëreheshin në pamjen lindore që arrinin deri në 1. 5 cm dhe sidomos në qoshen juglindore të ndërtesës.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Çarje në muraturë



Çarje në muraturë

3.3. Kolonat:

- Inklinime. Rrëshqitja e bazës kishte tërhequr me vete dhe kolonat, të cilat paraqisnin shmangie nga vertikaliteti, diku të pakta dhe diku të ndjeshme. Inklinimi i kolonave nuk ishte uniform, ashtu si dhe inklinimi i dyshemesë. Ai shkonte në drejtimin verior në masën 5-8 cm dhe në drejtimin lindor 0-9 cm.
- Deformime. Kolona e dytë rrethore e rreshtit jugor kishte pësuar një deformacion të dukshëm, një përkulje në mesin e saj, që e vinte në pikëpyetje qëndrueshmërinë e saj.

3.4.- Harqet:

Rrëshqitja e bazës dhe inklinimi i kolonave kishin shkaktuar dëmtime serioze dhe në harqet lidhëse të kolonave ndërmjet tyre dhe me muret perimetrale, të cilat shfaqeshin në këto forma:

- Deformime.- Vëreheshin deformacione të konfiguracionit gjysëm rrethor dhe ulje të shigjetës se tyre.

DO NOT COPY



Çarje të tamburit

- Çarje.- Janë shkaktuar çarje të theksuara në kyçet, deri në rënie të gurëve të kyçit në disa harqe.

3.5.- Qemerët e nefit qendror:

- Çarje. Paraqisnin çarje të theksuara, sidomos në kyçet (kulm), të cilat shkonin pandërprerë gjatë gjithë drejtimit gjatësor.

Çarje të tjera me drejtim të çrregullt viheshin re në qemerë të veçanta, sidomos në ato të pjesës perëndimore dhe lindore të naosit.

3.6. Kalotat sferike të nefeve anësore:

- Çarje. Vëreheshin çarje të shumta dhe të konsiderueshme në të gjitha kalotat në drejtime të çrregullta.
- Deformime. Këto dëmtime kishin shpënë në deformacion të konfiguracionit fillestar.

3.7. Apsida:

- Çarje. Kishte një çarje të theksuar gjatë gjithë aksit vertikal, që fillonte në konkë dhe vazhdonte në muraturë, deri në bazë të saj. Kjo çarje ishte njëkohësisht vazhdim i çarjes gjatë aksit gjatësor të qemerëve të nefit qendror.

Në pamjen e jashtme lindore kjo çarje nuk pasqyrohet. Siç duket ajo është e mbuluar nga çatia e konkës së apsidës, ndërsa në muraturë nuk ka arritur deri në faqen e jashtme të saj tepër solide, të ndërtuar me gurë të rregullt e të latuar.

Të tjera çarje në drejtimin vertikal vëreheshin dhe në bashkimin e apsidës me murin lindor të naosit.

3.8. Kupola dhe tamburi:

- Çarje. Çarje të konsiderueshme kishte baza e tamburit, si dhe në mënyrë të veçantë, muratura e tij, të cilat shfaqeshin edhe në pamjet e jashtme. Çarje vëreheshin gjithashtu dhe në kupolën qendrore.

3.9. Tirantat:

- Shkëputje. Pjesa më e madhe e tyre kishte dalë jashtë funksionit. Ato ishin shkëputur nga muratura dhe nga pikat e tjera mbi kolonat ose bazat (thembrat) e harqeve e të qemerëve, pra ishte prishur sistemi i fiksimit dhe i bashkëpunimit me elementet e tjera konstruktive.

DO NOT COPY

3.10. Narteksi:

- Gjithë elementet prej druri të narteksit, si: jinekoniti, konstruksioni mbajtës i çatisë, çatia, dyshemeja prej druri dhe tavanet, ishin krejtësisht të dëmtuara.
- Tavanet ishin tërësisht të dëmtuara. Tavani i drunjtë dekorativ, si pasojë e dëmtimit të strukturës mbajtëse të saj, paraqiste deformacion, shkëputje të dërrasave, kalbje dhe rënie të disa prej tyre. Struktura prej çatmaje e pjesëve anësore ishte prishur tërësisht dhe vetëm disa fragmente të pakta të mbetura dëshmonin për ekzistencën e tyre, ndërsa nga tavanet e nefeve anësore, thuajse nuk kishte mbetur asgjë.

3.11. Hajati:

- Në hajat janë kryer punime të rëndësishme restaurimi, të cilat kanë prekur harkadën dhe rindërtimin e çatisë, si dhe janë ndërtuar dy mure mbajtëse në anën veriore. Megjithatë, për arsye të moskujdesjes për një kohë të gjatë dhe të përdorimit të materialeve me cilësi të dobët, kishte nevojë për një rishikim tërësor të konstruksionit të çatisë dhe të trajtimit arkitektonik të pamjes veriore.

3.12. Qimiteri:

Ishte krejtësisht i braktisur dhe paraqiste dëmtime të konsiderueshme në strukturat e saj, që vëreheshin në:

- Çarje në muraturë.
- Dëmtime të strukturës së çatisë.
- Rrëzime të konstruksionit të dyshemesë.

4. Shkaqet e Dëmtimeve

Në qoftë se i hedhim një vështrim tërësor dëmtimeve, që ka pësuar ndërtesa, mund të nxjerrim disa përfundime të përgjithshme mbi natyrën e tyre dhe shkaqet prej nga kanë rrjedhur ato.



Çarje të kalotave sferike

- Inklinimi i dyshemesë dhe çarjet që ajo ka pësuar na dëshmojnë qartë se kemi të bëjmë me paqëndrueshmëri të terrenit ku mbështetet ndërtesa.
- Dëmtimet jo të njëjta që vëreheshin në pjesë të ndryshme të ndërtesës, ku pjesa jugore kishte pësuar dëmtime më të mëdha nga ajo veriore përsa i përket çarjeve dhe cedimeve, si dhe çarja e madhe në aksin gjatësor të ndërtesës, e cila shkonte pa



Shkëputje të tirantave



Deformime dhe inklinime kolone

ndërprerje në të gjitha qemerët e nefit qendror dhe zbriste vertikalisht poshtë në apsidë, tregonin se kishim të bënim me kushte jo të njëjta pune të këtyre dy pjesëve.

Për këtë arsye u pa e domosdoshme të kryhej një studim gjeoteknik i terrenit të monumentit.

Rezultatet e studimit, janë të bazuara në vrojtimet dhe sondazhet e kryera në terren dhe në analizat laboratorike të kampioneve të marra në themelet e ndërtesës.

Nga ky studim po veçojmë disa nga rezultatet e arritura, që shpjegojnë në mënyrë të qartë shkaqet kryesore të dëmtimeve të monumentit.

- Sipas profilit gjeologjik, ndërtesa mbështetet mbi dy formacione të ndryshme gjeologjike, me tregues të ndryshëm fiziko-mekanikë. Kështu pjesa jugore mbështetet mbi formacione flishi kryesisht ranor, të përfaqësuar nga surana deri ranë e imët me copëra flishi, ndërsa ajo veriore mbi formacione të depozitimeve koluviale (brekçie), që paraqiten si përzierje çakulli gëlqeror me mbushës suargjila të lehta. Kufiri ndarës i këtyre dy formacioneve kalon pothuajse nëpër aksin gjatësor të ndërtesës, duke e ndarë atë në dy pjesë. Këto formacione kanë dendësi dhe plasticitet të ulët dhe zakonisht paraqesin probleme cedimi.
- Rrjedhja e lirë dhe e padisiplinuar e ujërave nëntokësore dhe sidomos e atyre sipërfaqësore dhe depërtimi i tyre nëpër themelet e ndërtesës, ka shkaktuar fenomenin e sufozionit, ose të largimit mekanik të fraksioneve të imta të dherave për efekt të presionit hidrodinamik të ujërave nëntokësore. Sondazhet e kryera treguan se themelet e godinës, në një pjesë të mirë të tyre, qëndrojnë mbi boshllëk.

Në qoftë se do të mbaheshin parasysh vetëm të dhënat e mësipërme do të priteshe që ndërtesa të

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Gjendja e bazamentit të kolonës



Gjendja e çatisë së naosit



Gjendja e çatisë së narteksit

kishte inklinim drejt jugut, gjë që në të vërtetë ka ndodhur e kundërta: ndërtesa ka pësuar një inklinim nga jugu drejt veriut.

Duke studiuar me vëmendje profilet gjeologjike dhe duke e kombinuar me patologjinë e ndërtesës, le të kuptohet se në rastin konkret ka ndodhur dhe fenomeni i rrëshqitjes ndërmjet sipërfaqeve të brekçieve dhe të flisheve, madje me kënd rrëshqitjeje më të vogël së këndi më i vogël i fërkimit.

Në këtë përfundim të shpie dhe studimi i patologjisë së ndërtesës:

- Inklinimi i dyshemesë së naosit është në drejtim të veriut. Në dysheme vërehet gjithashtu një çarje e rëndësishme në drejtimin gjatësor pranë radhës jugore të kolonave, aty ku kalon afërsisht kufiri i ndryshimit të formacioneve gjeologjike.
- Qemerët e nefit qendror janë çarë gjatë gjithë drejtimit gjatësor në kulmet e tyre, çarje e cila vazhdon edhe në drejtimin vertikal në muraturë, duke e ndarë ndërtesën në dy pjesë.

DO NOT COPY



Çarje të konstruksionit të mbulesës



Çarje të konstruksionit të mbulesës

- Pjesa jugore ka dëmtime me të mëdha, që shfaqen si në shmangien nga vertikaliteti i kolonave, ashtu dhe në çarjet e harqeve, të kalotave sferike dhe të qemerëve, në krahasim me atë veriore. Kjo shpjegohet me faktin që pjesa veriore rrëshqet lehtësisht dhe, si pasojë, shkakton çarje me të pakta dhe një shpërndarje relativisht me të rrjedhshme të sforcimeve.

Nga sa parashtruam me sipër, fenomeni i rrëshqitjes duhet të ishte i pranishëm dhe, si rrjedhim, kërkoheshin masa për eliminimin e tij.

II. Punimet e Restaurimit

1. Propozimet Për Ndërhyrjet Restauruese

Duke u bazuar në studimin historiko-arkitektonik

DO NOT COPY



Çarje të konstruksionit të mbulesës



Çarje të konstruksionit të mbulesës



Çarje të konstruksionit të mbulesës

të monumentit, ku vumë në dukje vlerat që ai përmban, në studimin e plotë të patologjisë së ndërtesës, d.m.th. në analizën e gjendjes ekzistuese të monumentit, dëmtimet që ai paraqet dhe zbulimin e shkaqeve kryesore që kanë sjellë këto dëmtime dhe e kanë shpënë monumentin në këtë gjendje, në projekt parashtrohen propozimet për t'i rikthyer ndërtesës aftësinë e saj mbajtëse dhe për të eliminuar rrezikun që ajo paraqet.

DO NOT COPY

1.1. Parimi bazë i ndërhyrjeve të propozuara

Me gjithë dëmtimet serioze të strukturës mbajtëse të ndërtesës, parimi bazë i ndërhyrjeve të propozuara ishte të ndihmohet konstruksioni që të rifitojë aftësitë mbajtëse të humbura dhe jo të ndryshojë funksionin ose skemën konstruktive fillestare.

1.2. Vërejtje të përgjithshme

Në projekt është theksuar që në fillim se në rastin konkret, kur interieri i monumentit është i veshur i tëri me pikturë murale, ndërhyrjet e çdo lloj karakteri paraqesin jo vetëm vështirësi, por dhe rrezikshmëri për dëmtimin e pikturës. Për këtë arsye punimet e konsolidimit u paraprinë nga punimet e konservimit të pikturës murale dhe prania e restauratorit të pikturës ishte e vazhdueshme gjatë gjithë kohës që do të vazhdonin ndërhyrjet konsoliduese.

1.3.- Përcaktimi i kushteve dhe i parametrave llogaritëse

Problemet kryesore që paraqiste gjendja e monumentit ishin ato të humbjes se qëndrueshmërisë statike të tij, si rrjedhim ndërhyrjet më të mëdha në monument janë ato të karakterit statik.

Me qenë se deri më sot nuk ekziston ndonjë rregullore e veçantë për projektimin dhe ndërtimin e ndërtesave me konstruksion guri, si dhe për kontrollin e konstruksioneve të tilla ekzistuese, janë marrë parasysh studime që i përkasin monumentit dhe rregullores që i përafrohen kushteve të vendit dhe të konstruksionit siç janë:

- Relacioni mbi kushtet gjeoteknike të kishës së Leusës në rrethin e Përmetit, pjesë e këtij studimi
- Eurokodi 6 (ENV 1996-1-1/1995)
- Kushtet sizmike të Shqipërisë
- Për krahasim: rregullorja antisizmike për Greqinë, me qenë se kushtet gjeofizike të saj janë të afërta me ato të Shqipërisë.



Ndërtime muresh mbajtëse të terrenit



Ndërtime muresh mbajtëse të terrenit

DO NOT COPY

2.- REALIZIMI I PROJEKTIT.

ZBATIMI I PUNIMEVE TË RESTAURIMIT

Theksojmë që në fillim se gjatë punimeve përgatitore dhe atyre të zhveshjes dhe të prishjeve nuk dolën elemente ose të dhëna që të sillnin ndryshime të projektit, kështu që punimet e restaurimit u kryen në përputhje të plotë me propozimet dhe mënyrën e zbatimit të parashikuara nga projekti.

2.1. Masat urgjente dhe punimet parapërgatitore

Këtu hyjnë masat që u morën për të shpëtuar elementet konstruktive, të cilat jo vetëm kishin humbur qëndrueshmërinë e tyre, por dëmtimi i mëtejshëm i tyre do të sillte dëmtime serioze në gjithë sistemin konstruktiv. Gjithashtu përfshihen dhe punimet e puntelimit të konstruksionit të mbulesës së brendshme për ta siguruar atë gjatë kryerjes së punimeve konsoliduese. Paraprakisht, për ta mbrojtur ndërtesën nga agjentët atmosferikë gjatë kryerjes së punimeve restauruese, u ndërtua një mbulesë provizore dhe e lëvizshme prej panelesh të mëdha, të veshura me llamarinë.

- Konsolidim kolone. Kolona e dytë rrethore e radhës jugore kishte pësuar një deformim të dukshëm në përkulje, që rrezikonte qëndrueshmërinë e mëtejshme të saj. Për këtë qëllim u bë puntelimi i harqeve që mbështeten mbi të dhe ngritja minimale e tyre me kriko, sa për të çliruar kolonën nga ngarkesa. Më pas, me anë të një sistemi tirantash dhe krikosh, u korrigjua deformacioni që ajo përmbante në pjesën qendrore të saj.
- Puntelimi i konstruksionit. Masat për sigurimin e konstruksionit të mbulesës së brendshme konsistuan në ndërtimin e kallëpeve mbështetëse prej druri, sipërfaqja e sipërme e të cilave u vesh me një shtresë të butë për të mos dëmtuar pikturën murale. Më tej u bë një përpjekje për të korrigjuar sadopak deformacionet e harqeve, duke ngritur kallëpet me kriko ose me pyka.

2.2. Punimet e zhveshjes dhe të çmontimit.

Punimet e zhveshjes ose të zbulimit të çatisë dhe të pastrimit të mbushjeve nën çati ishin të domosdoshme për të njohur shkallën e dëmtimeve, të strukturës konstruktive të mbulesës së brendshme dhe për të kryer punimet e konsolidimit të saj.

- U krye pastrimi i kujdesshëm i hapësirës nën çati nga mbeturinat e konstruksionit të çatisë dhe gjithë mbushjeve e depozitimeve të mëvonshme, deri sa u shfaq e plotë dhe e pastër struktura mbajtëse e kurbëzuar.
- Pastrimi u bë me përkujdesjen më të madhe, si të thuash me «metoda arkeologjike», për të zbuluar eventualisht ndonjë element ose gjurmë të fazave më të hershme të monumentit, me qenë se në studimin historiko-arkitektonik të monumentit ishte hedhur hipoteza se gjendja e sotme është si rezultat i të paktën një rikonstruksioni të rëndësishëm, në mos i një rindërtimi tërësor mbi një ndërtesë më të vjetër. Dhe me të vërtetë, në mbeturinat dhe në strukturën e mbulesës u zbuluan gurë që përmbanin elementë pikturë murale, të cilat ishin ripërdorur në ndërtimin të qemerëve. Që nga ky moment filloi të fitojë një bazë vërtetësie hipoteza e hedhur.
- Të nevojshme ishin gjithashtu dhe punimet e çmontimit të pjesëve arkitektoniko-dekorative prej druri, si: çati, dysheme, shkallë, dritare etj., të cilat do t'i nënshtroheshin përkujdesjeve konservuese, si dhe të atyre që kishin pësuar dëmtime tërësore, si rrjedhim lindte nevoja e



Përforcime themelesh të ndërtesës

zëvendësimit të tyre.

2.2.1. Çmontimi i tavanit dekorativ të narteksit

U krye çmontimi i tavanit dekorativ të narteksit për arsye të degradimit si të vetë tavanit, ashtu dhe të strukturës mbajtëse të tij. Çmontimi i tavanit u bë me kujdesin më të madh për të shmangur dëmtimet e mëtejshme, duke e shkëputur atë pa e sforcuar nga struktura mbajtëse e tij.

Para çmontimit u realizua dokumentacioni i plotë i tavanit dhe shënimi i çdo elementi të tij, për të mundësuar rimontimin e saktë të tyre.

2.2.2. Çmontimi i tavanit me strukturë çatmaje

Pjesa e tavanit të nefit qendror të narteksit, në të dy anët e tavanit dekorativ prej druri, e ndërtuar me strukturë çatmaje, ishte shumë e dëmtuar; kishte mbetur vetëm një fragment në pjesën veriore, ndërsa pjesa jugore ishte shkatërruar plotësisht. Pjesa që ruhej përmbante dekoracion të thjeshtë me motive gjeometrike, të pikturuara në suva.

Gjatë çmontimit u tregua kujdes për të ruajtur një fragment, për ta përdorur si model të dekoracionit që përmban dhe për ta rivendosur atë gjatë



Përforcime themelesh të ndërtesës

rindërtimit të tavanit, si dëshmi të ekzistencës së kësaj faze fillestare.

2.3. Punime për konsolidimin e konstruksionit mbajtës

Punimet për rikthimin e qendrueshmërisë statike dhe rritjes së aftësisë mbajtëse të monumentit do t'i klasifikojmë në: a) ndërhyrjet për shëndoshjen e konstruksionit ekzistues; b) ndërhyrjet konsoliduese me

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Ndonëse në raste të tilla, kur dëmtimet dhe çarjet e strukturës mbajtëse ishin të mëdha, injektimet për konsolidimin dhe kompaktësimin e kësaj strukture ishin të nevojshme, në rastin konkret, kur i gjithë interieri është i veshur me pikturë murale, kjo ndërhyrje rekomandohej të ishte e kufizuar dhe e kujdesshme.

Injektimet u kryen kryesisht në zonat ku çarjet e strukturës shfaqeshin më të dendura dhe mbasi u bënë fugatimet dhe qepjet.

Llaçi i injektimit përbëhej prej materialesh tradicionale, më përdorim minimal të çimentos dhe me rezistencë jo me të madhe se llaçi i shëndoshë i muraturës, për të shmangur rrezikun e krijimit të bërthamave rigjide brenda masës së muraturës. Megjithatë u përdor një lëndë e veçantë, Trikosal, e cila eliminon efektet negative të çimentos.

Injektimi u krye me gravitacion, d.m.th. me vetërrjedhje dhe në një drejtim, duke filluar nga pjesët e poshtme të muraturës dhe duke u ngjitur në lartësi.

Siç e theksuam dhe më sipër, veçanërisht për injektimet, kjo ndërhyrje u krye mbasi u morën masat e nevojshme në pikturën murale, d.m.th. mbasi përfundoi mbyllja ose vulosja e çarjeve, konsolidimi i pikturës me anë të injektimeve e plombimeve etj. Në këtë mënyrë do të krijohej një shtresë mbrojtëse ndërmjet pikturës dhe muraturës që do të ndalonte depërtimin e materialit injektues të konstruksionit në pikturë.

2.3.2. Ndërhyrjet konsoliduese me anë të masave ndihmuese

Në këtë kategori hyjnë ato ndërhyrje të cilat u kryen atëherë kur ndërhyrjet e mësipërme të shëndoshjes së konstruksionit ishin të pamjaftueshme për të arritur aftësinë mbajtëse të kërkuar. Këtu përfshihen vendosja e tirantave rrethore në kupolë dhe në kalotat sferike, përforcimi i themeleve, ankorimi i qosheve të ndërtesës etj.

2.3.2.1. Tirantat rrethore ose unazat shtrënguese

Me qenë se kalotat sferike të nefeve anësore paraqisnin dëmtime të mëdha dhe masat e mësipërme për konsolidimin e tyre në kushtet kur ato nga ana e brendshme e tyre janë të veshura me pikturë murale mund të mos kishin rezultatin e kërkuar, u bë konsolidimi i tyre i mëtejshëm me anë të unazave metalike shtrënguese në bazën e tyre.

Unaza të tilla shtrënguese u vendosën edhe në muraturën e tamburit të kupolës, me qenë se ajo kishte pësuar çarje të konsiderueshme, përmban pikturë në faqen e brendshme dhe ka trashësi të vogël, të cilat nuk lejonin të merreshin plotësisht masa të tjera përforcimi. Në tamburin e kupolës u vendosën dy radhë unazash në pjesën e sipërme të tij dhe një radhë në bazë.

Materiali i përdorur për tirantat unazore është hekur inoksidabel nikelkrom 316, Φ10. Unazat metalike mbështeten në jastëkë, distanca ndërmjet të cilave është llogaritur në mënyrë që të kemi një shpërndarje uniforme të ngarkesës. Tirantave u është dhënë një paratensionim i lehtë me anë të shtrëngimit të tyre me muftat.

2.3.2.2. Përforcimi i terrenit.

Siç e kemi venë në dukje më sipër, fenomeni i rrëshqitjes se terrenit duhet të ishte i pranishëm, prandaj, para se të kryheshin ndërhyrjet konsoliduese, duhej të merreshin masa për përforcimin e terrenit të kishës. Vendi ku u aplikuan këto përforcime dhe mënyra e ekzekutimit të tyre ishin ato të propozuara nga studimi gjeoteknik.

Kështu pothuajse në të gjitha anët e terrenit, muret ekzistuese mbajtëse, të ndërtuara me mure guri në të thatë, të cilat thuajse kishin dalë jashtë funksionit, u përforcuan me këmisha ose me mure mbajtëse

DO NOT COPY



Mbulimi i çatisë së kishës

prej betoni të armuar. Këmishat ose muret e reja mbajtëse u ndërtuan nga ana e brendshme e mureve ekzistuese, duke ruajtur faqen e jashtme të tyre dhe duke e përdorur atë si kallëp për derdhjen e betonit. Në këtë mënyrë dhe me meremetime të pakta, u sigurua të ruhej pamja e jashtme e mureve mbajtëse ekzistuese, megjithë teknikën e ndërtimit dhe fakturën e tyre.

2.3.2.3. Konsolidimi i themeleve të ndërtesës.

Për arsye të cilësisë së dobët të terrenit dhe llojit të ndryshëm të shtresave gjeologjike mbi të cilat mbështetet ndërtesa, u quajt e domosdoshme konsolidimi i themeleve dhe bazës mbështetëse të godinës. Ky përfundim i studimit gjeoteknik u vërtetua edhe gjatë punimeve të gërmimit për konsolidimin e themeleve. U vërejt se themelet ekzistuese kishin pësuar të çara, ashtu si dhe muret e kishës, mbështeteshin në bazamente natyrale tepër të paqëndrueshëm, ndërsa themelet e kolonave, kryesisht ato të anës jugore, kishin një thellësi prej 20-30 cm, pra praktikisht ishin inekzistente.

Konsolidimi i themeleve të ndërtesës u arrit duke bërë zgjerimin e themeleve ekzistuese me mure të holla B. A. dhe duke vendosur nën to jastëkë B. A. Jastëkët nën muret perimetrale u vendosën 1, 0 m. larg njëra-tjetrës. Ato kanë thellësi 0. 50 m, nën muraturë, ndërsa plintuset nën kolonat arritën thellësinë minimale 1. 0 m. U realizua gjithashtu lidhja e themeleve të kolonave dhe të mureve me trarë, duke krijuar një rrjetë të plotë, i cili do të zvogëlojë presionet jouniforme të terrenit. Elementet e reja janë prej B. A. C 20 (që i korrespondon afërsisht markës së betonit 300, sipas standardeve të vjetra).

Para zbatimit të punimeve të betonimit u bë mbushja e terrenit nën themelet me një shtresë çakulli me trashësi 0. 50 m, meqenëse, siç është vënë në dukje, këtu ka vepruar fenomeni i sufozës.

Gjatë gërmimeve për konsolidimin e themeleve, dolën në dritë gjurmë të vjetra: mure, fragment kolone, pikturë murale, të cilat i përkisnin një ndërtimi më të vjetër, të cilat u dokumentuan dhe u lanë të paprekura.

2.3.2.4. Ankorimi i qosheve të murit

Shmangia minimale e qosheve të ndërtesës nga vertikaliteti nuk paraqet ndonjë rrezik, ndonëse qoshet janë elemente të rëndësishme për qëndrueshmërinë dhe lidhjen muraturës. Përkundrazi problematike

DO NOT COPY

paraqitej hapja e qoshes juglindore. Rikthimi i aftësisë mbajtëse të saj, me ndërhyrje lokale, nuk do të ishin të rekomandueshme dhe efikase në këtë rast. Për këtë arsye konsolidimi i qoshes u bë duke i lidhur ose ankoruar muret suksesive me njëra-tjetrën me anë të shufrave metalike. Gjatë gjithë lartësisë së qoshes u vendosën shufra me gjatësi 1.5 m, çdo 0.80 m në formë shahu, në mënyrë që të ankorohen të dy faqet e muraturës, Shufrat janë prej hekuri inoksidabël, Φ12. Mbasi u çimentuan në brendësi të muraturës dhe mbas 28 ditësh, shufrave iu dha një paratensionim prej 2-3 tonësh, në mënyrë që ato të punojnë në mënyrë aktive.



Restaurimi i tamburit të kupolës

2.3.3. Konsolidimi i konstruksionit me zëvendësimin e strukturave tërësisht të dëmtuara

Në këtë kategori hyjnë ndërhyrjet në elementet konstruktive tërësisht të dëmtuara ose të dala jashtë funksionit, duke i zëvendësuar ato me elemente dhe materiale të reja. Në këto ndërhyrje përfshihen vendosja e tirantave horizontale metalike në vendin e tirantave të vjetra prej druri, lehtësimi i konstruksionit mbajtës të naosit nga ngarkesat e mbulesës, duke ndërtuar një çati të pavarur, rikonstuksioni i strukturave të drujta të narteksit, si çati, elemente konstruktive të jinekonitit etj.

2.3.3.1 Zëvendësimi i tirantave horizontale

Siç e kemi venë në dukje tashmë në kapitullin mbi patologjinë e monumentit, tirantat ekzistuese prej druri ishin shkëputur nga muratura dhe kishin dalë jashtë përdorimit, d.m.th. nuk ishin më në gjendje të thithin spintat (shtytjet horizontale) të harqeve dhe të qemerëve. Rivendosja e tirantave prej druri, të cilat vendoseshin që gjatë ndërtimit të kishës dhe krijonin një rrjetë së bashku me brezat e drurit të muraturës, sot është praktikisht krejt e pamundur. Janë parapëlqyer tirantat metalike jo vetëm për arsye të jetëgjatësisë se tyre, por se i japin gjithë konstruksionit një elasticitet më të madh.

Tirantat metalike u vendosën në drejtimin dhe vendin e tirantave të vjetra prej druri. Shpimi i vrimave në muraturë dhe në thembrat e harqeve e të qemerëve u bë me trapano me rrotullim, pa goditje, për të mos dëmtuar konstruksionin dhe pikturën murale.

Për të mos e dëmtuar akoma më tepër sistemin

DO NOT COPY



Proces nga rikthimi në pozicionin fillestar të kolonave



Gurë me pikturë të ripërdorur

konstruktiv ekzistues, edhe kështu tepër të dëmtuar, tirantat e vjetra prej druri nuk u prishën. Tirantat e reja metalike u vendosën të paktën 10-15 cm mbi ato ekzistueset për të mos krijuar përqëndrime tensionesh mbi kapitelet e kolonave.

Pas vendosjes dhe ankorimit, tirantave iu dha një paratensionim me anë të muftave në masën 50% të aftësisë tensionuese të tyre d.m.th. 1800 Kg/cm2 për të eliminuar përqëndrimin e tensioneve të tepërta lokale në masën e muraturës, që mund të sillnin shkatërrimin e saj. Me zgjedhjen e kësaj vlere paratensionimi, në rastin e tërmeteve të vogla, ndërtesa do të mund të përballojë tensionet e tërheqjes, ndërsa në tërmetet më të mëdha do të krijohen vetëm çarje kapilare, të padëmshme dhe të përballueshme.

- Tirantat gjatë aksit tërthor në kuotën + 3.50

Në drejtimin tërthor veri-jug në kuotën +3.50 m. u vendosën 5 radhë tirantash Φ 24. Për të mos krijuar tensione negative në kolonat, tirantat nuk u ankoruan në pilastrat mbi kolonat, por vetëm u mbështetën në to. Ankorimi u bë në muret perimetrale të ndërtesës. Zona e ankorimit u gërmua, u bë shëndoshja e muraturës në këtë zonë me anë të fugatimit të thellë dhe u ndërtua një jastëk me llaç tip EMACO S88 të armuar, mbi të cilin mbështetet pllaka metalike e ankorimit. Foleja e ankorimit u mbyll me një pllakë guri, në mënyrë që pllaka metalike të jetë e maskuar nga jashtë.

- Tirantat gjatë aksit gjatësor lindje-perëndim

Në drejtimin gjatësor lindje-perëndim, në të njëjtën kuotë u vendosën 2 radhë tirantash. Këto tiranta janë të së njëjtës cilësi me ato të drejtimit tërthor, por me seksion Φ30, i cili rezulton nga llogaritjet përkatëse.

DO NOT COPY



Mure të vjetra nën dyshemenë e kishës



Fragment kolone

Ankorimi i tirantave u bë njëlloj me ato të tirantave tërthore.

- Tirantat në kuotat +6.20 dhe +7.20 m.

Tiranta horizontale metalike u vendosën edhe në nivele të tjera, në kuotat + 6.0 m. dhe + 7.20 m. në drejtimin tërthor, të cilat thithin shtytjet vetëm të qemerëve të nefit qendror. Cilësia e tyre është e njëjtë me atë të tirantave të mësipërme, por me seksion Φ24. Ankorimi i tirantave u realizua me anë të një profili metalik, të vendosur gjatë gjithë gjatësisë së qemerit, në mënyrë që të sigurohet një shpërndarje sa më uniforme e sforcimeve.

2.3.4. Rindërtime dhe meremetime të çatisë.

2.3.4.1. Çatia e naosit.

Për rindërtimin e çatisë se naosit në projektin e fazës së parë propozoheshin dy mënyra. Pjerrësia e flegrës së çatisë mund të krijohej me mbushje me material të lehtë, për të krijuar një shpërndarje sa më uniforme të ngarkesave mbi strukturat e kurbëzuara, ose duke ndërtuar një çati të pavarur druri, e cila do të çlironte strukturat e kurbëzuara nga ngarkesa e çatisë. Zgjedhja ndërmjet dy varianteve do të bëhej mbas zbulimit të çatisë ekzistuese, kur të dilte forma e konstruksionit fillestar.

Mbas punimeve të zbulimit doli qartë se çatia fillestare ishte me konstruksion druri. Për arsye të shkallës së lartë të degradimit të strukturave të drurit të çative, u bë rindërtimi i tyre, sipas skemës ekzistuese. Lënda e përdorur për ndërtimin e çative është prej gështenje të staxhionuar dhe të dezinfektuar.

Shtresa e mbulesës me pllaka guri u realizua mbi një shtresë llaçi mbi një rrjetë metalike inoksidabël, e

cila do ta sigurojë nga rrëshqitja dhe do t'i japë jetëgjatësi.

2.3.5. Rikthim në pozicionin fillestar të elementeve të deformuara

Kësaj kategorie ndërhyrjesh iu nënshtruan ato elemente konstruktive apo arkitektonike, të cilat paraqisnin deformacione të tilla, sa që mund të vinin në pikëpyetje qëndrueshmërinë e tyre, ose kompromentonin unitetin estetik të veprës. Të tilla elemente janë kolonat e brendshme, sidomos ato të anës jugore, të cilat kishin pësuar një shmangie nga vertikaliteti, që arrinte deri në 9 cm. Ky proces konsistonte në korrigjimin, aq sa të ishte e mundur, të deformacioneve ose të inklinimeve të elementit, pa prekur strukturën formuese të tij. Nënkuptohet se ky proces kërkonte një kujdes të veçantë dhe përvojë të madhe në punimet e këtij karakteri, aq më tepër se elementet ndodheshin nën ngarkesë, përndryshe mund të rrezikohej qëndrueshmëria e elementit dhe, si rrjedhim, prishja e ekuilibrit statik e të gjithë ndërtesës. Po ashtu paraqiste rrezikshmëri dhe për personelin që do të punonte për realizimin e këtij procesi.

Për këtë arsye, pikë së pari, u çliruan kolonat nga ngarkesa e një sistemi të tërë harqesh, qemerësh e kolotash sferike që transmetohen mbi to, nëpërmjet kallëpeve mbajtëse, të ndërtuara që në punimet përgatitore. Meqenëse ky shkarkim nuk mund të konsiderohej i plotë, u vendosën trarë mbështetës (puntelime) në nivelin e kapiteleve. Gjithashtu në bazën e kolonës u vendosën dy profile metalike të fuqishme mbajtës. Tashmë kolona, e çliruar plotësisht nga ngarkesat, mund të lëvizte lirisht në drejtimin e duhur. Lëvizja u krye në bazën e kolonës, duke përdorur profilet metalike dhe duke i spostuar ato me anë të krikove. Si rezultat, kolonat thuajse fituan vertikalitetin e nevojshëm, pa pësuar më të voglin dëmtim.

2.3.6. Punime të ndryshme

2.3.6.1. Konsolidimi dhe restaurimi i qimiterit

Konsistuan në punimet e mëposhtme:

- Konsolidimin e muraturës
- Rindërtimin e dyshemesë
- Rindërtimin e çatisë
- Përgatitjen dhe vendosjen e dyerve dhe të dritareve.

2.4. Ndërhyrjet e karakterit arkitektonik

Monumenti kishte arritur deri në ditët tona me ndryshime shumë të pakta të tipareve tipologjike e morfologjike. Për këtë arsye ndërhyrjet restauruese kishin më tepër karakter konservimi e plotësimi të elementeve arkitektonike e dekorative të dëmtuara ose atyre munguese, si dhe zëvendësimin ose rindërtimin e elementeve tepër të degraduara.

2.4.1. Punimet në naos

Punimet në naos u përqëndruan në:

- Konservimin dhe plotësimin e pjesëve munguese të portës veriore të naosit, duke bërë një integrim me të kujdesshëm të pjesës ekzistuese me atë të re;
- Konservimin dhe plotësimin e elementeve arkitektonike e dekorative në murin ndarës të naosit me narteksin (portës, kafazeve etj.);
- Plotësimin e shtresës me pllaka guri të dyshemeve mbas punimeve të konsolidimit të themeleve, duke përdorur të njëjtat pllaka ose duke i plotësuar ato me pllaka të së njëjtës natyrë, të nxjerra nga shtëpitë e vjetra të fshatit. U lanë hapësira të mbyllura tani për tani me kapakë dërrase, për të qenë të vizitueshme gjurmët e kishës së vjetër, si një fragment muri me pikturë murale dhe një fragmenti i kolonës rrethore,

DO NOT COPY

- Zëvendësimin e dritareve të dëmtuara, me të njëjtën formë dhe dimension me ato të vjetrat,
- U ribënë gjithashtu dhe kasat e dëmtuara të dritareve, si dhe plotësimi i tyre me zgara metalike,
- Konservimin e pajisjeve të interierit: ikonostasit, fronit peshkopal, amvonit, prosqinitareve, karrigeve etj.

2.4.2. Punimet në narteks

Punimet konsistuan kryesisht në restaurimin e tavanit të narteksit.

2.4.2.1. Restaurimi i tavanit të narteksit

Siç dukej nga pjesët dhe gjurmët e ruajtura, tavani i narteksit ishte tre llojesh, të cilat rrjedhimisht do të kishin dhe mënyra të ndryshme ndërhyrjesh.

1. Pjesa qendrore e tavanit të nefit qendror

Është pjesa me e dekoruar, e cila ruhej në gjendje me të plotë, por shumë e dëmtuar, si vetë dërrasat e tavanit, ashtu dhe konstruksioni mbajtës i tyre. Ndërhyrjet në të ishin me tepër të karakterit konservues:

- U bë çmontimi i kujdesshëm i dërrasave nga struktura mbajtëse e tyre dhe shënimi i tyre sipas skicës të hartuar që më parë,
- U krye dezinfektimi i çdo dërrase dhe konsolidimi i tyre me kimikate të përshtatshme,
- U ndërtua struktura e re mbajtëse,
- U bë rimontimi i tavanit dhe plotësimi i ndonjë pjese munguese.

2. Pjesët anësore me strukturë çatmaje të tavanit të nefit qendror

Ishte ruajtur vetëm një pjesë e vogël në anën veriore në gjendje shumë të dëmtuar, ndërsa e gjithë pjesa jugore ishte e rrëzuar. Për restaurimin e saj u veprua në këtë mënyrë:

- U shkëput dhe u ruajt një pjesë origjinale e tavanit të saj
- U rindërtua struktura e re mbajtëse e çatmasë, por në vend të paretkave të dërrasës u vendos rrjetë teli inoksidabël, për ta bërë me të qëndrueshme në kohë,
- U ripikturua sipas modelit ekzistues. U pranua kjo zgjidhje, meqenëse kemi të bëjmë me motive të thjeshta gjeometrike, të cilat përsëriten ritmikisht dhe simetrikisht, për rikrijuar integrimin estetik të tavanit.

3.- Tavani prej druri në nefet anësore të narteksit

Sipas gjurmëve të ruajtura nefet anësore të narteksit mbuloheshin gjithashtu me tavan dërrase, i cili ishte i rrëzuar së bashku me strukturën mbajtëse. Zbuluam vetëm një dërrase të ngjyrosur në qoshen veriperëndimore, pjesë e kornizës rrethuese, e cila, së bashku me gjurmët në konstruksionin mbajtës, dëshmonin për ekzistencën e tavanit në këto pjesë.

Duke mos patur elemente të mjaftueshëm, rikonstruksioni u bë duke ruajtur dhe plotësuar kornizën rrethuese, ndërsa fusha u plotësua me dërrasa të thjeshta, për të mos krijuar konfondime dhe keqinformime.

4. Punimet e tjera në narteks konsistonin në:

- Zbulimin, pastrimin dhe konservimin e elementeve të vjetra të portës perëndimore të narteksit,
- Zëvendësimin e kolonave të drujta të narteksit,
- Plotësimin dhe meremetimin e dyshemesë me pllaka guri dhe rindërtimin e dyshemesë me dërrasa.

2.4.3. Restaurimi i jinekonitit

Jinekoniti u restaurua pjesë-pjesë dhe me kujdes,

DO NOT COPY

DO NOT COPY

për të mos dëmtuar elementet që do të ruheshin, siç janë struktura e çatmasë së bashku me parapetin nga ana e naosit, të cilat përmbajnë piktura murale. Punimet u përqendruan në:

- Rindërtimin e dyshemesë dhe të konstruksionit mbajtës të saj;
- Struktura e çatmasë në pjesën e poshtme të dyshemesë u konsolidua për aq sa të mos dëmtohej piktura murale që e vesh atë;
- Pjesa e parapetit nga ana e naosit, sipas gjurmëve të ruajtura, ka qenë me dërrasa të punuara, të cilat në një fazë të dytë janë çukitur dhe veshur me pikturë. Këto gjurmë nuk u prekën, por pjesët e dala nga dëmtimi ose rënia e pikturës u evidentuan, pa e plotësuar dhe intonuar pikturën që i vishte ato;
- Pjesa tjetër e parapetit nga ana e naosit në formë kafazi u ruajt gjithashtu e paprekur. Në të u kryen përforcimet e nevojshme dhe u morën masa konservuese të drurit;
- Parapeti nga ana e narteksit u çmontua para fillimit të punimeve. Ai iu nënshtrua punimeve konsoliduese, konservuese, si dhe të plotësimit të pjesëve munguese dhe së fundi u montua në vendin e vet;
- U bë zëvendësimi tërësor i shkallës, e cila ishte krejtësisht e degraduar.

2.4.4. Restaurimi i hajatit

Restaurimi i dobët i hajatit, që konsistonte në rindërtimin e një pjese të harkadës dhe suvatimin e saj, si dhe dëmtimi i mëtejshëm i saj, krijonte një prishje të unitetit estetik të gjithë pamjes kryesore veriore. Për këtë arsye u pa me vend të ribëhej kjo pjesë me teknikën vendase, duke lënë në dukje gurët e harqeve dhe duke i fugatuar ato.

2.5. Punimet e rregullimit të territorit të kishës

Në projektin e rregullimit të territorit, tërhiqej vëmendja për të ruajtur karakterin e monumentit, i cili ka shërbyer njëkohësisht si kishë dhe varrezë e fshatit, pra duhej të kishte një karakter të qetë e solemn. Njëkohësisht, përveç konsolidimit të mureve mbajtëse, për të cilat u bë fjalë më sipër, duhet të merreshin masa për eliminimin e mëtejshëm të shkaqeve, që kishin shkaktuar dëmtimet.

Në bazë të këtij projekti, punimet u përqendruan në:

- Disiplinimin dhe largimin e ujërave nëntokësore dhe atyre sipërfaqësore, me anë të drenazheve dhe kanaleve ose kunetave;
- Konservimin dhe plotësimin e portës së hyrjes të oborrit;
- Meremetimin dhe plotësimin me pllaka guri të rrugicës kryesore nga porta deri në hyrje të kishës;
- Meremetimin dhe plotësimin e shkallares së harkuar në hyrje të kishës;
- Sistemimin e parcelave të varrezës, duke lënë ndërmjet tyre rrugica të shtruara me çakëll ose me pllaka guri;
- Krijimin e shesheve për shlodhjeje të shtruara me pllaka guri;
- Disiplinimin e gjelbërimit, duke prerë bimësinë e egër dhe duke bërë seleksionimin e pemëve. U krijuan partere (parcela) të gjelbëruara dhe me lule, ndërsa gjelbërimi i ri u zgjodh i ulët.

2.6. Instalimet elektrike

Kërkesat që do të shërbenin si detyrë bazë projektimi për specialistët përkatës dhe që u zbatuan në praktikë ishin:

- Monumenti u pajis me ndriçim të brendshëm dhe të jashtëm;

- Ndriçimi i brendshëm ka dy funksione të pavarura nga njëra tjetra. Ndriçimi i parë i shërben nevojave të zhvillimit të liturgjisë fetare dhe në përputhje me kërkesat e saj, ndërsa ndriçimi tjetër është në funksion të theksimit të vlerave arkitektonike e artistike të monumentit, si dhe të gjurmëve të kishës së vjetër;
- Ndriçimi i jashtëm ka gjithashtu dy funksione: për të nxjerrë në dukje vlerat e jashtme të monumentit dhe për ndriçimin e rrugicave të kalimit dhe të shesheve të pushimit.

PËRFUNDIME

1. Gjurmët e zbuluara dhe respektimi i tyre, hedhin dritë sa do pak për fazat më të hershme të monumentit. Gurët që përmbanin pikturë dhe ishin ripërdorur në ndërtimin e qemerëve të mbulesës, së bashku me gjurmët e dala nga gërmimi i themeleve, vërtetuan në mënyrë të plotë ekzistencën e një kishe më të vjetër dhe se kisha e sotme ishte ngritur mbi të. Tani për tani, vetëm me këto të dhëna, rezervohemi të japim një kronologji të saktë për këtë ndërtim të vjetër. Studimet dhe analizat në të ardhmen mund ta ndriçojnë këtë problem. Lënia në dukje dhe të vizitueshme të këtyre pjesëve do ta lehtësojnë këtë studim.
2. Në përfundim të punimeve të mësipërme mund të themi se aftësia mbajtëse iu rikthye përfundimisht ndërtesës, duke shpëtuar këtë monument të rëndësishëm nga shkatërrimi i sigurt. Këtë e provoi më së miri dhe koha prej një viti e garancisë së punimeve, gjatë së cilës në këtë krahinë u ndjenë dhe lëkundje jo të pakta sizmike. Kontrolli i bërë në objekt mbas kësaj periudhe garancie, tregoi se ndërtesa nuk kishte pësuar as më të voglin dëmtim.
3. Duhet theksuar se kjo u arrit në saje të një bashkëpunimi të ngushtë dhe të vazhdueshëm gjatë gjithë fazave, që nga studimi e projektimi e deri te zbatimi dhe përfundimi i punimeve, i të gjithë hallkave përbërëse: restauratorëve të arkitekturës, inxhinierëve, gjeologëve, restauratorëve të pikturës dhe të arteve të aplikuara, e deri të mjeshtrave të aftë dhe me përvojë për punime të këtij karakteri.
4. Në punimet e konsolidimit dhe të restaurimit u përdorën metoda, teknologji dhe materiale të provuara dhe të miratuara nga praktika bashkëkohore e restaurimit, si për punimet e arkitekturës, ashtu dhe ato të pikturës murale dhe të drudhendjes.
5. Ndonëse gjendja e monumentit ishte pranë asaj katastrofikes, si rrjedhojë dhe ndërhyrjet për konsolidimin e strukturave konstruktive ishin të shumta, ekzekutimi i tyre dhe i punimeve të tjera të restaurimit u bë në mënyrë shumë diskrete, aq sa një sy i pastërvitur, ose që nuk njeh gjendjen fillestare të ndërtesës, nuk mund të rrokë shkallën e këtyre ndërhyrjeve. Por kjo ka më tepër rëndësi për të ashtuquajturën «qëndrim estetik të restaurimit», që synon qëndrimin sa më larg gjeometrizimit dhe lustrimit dhe ruajtjen sa më shumë të patinës së kohës dhe fakturës origjinale të monumentit.
6. Si përfundim mund të themi se fondit të kulturës kombëtare iu rikthye me gjithë autenticitetin e vet një monument me vlera të veçanta arkitektonike dhe artistike dhe besimtarëve një tempull i denjë lutjesh dhe ceremonish ■

DO NOT COPY

DO NOT COPY


PRERJA 2–2


PRERJA 5–5

Parametrat, llogaritjet statike dhe të dhena të tjera teknike

1. Parametrat gjeofizike

Disa nga karakteristikat kryesore të formacioneve gjeologjike janë si më poshtë:

Për flishet: ngarkesa e lejuar = 1.4 kg/cm2
moduli i deformacionit E=30 kg/ cm2
kohezioni C = 0.0 kg / cm2
këndi i fërkimit të brendshëm Φ = 260
Për brekçiet: ngarkesa e lejuar = 1.8 kg/cm2
moduli i deformacionit E=40 kg/ cm2
kohezioni C = 0.014 kg / cm2
këndi i fërkimit të brendshëm Φ = 330

2.-Parametrat e llogaritjeve të muraturave

Ngarkesat vertikale

Ngarkesat konstante vertikale përbëhen nga pesha vetjake e ndërtesës dhe nga ngarkesa e mbulesës së çatisë. Është konsideruar pesha vetjake e konstruksionit mbajtës e barabartë me 2 t/m3 dhe pesha vetjake e mbulesës së çatisë 1,8 t/m3, me qenë se ka trashësi jouniforme.

Ngarkesa të lëvizshme

Nuk u morën parasysh ngarkesat e lëvizshme, për arsye të vlerës shumë të vogël të tyre në krahasim me peshën vetjake të konstruksionit, me përjashtim të peshës së lëvizshme në çati. Ngarkesa e dëborës dhe e njeriut në rastet e meremetimit: qσ = 0,1 t/m2

Forcat sizmike

Llogaritja e saktë e forcave sizmike ose e akseleracionit sizmik kërkon njohjen e izoperiudhës së lëkundjes së ndërtesës. Theksojmë megjithatë se, pavarësisht nga mosnjohja e vlerës së saktë të izoperiudhës të konstruksionit, akseleracionet që dalin për ndërtesat me konstruksion mbajtës muraturën prej guri, të cilat karakterizohen nga plasticiteti shumë i ulët, nga rezistenca e ulët dhe nga plakja e materialeve, janë shumë të larta. Akseleracioni sizmik është llogaritur nga relacioni:

Rd(T) = A x γI x β0 x Θ/q

ku:

- A: Akseleracioni sizmik i terrenit. Leusa përfshihet në zonën sizmike me intensitet lëkundjeje prej 7 ballësh, sipas studimit gjeoteknik, të cilës i korrespondon a = 0,16 g.

DO NOT COPY



Pamje e çatisë pas restaurimit



Pamja veriore pas restaurimit



Pamja e përgjithshme e kishës pas restaurimit



Pamja lindore pas restaurimit

DO NOT COPY

- γI : koeficienti i rëndësisë. Për arsye të cilësimit të ndërtesës si Monument Kulture, ajo hyn në kategorinë me të lartë të rëndësisë (Σ4), e cila ka γI = 1,3.
- β0 : vlerë e cila është funksion i kategorisë se terrenit, i themelit dhe i izopoeriudhës së ndërtesës. Meqenëse izoperiudha e ndërtesës nuk është e njohur, megjithatë pritet të jetë diçka më e madhe nga vlera T1=0,15 sek, mbi të cilën konfiguracioni bëhet horizontal, është marrë vlera maksimale β0=2,50
- Θ: koeficient i ndikimit të themelit. Me qenë se ndërtesa nuk hyn në ndonjë nga kategoritë ku lejohet zvogëlimi i koeficientit, është marre Θ=1,00
- q: koeficienti i punës. Është marrë q=1,50, që i korrespondon muraturës me radhë horizontale
- Me vlerat e mësipërme, madhësia e akseleracionit sizmik është e barabartë me:

Rd(T) = 0,16x1,3x2,5x1/1,5 = 0,35 g

Rezistencat

Në mungesë të të dhënave të drejtpërdrejta nga monumenti përsa i përket rezistencës së materialeve të ndërtimit dhe të muraturës, janë marrë me rezervë vlerat kufitare nga monumente të tjera të ngjashme

- Rezistenca në shtypje: fwc=20,0 kg/cm2
- Rezistenca në tërheqje: fwt=1,0 kg/cm2
- Masa e elasticitetit: Ew=30000 kg/cm2
- Koeficienti Poisson: u=0,2

Vlerat e mësipërme janë marrë relativisht të mëdha, duke patur parasysh se konstruksioni i ndërtesës në pjesën me të madhe të tij është prej guri.

Vlerat karakteristike të rezistencave dalin nga pjesëtimi i vlerave të mësipërme me koeficientin e sigurisë së materialit. Sipas Eurokodit 6 propozohet koeficienti i sigurisë në raport me shkallën e kontrollit të cilësisë të materialeve, me shkallën e kontrollit të konstruksionit dhe me karakterin e ngarkesës. Në rastin konkret konsiderohet se materialet dhe konstruksioni duhet të përfshihen në kategorinë e dytë. Koeficienti korrespondues i sigurisë së materialit është γM=1,7, si për atë bazë, ashtu dhe për sizmicitetin. Kështu rezistencat karakteristike korresponduese janë:

- Kategoria e gurëve (gurë natyralë): II
- Kategoria e konstruksionit: III
- Rezistenca në shtypje: fwc wall20,0/1,7=11,8 kg/cm2
- Do të merren parasysh dy rezistenca të lejuara në tërheqje, për arsye të teknikes së ndryshme të muraturës dhe të qemerëve. Kështu muratura do të konsiderohet me rezistencë në tërheqje më të madhe se ajo e qemerit.

Rezistenca në tërheqje e muraturës:
fwt wall 1,0/1,7=0,6 kg/cm2
Rezistenca në tërheqje e qemerit:
fwt arch= 0,50 kg/cm2

3.- Llogaritjet e tirantave horizontale

Tirantat metalike janë prej hekuri inoksidabël nikelkrom 360.

Karakteristikat teknike të tij janë:

- Kufiri i rrjedhshmërisë: f0,2=420 Mpa
- Zgjatja e rrjedhshmërisë: e0,1>0,6 %
- Kufiri i shkatërrimit: ffail=700 Mpa
- Pllakat e ankorimit dhe dadot janë prej të njëjtit material.

3.1.- Tirantat në kuotën +3,50 m.

a) Tirantat tërthore veri-jug

Amin>4cm2.

Kështu në raport me hapësirën prej 12 m.:

Amin=10,66 cm2 =>Amin për çdo tirant baras me 2,66 cm2=>të paktën 1Φ20

Zgjedhim seksionin Φ24 për çdo radhë (5 radhë në

kuotën +3,50 m.)
Fe=4,52cm2

Duke marrë parasysh se tirantat do të kenë fileto, llogaritet një ulje e seksionit prej 14%

- Tensioni i dizanjit $fsd=\frac{fy}{1,15}=\frac{4200}{1,15}=3652 kg/cm^2$
- Forca max. e tërheqjes $Z=F_e x f_y=4,52x3652=16507Kg\approx 16,50$ ton
- Tensioni i funksionimit $\sigma_d=\frac{16507}{25\times 25}=26,41\ Kg/cm^2$
- Tensioni i lejuar sipas DIN1045/78

$\sigma_1=\frac{\beta_R}{2,5}\sqrt{\frac{F}{F_1}}$ $\frac{F}{F_1}=9$

$\beta_{R/wall}=20\times 1.20=24\ Kg/cm^2$

$\sigma_1=\frac{24}{2,5}\sqrt{9}=28,8\ Kg/cm^2$

$\sigma_d=26,41<28,8\ Kg/cm^2$

b) Tensionet e thërmimit nën pllakën e ankorimit

a=25cm
d=90cm (trashësia e muraturës)
b=90cm (trashësia e muraturës)

$\frac{a}{d}=\frac{25}{90}=0,28$

$\sigma_0=\frac{N}{d(a+d)/2}=\frac{16507}{90(25+90)/2}=3,19\ Kg/cm^2$

Tensioni tërthor i tërheqjes

$\sigma_y=0,4\sigma_0=0,4\times 3,19=1,27\ Kg/cm^2$

Rezistenca ekzistuese në tërheqje
$f_{tk}=4x1,2=4,8$ Kg/cm^2
Rezistenca në tërheqje e muraturës mbas shëndoshjes

DO NOT COPY

DO NOT COPY

c) Përcaktimi i trashësise së pllakës së ankorimit



σ_d=26,41 Kg/cm^2
M_{max}=26,41x25x12,5^2/2=51585 Kgcm
W_{kerk}=51585/4200=12,28 cm^3

$$\frac{bt^2}{6} \Rightarrow t = \sqrt{\frac{6\times12,28}{25}} = 1,71cm \Rightarrow t = 2cm$$

4.- Llogaritja e unazave shtrënguese

a) Kupola qendrore

Dex=2,86m Aex= D2/2=12,76 m2
Dint=2,40m Aint= D2/2=9,047 m2
A=Aex-Aint=3,71 m2
γ=1,8 t/m3 1,8x3,71=6,68 t/m
ngarkesa e dëborës 0,1t/m2 0,10 t/m
6,78 t/m

Forca horizontale për sismicitetin ε=0,12%
P=g+g1=0,12x6,78=0,8 t/m
Forca e përgjithshme unazore
Z=PxR=0,8x2,85/2=1,14 t
Vendosim 2Φ10
σ=1,14/2x0,8=0,7 t/cm2

b) Llogaritja e jastëkëve

Do të përdorim jastëkë me trashësi 4 cm.

$$S_o = \frac{\pi \times R}{90} \arccos\frac{R-t}{R} = \frac{3,14\times1,425}{90} \arccos\frac{1,425-0,04}{1,425} = 0,67$$

Distanca aksiale e jastëkëve mbështetës
S=0,67+0,1=0,77 Marrim distancën aksiale **1,10 m**.



D=2ZsinΦ/2=2x1,12x1,10/2:1,425=0,86 Kg/cm^2
(shumë e vogël)

c) Kontrolli i tensioneve në shtypje të muraturës

Gjatë drejtimit rrezor (radial)
D=2Zsin Φ/2
Z=Fexσfun=0,7x0,8x2=1,12
Gjatë drejtimit tangencial
Z0=1,12t

FWall=0,3x1,9=0,57 m2
σ=1,12/0,57=1,96<20/3=6,66 Kg/cm2
d) Kontrolli i tensioneve tërthore në tërheqje
a=0,1m
b=0,30m
d=0,30m
a/d=1,33 D=0,63 t
σZmax=0,35x(D/bxd)=0,02<<1 Kg/cm2

5. Përbërja e llaçit të fugatimit

- Rërë e larë 3 pjesë
- Rërë vullkanike pluhur 2 pjesë
- Pluhur tulle dhe shmërçi 1/2 pjesë
- Gëlqere e vjetër 2 pjesë
- Çimento e bardhë 1/2 pjesë
- Çimento e zezë 1 pjesë

6. Përbërja e llaçit të injektimit:

- Gëlqere e shuar mirë (e vjetër) 10kg.
- Rërë e imët dhe e larë mirë 19kg.
- Rërë vullkanike 10kg.
- Çimento 5kg.
- Ujë 18lt.
- TRICOSAL 150gr.

7. Përbërja e llaçit EMACO:

- Çakëll i imët 4 pjesë
- Rërë 4 pjesë
- Rërë vullkanike 3 pjesë
- EMACO 4 pjesë

(afërsisht 400kg/m3) ■

DO NOT COPY

BIBLIOGRAFIA:

- Karta e Venecias, Venecia 1964
- European Cultural Convection of the Protection of World Cultural and Natural Heritage, Paris 1985.
- Konventa për ruajtjen e trashëgimisë Arkitektonike Europiane, Granada 1985
- L. Bozo, B. Lilaj, Relacion mbi kushtet gjeoteknike të kishës së Leusës në rrethin e Përmetit, Tiranë 1998.
- Eurokodi 6 (ENV 1996-1-1/1995).
- Neo Elliniko Antisismiko Kanonismo (Rregullorja e re antisizmike greke).
- Tasios, «I mihaniki tis tihopiias» (Mekanika e muraturës), Athina 1986.
- «Methodi enishisis tihopiias» (Metodat e konsolidimit të muraturës), nga Programi pasuniversitar i restaurimit të monumenteve të Fakultetit Politeknik të Universitetit Aristoteli të Selanikut. 1999.
- Cestelli, «Rivista Restauro», kap. III, Il cedimento delle fondazioni, kap. IV, Il cedimento dei terreni di fondazione, kap. V, Il cedimento delle strutture fuori terra, kap. VI. Le puntellature, Kap. VII, Il consolidamento dei terreni di fondazione, kap. VIII, Il consolidamento delle murature.
- P. Thomo, «Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut», Tiranë 1998

LEUSI'S CHURCH IN PËRMET

PROF. DR. PIRRO THOMO

DO NOT COPY

Leusi's church had serious damages of the constructive structures, that had decreased her skill to kep herself. If we wouldn't take measures, it could be destroyed.

Sant Maria's church is located near the village at the road where, you can go from Përmet at Leusë for 30 minutes on foot.

The church is placed at the east of the village, in a picturesque place where you can see the wonderful view of the Vjosa's river.

At the door of entrance you can see something written, that maybe is very important to the history. It talks about the construction and the way like it was pictured the church by help of the people of the village.

Leusi's church is composed from naos, nartex at the west side and "hajat" at the nord side.

Naosi belongs to the basical type with cupola. Two parts of stone columns, separate the " nefs".

Naos communicates with nartex by a door in the middle, of the separating wall and the windows at the level below and three spaces at the up level.

Hajat is located at the nord part, an orientation that it is not very common to this element. There is a "nike" in a apside from at the east wall.

The monument is constructed by a combination ; with topographic things and with architectonic classical methods.

The topographic method is used about the genplan, that means the selection of the relieve, his configuration, his relationship with the village roads, ect.

The monument had serious damages of the keeping structure. Because of this some constructive elements were destroyed as had no function.

That was a big danger for the monument, and mostly for Leusis village.

If we take a look to the damages, we can make some conclusions:

The damages not similar at different parts of the building, showed us that we had to do witer different conditions of work to these two parts. All the changes and the restauration have been made according to the project.

Column consolidation. The second oval column had a very dangerous damage.

Measures for the construction of the church consisted on the construction of things made from wood.

They are by wood, because we don't wont to damage the mural pictures. The general damage it was all over. Even in there cases, when the damages had touch everything, injections for consolidation and compaction of this structure were necessary, for example when

the wall had mural pictures. For this was used a special material "Tricasal", that eliminates all the negative effects. During the restauration, we discovered: walls, columns, mural pictures that belonged to an old building.

In this project, we payed attention to preserve the monument's character.

To conclude, this restauration gave back the authencity to Leusi's church, that is a monument with special architectonic and artistical values.

DO NOT COPY

DY VARRE MONUMENTALË NË RAJONIN E DIBRËS

PROF. DR. ADEM BUNGURI

DO NOT COPY

Punimet bujqësore në rajonin e Dibrës, kanë mundësuar që, përveç varreve të periudhës romake të gjetura në Udovë dhe në Banisht[1] , në afërsi të qytetit eponim, daljen në dritë edhe të varreve me trajtim monumental të periudhës së vonë antike. Dy varrre të këtij tipi janë zbuluar në fshatin Ushtelenzë afër qytetit të Peshkopisë nga I. Kaca, i cili raporton edhe për një varr tjetër monumental të kësaj periudhe në fshatin Ploshtan të Kalasë së Dodës, në skajin verior të rrethit të Dibrës[2] . Një varr tjetër monumental i fillimit të shek. IV pas Kr. u zbulua në vitin 1981 në lagjen Taranesh[3] të fshatit Sollokiç, në afërsi të qytetit të Dibrës (FYROM). Këtyre u shtohen edhe dy varre monumentale, të zbuluara nga punimet bujqësore në vitet 1986 dhe 1987, cilët u gërmuan menjëherë pas zbulimit[4] . Ata gjendeshin në fshatrat Vajmëdhej afër Zall-Sinës dhe Kurtbeg (Fushë e Vogël) të Maqellarës, që përfshihen përkatësisht në pellgun e Peshkopisë dhe në atë të Dibrës. Megjithëse të ndërtuar thuajse në të njëjtën kohë, ata ndryshojnë shumë si nga arkitektura ashtu edhe nga teknika e ndërtimit. Trajtimi i tyre përbën objektin e këtij punimi, ku kemi përfshirë gjithashtu edhe një stelë varri të periudhës së vonë romake, të gjetur në Pesok të zonës së Maqellarës.

1.Varri monumental i Zall - Sinës

Ndodhej në veri të fshatit Vajmëdhej, në krahun e majtë të Drinit të Zi dhe përroit të Shehut, në vendin e quajtur "Kodrat e Rencit", afër Zall-Sinës. Varri ishte i tipit me një ambient, me planimetri katërkëndëshe dhe qemer cilindrik të ndërtuar me tullë. Përbëhet nga dhoma e varrimit dhe hyrja e varrit[5] (fig, 1).

Dhoma e varrimit ka formë katërkëndëshe dhe përmasa 2.53 x 2.06 m. Ajo ka orientim veriperëndim-juglindje. Muret anësore të saj, me lartësi 1.20 m dhe gjerësi 0.28 m, janë ndërtuar me tulla, sipas teknikës opus testaceum. Tullat kanë përmasa 0.28 x 0.30 x 0.04 cm, dhe i përgjigjen standardeve të periudhës së vonë romake[6] , ndërsa trashësia e fugave të llaçit është 3-4 cm. Harkimi i brendshëm i dy mureve

[1] V. Bitrakova - Groždanova, Prilog kod antičkata istorija na Debarskijot kraj, Spiasnje na Sojuzot na družvata na istoričarite na Republica Makedonija, Skopje 1966, f. 199.

[2] I. Kaca, Dy varre monumentale në fshatin Ushtelenzë(rrethi i Dibrës), Ilira 1988, 1, f. 239-240, tab. I, 1-5.

[3] M. Ivanovski, Eden docnoantičen grob od Taraneŝ, Živa Antika, Skopje 1984, f.219-226, tab. I-VII; Po ai, The grave of a warrior from the period of Licinus I found at Taranesh, Archeologica Iugoslavica, 24, Ljubljana 1987, p. 81-90, fig. 2.

[4] Në gërmime mori pjesë edhe skicografi Y. Pupli, i cili ka bërë edhe skicat përkatëse.

[5] Pas viteve 90' varri është shkatërruar nga banorët përreth tij.

[6] F. Miraj, Tulla material ndërtimor në periudhën antike në urrës dhe monogramet, Monumentet 1986,2,f. 141.

DO NOT COPY



Pamje e përgjithshme e varrit



Pamje e dhomës së varrimit

anësorë për krijimin e qemerit cilindrik, fillon në lartësinë 0.80 m nga tabani i dhomës së varrimit ose në rreshtin e 14 të muraturës së tullës, harkim që vjen duke u theksuar me rritjen e lartësisë së tij. Kështu në pjesën e kubesë pjesërisht të ruajtur të anës së majtë, fugat e llaçit trashen gradualisht dhe marrin formën e një pyke të rregullt trapezoidale me bazën e vogël në anën e brendshme të murit (fig. 2).

Ana fundore e dhomës së varrimit, mbyllet me një mur tërthor me lartësi 1.30 m dhe gjerësi 0.40 m, të ndërtuar me teknikën e alternuar tulla dhe gurë. Nga tabani deri në lartësinë 0.58 m, muri është ndërtuar me 9 rreshta tullash, me trashësinë e fugave të llaçit gëlqerorë 0.04 m. Tullat kanë përmasa 0.40 x 0.25 x 0.04 m. Mbi këtë mur vijon një brez me mbushje gurësh të vegjël, tullash të thyera e llaçi, me trashësi 0.14 m, ndërsa sipër tij, muri është ndërtuar me gurë shtuforë të lidhur me llaç gëlqerorë të së njëjtës cilësi. Faqja e brendshme e këtij muri krijon fasadë të rregullt, ndryshe nga faqja e jashtme e tij që mbështetet në faqen e kodrës. Lartësia e këtij muri është 0.58 m dhe gjerësia 0.40 m (fig. 3. Pamje e dhomës së varrimit nga muri fundor). Përdorimi i muraturës së alternuar gurë dhe tulla ndeshet edhe në ndërtimin e varrit monumental të Suçit (Mat) të datuar në shek. V-VI pas Kr[7] .

Në konstruksionin e këtij varri vihet re edhe një veçori interesante, e lidhur me kujdesin e ndërtuesit për hidroizolimin e jashtëm të dhomës së varrimit nga lagështira. Kështu duke filluar nga hyrja deri tek muri fundor i kësaj dhome, i gjithë varri monumental është veshur nga jashtë nga një mur i ngushtë gurësh zalli të lidhur me llaç gëlqerorë, i cili rivishet në anën e tij të jashtme nga një muri tjetër prej gurësh zalli,

[7] D. Kurti-S. Duka, Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Suç të Matit, Buletin Arkeologjik, 5, 1975, f. 129-130.

DO NOT COPY



Dhoma e varrimit e shikuar nga muri fundor

me lidhje të thatë. Të dy këto mure, që formojnë këmishën e jashtme mbrojtëse të dhomës së varrimit, arrijnë trashësinë 0.40 - 0.74 m. Ky mur i jashtëm mbrojtës i dhomës së varrimit, ka fshehur bukurinë dhe elegancën e muraturës së tullës, por një masë e tillë hidroizoluese, ka qenë diktuar nga pjerrësia e terrenit ku është ndërtuar varri monumental. (fig. 5. Prerje A-A1 e dhomës së varrimit)..

Dhoma e varrimit përshkohet nga një korridor gjatësor me gjatësi 2. 53 m dhe gjerësi 0.80 m, në të dy anët e të cilit lartësohen dy sofa simetrike me gjatësi 2. 53 m, gjerësi 0. 60 m dhe lartësi 0.30 m. Sofatë janë ndërtuar nga dy radhë vertikale pllakash të mëdha tulle, të riformuara nga bashkimi i tullave të thyera e të ngjeshura në llaç shamot. Përmasat e këtyre pllakave janë: 0.66 x 0.60.x 0.06 m. Disa nga pllakat e sipërme të sofave janë të dëmtuara, me sa duket nga përpjekjet grabitëse të thesarkërkuesve antikë. Edhe dyshemeja e korridorit është shtruar me llaç shamot me trashësi 2.5-3 cm, i cili është vendosur mbi një shtresë çakëlli, tullash të thyera e llaçi gëlqeror, me trashësi 7-8 cm. Gjithashtu me llaç shamot është suvatuar edhe hapësira e brendshme e dhomës së varrimit, e cila ruante gjurmë të suvasë me trashësi të njëjtë 2.5-3 cm.

Hyrja e dhomës së varrimit, me gjerësi 0.80 m, ndodhet në anën juglindore të varrit. Përfaqësohet nga hapësira e krijuar midis dy kollonetave prej tulle, që janë vazhdim i mureve anësorë. Ajo mbyllej nga jashtë nga një rrasë e madhe monolite guri me përmasa 1.13 x 0.96 x 0.20 m. Ruhet e plotë vetëm kolloneta e majtë, me lartësi 0.54 m dhe gjerësi 0.60 m, ndërsa kolloneta e djathtë identike me të, ishte shkatëruar nga zbuluesi. Kolloneta e ruajtur është e ndërtuar me tullë, sipas teknikës opus testaceum, me trashësinë e fugave të llaçit 0. 03 m. (fig. 4.) Fasada e kollonetës së tullës). Mbi dy kollonetat e hyrjes ka qenë ngritur qemeri cilindrik me rreze 0.46 m, që u gjet i shembur. Përveç harkimit të dukshëm të mureve të kollonetave, ai dëshmohet edhe nga mbetjet arkitektonike të tij, si tulla të plota e të thyera, blloqe tullash e llaçi të pashkëputura etj). Për ndërtimin e qemerit, përveç tullave të zakonshme me përmasa 0.28 x 0.30 x 0.04 m, janë përdorur edhe tulla më të mëdha, me përmasa 0. 45 x 0. 29 x 0. 045 m. Tullat janë të anuara në anën e brendshme dhe përputhen me harkimin e brendshëm të murit. Sipas llogaritjeve lartësia e hyrjes duhet të ketë qenë 0.94 m, lartësia e qemerit 1.03 m dhe lartësia fillestare e dhomës së varrimit 1.97 m[8] . (fig. 5. Prerje e dhomës së varrimit).

Në pikëpamje arkitektonike, varri monumental i Zall-Sinës është i ngjashëm me një varr monumental të shek. V-VI pas Kr të nekropolit të Suçit (Mat)[9] , me dy varre me qemer tullash të ekzonarteksit të bazilikës së Tepes në Elbasan[10] të shek. VI pas Kr,

si dhe me një varr me mbulesë në trajtë kubeje, të periudhës së vonë antike të nekropolit të Durrësit[11] dhe i referohet kësaj periudhe.

Varret dhe gjetjet:

Brenda dhomës së varrimit, në sofanë e djathtë dhe në korridor, u gjetën disa pjesë skeletesh të përziera e të shpërndara, që përfaqësojnë mbetjet e tre varreve.

Varri nr.1:

U gjet mbi sofanë e djathtë, pranë hyrjes së dhomës së varrimit. Riti i varrimit me djegie. Mbeturinat e djegies të grumbulluara këtu janë rrethuar nga disa rrasa të vogla guri në një zonë me gjerësi 0.72 m. Nga mbetjet e skeletit u gjetën vetëm pjesë të kafkës, brinjëve dhe dy dhëmbë. Pa inventar.

Varri nr. 2:

U gjet në fillim të korridorit, afër hyrjes së dhomës së varrimit. Riti i varrimit me trupvënie. Pozicioni i skeletit i paqartë. Pjesët e ruajtura të tij janë të trazuara dhe të përziera. Fare pranë mbetjeve të kafkës u gjetën eshtrat e gjata dhe të legenit dhe një dhëmb. Të përziera me to u gjetën edhe disa eshtra gjymtyrësh shtazore të paidentifikuara (derri i egër?) dhe dy dhëmbë të derrit të egër, të lidhura sa duket me ndonjë akt flijimi. Inventari përfaqësohet vetëm nga disa rruaza të vogla prej brumi qelqi.

Varri nr. 3:



Prerje E V. Monumental-Z. Sinë 86

U gjet në fund të korridorit, afër murit fundor të dhomës së varrimit. Riti i varrimit me trupvënie, pozicioni i skeletit i paqartë. Pjesët e ruajtura të tij si pjesë të kafkës, brinjë, falangje, vertebra, dhëmbë dhe eshtra të gjata, u gjetën të përziera e të shpërndara në një zonë me gjatësi 1. 10 m. Inventari është shumë i varfër. Përfaqësohet nga stoli bronzi, pajime rripi bronzi e hekuri, një rreth hekuri dhe disa petëza hekuri me perçina të thyera dhe mbetje druri në anën e brendshme të tyre[12] .

Analiza e gjetjeve:

Meqenëse varret u gjetën të profanuara, inventarin e tyre, po e trajtojmë sipas tipologjisë dhe funksionit.

Stolitë trupore janë shumë të pakta e të dëmtuara, por tipologjikisht me karakter të qartë kronolo-

---

[8] Duke ditur gjerësinë 2. 06 m të dhomës së varrimit dhe lartësinë 0. 80 m ku fillon harkimi i brendshëm i mureve anësorë, gjendet lartësia dhe rrezja e qemerit.

[9] D. Kurti-S. Duka, Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Suç të Matit, Buletin Arkeologjik, 5, 1975, f. 129-130.

[10] A. Meksi-N. Ceka, Bazilika paleokristiane në Tepe të Elbasanit, Buletin Arkeologjik, 3, 1973, f. 187.

[11] A. Hoti, Dy varre të periudhës së antikitetit të vonë në Durrës, Iliria 1988,1 f.223, fig. 1, tab. 1, 3.

[12] Petëzat e copëzuara të hekurit me trashësi deri në 0, 5 cm dhe perçinat e thyera me mbetje druri në anën e brendshme të tyre, duket se përfaqësojnë mbetje të rrathëve përforcues prej hekuri që i montoheshin enës së drunjtë, për të rritur qëndrueshmërinë e saj. Ky fakt është ndoshta një e dhënë e përdorimit në këtë periudhë të enëve prej druri, ç'ka do të shpjegonte edhe mungesën e atyre prej balte të pjekur. Mungesa e enëve qeramike është konstatuar edhe në lëndën arkeologjike të varrezës së kalasë së Dalmaces. Për këtë shih : H. Spahiu, Gjetje të vjetra nga varreza mesjetare e kalasë së Dalmaces, Iliria 1, 1971,f. 260.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

gjik dhe kulturor. Vathët prej bronzi janë të dëmtuar dhe përfaqësohen nga dy çifte vathësh tipash të ndryshme. Vathët e tipit të parë, që ruhen më të plotë, i përkasin tipit me varëse unazore. Trupi i tyre përbëhet nga një rreth i hollë teli me prerje rrethore në pjesën e sipërme dhe katërkëndëshe në atë të poshtme, ku kapen varëset e veshëve (tab. I, 1). Vathët e tipit të dytë, përfaqësohen nga dy pjesë vathësh prej tel bronzi, njëri prej të cilëve përfundon me një të fryrë shumëfaqëshe të rregullt (tab. I, 2 – 3, fig. 6, 1-2). Vathët e tipit me varëse trajtash të ndryshme, përbëjnë një stoli të zakonshme për kulturën e hershme shqiptare, siç dëshmojnë prototipet e tyre të gjetura në varrezat e kalasë së Dalmaces, Krujës, Lezhës, Shurdhahut, Buklit[14] etj. Në grupin e stolive përfshihet edhe një unazë bronzi me fushë eliptike të veshur me oksid hekuri (tab. I, 4), e përdorur gjithashtu në periudhën e hershme mesjetare. Në bizhuteritë femërore bëjnë pjesë edhe 7 rruaza prej brumi qelqi, që përfaqësojnë 5 tipe të ndryshme të tyre, të përfaqësuar në ekzemplarë të vetëm e rrallë të shoqëruar. (tab. I, 8; fig. 6, 6). Më e madhja prej tyre, në trajtë të një cilindri 6 faqësh, është bërë prej brumi qelqi ngjyrë të gjelbër dhe është lyer me varak ngjyrë argjendi. Dy rruazat e tjera përfaqësojnë tipin "perlstab" me trup në trajtën e dy sferave të vogla, njëra me ngjyrë blu dhe tjetra e lyer me varak ngjyrë argjendi. Edhe dy rruazat e tjera me trup të stërzgjatur, kanë gjithashtu ngjyrë blu, ndërsa dy të fundit, të dëmtuara janë përkatësisht në trajtë sferike të profiluar dhe në trajtë të kokrrës së kafesë. Rruazat e mësipërme janë gjetje e zakonshme në takëmin e varreve femërore të periudhës së hershme mesjetare[14] .

Pajimet e rripit përfaqësohen nga tre objekte që i takojnë veshjes së burrave. E vetme në llojin e vet është një tokëz rripi prej bronzi me trup oblik dhe thumb të lëvizshëm, e periudhës së vonë antike (tab. I, 5; fig. 6, 3), identike me një tokëz rripi prej bronzi të varrit monumental të Suçit (Mat) të kësaj periudhe[15] . Megjithëse objekt karakteristik i antikitetit të vonë, ky tip tokëze, do të vazhdojë të përdoret edhe në mesjetën e hershme, kur me ndonjë ndryshim të vogël stilistik, e gjejmë në një varrezë të kësaj kohe në Durrës[16] . Tokëza e vetme prej hekuri, përfaqëson tipin me strukturë të palëvizshme dhe trajtë katërkëndëshe, dy brinjët e gjata të së cilës bashkohen në mesin e tyre nga një brinjë hekuri e palëvizshme (tab. I, 6, fig. 6, 5). Tokëza të tilla ose të ngjashme janë zbuluar në të gjitha varrezat e kulturës së hershme mesjetare si në kalanë e Dalmaces, Krujë, Lezhë, Durrës[17] etj . Objekti i tretë përfaqësohet nga një rreth i thjeshtë prej hekuri (tab. I, 7, fig. 6, 4), i përdorur për varjen në rripin e mesit të sendeve të përdorimit të përditshëm (thikë brezi etj), gjithashtu i ndeshur në kulturën e hershme mesjetare[18] . Ndonëse të përziera e të profanuara, shihet se gjetjet e mësipërme janë

[13] H. Spahiu, art. cit. f.227 v ; Po ajo, Varreza arbërore e kalasë së Dalmaces, Iliria IX-X, 1979-1980,f.36-37, tab.IV, 1 ; S. Anamali, Mbi kulturën e hershme shqiptare, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, Titanë 1969,tab. I, 3-4 ;S. Anamali-H,Spahiu, Varreza arbërore e Krujës,Iliria IX-X, 1979-1980, f.66, tab. IX,9-10; F. Prendi, Një varreezë e kulturës arbërore në Lezhë, Iliria IX-X, 1979-1980, f.134,tab. XVIII, 6-8 ; D. Komata, Varreza arbërore e Shurdhahut, Iliria IX-X, 1979-1980, f.110,tab.IV, 8 ; S. Anamali, Një varrezë e mesjetës së hershme në Bukël të Mirditës, Iliria I, 1971, f. 220-221, tab.IX,1-5.; E. Nallbani, La Civilisation de "Komani" de l'antiquié tardive au haut moyen age, Etude du moobilier metallique, Doktoraturë, Paris 2002, vol. II, Catalogue, f. 57, nr. 373, tab. XLIV, 3, f. 58, nr. 381, tab. XLV, 1.

[14] H. Spahiu, Gjetje të vjetra...; S. Anamali-H. Spahiu, varreza...f. 75, fig. 6 Shih citimet nr.6

[15] D. Kurti-S. Duka, Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Suç të Matit, Buletin Arkeologjik, 5, 1975, f. 129-130, tab. III, 9.

[16] F. Tartari, Një varrezë e mesjetës së hershme në Durrës, Iliria 1984, 1,f.238, tab. III,9,

[17] H. Spahiu, Gjetje të vjetra nga varreza e kalasë së Dalmaces, Iliria I, 1971, f.254; S. Anamali-H.Spahiu, Varreza...f. 73,tab. XI, 4-7; F. Prendi, Një varrezë...,f.136, tab. XXI,7-12

[18] H. Spahiu, Varreza arbërore e kalasë së Dalmaces, Ilriria IX-X, 1979-1980, tab. V, 6-9 ; F. Prendi, Një varrezë...tab. IV,v. 9 ;F. Tartari, Një varrezë e mesjetës së hershme në Durrës, Iliria 1984, 1,f.238, tab, IV,11.

DO NOT COPY

pjesë e takëmit mortor të një gruaje dhe të një burri, dhe ndoshta mund t'i referohen një çifti familjar të shtresave të pasura. Siç shihet, këto gjetje nuk pajtohen as me tipin monumental të varrit, as me periudhën e vonë antike kur ai është ndërtuar, dhe i takojnë padyshim ripërdorimit të këtij varri, në periudhën e hershme mesjetare.

Nga zgjidhja arkitektonike dhe teknika e ndërtimit varri monumental i Zall-Sinës është ndërtim i periudhës së vonë romake, datim që mbështetet nga disa elementë të teknikës së ndërtimit. Si të tillë përmendim teknikën opus tesatceum të kollonetave të hyrjes së varrit dhe përdorimin e qemerit cilindrik të tij, elementë që janë tipike për periudhën e vonë romake. Kësaj periudhe i takojnë edhe përdorimi i muraturës së alternuar tulla dhe gurë në murin fundor të dhomës së varrimit, e ndeshur edhe në varre monumentalë të kësaj periudhe, siç është ai i Suçit[19] . Një teknikë e tillë është e zakonshme edhe në fortifikimet e mëdha të periudhës së vonë antike (Skampin, Paleokastër, Grazhdan etj)[20] . Përmendim gjithashtu përmasat e tullave 0. 28 x 0. 30 x 0. 04 m dhe 0. 40 x 0. 25 x 0. 04 m, që i përgjigjen kësaj periudhe[21] , trashësinë e fugave 3-4 cm, përdorimin e llaçit shamot dhe të tullave të mëdha të bashkuara me anë të këtij llaçi për ndërtimin e sofave të dhomës së varrimit etj.

Varri është i grabitur që në kohën antike, gjë që dëshmohet nga gjurmët e shkatërrimit të sofave, në përpjekje për gjetjen e thesarit imagjinar. Pas kësaj, në një kohë më të vonë, që sipas gjetjeve përputhet me periudhën e hershme mesjetare, varri është ripërdorur.



V.Mon. Zall-Sinë tab. I

Varre monumentalë të këtij tipi ose të ngjashëm me të janë zbuluar edhe në vise të tjera të vendit tonë. Në pikëpamje të ndërtimit arkitektonik ai është shumë i ngjashëm me varret monumental të periudhës së vonë antike shek. V-VI pas Kr. të Suçit (Mat)[22] dhe me një varr me mbulesë në trajtë kubeje të nekropo-

[19] D. Kurti-S. Duka, art. cit. f. 130.
[20] A. Baçe, Fortifikimet e antikitetit të vonë në vendin tonë, Monumentet , 11, 11976, f. 54.
[21] F. Miraj, Tulla material ndërtimor në periudhën antike në urrës dhe monogramet, Monumentet 1986,2,f. 141.
[22] D. Kurti-S. Duka, Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Suç të Matit, Buletin Arkeologjik, 5, 1975, f. 129-130, tab. III, 9. Pranë këtij varri janë gjetur 3 copë monedha bronzi të perandorëve të Bizantit Marciani (450-457), Leoni I(467-473) dhe Justiniani I(527-565).

DO NOT COPY

lit të Durrësit[23] , të përmendur edhe më lart.

Zbulimi i këtij varri në pjesën më veriore të pellgut të Peshkopisë është i rëndësishëm, pasi dëshmon për njohjen dhe përdorimin në këtë rajon të këtij tipi monumental të ndërtimeve sepulkrale të periudhës së vonë romake. Gjithashtu e rëndësishme është gjetja për herë të parë në rajonin e Dibrës e disa objekteve të kulturës së hershme mesjetare, të njohur edhe si kulturë e Komanit, gjë që e zgjeron hapësirën gjeografike të shtrirjes së saj në zonat e brendshme të vendit tonë.

2.Varri monumental i Kurtbegut (Fushës së Vogël)

Ndodhej në lagjen "Çangë" të fshatit Kurtbeg (Fushë e Vogël) të Maqellarës 24 .

Ndërtimi:

Varri është i tipit me sarkofag blloqesh guri. Ai është i thelluar vertikalisht në tokë dhe përbëhet nga dhoma e varrimit me planimetri katërkëndëshe dhe mbulesë të sheshtë pllakash guri. E veçanta e këtij varri është përdorimi i një sarkofagu monolit prej plumbi, të vendosur brenda sarkofagut prej blloqesh guri në trajtë paralelopipedi. (fig. 1. Pamje e varrit para zbulimit). Varri ka orientim jug-veri, me një shmangie të lehtë perëndimore. Përmasat e tij të jashtme janë 2. 64 x 1. 38 m dhe ato të brendshme 2. 00 x 0. 70-0. 77 m, ndërsa thellësia 0. 70- 0. 80 m. (fig. 2. Pamje e varrit pas heqjes së mbulesës).

Në ndërtimin e varrit janë përdorur 13 blloqe gëlqerorësh të mermerizuar, me trajtë paralelopipedësh të rregullt gjeometrik, me përmasa të mëdha. Blloqet kanë ngjyrë të bardhë të mbyllur, dhe gjatësi 0. 40 -1. 50m, gjerësi 0. 22 - 0. 72 m dhe lartësi 0. 12 - 0. 30 m. Në dy anët e ngushta dhe në anën e djathtë janë përdorur nga tre blloqe të tillë, ndërsa ana e majtë plotësohet nga 4 blloqe.

Lidhja e blloqeve është bërë me tri metodat e mundshme: me llaç gëlqeror, me çifte kllapash në trajtë L-je në këndet dhe me lidhje tranversale në formën e shkronjës "T". Llaçi është përdorur në të gjitha llojet e lidhjeve. Ai është pa përzierje rëre, ndaj është i dobët. Trashësia e fugave midis blloqeve është 1. 5 – 2 cm. Lidhja me çifte kllapash në formën e shkronjës "L" është përdorur në montimin e blloqeve në këndet. Blloqet monolite të anëve të ngushta, të vëna pingul mbi tokë, përshkohen në të dy krahët nga kllapa vertikale të thelluara me gjerësi 0. 10 m, të cilat përsëriten edhe në dy blloqet e vëna mbi ta. Me kllapa të tilla dhe me përmasa të njëjta përshkoheshin edhe blloqet gjatësorë, duke realizuar kështu puthitjen e plotë të tyre. Kjo lloj lidhje është përdorur në një rast edhe në anën e djathtë të varrit. Ndërsa lidhja tranversale në formën e shkronjës "T" është përdorur vetëm në një rast në anën e majtë të varrit (fig. 7). Pamje e dhomës së varrimit pas heqjes së skeletit dhe të sarkofagut). Teknika e lidhjes me kllapë është konstatuar edhe në dy varret monumentalë me sarkofag pllakash guri të fshatit Ushtelenzë dhe në atë të Ploshtanit në rrethin e Dibrës, të datuar në shek. V-VI pas Kr[25] .

Ndërsa në anën e brendshme puthitja e blloqeve është e plotë (veç dy blloqeve të anës së majtë), kjo nuk ndodh në anën e jashtme të varrit, ku krijohen disnivele përmasash të ndryshme, si pasojë e trashë-

---

[23] A. Hoti, Dy varre të periudhës së antikitetit të vonë në Durrës, Iliria 1988,1 f.223, fig. 1, tab. I, 3.
[24] Varri gjendej shumë pranë shtëpisë së z. I Skuka, i cili e zbuloi atë gjatë punimeve bujqësore.
[25] I. Kaca, Dy varre monumentale në fshatin Ushtelenzë(rrethi i Dibrës), Iliira 1988, 1, f. 239-240.

DO NOT COPY

sisë së ndryshme të blloqeve. Dyshemeja e varrit përbëhet nga një shtresë llaçi gëlqeror, e shtruar mbi një platformë gurësh të vegjël. Gjithashtu, me një shtresë të hollë llaçi, janë suvatuar edhe vijat e bashkimit të blloqeve në fasadë.

Hapësira e varrit ka qenë e mbuluar nga dy rrasa të mëdha guri (me përmasa 1. 20 x 0. 96 x 0. 12 m dhe 0. 98 x 1. 06 x 0. 12 m) , të mbështetura në anët e gjata dhe të ngushta të varrit. Në nivelin e këtyre pllakave, varri konturohet nga një rresht i vetëm prej 16 tullash, të vendosura mbi blloqet e murit, dhe të lidhura me llaç gëlqeror. (fig. 2. Pamje e varrit pas heqjes së mbulesës). Tullat janë prerje të dy kallëpeve, me përmasa të afërta. Shumica e tyre, 13 copë, kanë përmasa 0. 42 x 0. 27 x 0. 05 cm, ndërsa 3 copë, 0. 40.5 x 0. 26.5 x 0. 05 m. Njëra nga tullat zbukurohet me motivin e kryqit, i realizuar nga tri kanelyra gishtërinjsh që priten në qendër sipas drejtimit diagonal.



Stoli arbërore të Zall-Sinës

Sarkofagu

Në pjesën qendrore të dhomës së varrimit, simetrikisht me anët e gjata (10-18 cm larg) dhe të ngushta (4-5 cm larg) të saj, ishte vendosur një sarkofag plumbi, në të cilin gjendej skeleti. Sarkofagu ka prerje trapezoidale, me përmasa 1. 90 x 0. 44-0. 54 x 0. 32 m, pa mbulesë[26] . Ai ruhet i plotë, është shumë i rëndë dhe është veshur me një patinë jeshile të errët. (fig. 3. Pamje sarkofagut prej plumbi; fig. 9. Prerje e sarkofagut). Ai shoqërohet nga dy mbajtëse prej hekuri, me doreza unazore për varje. Këto mbajtëse kalonin nën sarkofag, përkatësisht tek koka dhe tek këmbët, të vendosura 0. 20- 0. 22 m larg tyre. Ato kanë prerje trapezoidale, dhe përputhen me madhësinë e sarkofagut në vendin e montimit. Ruhet e plotë vetëm mbajtësja e vendosur afër kokës, që ka gjatësi 0. 62 m, lartësi 0. 36 m dhe gjerësinë e brinjëve 0. 06 m. Brinjët anësore të saj përfundojnë me dy të kthyera në trajtë rrezesh, të punuara me rrahje, ku janë kapur unazat me diametër të brendshëm 0.09 m dhe të jashtëm 0. 12 m. Kjo mbajtëse ruan të fiksuara mbetjet e 7 perçinave prej hekuri, që e kanë lidhur atë me sarkofagun, 3 në pjesën e poshtme dhe 4 në dy brinjët anësore. Mbajtësja e dytë, e vendosur pranë këmbëve nuk ruhet e plotë, dhe është e copëtuar në tri pjesë. Ajo ka gjatësi 0. 55 m, gjerësinë e brinjëve 0.06 m dhe diametrin e unazave 0. 07-0. 10 m. Edhe kjo ruan gjurmët e dy perçinave, të vendosura në pjesën fundore dhe atë anësore. Ndërkohë disa perçina, që u takojnë të dy mbajtëseve, u gjetën të shkëputura. Për të rritur qëndrueshmërinë e sarkofagut, në të 4 këndet e tij, u gjetën disa përforcuese hekuri, në trajtë të germës "L", me përmasa 8. 5 x. 6 cm, 5 prej të cilave "in situ" të montuara në sarkofag. Secila prej këtyre përforcueseve ruan gjithashtu gjurmët e dy perçinave të montimit. Interesant është fakti se ky sarkofag plumbi ka qenë vendosur pezull në ajër, i mbajtur nga dy çifte mbajtësesh prej hekuri, dorezat rrethore të të cilave, kanë qenë fiksuar me anë të kanxhave prej hekuri midis pllakave prej mermeri të

[26] Sarkofagu mund të ketë qenë mbuluar me kapak dërrase, pasi në zonën e kraharorit, mbi eshtrat e palëvizura, u gjetën disa petëza të holla të karbonizuara druri.

DO NOT COPY



Pamje e varrit para zbulimit



Pamje e varrit pas heqjes së mbulesës. monumental

dhomës së varrimit. (fig. 10. Mbajtëset prej hekuri të sarkofagut).

Riti i varrimit është me vendosje trupi në shpinë, me duar të shtrira drejt anësive. Skeleti ruhet i plotë[27] dhe ka gjatësi 1. 90 m. Orientimi i varrit është jugveri, me një shmangie të lehtë perëndimore (fig. 5. Pamje e skeletit; fig. 6. Planimetri e varrit dhe e skeletit). Shihet se duke filluar nga vertebrat e toraksit, trupit i është dhënë një lakim i lehtë, që mbyllet me zhvendosjen e theksuar të kokës djathtas. Një gjë e tillë, me sa duket, ka ardhur nga gjatësia e njëjtë e personit të vdekur dhe e sarkofagut.

Varri është pa asnjë inventar, gjë që na detyron të kërkojmë elementë të tjerë datues, të sferës arkitektonike dhe botëkuptimore.

Së pari, përdorimi i llaçit gëlqeror, në ndërtimin dhe suvatimin e dhomës së varrimit, është një element i sigurt i arkitekturës së vonë romake..

Së dyti, përmasat e tullave që konturojnë muraturën e dhomës së varrimit, përputhen me periudhën e vonë romake. Megjithëse ende nuk kemi një katalog të përmasave të tullave, me përkatësi kohore të precizuar, është vënë re prirja e rritjes së dimensioneve të tullave dhe orientimi i tyre drejt formave drejtkëndëshe, sidomos pas shek. IV[28] etj. Kështu në se në shek. IV etj., tullat më të zakonshme janë ato

[27] Skeleti ruhet në fondet e Arkeologjisë pranë Muzeut historik Peshkopi. Në vitin 1989, ai u studiua nga antropologu A. Dhima, të cilin gjejmë rast për ta falenderuar. Sipas vlerësimeve të tij, i varrosur i seksit mashkull, rreth moshës 49-50 vjeç, ka vdekur nga një poliartrit i rëndë reumatizmal, që duket në disa deformime kockore në trajtë shtesash të klavikulës, kyçeve dhe artikulacioneve të tjera.

DO NOT COPY

me formë katrore (0. 35 x 0. 36 x 0. 04 m) dhe ato në masën e këmbës romake (0. 28 x 0. 30 x 0. 04 m), në shek. V-VI etj., tullat priren drejt formave drejtkëndëshe (0. 35 x 0. 29 x 0. 04 m dhe 0. 37 x 0. 27 x 0. 05 m)[29] . Në ndihmë të këtij datimi vjen ndoshta edhe motivi i kryqit, i presuar në njërën nga tullat, si simboli i kristianizmit që po triumfonte mbi botëkuptimin pagan.

Së treti, ripërdorimi i blloqeve antikë për ndërtimin e këtij varri, i jep atij një datë më të vonë se sa qendra romake prej të cilit ato blloqe janë hequr, pasi një shkëputje kohore në raste të tilla është e nevojshme dhe e kuptueshme[30] . Së fundi, mungesa e inventarit, është një e dhënë indirekte në favor të datimit të këtij varri pas shek. IV pas Kr., kur botëkuptimi ende i pakristalizuar kristian, duket se ndalonte shoqërimin e të vdekurit me inventar, dukuri e konstatuar edhe në raste të tjera të kësaj periudhe[31] . Të mbështetur në argumentet e mësipërme, mendojmë se ky varr me trajtim monumental është ndërtim i fillimit të shek. IV pas Kr.

Varret me trajtim monumental, si një shfaqje e veçantë e arkitekturës sepulkrale ilire, pas lulëzimit arkitektonik dhe tipologjik të shek. IV-I p.e.s.[32] , do të rishfaqen edhe në shekujt e parë të erës sonë[33] , dhe sidomos në shek. IV-VI pas Kr[34] , kur numri i tyre shtohet në mënyrë të dukshme.



Pamje e dhomës së varrimit-pa skelet e sarkofag

Varri monumental i Kurtbegut, përfshihet në tipin e varreve me sarkofag pllakash mermeri dhe mbulesë të sheshtë pllakash guri. Varre me trajtim monumental të ngjashëm me të janë zbuluar dhe më parë në rajonin e Dibrës[35]. Përmendim këtu dy varre

---

[28] F. Miraj, Tulla material ndërtimi...f. 141.

[29] Gj. Karaiskaj- A. Baçe, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë, Monumentet 1975, 9, f. 13. Ritja e përmasave të tullave në rastin tonë (0.42 x 0.27 x 0.05 m dhe 0.40.5 x 0.36.5 x 0.05 m), duket se mbështet prirjen e theksuar më lart.

[30] Ka shumë të ngjarë që 13 blloqet kuadratikë në përbërje të këtij varri, të janë marrë nga muret e kalasë së Grazhdanit, që ndodhet vetëm gjysëm ore larg që këndej. Për këtë supozim na shtyn të mendojmë edhe përbërja e njëjtë gëlqerore e tyre me atë të mureve rrethuese të asaj kalaje.

[31] A. Meksi-N. Ceka, Bazilika paleikristiane në Tepe të Elbasanit, Buletin Arkeologjik, 3, 1973, f. 187; D. Kurti-S. Duka, Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Suç të Matit, Buletin Arkeologjik, 5, 1975, f. 129-130,

[32] N. Ceka, Ndërtimet sepulkrale të qyteteve ilire, Monumentet, 9, 1975, f. 35-45.

[33] Po aty, f. 44-45.

[34] A. Meksi-N. Ceka, Bazilika paleokristiane në Tepe të Elbasanit, Buletin Arkeologjik, 3, 1973, f. 187; D. Kurti-S. Duka, Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Suç të Matit, Buletin Arkeologjik, 5, 1975, f. 129-130 ; A. Hoti, Dy varre të periudhës së antikitetit të vonë në Durrës, Iliria 1988,1 f.223, fig. 1, tab. I, 3; I. Kaca, Dy varre monumentale në fshatin Ushtelenzë(rrethi i Dibrës), Ilira 1988, 1, f. 239-240, tab. I, 1-5.

[35] I. Kaca, Dy varre monumentale në fshatin Ushtelenzë(rrethi i Dibrës), Ilira 1988, 1, f. 239-240, tab. I, 1-5.

DO NOT COPY



Pamje e sarkofagut prej plumbi

monumentalë me sarkofagë pllakash guri të shek. IV-VI pas Kr[36]. të zbuluara në fshatin Ushtelenzë dhe një tjetër i këtij tipi në Ploshtan të rrethit të Dibrës. Varri monumental i Kurtbegut shënon ngjashmëri të plotë me varrin monumental të Taraneshit të fillimit të shek. IV pas Kr. , në krahun e djathtë të Drinit të Zi dhe afër qytetit të sotëm të Dibrës(FYROM). Këto ngjashmëri shfaqen si në pikëpamje të arkitekturës, të planimetrisë së njëjtë dhe teknikës së njëjtë të ndërtimit ashtu edhe në aspektin ritual. Në të dy rastet varret i përkasin tipit monumental të përbërë nga dhoma e varrimit e ndërtuar me blloqe gurësh gëlqerorë, të punuar në trajtë paralelopipedi, dhe të mbuluar nga rrasa monolite prej guri gëlqeror. Riti i varrimit është me trupvënie, me skelet të vendosur në shpinë, me duar të shtrira në anësitë. Ndryshon vetëm orientimi, i cili në Kurtbeg është nga veriu, me një shmangie të lehtë perëndimore, ndërsa në Taranesh nga perëndimi[37] , dukuri e lidhur me sa duket, me ndryshimin e drejtimit të lëvizjes së diellit në kupolën qiellore në kohën e vdekjes së personit të varrosur. Në ndryshim nga varri i Kurtbegut pa inventar, varri i Taraneshit përmbante një inventar mallrash luksozë të fillimit të shek. IV pas Kr[38] .

Të veçantën e varrit monumental të Kurtbegut e përbën padyshim sarkofagu prej plumbi, që përfaqëson edhe të vetmen gjetje të këtij lloj në Shqipëri[39] . Ai përbën një objekt të mirëfilltë importi[40] , i blerë ndoshta nga punishtet romake të municipumit DD të Soçanicës[41] , në provincën e Dardanisë. Pikërisht në nekropolin romak të këtij qyteti, në vitin 1876 erozioni i shirave nxori në dritë 50 sarkofagë plumbi me skelete njerëzore brenda tyre[42] , ndërsa në vitin 1885, arkeologu i shquar A. Evans pati zbuluar sarkofagun romak me mbishkrimin e njohur "Monte argentaro"

---

[37] Po aty. f. 89.

[38] Inventari luksoz i këtij varri përbëhej nga një fibul prej ari e tipit kryq me mbaresa në formë qepe, kotruve argjendi, një pjatë e madhe argjendi ku janë skalitur simetrikisht 8 portrete të të njëjtit person, që autori ja atribuon Licinit I(308-324), lugë argjendi, gërryes argjendi, dorezë bronzi, pajime shkrimi, kupë qelqi, dy mbajtëse pomade në trajtë boshti, guackë molusku në trajtë venusi, komplet lojërash, amforë e fragmentuar qelqi. Këtij inventari i shtohen edhe tri objekte hekuri, pjesë e armatimit të lehtë, përkatësisht një sëpatë, një thikë dhe një dorezë. Objektet e këtij varri ruhen në Muzeun Arkeologjik të Shkupit. Shih : M. Ivanovski, The grave of a warrior from the period of Licinus I found at Taranesh... p. 86.

[39] Ky sarkofag, i lënë në Muzeun lokal të Maqellarës, për fat të keq, në vitin 1991, është humbur nga drejtuesit e atij muzeu dhe ndoshta është trafikuar prej tyre apo nga persona të tretë.

[40] Mospërputhja e gjatësisë së sarkofagut dhe të skeletit, tregon se ato përgatiteshin nga punishte zejtare të qendrave të zhvilluara romake, sipas kallëpeve standart.

[41] Municipi i Soçanicës gjendet 27 km në veri të Mitrovicës, pranë malit të Kapaonikut, i pasur me rezerva të shumta minerare argjendi, plumbi e zinku.

[42] A. Popović, Gornji Ibar sredneg veka, Gadisnjak NC,SXVI/1906, XXVI/1907.

[43] A. J. Evans, Antiquarian Reseqrches in Illyricum, Archaeologica XLIX, Westminsster 1885, f. 56, fig. 27.

DO NOT COPY

ose "Montagna dell'Argento"[43] , që arkeologët e kanë identifikuar me malin e Kopaonikut të njohur prej tyre edhe si " mali i argjentë"[44] .

Përdorimi i sarkofagut monolit prej plumbi, mjaft i kushtueshëm për kohën, pajisja e tij me mbajtëse e përforcuese hekuri, si dhe kujdesi i treguar për ndërtimin dhe suvatimin e dhomës së varrimit, dëshmojnë qartë se ky varr monumental i është kushtuar një personaliteti të lartë shoqëror apo ushtarak të perandorisë romake[45] . Përkundrejt këtij vlerësimi të lartë, mungesa absolute e inventarit të tij, na shtyn të besojmë në kufizimet e forta në këtë drejtim, që botëkuptimi i ri kristian duket se praktikonte në fillimet e tij.

Paralelet më të sigurta arkitektonike dhe konceptuale, ai i shënon në varret me sarkofag plumbi të periudhës romake të qytetit të Soçanicës në Dardani[46] , prej nga edhe mund të jetë importuar.

Zbulimi i varreve monumentalë në luginën e mesme të Drinit të Zi (Ploshtan, Zall-Sinë, Ushtelenzë, Kurtbeg, Taranesh), është i rëndësishëm për njohjen e këtij aspekti të veçantë të jetës shpirtërore të popullsisë së këtij rajoni, e cila, në periudhën e vonë antike, ishte e njëjtë ose e ngjashme me atë të rajoneve të tjera të provincës së Epirit të Ri, ku përfshihej në këtë periudhë rajoni i Dibrës.



Mbajtëset prej hekuri të sarkofagut

3. Stela me mbishkrim e Pesokut

Një tip tjetër varri ka qenë zbuluar nga punimet bujqësore të vitit 1977 në vendin e quajtur Pesok[47], prej të cilit kemi në dorë vetëm stelën mbivarrore të tij, me emra të skalitur me alfabetin grek (fig. 1-2. Pamje e stelës së Pesokut). Me emrin Pesok njihet një rrafshinë e pjerrët me sipërfaqe mbi 15 – 20 ha, e vendosur midis fshatrave Kërçisht i Epër dhe Kllobçisht, në juglindje të Maqellarës. Stela është punuar me gur gëlqerorë të mermerizuar me ngjyrë të bardhë, të veshur me një patinë të lehtë me ngjyrë të verdhë. Ajo ka trajtën e një paralelopipedi dhe është e thyer në gjysmën e sipërme. Në pjesën fundore ajo është e dëmtuar, ndërsa në atë të sipërme është trajtuar në trajtë frontoni.

Stela ka përmasa 0. 82 x 0. 35 m. Trashësia e saj lëviz nga 0. 11m në gjysmën e sipërme në 0. 12-0. 13

[44] E. Ćerskov, Municipum DD kod Soçanice, GMKM, IX, Prishtinë 1964, f. 617-620, fig. 1-8 ; M. Ivanović Kulturna Bashtina Kosova i Metohije- I Deo (od prahistorije do XII veka), Kniga X, Prishtinë 1977, f. 17, citimi nr. 41.

[45] Një statusi të tillë social do t'i shkonin edhe të dhëna antropometrike të fituara nga skeleti, që i takojnë një burri 49-50 vjeç, me trup të gjatë, të fuqishëm e muskuloz, me perimetër të zhvilluar të toraksit etj.

[46] M. Ivanović, Kulturna Bashtina Kosova ...f. 17

[47] Ky emër duket se rrjedh nga bullgarishtja e vjetër "pesak" që do të thotë vend me rërë e zhavorr dhe përfaqëson një përkthim administrativ të atributeve fizike të tij, të kryer me sa duket, gjatë pushtimit bullgar të shek. IX-XI. Këto depozitime ranore janë shembur për shkaqe gjeologjike, sa duket që në këtë kohë, dhe kanë mbuluar nekropolin e periudhës romake që gjendet këtu.

DO NOT COPY



Pamje e skeletit



Pamje e skeletit

m në atë fundore, që ka qenë e futur në tokë. Frontoni me bazë 0. 35 m, dhe lartësi 0.11m ka të papërfunduar krahun e tij të majtë, ndërsa në mesoren e trekëndëshit të tij, është modeluar në reliev një figurë e paqartë, ndoshta një luan.

Fusha e shkruar, me përmasa 0. 40 x 0. 22 m, është 2 cm më e thelluar se niveli i vetë fasadës. Në faqen e saj janë skalitur në tri radhë horizontale tri emra, me lartësinë e shkronjave 2 – 2.5 cm.

ΑΡΘΑΔΙϹ
ΛЄΝΑΤΟΥ
ΚЄΙΤЄЄΤωΝ
ΝΗ

Emrat që lexohen aty janë Arthadis, Lenato dhe Kleit[48] . Në fund të emrit Kleit (sa duket i shkruar gabim nga shkruesi në Keit) është shënuar një omega e përmbysur dhe një N (ni), ndërsa poshtë tij, në mes të rreshtit të katërt, formula e zakonshme fetare

DO NOT COPY



Foto bardhë e zi e stelës së Pesokut



Foto kolor e stelës së esokut

e lamtumirës, e shkurtuar në gërmat: NH.

Rasa dhanore e emrit të fundit (Kleiton), na shtyn të mendojmë se këtë stelë, Kleiti ua ka kushtuar dy njerëzve të tij të afërt, të quajtur Arthadis dhe Lenato. Karakteri ilir i emrit Kleit është i padyshimtë, nisur nga fakti se ai është mbajtur nga mbreti ilir Kliti i dinastisë së Bardhylit. Prof. S. Anamali ka argumentuar se ky emër mbretëror është mbajtur edhe nga ilir të zakonshëm, siç është p.sh. një Kleit i stelës së varrit të Verri Sllatinës në Pogradec apo një tjetër Kleit i stampuar në një pitos të Gramshit[49] , si dhe në një gurë varri të shek. II-III të Selcës së Poshtme. I njëjti emër ndeshet edhe në dy epitafe nga Durrësi, ku shfaqet në trajtën femërore Kleitia ose Klea[50] .

Edhe emri Lenato është emër i sigurt ilir, bazuar në sufiksin "ato" të tij. Sipas studiuesëve, emrat e

[48] S. Anamali, Antroponimia ilire në mbishkrimet e lashta të krahinave të Tetovë – Gostivarit, Dibër – Kërçovë dhe Strugë – Ohrit, Iliria 1992, 1-2, f. 63 – 64.

[49] Po aty, f. 63 – 64 ; N. Ceka, Qyteti ilir pranë Setës së Poshtme, Tiranë 1985, f. 107

[50] V. Toçi, Të dhëna të reja për onomastikën ilire në Dyrrah, Iliria 1986, 2. f. 125, nr. 52 ; Për përkatësinë ilire të tyre shih edhe R. Katičić, Die Illyrischen Personennamen in ihren sudostlihen Verbreitungsgebeit, " Źiva Antica", viti XII, 2 Tom, Skopje 1962, f. 95-120.

formuara me sufiksin "ato" ose "atos" përfshihen në grupin e emrave juglindorë ilirë[51], ose e thënë ndryshe, në krahinën onomastike juglindore, banorët e së cilës, njiheshin nga burimet historike si "Illyri proprie dicti"[52].

Emri i ri Arthadis, duket se është emër i greqizuar i një banori ilir i të njëjtës familje, dukuri e njohur në shtresat e mesme e të pasura të Ilirisë së Jugut, e lidhur me proceset e akulturimit.

Stela e Pesokut përfaqëson gjetjen më veriore të këtij tipi stelash në Shqipëri, dhe njëherësh të vetmin dokument sepulkral të periudhës romake në rajonin e Dibrës. Mendojmë se duhet datuar në periudhën e vonë perandorake, pas shek. III pas Kr., kur rifillon përdorimi i greqishtes si gjuhë mbishkrimore, jo vetëm në zonat e brendshme, por edhe në ato bregdetare, ku latinishtja pati gjetur një përhapje të kufizuar gjatë shek. I-III pas Kr. [53]

Këtë datë të vonë të stelës së mësipërme e tregon edhe karakteri i germave të përdorura. Në emrin e parë Arthadis është përdorur sigma lunare (C) në vend të asaj këndrejtë (Σ), ndërsa në fund të emrit Kleit, siç u tha, është përdorur omega e përmbysur (ω) në vend të asaj të drejtë (Ω). Gjithashtu tek formula e lamtumirës në vend të germës X (hi) përdoret germa H (eta) e paraprirë nga një N (ni). Siç dihet këto ndryshime në karakterin e shkronjave ndeshen në dokumentet mbishkrimore vetëm pas shek. III pas Kr.

Zbulimi i kësaj stele me emra të skalitur në Pesok është i rëndësishëm, pasi dëshmon se në shek. III-IV pas Kr. vazhdojnë të përdoren emrat ilirë në zonat e brendshme të Ilirisë së Jugut, ku përfshihej rajoni i Dibrës. Është hedhur hipoteza se në Pesok duhet lokalizuar qyteti ilir i periudhës romake i këtij rajoni[54] Sipas mendimit tonë, të dhëna më të besueshme për lokalizimin e këtij qyteti ofron trualli i qytetit të sotëm të Dibrës[55], rreth 3 km në jug të Pesokut. Sipas stelës së paraqitur më lart, Pesoku përfaqëson nekropolin e këtij qyteti dhe jo vetë qytetin. ■

DO NOT COPY

[51] S. Anamali, Antroponimia ilire... f. 64.
[52] Carlo de Simone, Ilirët e Jugut, përpjekje për një përkufizim Kuvendi II i stud. Ilire, Iliria 1986, 1, f. 241.
[53] S. Anamali, Procese shndërrimi në trevën jugore ilire, Iliria 1986, 1, f. 16-21, fig. 2-4.
[54] H. Sadikaj, Dibra dhe vendi i saj në arealin Arbër, Dibra dhe etnokultura e saj, vol. I. Dibër 1995,,f.92.
[55] A.Bunguri, Të dhëna plotësuese mbi periudhën antike në Dibër, material i pabotuar; V. Bitrakova – Grożdanova, Prilog kod antičkata istoria na Debarskijot kraj, Spisanje na Sojuzot na družvata na istoričarite na Republika Makedonija, Scopje 1966, f. 200 ; V. Sokolovska, Antičkata Skulptura gvo SR Makedonija, Scopje 1987, f.126-127, tabb. 23,1-3

DO NOT COPY

Two Monumental Tombs at Dibra Region

Adem Bunguri

DO NOT COPY

The monumental graves discovered in the Dibra region, represent an increase of their number during the late roman period in the eastern part of Albania. Untill now there have been discovered 5 graves of this type and for three of them have publications . This summary includes the two other monumental graves from this area. They have been discovered at the villages of Vajmëdhej near Zall-Sina, and Kurtbeg near Maqellara, which geographically belong respectively to the Peshkopia and Dibra cities.Though they have been constructed nearly in the same period, they represent two different types of the monumental graves.

The grave in Zall-Sina belongs to the type with the cylindrical arch, similar to the other examples of this period, such as the same type of grave at Suçi necropolis in the Mati River valley, as well as one in the Dyrrachion necr opolis. The grave of Kurtbeg belongs to the type prepare with sarcophagus slates of marble with parallelepiped form, covered with two plain large stone slates, which are similar to the monumental graves of Taranesh near Dibra town, as well as the two graves to Ushtelenza village, close to Peshkopia town, still the last ones which had been placed within a right angles platform circled with limestone walls. These monumental graves had been stealed at previoua time but they have been reused later, at the beginning of the early medieval ages.

The most interesting feature of the grave of Kurtbeg is its lead sarcofaghus placed within the paralelopedic marble ones. Though this phenomen appears for the first time in the territory of Albania, it had been known during the roman period in the province of Dardania, respectively in municcipum DD of Soçanica. In the year 1876 in its roman necropolis have been discovered 50 sarcofaghus made of lead with human skeleton within them, whereas in 1885 was discovered here, by the wellknown archaeologist A. Evans, another lead sarcofaghus with the inscription "Monte argentaro" or "Montagna dell'Argento", which had been identified by archaeologists as the Kopaonik mountains near to this municcipum.

The using of a lead sarcophagus, was very expensive during that period, as well as the skills needed for the construction of this grave, the room with marble slates and their interior plastering, clearly confirm that this monumental graves had been dedicated to a high social category or military individuality of the Roman Em-

DO NOT COPY

pire or the early byzantine personalities. This is very similar as concept for the graves with lead sarcophagus of the roman municcipum DD of Soçanica , near the nowadays town of Leposavić at the northern part of Kosovo, and maybe had been imported from there.

The discovering of the monumental graves in the middle valley of Black Drin river, such as the graves at Ploshtan, Zall-Sinë, Ushtelenzë, Kurt-beg and Taranesh, is important because help us to understand this special aspect of the spiritual life of the inhabitants of this region, which results to be identical or similar with other parts of Epirus Nova province, during the late antiquity period.

The grave stele of Pesok (Dibër) is the nor-



Pamje e skeletit



Pamje e sarkofagut prej plumbi

theast exemplar of this type of steleae in Albania, which expands towards the north the area of distribution of the Greek inscriptions of the II-III century A.D in the Albanian territories. It also proves, that in this period had been in using the Illyrian names as well as the acculturated ones, in the inner parts of South Illyria, such as Dibra region, despite their writing with the Greek Alphabet ■

STUDIMI DHE RESTAURIMI I NJË VAZOJE QELQI ZBULUAR NË DURRËS

PROF. DR. FREDERIK STAMATI

DO NOT COPY

Në fillim të vitit 2002, në laboratorin e Konservimit dhe Arkeometrisë të Institutit të Kulturës Popullore, u soll për restaurim një grumbull fragmentesh qelqi (249 copa) që dukej se i përkisnin një ene (foto 1). Ato ishin zbuluar disa muaj më parë në themelet e banesës së administratës së sanxhakut të Durrësit ndërtuar në vitin 1888[1] pranë murit bizantin dhe në thellësi rreth një metër. Studimi dhe restaurimi i kësaj ene paraqiste probleme të aspekteve të ndryshme.



foto 1

I. Shqyrtimi vizual

Puna filloi me inspektimin optik dhe dokumentimin e të gjitha fragmenteve. Kjo ishte e nevojshme si për verifikimin e gjendjes së ruajtjes së tyre, ashtu edhe për rindërtimin e ardhshëm të vazos. Inspektimi tregoi se kemi të bëjmë me një vazo të bukur, të punuar me kujdes duke përdorur një teknologji të komplikuar.

Fragmentet në faqen që i përket pjesës së brendshme të enës përbëhen nga një qelq pa ngjyrë dhe pa aplikacione zbukurimi. Pas pastrimit nga balta rezultoi se qelqi në këtë pjesë ruhet përgjithësisht mirë, pavarësisht nga disa gërryerje të veçuara në formë gropëzash, (foto 2) dhe ka një irideshencë të lehtë.

[1] Zbulimi arkeologjik u bë nga A. Hoti

DO NOT COPY



foto 2



foto 3

Situata është e ndryshme në faqen që i përket pjesës së jashtme të vazos. Në këtë pjesë fragmentet ishin të mbuluara me baltë poshtë së cilës dalloheshin vende-vende sipërfaqe që dukeshin të lyera me ngjyrë kafe dhe e vijëzuar në distanca të barabarta në drejtimin gjatësor me dy lloj fijesh qelqi të bardhë opak.

Cipa e ngjyrës kafe paraqitet e palidhur dhe bie lehtësisht duke zbuluar një nënshtresë iridishente të shtresëzuar, të qëndrueshme dhe me ngjyrime ylberi sidomos në linjat e thyerjes. Ngjyra kafe tretet në ujë, ndërsa irideshenca zhduket me larje për t'u rishfaqur pas avullimit të ujit (foto 3).

Njëra nga fijet e qelqit të bardhë të kujton një fill

Elementët	Qelqi (prapa)	Qelqi me fije të bardha	Ngjyra kafe
Na_2O	12.78		
MgO		1.40	1.91
Al_{203}		3.78	6.35
SiO_2	79.62	28.35	35.34
P_{205}		5.70	6.34
K_{20}	2.51	1.38	3.82
CaO	5.09	6.35	18.57
MnO		3.38	15.43
Fe_{203}		3.14	6.49
SnO		40.69	
PbO		5.33	5.31

DO NOT COPY



foto 4



foto 5

të sajuar nga përdredhja e lehtë e një tufëze fibrash të hollë qelqi (foto 4). Të dy fijet janë ngjitur në sipërfaqen e vazos me anë të nxehjes duke krijuar një dekoracion që karakterizohet në llojin "vetro filigrana", i aplikuar që nga vitet 1527-1529 në Murano. Në pjesët e barkut të vazos për efekt të fryrjes dhe hollimit të qelqit, dekoracioni zgjerohet e duket sikur kalon në tipin e formuar nga ngulitja në xham e qelqit të bardhë opak "lattimo" dhe tipit "vetro a fili" (foto 5).

II.Shqyrtimi analitik

Disa fragmente të vogla nga qelqi pa ngjyrë (faqja e brendshme), qelqi me fije të bardha dhe i materialit të ngjyrës kafe iu nënshtruan analizave për përcaktimin e përbërjes elementore. Fillimisht u tentua analiza e mostrave me metodën e Fluoreshencës së Rrezatimit X në Institutin e Fizikës Bërthamore në Tiranë. Rezultatet e marra gjatë këtij ekzaminimi treguan praninë e manganit në mostrën e ngjyrës kafe, si dhe të kallajit e plumbit në mostrën e qelqit me fije të bardha (foto 6). Megjithatë, për të marrë informacion mbi përbërjen e zonave të ngushta të mostrave ato u analizuan në një sistem të mikroskopisë elektronike me skanim (SEM-EDS) në laboratorin e Fizikës së Trupit të Ngurtë të departamentit të Fizikës të universitetit "Aristotel" të Selanikut. Rezultatet e analizave paraqiten në tabelën 1.

III. Diskutimi i analizave

A-Ngjyra kafe ka për bazë një komponim mangani nga të cilët më i mundshmi është piroluziti që përdorej edhe si pigment. Shtresa kafe është shumë e ndotur nga qëndrimi në tokë. Duke qenë e degraduar dhe e dobët nuk u arrit që ajo të pastrohej plotësisht. Për këtë arsye nuk u kryen as analiza me difraksion të rrezeve X për të përcaktuar përbërjen mineralogjike. Kështu që në këtë fazë të studimit nuk u arrit të konkludohej në se përqindjet e aluminit, fosforit, kalciumit dhe silicit lidhen me praninë e dheut apo janë shtuar nga dekompozimi i qelqit.

B-Linjat e qelqit të bardhë, që formojnë filigramin ruhen shumë mirë. Kjo i dedikohet pranisë së fosforit dhe aluminit që është karakteristike e disa qelqeve mesjetarë[2] . Përqendrimi i oksideve të këtyre dy elementëve është i studiuar dhe dëshmon për eksperiencën e pasur të prodhuesit. Prania e këtyre oksideve e mbron qelqin nga dekompozimi për efekt

DO NOT COPY



foto 6



foto 7

të eliminimit të prodhimit të oksigjenit të palidhur në rrjetin kristalor. Praktikisht është formuar një shtresë e pasur alumino-silikate e patretshme mbi shtresën silicore dhe një shtresë e patretshme e fosfatit të kalciumit. Fillimisht kjo shtresë është krijuar me ritme të larta për t'u ngadalësuar shumë shpejt. Duke qenë e qëndrueshme si në mjedise acid ashtu dhe në bazik ajo i ka mbrojtur vijat e filigramit pavarësisht nga mjedisi i formuar në vend groposje.

Një grup tjetër komponimesh që kanë ndikuar pozitivisht në mbrojtjen e filigramit kanë qenë CaO, që ka krijuar një shtresë hidroksiapatiti dhe sasia e vogël e PbO. Gjithsesi kontributin kryesor në mbrojtje e ka kallaji (SnO-40.60) që ka luajtur rol të dyfishtë: ngjyrues dhe mbrojtës. Përgjatë linjave të filigramit vihen re shirita të verdhë (foto 7), të cilët duhet të jenë rezultat i migrimit të joneve të natriumit.

C-Nën shtresën kafe vihet re një shtresë irideshente, ngjyrë argjendi, e përbërë nga shtresa të mbivëna, shumë e bukur, por gjithsesi jo origjinale dhe rezultat i gërryerjes së qelqit. Uji i depërtuar në shtresën e groposjes ka vepruar me atomet e palidhur të oksigjenit prezent në qelq duke formuar jonet hidroksil të cilët në rastin e qelqit në studim që është relativisht i pasur me natrium dhe kalium kanë migruar së bashku me jonet alkalinë respektivë, fillimisht me ritëm parabolik e me një ulje të mëvonshme. Kështu jonet alkalinë janë larguar gjatë situatave me lagështi duke u zëvendësuar me protone, që kanë mbajtur neutralitetin elektrik. Si pasojë e volumit të vogël të protoneve në krahasim me kationet alkalinë sipërfaqja është zvogëluar dhe rrudhosur. Ky fenomen karakteristik për sipërfaqe të pasura me silic ka çuar në mikroporozitetin e shtresës sipërfaqësore duke formuar një prishje shtresëzore që ndeshet në disa qelqe mesjetar.

Kjo masë e shtresëzuar, e varfëruar me elemente alkalinë nuk është mbrojtëse. Ajo depërtohet nga avujt e ujit, që çojnë në rinovimin e frontit të prishjes në sajë të akumulimit të joneve alkalinë dhe rritjes së pH në shifrën 9 që atakon rrjetin e silicit. Kështu, konkludohet se ena e qelqit në studim është e pambrojtur dhe prishja do të vazhdojë në vartësi të konditave të konservimit apo ekspozimit.

[2] NEUTON R. dhe DAVISON S. "Conservation of glass", Butterworth and Co, Ltd., 1989



foto 8



foto 9

D-Sipërfaqja e brendshme e enës së qelqit ruhet pak a shumë mirë. Kjo i dedikohet pranisë së kaliumit si një element alkalin i dytë veç natriumit, duke formuar atë që njihet "efekt i përzierjes alkaline". Prania e natriumit dhe e kaliumit në këtë qelq paraqitet në raportet më të mira për të dyfishuar qëndrueshmërinë e qelqit. Ky fakt dëshmon për eksperiencën e pasur të mjeshtrave që kanë realizuar enën. Megjithatë është fakt se në zona të kufizuara edhe në këtë faqe vihen re gropëzime, që janë pasojë e humbjes së madhe të natriumit dhe silicit.

Duke shqyrtuar me kujdes këtë situatë lind në mënyrë të vetvetishme pyetja; përse qelqi ruhet relativisht mirë në pjesën e brendshme dhe është gërryer shumë nën pjesën kafe? Përgjigja e kësaj pyetje kërkon të dhëna analitike më të plota, megjithatë mbështetur në shkallën e tanishme të njohjes mund të supozojmë dy shkaqe kryesorë që lidhen me efektin teknologjik gjatë aplikimit të ngjyrës kafe, që gjithsesi nuk është e pjekur apo me praninë e lartë të kalciumit në ngjyrën kafe, që mund të ketë çuar në atakimin e qelqit. Në mos kemi të bëjmë me dy lloj qelqesh të ngjitur njëri mbi tjetrin.

Sidoqoftë fenomeni mund të sqarohet në mënyrë më të plotë në të ardhmen nëpërmjet studimeve dhe analizave më të hollësishme.

* * *

Restaurimi i enës u paraqit shumë i vështirë dhe zgjati më tepër se një vit. Së pari u krye pastrimi me etanol i sipërfaqes së brendshme dhe buzëve të fragmenteve të shumta të enës (foto 8). Sipërfaqja e jashtme u pastrua me kujdes vetëm mekanikisht dhe aq sa ishte e mundur

(foto 9).

Për ngjitjen e fragmenteve u përdor Plastogen EP, që është një rezinë epoksite, bis fenol A diglicidil eter i përzier me dibutilftalat[3] , ngurtësuesi i të cilit është një aminë alifatike. Gjatë ngjitjes u përdor raporti 3:2 në mënyrë që të shpejtohej kinetika e reaksionit. E mira e këtij ngjitësi është lidhja e fortë me qelqin dhe qëndrueshmëria ndaj dritës, sidomos ndaj rrezatimit UV.

Ngjitja e fragmenteve u bë një e nga një dhe pa

[3] Norman H. Tenet ''Clear and pigmented epoxy for stained glass conservation: ligh ageing studies'', Studies in conservation, Vol.24, 4, 1979

DO NOT COPY

krijuar lidhje paraprake në formë urash midis fragmenteve. U detyruam të vepronim kështu për të shmangur prishjen e ngjyrës kafe në sipërfaqe, që do të vinte si rezultat i përdorimit të ngjitësve cianoakrilate që përdoren për fiksimin e urave lidhëse.

Rruga e ndjekur ruajti sipërfaqen kafe të enës, por nuk shmangu dot deformimet që lindën si rezultat i ndryshimit të dimensioneve nga shtresat e ngjitësit që u vendosën midis fragmenteve.

Rikonstruktimi i enës u shoqërua me një sërë vështirësish që lidheshin me prishjen për shkak të gërryerjes së sipërfaqeve të thyera, sepse shtresa silicore shkëputej së bashku me ngjitësin, sidomos në fragmentet e holla të zonës së barkut të enës (rreth 0. 5 mm të trasha). Një vështirësi tjetër lidhej edhe me mungesën e shumë fragmenteve sidomos në pjesën e barkut. Të gjitha këto na bën të mendonim se ena nuk do të mund të qëndronte pa përforcues. Për këtë arsye u vendosën nga brenda enës disa shirita të hollë prej pleksiglasi të tejdukshëm duke u ngjitur me të njëjtin ngjitës. Si mbështetës u përdor një bazament prej graniti të zi në të cilin u montua një shufër inoksi me diametër 6mm. Kjo shufër depërton në brendësi të enës nëpërmjet një vendi ku mungojnë fragmentet dhe në pjesën e sipërme u montua një dado pleksiglasi ku mbështet gryka e enës.

Për shtresën irideshente nuk u përdor ndonjë lidhës apo përforcues, meqenëse trajtimi me Paraloid B72, polivinil butiral, etj, që rekomandohen në këto raste, përveç forcimit të qelqit eliminon pamjen e bukur irideshente. Shqyrtimet tona kanë treguar se gjatë veprimeve të tilla eliminohet "fisnikëria" e objektit dhe sipërfaqja të krijon përshtypjen e diçkaje të lagur. Për më tepër në rastin tonë shtresëzimi irideshent dhe ngjyra kafe nuk pranonin të tilla trajnime. Rezulton se problemi i konservimit të kësaj ene nuk mund të konsiderohet i zgjidhur vetëm me ndërhyrjen e paraqitur laboratorike, por duhet të shoqërohet me masa të tjera mbrojtëse gjatë ekspozimit. Kështu ajo duhet të mbahet në mjedise me lagështi relative në nivele më të ulëta se ajo e higroskopicitetit të kompozimeve, që janë krijuar në sipërfaqen e enës.

Në foton 1 paraqitet ena pas restaurimit. Kjo vazo lulesh me lartësi 51cm dhe diametër maksimal 20 cm përbën enën prej qelqi më të madhe dhe më të bukur të zbuluar në Shqipëri.

Së fundi mund të themi disa mendime për prodhimin e enës prej qelqi. Që në fillim ka ekzistuar ideja e realizimit të një vazoje të dekoruar me teknikën e filigramit. Paraprakisht është përgatitur një tub qelqi me parete të trasha, në sipërfaqen e të cilit janë ngjitur alternativisht dy llojet e fillit të qelqit të trashë. Pastaj njëra anë është nxehur dhe me fryrje është formuar barku i enës dhe fundi i saj, ndërsa më pas në grykë janë montuar dy radhë zbukurimesh. Përmbajtja e lartë e kuarcit krijon një qelq me koeficient të bymimit termik shumë të ulët, që lejon punime të natyrave të komplikuara pa u thyer. Së fundi ena është lyer me ngjyrë kafe për të bërë të mundur leximin e filigramit. Kjo teknikë njihej që në kohën Romës dhe përdorej për enët me dimensione të mëdha, që nuk i nxinin furrat apo nga fshatarë të cilët nuk dispononin furra të mëdha për pjekje. ■

DO NOT COPY

DO NOT COPY



foto 10

"THE CONSERVATION AND RESTAURATION OF THE GLASS DISCOVERED IN DURRËS"

FEDERIK STAMATI

DO NOT COPY

At the begining of year 2002, at the laboratory of Conservation and Arcometria in the Institute of Popular Culture, were brought for restauration 249 glass pieces.

They were discovered same months ago at the administration of " Durrësi 's Sanxhak", that was built on year 1888 near the bizantine wall.

Firsthy, they tried the analysis by the methad of X-ray radiance at the Institute of Nuclear plrysics in Tirana. The results that were taken during this examination showed that the brown glass had Mn and the white glass had Pb.

A-The broun color is based on a Mn (mangane) componation, where the most probable is "piralusit" that was used like a pigment. The brown part is very polluted because of the staying in the land.

B-The lines of the white glass, that form the filigram are well conserved, because they contain phaspor and aluminium. It is studied the Concetration of these two elements and tells a lot about the rich experience of the producter.

C-Under the brown part, we can see a very beautiful part in argend color, but not original.

D-The surface inside the glass it is well preserved, because it contains calium that is the secand alcalin element beside natrium.

This is all we can talk about the conservation of the glass. ■

STUDIMI I MOZAIKUT TE SARANDES

ABU AYSHEH MOH'D*, AGRON ISLAMI**, RICCIARDONE MICHELE***

DO NOT COPY

• Hyrje

Kjo punë u krye gjatë aktivitetit didaktik pranë Qendrës për Restaurime Arkeologjike (CRA), me vendndodhje qytetin e Sarandës, Shqipëri, në kuadër të një bashkëpunimi ndërmjet Departamentit të Arkeologjisë së Universitetit të Bolonjës nën drejtimin e Prof. Sandro De Maria, Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Institutit të Arkeologjisë në Shqipëri; dhe me pjesëmarrjen e studenteve të qendrës[1] .

Në vitin 1967 gjatë ndërtimit të Zyrës Qendrore të Postë-Telegraf-Telefon në Sarandë, u zbuluan gërmadhat e disa ndërtesave antike, ato përbëheshin prej njësi stratigrafike murale (mure), dhe ambjente të shtruara. Në vazhdim të këtij zbulimi u krye një fushatë gërmimi që nxorri në dritë një hapësirë 11x8 m, me drejtim lindje – perëndim kurse ambiente e tjera ishin të vendosura në pjesën juglindore nën ndërtesat moderne të qytetit[2] . Ambienti është i rrethuar nga struktura murale me gurë të lidhur me maltë dhe me lartësi maksimale prej 0.30 m e trashësi maksimale 0, 60 m. Lartësia e murit ruhet më mirë në pjesën veriore të dhomës, ku arrin rreth 30 cm.

• Analiza vizive e motiveve gjeometrike të dyshemesë me mozaik

Analiza u krye duke mbikëqyrur territorin nga veriperëndimi drejt juglindjes: rresht me tesera të bardha e pasuar nga një kornizë e kufizuar si nga brenda dhe nga jashtë nga tre rreshta teserash të zeza; e dekoruar me një gërshet polikrom (shumëngjyrësh), me dy nyje,(me gjerësi 0. 40 m). Nyja e formuar prej gërshetit shtrihet përgjatë gjithë krahut verilindor nga lart, në një pjesë në drejtimin veri-jug në krahun e djathtë të dyshemesë dhe në një pjesë të krahut juglindor.

Gërsheti në krahun verilindor pasohet nga një kornizë e përbërë nga disa kopje pelteje të përkulura (të anuara), por edhe të drejta ose të shtrira në mënyrë të alternuar përgjatë gjithë krahut verilindor dhe i gjatë rreth 50 cm. Format e tyre zmadhohen në dimensione në lindje të mozaikut; dhe konturi është i realizuar me një rresht teserash të zeza, pjesa e brendshme me tesera të kuqe, dhe sfondi me tesera të

*Doktor i Kërkimeve Arkeologjike, Restaurator - Profesionist i lirë.
**Restaurator në Institutin e Monumenteve në Shqipëri.
***Doktor Mjeshtër në Arkeologji,Restaurator – Profesionist i lirë.

[1] studentët e qendrës CRA janë: Admir Xhelaj, Arjan Dimo, Edvin Lamçe, Elton Xheka, Erjona Qilla, Florian Mino, Ilir Parangoni, Klejdi Zguro, Lavdosh Jaupaj, Ermal Cara, Ardiola Alikaj.

[2] Dhimosten Budina, Belul Korkuti, "Mozaik të rinj të zbuluar në Onhezmin e lashtë, Sarandë", fq. 207-247, në Studime Historike" Nr. 1/1971.

DO NOT COPY

bardha. Në pjesën e brendshme (jugore) gjendet një tapet shumëngjyrësh që përfshin (zë) gati gjysmën e dhomës, dekoracioni përbëhet prej rrathësh të lidhur[3] (ndërthurur). Ata janë të vizatuar me një rresht teserash të zeza, që shfaqen me një diametër rreth 0. 25 m dhe të përbërë nga katër boshte të formuar nga një kuadrat konkav mbi diagonale, brenda së cilës paraqitet një motiv dekorativ i thjeshtë prej pesë teserash të zeza e të bardha, motivi ka një radhë kronologjike që shtrihet nga epoka e parë perandorake deri në fillimet e shek II pas K.

Dizenjoja e thjeshtë gjeometrike, e riprodhuar në brendësi të çdo rombi me brinjë konkavë, pasqyron plotësisht kuadrin dekorativ që dominon në shek. II pas.K. përcaktuar nga M.E. Blake si "love of ornamentation"(dashuria e dekorimit). Padyshim që kjo tipologji dekoracioni vazhdoi të përdoret edhe në shekujt në vazhdim në hapësira të ndryshme gjeografike. Në ndarjen lindore të ambjentit dhe afër pjesës me rrathë të ndërthurur, ndodhen disa kuadrate të mbuluara me dekoracione të ndryshme gjeometrike dhe figurative[4].

Në veri, gjendet një kuadrat që shtrihet në drejtim lindje-perëndim me gjatësi rreth 180 cm, dhe gjerësi rreth 130 cm. Mozaiku i këtij kuadrati është i formuar nga 14 kuadrate në gjatësi dhe 10 në gjerësi. Bordurat e çdo kuadrati janë të realizuara nga një rresht teserash të bardha në një sfond të zi, me një rreth të brendashkruar i realizuar me tesera të kuqe. Kuadratet e vegjël kanë formë të çrregullt me përmasa rreth 15 x 10 cm.

I njëjti motiv dekorativ përsëritet edhe në pjesën jugore të kuadrati, i cili ishte i dekoruar ndoshta me një delfin të konsideruar si "emblema". Ai përbëhej nga motive gjeometrike, të realizuara në formë rrethore, në qendër të të cilit ndodhet figura e këtij delfini të supozuar i rrethuar nga një rresht teserash të zeza në një sfond të bardhë. Figura është e rrethuar me kuadrate të mëdhenj nga ana e jashtme dhe të vegjël nga ana e brendshme, i gjithë kompozimi i "emblemës" mbyllet nga një rresht teserash të zeza, duke formuar një figurë në formë rombi.

Akoma më në lindje të dhomës, ku mozaiku i mëparshëm ka pësuar shumë ndërhyrje si restauruese edhe ndërtimore, shfaqen dekoracione në formë rrethore me elipse të zgjatura, të brendashkruar në kuadrata, konturet e të dyja figurave janë realizuar me një rresht teserash të zeza; në brendësi të rrathëve shfaqen të tjerë rrathë më të vegjël, të ndarë në katër pjesë të rregullta të punuara në tesera të kuqe. E njëjta gjë ndodh edhe me elipsët, të cilët alternohen në mënyrë të rregullt me rrathët.

Në pjesën këndore - veriore gjenden dekoracione gjeometrike në formë rombi me tesera të zeza, në qendër të së cilit ndodhen dy rrathë të vegjël koncentrik, të realizuar me një rresht teserash së zeza dhe fundi është realizuar me tesera të kuqe. Më në jug gjendet një kuadrat me përmasa 2 x 2 m me motive të ndryshme dekorative të dallueshëm qartë. E gjithë zona juglindore e hapësirës, është e dekoruar me kompozime pingule tetëkëndorësh të çrregullt afër katër brinjëve konkave që formojnë ndërmjet tyre rrathë të bashkuar me dy breza (rrip me vija) paralele ; motive të tilla përhapen në mënyrë lineare me dre-

[3] Për skemën gjenerale dhe zhvillimin e saj, shih C. Balamella et al., "Le dècor gèometrique de la mosaique romanine", Paris 1985, harta 238-241; Cfr. G. Salies, "Untersuchungen zu den geometrischen
Gliederungschemata rimischer mosaiken", në "Bonn. Jahrb." 174 (1974), p. 15 (Kerissytem II, fig.4 n. 54); shih përvec kësaj M. E. Blake, Dyshemetë e ndërtimeve"The pavements of the Roman buildings of the republican and early empire", në "Mem. Amer. Acad. Rome" III, 1930, fq. 104, tab. 23.3.

[4] Shiko op. cit. në shënimin e parë.

DO NOT COPY

jtim lindje - perëndim: bordurat e rrathëve janë të realizuar me një rresht teserash të zeza, brenda të cilëve gjenden dy rreshta me tesera të bardha, të tillë rrathë brendashkruhen nga të tjerë me përmasa më të vogla, të realizuar me një rresht teserash të zeza; ata ndahen në katër pjesë, të formuar nga ndërthurja e dy diametrave të realizuar me një rresht teserash të zeza, këto katër "sektorë" janë të mbushur në mënyrë të arsyeshme me tesera të kuqe e të bardha.

Në brendësi të tetëkëndshave gjenden dy rrathë koncentrik të vizatuar me një rresht teserash të zeza, të ndarë njëri nga tjetri nga dy rreshta teserash të bardha; baza e rrethit më të vogël është e realizuar në tesera të kuqe.

Në kufi të gërshetimit në pjesën jugore dhe kompozimit tetëkëndor të tetëkëndshave të çrregullt, shfaqen dy drejtkëndsha të përbërë nga dy rreshta teserash të zeza në një sfond të bardhë, në një nga të cilët lexohet (përmasa 120 x 70 cm përmasa e germave rreth 5-6 cm) në greqishten antike:

.....ΟΠΡΕ CBYTEP ' Y CHP
K.....EYXHCE
Π ' OC CCM

Përkthimi nuk është akoma shumë i qartë, por supozohet të jetë një dedikim për shtetin ose donatorin që bëri të mundur ngritjen e kësaj ndërtese antike.

Supozohet që ky epigraf në mozaik i është shtuar pjesës lindore të ambjentit, pra i referohet një periudhe të mëvonshme, në fakt në mbishkrim shfaqet fjala "prezbiter" kur ndërtesa kishte ende synime kulturore. Në vazhdim të kornizës me valë që vazhdojnë drejt pjesës së jashtme, gjendet një gërshetim shumëngjyrësh me dy koka me nyje katrore e realizuar me tesera të zeza në kornizë në një sfond të kuq. U bë edhe një ndarje kronologjike në bazë të të dhënave arkeologjike që u vunë në dispozicion nga arkeologët shqiptarë dhe nga struktura e një varri të gjendur në pjesën perëndimore të ambjentit[5], që nxjerr në pah se:

-gjysma veri-perëndimore mendohet të jetë realizuar dhe mund të datohet rreth fundit të shek. II- fillimi i shek. të III pas.K:
-gjysma jug-lindore me të gjitha ndërhyrjet e mëpasshme mund të datohet rreth fundit të shek. IV fillimi të shek.V pas.K.

• Analiza e gjendjes së konservimit

Mozaiku në kohë ka pësuar disa ndërhyrje konservuese dhe restauruese, por në dokumentacionin e mëparshëm përmenden vetëm dy kryesore:

I pari, pas zbulimit në vitin 1969 dhe i dyti në fillim të viteve '90, ku në të dyja rastet janë kryer rimbushje dhe plotësime të konsiderueshme të lakunave (mungesave në mozaik), si me tesera ashtu edhe me material jo të përshtatshëm (llaç i përzier me çimento).

Gjendja në të cilën ruhej dyshemeja me mozaik në momentin e ndërhyrjes sonë ishte aspak e mirë, sepse paraqiste disa morfologji degradimi dhe modifikimi, dhe për më tepër ishte e palexueshme si nga ana gjeometrike edhe nga ajo kromatike (e ngjyrave) (fig. 1). Deformimi strukturor i dyshemesë me mozaik

Tapeti mozaik, ka pësuar një deformim strukturor të rrezikshëm të shtresave të përgatitjes (shtresat të cilat përbëjnë një mozaik), kjo formë degradimi lidhet si me natyrën e terrenit që ndodhet nën të, edhe me futjen e dherave dhe ujit të shirave, por dhe të ujit të përdorur për pastrimin e mozaikut në të kaluarën.

[5] Cfr. Op. cit. shënim 1.

DO NOT COPY



fig. 1



fig. 2

- Depozitimet sipërfaqësore të qëndrueshme dhe të paqëndrueshme
- Depozitime të paqëndrueshme (pluhurat), që ishin prezente në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë sipërfaqen ;
- Depozitime të qëndrueshme, në formën e konkrecioneve gëlqerore dhe mbetje të rezinave / substancave ngjitëse të llojeve të ndryshme, të përqëndruara këto veçanërisht në cepin veriperëndimor dhe atë jug-perëndimor (fig. 2).
- Lakunat (mungesat); me përmasa të vogla dhe të mesme (nga 20 - 340 cm), me ndikim të fortë mbi lexueshmërine e realizimit të mozaikut; paraqiten herë si lakuna të pjesshme me mungesën vetëm të teserave, dhe herë janë të plota me mungesën si të teserave edhe të një ose më shumë shtresave të përgatitjes.
- Njollat dhe lagështira e ngjitjes (sipas parimit të kapilaritetit nga poshtë-lart) ; që shkaktohen nga depërtimi i ujërave që vijnë nga ndërtesat ngjitur, të cilat lagin vazhdimisht murin verior të ndërtesës moderne.
- Kristalizimi i kriprave mbi dhe nën sipërfaqen e teserave; kjo është shumë e dukshme në këndin veriperëndimor dhe shkaktohet nga problemi i depërtimit të ujërave të cituar më lart (fig. 3).
- Mungesa e adezionit; vihet re ndërmjet shtresë së teserave dhe shtresës së llaçit mbi të cilën vendosen ato, dhe ndërmjet shtresave të ndryshme të ndërtimit së mozaikut, duke shkaktuar si rrjedhim shkëputjen e si pasojë edhe fryrjen e sipërfaqes së mozaikut.
- Degradimi biologjik; prezenca e algave mbi sipërfaqen e mozaikut vetëm në pjesën veriore (fig. 4).
- Ndërhyrjet e mëparshme; gjatë ndërhyrjeve të ndryshme të mëparshme, janë mbushur dhe plotësura lakunat, si me llaç të përzierë me çimento jo të përputhshme me materialet origjinale, ashtu dhe me tesera origjinale, duke e vështirësuar dallueshmërinë e ndërhyrjeve me kalimin e kohës.

• Ndërhyrjet konservuese

Duke folur për konservimin in situ, nuk mund të anashkalojmë disa konsiderata rreth koncepteve të kundërta, pra rreth muzeut. Në fakt muzeu, nuk është më vendi i vetëm ku përligjet arti ose më në



fig 3



fig 4

DO NOT COPY

përgjithësi "gjërat". Ky proces demokratik jo vetëm që po evoloun akoma, por atij po i shtohet edhe një mendim i përmirësuar mbi prezantimin e dëshmive njerëzore të së shkuarës. Ky mendim nuk është gjë tjetër, veçse Konservim in situ[6].

Është shumë e rëndësishme që të ketë një orientim të favorshëm drejt konservimit in situ , në fakt është e vërtetë se dalja jashtë nga konteksti i vetë origjinalit, shpesh provokon një realizim të gabuar. Sot pra, kur vizitojmë vendet që i kanë këta mozaikë, ose muzeumet, fatkeqësisht jemi të detyruar t'i shohim si të ishin "piktura" të vërteta të varura në mur, ndërkohë që e dimë mirë që funksioni i tyre antik dhe origjinal ishte mbi të gjitha për shfrytëzim (përdorim), pastaj për estetikë.

Pika e dytë në favor të moslëvizjes (mos heqjes së mozaikëve nga konteksti origjinal), është se në këtë mënyrë mozaikët nuk pësojnë trauma të veçanta si ai i heqjes dhe/ose shkuljes.

Veç kësaj, duke e ruajtur në sit, do të kemi mundësinë e ruajtjes së shumë informacioneve teknike dhe strukturore të mjedisit rrethues, që shpesh gjatë operacionit të heqjes shkatërrohen dhe humbasin pa qenë të dokumentuara; fatkeqësisht, shumë njerëz e shohin mozaikun duke i dhënë rëndësi më të madhe aspektit[7] të tij të jashtëm, pra sipërfaqes e jo strukturës (sfondit, mjedisit), duke mos patur parasysh që nuk mund të ekzistoj e para pa të dytën, sepse është e gjitha një gjë.

Çdo mozaik me gjendjen e tij të konservimit (prezencën e lakunave, rrëshqitjeve, etj.,) paraqet një dëshmi historike më vete, dhe kur hiqet dhe transportohet për në muze, i humbet ato vlera që e bëjnë të tillë në kontekstin historik.

Ruajtja e një vepre, përveç fakteve historike, influencohet edhe nga faktorët ambjental të tillë si lagështira, temperatura, ndotja, materialet që e prekin, etj.

• Dokumentacioni

Në fillim të viteve '90 u realizua një rilevim grafik i mozaikut, por që pas një analize të kujdesshme

[6] G. De Guichen, R. Nardi, "La conservazione dei siti archeologici: strategie, tecniche e strumenti. Il caso del mosaico", në "AISCOM" III, (Bordighera 1995), 1996, fq. 487-489.

[7] C. Brandi, "Teoria del restauro", Torino 1977, fq. 9-12.

u përcaktua si i paplotë, pra është azhornuar, duke i shtuar pjesët që i mungonin dhe duke e përdorur si bazë për dokumentcionin grafik të gjendjes së konservimit dhe ndërhyrjeve të kryera (harta tematike), duke u shoqëruar gjithçka me një dokumentacion të gjerë fotografik.

Të gjitha morfologjitë e ndryshimeve dhe degradimit u lokalizuan dhe rilevuan në harta prej letre dhe më pas u dixhitalizuan (fig. 5).

Në vazhdim të pastrimit paraprak, u realizuan disa rilevime në kontakt me shtresat në pvc (teserë për teserë) të motiveve të ndryshme dekorative të dyshemesë[8] (fig. 6).



fig 5

• Pastrimi

Pastrimi është një operacion[9] delikat dhe i pakthyeshëm që për arritjen e rezultateve të mira, duhet përballuar me shumë maturi dhe me njohuritë e nevojshme.

Për proceset e pastrimit, mund të citojmë disa kritere të përcaktuar nga Lazzarini e Tabasso [10]:

Procesi duhet të jetë i kontrollueshëm, gradual dhe selektiv në çdo fazë të tij; nuk duhet të prodhojë materiale të dëmshme për ruajtjen e gurit; nuk duhet të prodhojë modifikime, fraktura të vogla ose gërryerje të forta në sipërfaqen e veprës së artit (mozaikut). Pastrimi, në radhë të parë konsistoi në eliminimin e pluhurave me anë të penelëve të butë me qime kafshësh, ky operacion kishte si qëllim evidentimin e ngjyrave të teserave, dhe leximin pak a shumë të dekoracionit të paraqitur në mantelin e mozaikut; gjithashtu lejoi të kuptonim më mirë tipologjitë e ndryshme të degradimit të paraqitur. Në radhë të dytë u përballua problemi i degradimit biologjik


fig 6

[8] Dokumentacioni në pvc gjendet pranë zyrave CRA në Sarandë.
[9] Cfr. Dok. Normal 20/85, "Interventi conservativi: progettazione e valutazione preventiva", CNR-ICR, Romë 1985.
[10] L. Lazzarini, M.L. Tabasso, "Il restauro della pietra", Padova 1984, fq. 107-108.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



fig 7

(algat dhe bakteret) dhe në vazhdim eliminimi i këtyre patologjive duke përdorur substancën biocide të përshtatshme për këto lloj patologjish. Pas disa kampionaturave u vendos përdorimi i një biocidi me spektër të gjerë veprimi me bazë kripërash kuaternale të amonit[11] ,i cili u aplikua në kontakt direkt me sipërfaqen me ndihmën e furcave me fibra natyrale, veprim i cili u pasua nga një shpëlarje e kujdesshme me ujë e sipërfaqes.

Në fund, u vu re nevoja e kryerjes së një pastrimi tjetër që të lejonte eliminimin e inkrostacioneve (koreve), të ndryshme mbi sipërfaqen e teserave; kjo lloj ndërhyrjeje pastruese e tipit kimik/mekanik u realizua, me përdorimin e një tretësire solucioni me pehash acid (pH 4.5)[12] duke i shtuar tretësirës dhe një detergjent jo jonik(neutro)[13] , tretësirë e cila u përdor duke patur parasysh patologjitë e ndryshme të degradimit, dhe kompaktësinë[14] dhe fortësinë e inkrostacioneve (fig. 7). Duke parë përqëndrimin dhe formimin e kristaleve të kripës në këndin veriperëndimor, u përdorën kompresa me celulozë, ujë, etanol (alkool etilik) 96° në raport 50 me 50[15] .

• Konsolidimi në thellësi

Me termin konsolidim, kuptojmë një trajtim që ka për qëllim përmirësimin e karakteristikave të kohezionit dhe zbatimit ndërmjet materialeve që përbëjnë objektin, që në këtë rast janë shtresat e përgatitjes. Si rrjedhim, duhet të përmirësohet rezistenca mekanike e materialeve të dëmtuara.

Në vazhdim të evidentimit me ndihmën çekiçave prej gome mundëm të individualizonim disa zona të dyshemesë ku mungonte aderenca midis shtresës së teserave dhe shtresës së llaçit ku ato vendosen, dhe shtresave të mëposhtme. Konsolidimi u realizua duke injektuar dhe përdorur një llaç të hollë hidraulik[16] nëpërmjet shiringave, deri në momentin kur llaçi i lëngshëm kthehej mbrapsht (fig. 8).

Përpara injektimit të llaçit, për të larguar papastërtitë dhe për të hapur rrugën u injektua ujë dhe alkool etilik në raportin 1:1.

• Teknika e ndërtimit të mozaikut

Nga vëzhgimet vizive u kuptua (por kjo teori duhet ende kohë për t'u konfirmuar) se aparati i mozaikut është ndërtuar mbi një terren jo të rregullt, sepse

---

[11] Solucion benzalkon cloruri (biocid-algicid me pH 7.0-8.0), 2% në ujë

[12] EDTA bisodike (kripë bisodike(dy molekula Na në strukturë) e acidit etilendiaminotetra acetik), 10% në tretësirë ujore.

[13] Tëeen 20,1% në ujë.

[14] Në këndin jug/perëndimor është aplikuar e njëjta zgjidhje nëpërmjet kompresave me përdorimin e celulozës, në një periudhë kohe prej 18 orësh, duke marrë rezultate të mira.

[15] Lokalizuar në veriperëndim të ambientit.

[16] Leit 01- maltë për injeksionin me peshë specifike shumë të ulët, me përmbajtje të ulët të kriprave të tretëshme, pozolana dhe perlite e kombinuar me ngjitës, e përshtatshme për ndërhyrjet e konsolidimit në brendësi të afreskeve dhe mozaikëve.

DO NOT COPY

edhe në kuotën e vet dyshemesë paraqiten në disa pika pjesë të dala shkëmbore. Veç kësaj prezenca e lakunave të përhapura e të thella në disa pika të dyshemesë ka penguar leximin vizual të saktë stratigrafik; është vënë re se në disa raste shtresa e vendosjes së teserave ishte mbështetur direkt mbi shkëmbinj, dhe në raste të tjera paraqiteshin 3-4 shtresa të preparatit direkt mbi tokë e jo mbi shtresën e ngjeshur dhe teserat. Një operacion i tillë në fakt nuk u interpretua lehtë për shkak të procedurave jo korrekte të mirëmbajtjes në të kaluarën, si edhe përdorimit të bollshëm të ujit për pastrim i cili ka shkaktuar një rrëshkitje të tokës ndërmjet shtresave të mozaikut në të gjithë dyshemenë, duke bërë kështu në disa raste të vështirë edhe leximin e vetë fragmenteve stratigrafike.

Në vija të përgjithshme, ka tre lloje shtresash llaçi nën tesera:

- shtresa e parë nga gjurma (me ngjyrë gri të hapur) me trashësi të ndryshueshme nga 3-5 cm, është e përbërë nga gëlqere (komponenti lidhës) dhe inerte, rërë lumi me granulometri më të vogël se 5-2 mm;
- shtresa e dytë (me ngjyrë rozë të ndezur), përbëhet nga komponenti lidhës (gëlqerja) dhe inerte të imët me bazë pluhuri tullash me përmasa rreth 2-1 mm ;
- shtresa e tretë, në kontakt direkt me teserat,(shtresa e vendosjes së tyre), përbëhet vetëm nga komponenti lidhës me një trashësi më të vogël se 3 mm.

Gjatë studimit të teknikës së ndërtimit të dyshemesë me mozaik dhe vëzhgimeve të kujdeshme vizive, u vu re (një e dhënë shumë e rëndësishme për



fig 8

teknikën e ndërtimit të këtij mozaiku) nën disa tesera dhe mbi shtresën e llaçit ku ato vendosen, disa gjurmë pigmenti të kuq[17] , këto gjurmë me ngjyrë u gjendën vetëm në gjysmën lindore të dyshemesë (fig. 9).

Vec kësaj në disa zona të lokalizuara kufiri ndërmjet "ditëve" të ndryshme të punës në të kaluarën, lidhur me përhapjen e shtresës së dytë të llaçit (atë në ngjyrë rozë të errët); e dhënë tjetër e rëndësishme për të kuptuar shkallën e përgatitjes praktike të mozaikut, që mendojmë se është jo e një niveli të lartë.

Përpara trajtimit dhe mbushjes së lakunave, nga prezenca e tyre u përfituan kampione të materialeve të ndryshme që ndërtonin mozaikun e dyshemesë (teserë dhe llaç preparati) për të kryer një studim arkeometrik të materialeve për të kuptuar e ditur natyrën dhe klasifikimin e teserave dhe përbërjen e tyre mineralogjike; kurse për llaçin do të mund të shohim natyrën e lidhësit, përbërjen e inerteve dhe raportin lidhës agregat[18] .

[17] Kjo ngjyrë përdorej nga mjeshtërit e periudhës romake si "sinopia", pra si dizenjo përgatitore mbi shtresën e vendosjes së teserave për të lehtësuar realizimin e mozaikut

DO NOT COPY



fig 9

• Trajtimi i lakunave (mungesave)

Ndërmjet problemeve të ndryshme që duhen përballuar në restaurimin e një mozaiku, një vend të veçantë zë trajtimi i lakunave, pra duhet të gjendet një zgjidhje dhe një mënyrë e përshtatshme për trajtimin e lakunave të atij mozaiku. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht "plotësimi ose integrimi" i lakunave, që është një ndërhyrje që nuk ka të bëjë shumë me konservimin e materialeve origjinale, sesa me zgjidhjen e një problemi estetik, për leximin e veprës.

Lakuna, siç dallohet edhe nga etimologjia e vetë fjalës, një mungesë, pra një humbje pak a shumë e konsiderueshme, e lokalizuar në një zonë të çfarëdoshme të veprës së artit. Cesare Brandi kur shkruante rreth saj e quan lakunën (ose mungesën) "njësi cilësore dhe jo sasiore" të veprës së artit[19] .

Përsa i përket përhapjes së llojeve të ndryshme të lakunave, Baldini i ndau në "lakuna dhe mungesa" dhe "lakuna, humbje". Nëse kjo teori është e vlefshme për pikturën në pëlhurë ose për afreskun[20] , në rastin e mozaikut është e aplikueshme në përmasa të kufizuara.

Ish-drejtori i Institutit Qendror të Restaurimit Cordaro, i ka konceptuar lakunat në mozaik si "çdo lloj mungese, pak a shumë e përhapur, e parametrit të teserës, dhe së bashku me të, mungesën e mundshme të një a më shumë shtresave përgatitore e të tërhequr, me qëllim ndërprerjen e vazhdimësisë e shtresës së jashtme të mozaikut, pra të imazhit të përfaqësuar në të[21] ".

Pra në fushën e mozaikut, janë mundur të përcaktohen dy tipologji të lakunave: Të pjesshme, kur mungojnë vetëm teserat; kurse me mungesën e shtresave të preparatit, duke nisur nga shtresa e vendosjes së teserave, përcaktohet si një lakunë e plotë.

Trajtimi i mungesave, më shumë se çdo ndërhyrje tjetër konservuese, duke përfshirë aspektin interpretativ, duhet të udhëhiqet nga një seri principesh themelorë[22] :

gjatë fazave të para të studimit dhe dokumentimit të gjendjes së konservimit të mozaikut, është thelbësore verifikimi i materialeve dhe metoda e teknikës së përdorur, duke ndarë pjesët origjinale nga materialet e mundshme të shtuara; përsa i përket plotësimeve të vjetra, kur ato bëhen pjesë e historisë së vetë mozaikut, nuk mund të lejohen heqje ose shembje, vetëm nëse shkaktojnë modifikime dëmtuese për vlerat estetike dhe historike të dyshemesë origjinale;

---

[18] Studimi arkeometrik i materialeve që formojnë dyshemenë me mozaik (llaç dhe tesera) do të kryhen më vonë dhe rezultatet do të aplikohen në përfundim të punës.

[19] C. Brandi, "Teoria del restauro" , Torino, 1977, fq. 89-97.

[20] U. Baldini, "Teoria del restauro e unità di metodologia" , Firenze, 1981, fq. 22.

[21] M. Cordaro"Il problema delle lacune nei mosaici", në Konservimi në sit "Mozaikët" n. 3, 1985, fq. 385-369; shiko edhe C. Fiori, M. Vandini, F. Casagrande, "L'integrazione delle lacune nel restauro dei mosaici", Padova, 2005.

22 Cfr. M. Montanaro, "Il problema delle lacune", në fletoret "ITREC" n. 6, 1996, fq. 73-105.

DO NOT COPY

ndërhyrja për plotësimin e lakunave, duhet të vendoset në bazë të përmasave dhe lokalizimeve të tyre; integrohen (plotësohen) fillimisht lakunat e vogla dhe mbulohen ato me shtrirje më të madhe; nuk mund të bëhen rikonstruksione hipotetike, edhe pse në formë të thjeshtuar; integrimi duhet të jetë i dallueshëm me sy në distancë të afërt; mund të përdoren materiale të ndryshme nga origjinali[23] , me kusht që të kenë veti fizike dhe kimike të përputhshme.

Ndërhyrja duhet të jetë e rikthyeshme për të lejuar që në të ardhmen mund të kryhen ndërhyrje të mëtejshme konservuese; pra është i nevojshëm dokumentimi i operacioneve dhe punës së kryer.

Duke ju kthyer përsëri dyshemesë me mozaik, përsa i përket lakunave të vogla, në zonat fundore vetëm me tesera të bardha pa dekoracione dhe/ose në motivet dekorative të përsëritura, janë integruar duke përdorur tesera origjinale të dyshemesë, që ndodheshin në vend, nëpërmjet një llaçi me bazë gëlqereje, pluhur mermeri, pluhur tulle dhe pozolana në raport lidhës: inerte 1 : 2. Ajo është përdorur edhe për fiksimin e teserave të lëvizshme në buzët e lakunave, një operacion i tillë u shoqërua me një dokumentacion të pasur fotografik.

Për aq sa i takon, lakunave "totale" me përmasa të mëdha, të cilat ishin mbushur edhe më parë me llaç të përzierë me çimento, me qëllim që gjatë risistemimit të tyre dhe eliminimit të mbushjes së vjetër, teserat anësore të mos zhvendoseshin, u krye fiksimi i përkohshëm i tyre duke përdorur garza dhe solucion Paraloid B72[24] .

Për trajtimin e të tilla lakunave, është studiuar një lloj llaçi "ad hoc" i cili të mbushë hapësirat e gjera dhe respektojë ose të mos stonojë me aspektin kromatik të teserave që formojnë dyshemenë me mozaik që janë të zeza dhe rozë.

Për arritjen e këtij rezultati u zgjodhën tre lloje inertesh me granulometri graduale: granil me gra-



fig 10



fig 11

[23] M.S.Abu Aysheh, "I materiali sintetici nei mosaici antichi e contemporanei" , në 20 vjet aktiviteti në AIMC për mozaikët bashkëkohor, Kongresi VII AMIC, nën kujdesin e I.R. Fiorentini, C. Fiori e M. Micchiarola, 2004, fq. 264-268; A. Lugari, "Metodologie di intervento delle lacune nei mosaici pavimentali", në "L'integrazione delle lacune nel mosaico" (2002), 2003, fq. 79-84.

[24] Rezinë akrilike (etilmetacrilat, 100% copolimer akrilik), në granula pa ngjyrë, 10% në açeton

nulometri 3-10 mm me ngjyrë të bardhë dhe rozë, granil i imët 1-3 mm (i bardhë dhe rozë) dhe rërë lumi me granulometri më të vogël se 2 mm me ngjyrë të zezë/gri, dhe e shtuar kjo me një përqindje të vogël pluhur tulle të imët, duke i shtuar kësaj përzierje një sasi të vogël rezine akrilike në tretësirë ujore; si element lidhës u përdor gëlqerja hidraulike (Lafarge) natyrale. Raporti lidhës agregat ishte 1:3 (fig. 10-11).

Për të plotësuar operacionin e restaurimit konservues, për t'i dhënë një gjallërim minimal sitit dhe vazhdimësi mozaikut, u shtrua një shtresë rreth 2-3 cm me granil me ngjyrë të bardhë dhe rozë për mbulimin e zonave pa mozaik. Në përfundim të punimeve u krye një operacion pastrimi në të thatë (penela, furça) dhe më pas me Tween 20, 1% solucion ujor, vetëm me sfungjer për heqjen e të gjitha depozitimeve të formuara gjatë ditëve të fundit (fig. 13) ■

DO NOT COPY

Përfundime

Në përfundim të të gjitha operacioneve dhe ndërhyrjeve konservuese, u shkruajtën një sëri këshillash që do të kryhen në të ardhmen për mirëmbajtjen e rregullt dhe për mbrojtjen e dyshemesë me mozaik, të cilat konsistonin në ndërhyrjet e mëposhtme:

- mbajtja gjithmonë hapur e dritareve të muzeut;
- hapja e derës së muzeut të paktën 2-3 orë në ditë për qarkullimin e ajrit në brendësi të ambjentit;
- kryerja e pastrimit në të thatë një herë në muaj për heqjen e depozitimeve sipërfaqësore të shpërndara mbi mbulesën e mozaikut; kryerja një herë në gjashtë muaj e një pastrimi në të thatë për eliminimin e kristaleve të kripërave (që shfaqen në formë pushi të bardhë) në sipërfaqe.
- kontrolli i infiltrimit të ujit nëpërmjet vëzhgimit të kanaleve, sidomos kur bie shi;
- moslejimi i shkeljes së mozaikut nga personat që e vizitojnë;
- moslejimi i larjes së sipërfaqes së mozaikut me ujë të bollshëm;

Padyshim që operacionet e lartpërmendura të mirëmbajtjes, duhet të kryhen nga persona të përgjegjshëm dhe me kualifikimin dhe njohuritë e duhura.

DO NOT COPY

PREFRACE AND STUDY OF SARANDA MOSAIC

ABU AYSHEH MOH'D

DO NOT COPY

Excavation campaign was conducted for the continuity of this discovery and as result of this was a space 11x8 m, with direction east-west; other surroundings was established at south-east part under the modern building of the city.

Environment was surrounded by mural structures which have stones linked with mortar calcareous; they have maximum highness 0,30m and 0,60m maximum width. Wall highness is preserved well in the north part of the room and it arrives up to 0,30m.

Entwist at the north-east wing is composed by frame which has some copies of lopsided jellies but some times are straight or lied in a alternate way along all the north-south wing and it is 0,50m long. There shapes are enlarge on east of mosaic; and frame is realized in a line of black gravels, internal part are red gravels, and setting with white gravels. In inside part (south side) is established a multicolor carpet which covers at almost half of the room, ornamentation is composed by intertwine circles. They are constructing with a black gravel line with a diameter around 0, 25 m, and they have also four axles which are constructed by a bowl-shaped, four-sided figure with a diagonal and this has inside a simple ornamental decoration with five black and white gravels. This motif has a chronological line which has its beginnings from first imperial era up to beginnings of II century after the Christ.

East parts of site are close to the part with intertwining circles and some covered squares are through different geographical and figurative decorations.

On north, is a square which is placed at east-west direction which arrives at 180cm long and 130cm wide. Mosaic of this square is composited by 14 squares with both sizes 10 cm, wide and long in total. Edgings of each square are compound by white gravels with black backgrounds, and they have also an inscribed circle which is realized with red gravels. Small squares have irregular shape with measurements which arrive at 15x10 cm.

Conservation and restoration interventions which are finished at mosaic during years in their previous documentations have declare only two important interventions:

First after discover on the year 1969 and the second on the beginning of 1990 year. Both interventions are completed with refilling and intensive fulfillments of the lacuna (missings at mosaic), with gravels or impropriate material (like mortar mixed with cement).

We are explaining conservation in situ, but we can not left aside some considerations about the contradictory reflections so in this case, about museum. In fact museum is not the only place where art or

DO NOT COPY

"things" in common are. This democratic process is under continuing development but another improvement idea about the appearance for the human evidences of the past are included. This is nothing else than Conservation in situ.

It is very important to have a complimentary orientation in the direction of conservation in situ, but in authenticity is also true that coming out from original background aggravate always wrong understanding. In the present day when we visit sites or museums where mosaics are established regrettably we are forced to understand them similar to "real work of arts" exhibitioned on the walls, but it is very well identified the aphorism: "The Mosaic antic and original function was first of all for exploitation (functional) and after that for their aesthetic side".

Second fact in favor of the no replacing (do not move the mosaics from their original context) is that: in this way the mosaic doesn't occur special damages like rip out or remove process.

Cleaning is a delicate and permanent process which for accomplishing good results is obligatory to be very careful, to have essential knowledge's and being with countless experience.

Some criteria of cleaning are defined by Lazzarini e Tabasso:

During the patency with the help of rubber hammers we are able to individualize at the floor the missing space between different areas of mortar (when gravels are fixed) and bottom. Consolidation was realized by mortar injection with syringes up to the moments when hydraulic liquid mortar come up to mosaic surface.

Before mortar injection for removing the contamination and open the space was injected water and ethylic alcohol in ratio 1:1.

Visional checking give you an idea about (this theory need to be confirmed) when the mosaic is established not in a regular terrain because at its base are at some positions stony tracks which are out of the mosaic surface.

There are three mortar layers in general under the gravels:

- First layer from the footprint (open grey color) with variable thickness from 3-5 cm, this is compound with lime (joint component), river sand with granulated stones less than 5-2mm;
- Second layer (strong pink color), is composite of solder component (lime) and granulated stones similar to brick powder with measurement about 2-1mm;
- Third layer, has direct contacts with gravels, (their placement layer), is compound by solder component with thinness less than 3mm.

During the study of construction technique of the mosaic floor and carefully visional checking was noticed fragments a red pigment (a very important data for the construction technique of this mosaic) under some gravels and over the mortar layer where these are placement, these fragments were found only at east half of the mosaic floor.

Treatments of the missing in every conserve intervention and determine interpretative aspect must have some necessary conditions.

During the first phases of study and documentation of the mosaic state is fundamental checking of the materials and technique used by separate original from supplementary materials. When are old fulfillments and they are considered as part of mosaic history as a result removing or destroying are not allowed, but in other cases when they cause damages modifications for aesthetic values of mosaic original floor removing or destroying are allowable. Intervention for refilling of lacunas must decide accor-

DO NOT COPY

ding to their positions and measurements. Firstly are integrate (fulfilled) small lacuna and are covered these which have great broaden. Integration must be clear closely; different original material must used with only one condition to have the same physical and chemical qualities. Hypothetic reconstructions are not allowed even they are considered as a very simple form.

Intervention must be reinstating to allow in the future other conservations so it is very important to document every process or work done.

After finishing all processes and preservation interventions was written some advices which must be in center of attention during the future for maintenance, regulation and protection of the mosaic floor which are as follow:

Window of the museum must be always open:

- Museum door must be open fewer than 2-3 hours per day to allow air exchange within the museum;
- Dry cleaning once in a moth for removing of surface dumps which are over at mosaic surface; dry cleaning twice in a year for removing the saline crystal (which is exposed as white flourish) at surface.
- Checking of water filterable by controlling irrigate channels when are rainy days
- Visitor trespassing is forbidden on mosaic surface
- Washing of mosaic with running water is prohibited.

It is very important for maintenance accomplishment that all above mentioned to be done by specialists and qualified persons who have appropriate knowledge. ■

MANASTIR ASKETËSH NË SHPELLËN E KAURRIT

ARK. REST. GENTIAN STRATOBËRDHA

Gjurmë të shpellave dhe ndërtimeve asketike bizantine mbi liqenin e Komanit.

DO NOT COPY

Në këtë artikull do të japim disa të dhëna nga hulumtimet fizike dhe historike për shpellën të cilën banorët vendas e quan "shpella e kaurrit" që ndodhet pranë fshatit Levrushkë, në zonën e liqenit të Komanit.

Ishte insistimi dashamirës dhe i vazhdueshëm i dy mësuesve nga qyteti i Pukës, që i falënderojmë me shumë respekt, të cilët e shihnin me shumë interes studimin e kësaj shpelle si një gjurmë e fuqishme e periudhës bizantine në Shqipëri, dhe që bënë të mundur organizimin e një ekspedite me qëllim studimin e kësaj shpelle asketësh.

Për të vajtur deri tek shpella është lehtë pasi transporti ujor bën që të afrohesh mjaft afër me mjete lundruese nëpër liqen. Po kështu distanca deri tek diga e Komanit është e shkurtër, vetëm 10 minuta me motobarkë, por ngjitja në shpellë ka vështirësi të mëdha.

Nga pamja e jashtme hyrja e shpellës pothuajse është mbuluar dhe duket si e zhdukur fare nga shkurret dhe bimësia e madhe që është zhvilluar në hyrje të saj. Fatmirësisht njerëzit që më shoqëronin e dinin ekzaktësisht vendndodhjen, dhe kështu që ne e patëm të lehtë të gjendeshim në pozicionin e duhur. Duke shfrytëzuar kuotën e lartë të liqenit, në atë periudhë mund të ngjiteshim me pak vështirësi, në të ashtuquajturin shesh para hyrjes së shpellës. Menjëherë të binin në sy rrënoja muresh të dimensioneve të ndryshme, që fillonin që nga hyrja në këtë shesh dhe zhdukeshin në brendësi të shpellës. Duke u përqendruar në detajet e këtyre mureve arritëm të kuptonim se muri që përshkruante pothuajse gjithë gjatësinë e këtij sheshi, me dimension 80 cm, ishte njëkohësisht një mur mbajtës, por edhe muri kryesor i fasadës së manastirit. Dukej qartë që i gjithë sheshi para manastirit dhe në brendësi të tij ishte ndarë me hapësira të vogla, ambiente të dikurshme dhe me funksion përkatës. Muret në brendësi kishin përmasa të zakonshme duke filluar 50, 60 dhe 70 cm. Në dukje të parë, nga struktura e mureve, të krijohet përshtypja se ky manastir duhet të ketë funksionuar me dy kate. Kati përdhes i manastirit, i cili përbëhet nga mure masivë është pothuaj gjysmë i zhytur në plehun dhe dherat e shumtë të cilët kanë mbuluar dyshemenë e shpellës. Në dukje kanë mbetur harqet e dyerve komunikuese të ambienteve të katit përdhe. Kurse në katin e sipërm seksioni i murit ngushtohet duke krijuar kështu një dhëmb në të cilin mendojmë që janë mbështetur trarët e dyshemesë. Duke parë trashësinë e murit të katit përsipër mendojmë që ishte e pamundur të ketë pasur një kat të tretë. Pra arrijmë në konkluzionin se i gjithë manastiri në shumicën e sipërfaqes së tij arrin të zhvillohet vetëm në dy kate.

Në brendësi të shpellës shohim tek-tuk mbetu-



rina muresh dhe mure të rrënuar, gjë që tregon se ambientet e këtij manastiri zhvilloheshin edhe në brendësi të shpellës, por gjithmonë në pjesën e parë të saj. Është shumë e domosdoshme që paraprakisht të realizojmë pastrimin nga plehu dhe mbeturinat e dherave për të identifikuar dhe rilevuar në mënyrë të saktë planimetrinë e këtij manastiri.

Shpella është e gjatë rreth 20 m dhe ka një shtrirje dyplanëshe dhe mbas një kalimi të ngushtë në fund të saj dhe duke u ngjitur në disa shkallare natyrore, ajo ndërron drejtim dhe ngjitet sipër në një hapësirë tjetër të saj nga ku del në një ballkonadë që sikur është krijuar, do të thonim, enkas për funksionin e kësaj shpelle askete.Mund të themi se ballkonada duhet të jetë shfrytëzuar edhe si pikë vrojtuese për manastirin në kohen kur ky i fundit mund të ishte i rrethuar dhe nuk kishte akses me jashtë. Kjo ballkonadë del pothuajse disa metra mbi hyrjen kryesore të shpellës dhe përpara saj shfaqet liqeni i Komanit si dhe faqja e malit përballë që vendasit e quanin Murga. Aty ndodhen gjurmë të disa staneve e kopshteve të vogla, të cilët, sipas vendasve ishin pronë e këtij manastiri. Vetë Murga lidhej me shpellën me një urë druri me këmbë prej guri, të cilën lumi i Gominës e ka shkatërruar plotësisht.

Në këtë shkrim nuk kemi për objekt thjesht Shpellën e Kaurrit si shpellë natyrore, por do të flasim edhe për ndërtimet e fuqishme që ndodhen edhe sot në hyrje të saj. Këto ndërtime që përbëhen nga mure me lidhje llaç gëlqereje, mendojmë se i përkasin një periudhe, dokumentacioni i të cilës për atë zonë të Shqipërisë është i pakët dhe i varfër .

Shumë studiues janë përpjekur të hedhin dritë rreth kësaj periudhe, por varfëria e fakteve që sjellin, ka vënë shumë pikëpyetje për ndërtimet e këtyre mureve. Ndërtimet në Shpellën e Kaurrit, u shpallën monument kulture në vitin 1984, dhe është numri pesë në listën e monumenteve të kulturës të rrethit Pukë. Por, edhe kur u shpall si i tillë, mungonte një emërtesë e saktë për to, dhe u mjaftua vetëm me emërtimin «Shpella e Kaurrit». Nga vrojtimet që janë bërë në terren këto mure, të pajisura me shumë kthina të japin përshtypjen se i përkasin një manastiri asketësh, pasi dhomëzat janë të vogla dhe të ngushta. Këtë më tepër mund ta justifikojmë me topomanistikën e zonës, me gojëdhënat etj. Muret hyrëse që janë edhe më të mbajtur mirë, janë ende të fuqishëm, me dyer e dritare në formë qemeri, dhe kjo na bën të dyshojmë se ka qenë një vend predikimi i kishës dhe i riteve bizantine.

Po sjell disa argumente për këtë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Studiuesi kroat Milan Shuflaj në librin «Shqiptarët e Serbët» thotë se :»Kufiri politik i perandorisë bizantine me atë romake kalonte nga Tivari në bërrylin e Drinit e merrte në veri drejt Danubit.» Shpella e Kaurrit» ndodhet pikërisht krejt pranë bërrylit të Drinit.

Dihet se pas ndarjes së Perandorisë romake, sulmet barbare shkatërruan perëndimin, por nuk lanë pa prekur skajin perëndimor të Bizantit. Po kështu, rol mjaft të madh patën sulmet sllave nga lindja që zgjatën një kohë të gjatë dhe patën pasoja të mëdha historike. Pikërisht për të ruajtur kufijtë e vet politikë, Bizanti ndërtoj në periudhën e shekujve të VI-XI-të shumë fortesa ushtarake të tipit kështjellë. Kjo solli fortësimin e kufijve të Bizantit dhe bashkë me të erdhi edhe normaliteti i jetës shpirtërore dhe pasurimi me ndërtime të ndryshme kishtare. Mendoj se muret e Shpellës së Kaurrit i përkasin pikërisht fillimit të kësaj periudhe, që mund ta quajmë periudhë të lulëzimit të jetës asketike dhe monastike në Shqipëri.

Me krijimin e Themës së Durrësit në fillim të shekullit IX-të, në të cilën u përfshinë përafërsisht trevat e Shqipërisë së mesme e të veriut, duket se u riorganizua administrata kishtare në trojet e Shqipërisë së sotme, pas dyndjeve të mëdha sllave. Me dobësimin dhe më pas rënien e perandorisë bizantine, në territoret e Shqipërisë se mesme e të veriut ranë përkohësisht nën sundimin e feudaleve latinë, dhe kështu krijohen një sërë peshkopatash te reja te lidhura me perëndimin katolik. Ato të veriut nëpërmjet kryepeshkopatës së Tivarit, e atë të Shqipërisë së mesme nëpërmjet Durrësit. U krijua peshkopata e Sapës në vitin 1291, e Danjës para vitit 1361, e ndër të tjera ajo e Lezhës etj., që prunë përfundimisht në gjysmën e dytë të shekullit të XIV, në ndarjen e kryepeshkopatës ortodokse të Durrësit. 1)

Për monumentin e «Shpellës së Kaurrit» na interesoi kjo thënie pasi është ndërtuar shumë më parë se kjo zonë të futej nën ndikimin e kishës romane, pikërisht në momentet e fuqizimit të kryepeshkopatës ortodokse të Durrësit, kur edhe kjo zonë ishte nën juridiksionin e saj.



Është interesante se pas zhdukjes së atyre njerëzve që ndërtuan dhe banuan në këtë manastir, kisha katolike nuk u interesua kurrë për këto ndërtime, gjë që saktëson më mirë së këto ndërtime i përkasin kishës së lindjes, dhe jo asaj të perëndimit, sepse përndryshe në vend të tyre sot patjetër do të kishte ndonjë ndërtim kulti romak.

Në librin «Në malet e Shqipërisë» At Gjon Karma thotë se:»..Kaurri u rrethua në kalanë e Dalmaces dhe

DO NOT COPY



qëndroi për tre vjet deri sa një plakë e fshatit Shënkollë u tha të huajve që t'u ndërpresin furnizimin me ujë të rrethuarve që për plakën ishin «kaurrë». Pra, nga kjo e dhënë që e gjejmë të cituar edhe nga Frang Bardhi, Milan Shuflaj etj., habitem se si nuk u ka shkuar në mendje studiuesve të ndryshëm të sqarojnë pyetjen se kush ishte «Kaurri», që mbronte kalanë e Dalmaces apo manastirin e shpellës së kaurrit. Vetë fjala «Kaurr» që përdorej në këtë kohë, dhe më vonë mund të sqarohet me fjalën turke të përdorur si simbolizim për të krishterët. Atëherë mund të jap shpjegimin tim për këtë. Siç duket popullsia e zonës ku ndodh ngjarja, tashmë me fe të tjetërsuar ndihmonte në aktet kundër kaurrëve.

Për herë të parë emrin e fshatit Levrushk e gjejmë të cituar nga Frang Bardhi në trajtën e emrit Lepurshuk-Lepurushk që më vonë mori trajtën e sotme Levrushk. Në vitin 1637 kur Frang Bardhi kaloi me mision fetar në luginën e Drinit, ky fshat kishte vetëm tre shtëpi. Frang Bardhi na thotë se ata banorë kishin ardhur këtu nga Komani rreth shekullit të XVI-të. Të dhënat arkeologjike flasin për ndërtime shumë më të hershme në këtë zonë.

Të tilla ndërtime që nuk i kanë bërë levrushkasit që jetojnë edhe sot aty janë: Ndërtimet e Shpellës së Kaurrit, kisha e Shënepremtes, varret e kaurrit pranë kësaj kishe etj. Me interes këtu është fakti së në këtë fshat ndodhej një kishë shumë më parë se sa të banohej nga fisi Koman. Banorët e rinj e braktisën kishën e vjetër të Shën e Premtes deri sa u rrënua plotësisht, dhe ritet fetare, si dhe varrimet e fshatit Levrushk kryheshin në kishën e Shën Martinit në fshatin Qerok, një orë larg nga fshati Levrushk. Nëqoftëse kisha e vjetër në qendër të fshatit do të ishte kishë katolike romane atëherë lind pyetja përse banorët katolike të Levrushkut të sotëm do ta braktisnin e do të shkonin kaq larg për të kryer shërbimet fetare jashtë fshatit të tyre? Sipas të thënave nga vetë banorët e Levrushkut kisha e ShënePremtes ishte kishë e kaurrit.

Në librin e tij me titull «Serbët e Shqiptarët» të Milan Shuflaj ndër të tjera përmendet ekzistenca e qytezës bizantine të Oblikës pranë Shkodrës. Përveç kësaj, . fragmente ndërtimesh bizantine gjejmë edhe sot në rrënojat e kishës se Shën Palit në Kabash të Pukës, ku janë përdorur si mjet ndërtues tulla dhe tjegulla, të periudhës bizantine. Zona ku ndodhet «Shpella e Kaurrit» është shumë pranë këtyre zonave, dhe pavarësisht që nuk është përdorur tulla e hollë e kuqe bizantine, në vend të tyre është përdorur guri gëlqeror në formë tullash që zona përreth i ka me shumicë. Kjo na bind se edhe këto mure janë

DO NOT COPY

bizantine të ndërtuara njëkohësisht me fortesën e Oblikës.

Po të bisedosh me banorët e sotëm të Levrushkut, ata pohojnë edhe emërtime interesante të shkëmbinjve, rrugëve, trojeve që janë emërtuar në një kohë shumë më të hershme sa edhe të parët e tyre nuk e mbajnë mend. Kështu në hyrje të kanionit të Gominës ku ndodhet shpella, gjendet guri i Solomonit. Askush nuk është në gjendje të na sqarojë se nga e mori këtë emër. Një qafë në veri të fshatit quhet qafë Pukë, që nga ana gjuhësore lidhet me fjalën romake publika - kjo tregon se që në kohën e Romës kalonte një rrugë e rëndësishme që lidhte Komanin-Bytyçin dilte në qafën e Sukullushit kalonte në Levrushk e ndiqte Drinin drejt Gjakovës e më në thellësi. Gjetjet e pakta arkeologjike dëshmojne se ky fshat është banuar që në kohën e gurit. Edhe shpella në fjalë përbëhej nga elemente që e dëshmojnë këtë, pasi është përdorur nga banorët si strehim që në kohët e vjetra. Levrushkasit i kanë ruajtur mirë emërtesat, si varret e kaurrit, shpella e kaurrit, por asnjë banor nuk na dha përgjigjen e pyetjes se kush dhe si ishin vënë këta emra në këtë zone, bile as që mundën të na sqarojnë mbi çështjen e besimit të popullsisë së hershme që patjetër ndryshonte nga ajo e banorëve të sotëm të Levrushkut.

Periudha e ekzistencës së perandorisë bizantine nuk është shuar as sot në kujtesën popullore, pasi ekzistojnë shume rrënoja dhe emërtesa topomanistike, që ruhen sot e kësaj dite dhe lidhen me emërtimet e besimit të krishterë. Kështu në zonën e Shoshit në Dukagjin ekziston termi «qyteza e kaurrit». Në shume vende ku janë dhe ku gjenden rrënoja të ndërtimeve apo fortifikimeve ushtarake, përdoren termat si «Forcomat e kaurrit», nga banorët e sotëm.

Edhe në zonën ku ndodhet shpella e kaurrit ka shumë material që e dëshmon këtë. Kështu dikur kjo



shpellë kishte edhe emërtesën «Shpella e Kllogjens» që rrjedh nga emërtesa kallogjer(murg). Kjo dëshmon më së miri se popullsia e atëhershme vendase nuk i quante kaurrë, por kallogjerë, pra murgj dhe më vonë ky emërtim ndryshoi si rrjedhim i ndryshimit të besimit në popullsinë vendase dhe si rrjedhojë e lëvizjeve të popullsisë.

Më poshtë do të përpiqemi të argumentojmë edhe pse kisha romane perëndimore nuk ka lënë asnjë dokument për këtë ndërtim, madje nuk gjejmë asgjëkundi të shkruar as emrin «Shpella e Kaurrit». Kështu bën prifti misionar Frang Bardhi i cili vizitoi këto zona në vitin 1637. Ai në relacionet që i dërgon papatit përmend Karmën, Komanin, Bytyçin, Le-

DO NOT COPY

vrushkun e Shënkollin, madje edhe emrat e kishave përkatëse, por sikur ka harruar ndoshta me dashje të na thotë dy fjalë të vetme për këtë manastir të vogël.

Vetëm at Gjon Karma e përmend termin : «kaurr» kur citon rrethimin e kaurrit në kalanë e Dalmacës nga serbët, por edhe ai nuk përmend ndërtimet e hyrjes së shpellës së kaurrit. Kjo si duket nuk ka qenë me interes për kishën romane, megjithëse ajo gjithmonë ka qenë e interesuar për zonat ku ka ushtruar influencën e vet kohë mbas kohe.

Banorët na thonë se kur filluan proceset demokratike në Shqipëri pas vitit 1991, në Pukë e zonën e Komunës së Qelzës, kanë ardhur shumë priftërinj e murgesha misionare, të shtyrë nga fjalët e populit dhe legjendat që tregonin ato për këto mure. Në fillim u duk sikur u interesonte, por pasi shkuan në vend e panë muret, jo vetëm që nuk u interesuan që të merreshin me vlerësimin e tyre, por as nuk u dukën më, sepse si duket panë që ato ndërtime i përkasin kishës së lindjes.

Është shumë interesante se populli i sotëm i Levrushkut edhe sot flet me krenari për muret e shpellës së kaurrit, ruan me fanatizëm varrezat e kaurrit që janë në mes të fshatit, megjithëse ata nuk kryejnë rite fetare apo varrime të të vdekurve në kishën e Shën e Premtes, dhe në varrezat e kaurrit si i thonë, por ato i kryejnë në një vend tjetër.

Thellësia e madhe e ujërave të liqenit dhe gryka ku bashkohen Gomina me Drinin është ndër bukuritë më të rralla natyrore të Shqipërisë, dhe kur udhëton mes për mes saj, sheh një larmi të pasur të peizazheve natyrore. Lartësia e shpellës së kaurrit është 220 m mbi nivelin e detit. Ajo sot ndodhet vetëm 10 m mbi nivelin e pasqyrës se ujërave të liqenit të Komanit.

Dikur këtu lumi i Gominës që është degë e majtë e Drinit, formonte një kanion të ngushtë e të thellë rreth 100 m me shpate tepër të pjerrët e me gjerësi vetëm 2 deri 20 m. Si duket ky kanion natyror i Gominës është shfrytëzuar për të modeluar këtë manastir në mënyrë që të jetë i pa arritshëm, karakteristikë kjo e manastireve asketikë të asaj periudhe. Pas ndërtimit të H/C Komanit, nivelet e ujërave mundësojnë një ngjitje më të lehtë në shpellë.

Kjo shpellë ndodhet në perëndim të krahinës së Pukës, pikërisht në një pozicion të favorshëm gjeografik lidhës midis malësive të Pukës, malit te Cukalit, Malësisë së Tropojës (Gjakovës).

Nga pikëpamja turistiko-kulturore, e tërë zona paraqet interes, pasi në afërsi të saj ka disa shpella të tjera, por që nuk kanë shenja ndërtimesh si shpella e Kolikës, shpella e Dakës, Shpella e Shqipeve, e Bojdanit, e Bushtrës në Cukal , e Zvinës dhe e Zhubit në Berishë.

Hulumtimin e mëtejshëm të saj e bën interesant fakti që na tregojnë nën zë banorët, është gjetja e elementëve arkeologjike të dala në drite kur janë bërë gërmime amatore. Sipas vendasve këtu janë gjetur enë balte, sëpata guri e vegla të tjera, që dëshmojnë se kjo shpellë mund të jetë banuar që në periudhën e gurit, e mund të jetë përdorur si vend strehimi i sigurt për banorët në rast rreziku nga sulmet nga jashtë.

Pastrimi i plehut në tërë gjatësinë e shpellës do të kishte vlerë edhe për gjetjen, evidentimin dhe ruajtjen e objekteve arkeologjike që mund të jenë ruajtur nën shtresën e plehut. Gërmimet mund të sjellin në dritë tunelin që sipas banorëve vendas lidhte shpellën me pjesën lindore të malit me gjatësi mbi 200 m e përdorej si dalje e fshehtë e saj në afërsi të fshatit Levrushk. Ndoshta zbulimi i këtij tuneli do të na ndihmojë të hedhim më shumë dritë edhe mbi vetë manastirin e shpellës së kaurrit. Thuhet se brenda këtij tuneli ishte ndërtuar një furrë gëlqereje që digjte gurin gëlqeror që murgjit e përdornin si mjet

lidhës në muret në hyrje të shpellës. Këtë na e bën ta besojmë edhe shtresat me pllaka gëlqerore në malin përballë të Murgës, material i cili mund të transportohej lehtësisht deri në shpellë.

Kjo temë më ka tërhequr, sepse ka pak dokumente që hedhin dritë mbi këtë periudhë, veçanërisht në Shqipërinë e veriut, ku ato ruhen vetëm në popull, si ngjarje dhe emërtesa, si është rasti i shpellës së kaurrit. Por sa të tilla mund të dalin gjatë kërkimeve dhe gërmimeve arkeologjike në këtë tokë të lashtë e të pasur me objekte të hershme, por që janë lënë në harresë si gjatë regjimit monist, ashtu vazhdojnë të mbeten të tilla edhe sot kur kushtet dhe mundësitë janë përmirësuar.

Gjithashtu jam munduar të jap disa argumente për këtë periudhe në linjën logjike, historike e shoqërore, po në fund të fundit duhet të jemi të bindur që përderisa kufijtë e perëndimit të Perandorisë së madhe Bizantine, kalonin pikërisht në luginën e Drinit dhe brenda tyre kemi argumente të shumta historike të ndërtimit të dhjetëra kështjellave e përforcimeve, dhe shumë kala të vogla me efekt mbrojtës nga Bizanti kundër sulmeve barbare e sllave që vinin nga veriu.

Shkrimi i mësipërm u krye pas studimit të materialeve të ndryshme të shkruara për zonën nga shekulli i XVII e këtej, si dhe duke u mbështetur në të dhënat gojore të banorëve të zonës, informacione të cilat ia japin kujtdo që pyet, dhe me një krenari lehtësisht të evidentueshme për këto ndërtime. Ata duket sikur tregojnë historinë e tyre të lidhur ngushtë me ngjarjet dhe luftërat e zhvilluara këtu në kohërat kur këto ndërtime ishin në lulëzim.

Shënim

1) Informacioni është marrë nga referati i Aleksandër Meksit me titull «Kishat mesjetare të Shqipërisë së mesme e të veriut» botuar në «Monumentet» 1983 Nr.2 fq 78v. ■

DO NOT COPY

Literatura:

1. «Në malet e Shqipërisë së Epërme» At Gjon Karma.
2. «Serbët e Shqiptarët» Milan Shuflaj 1925.
3. «Brenga e Ballkanit» Edit Durham.
4. Relacionet e Frang Bardhit dërguar selisë së shenjtë mbi gjendjen e kishave në zonën e Pukës 1637.
5. Referati i z. Aleksandër Meksi me titull «Kishat mesjetare të Shqipërisë së mesme e të veriut» Monumentet 1983» fq. 78
6. Topomanistika e zonës.
7. Gojëdhëna
8. Vrojtime të kryera në terren.

AN INTERSTING MONUMENT IN KOMAN.

GENTIAN STRATOBËRDHA

DO NOT COPY

Inside the cave we can see that the walls are damaged, mostly at some special parts. It is necessary that firstly we clean this place and then restaurate it.

The buildings at Kaurri's Cave became a cultural monument at year 1984 and it's number five at the list of the cultural monuments of Puka.

In the book "The mountains of Albania" Ojon Karma says: "Kaurri is located at Dalmace's cave. For the first time the name of Levrushk's village, we find used from the writer Frang Bardhi in another form. Firstly, this village was named Lepurshub – Lepurushk and later took the name Levrushk. In the year 1637 when Frang Bardhi says that those people had come here at the XVI century.

This cave is placed at the west of Puka, in a very likeable position between the mountains of Puka, Cukali and Tropoja. This zone is very interesting because near that there are some other caves.

Here we have found some important archaeological elements like stone things. ■

STUDIMI DHE RESTAURIMI I IKONES "DEISIS"

GENTIAN VOKOPOLA
ADRIAN ÇENE

DO NOT COPY

Gjatë vitit 2009 në Laboratorin e Qendrës së Konservimit dhe Restaurimit të Monumenteve të Kulturës, pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" u restauruan një grup ikonash, mes tyre dhe ikona "DEISIS". Këto ikona i përkasin pavionit të artit mesjetar në Muzeun Historik Kombëtar, Tiranë. Ikona "DEISIS" është me numër kartele 3688/MHK Nr. 65 dhe është marrë nga kisha e Shën Kollit – Toshkëz në rrethin e Lushnjes, e cila është ndërtuar në vitin 1813. Për të qenë të sigurtë në ndërhyrjen restauruese dhe që kjo ndërhyrje të ishte e plotë për këtë ikonë u kryen ekzaminime të ndryshme si ekzaminimi viziv, ekzaminimi viziv dhe i prekshëm si dhe ekzaminimin e pjesës prapa. Ikona "DEISIS" (foto 1) daton vitin 1761 dhe i përket kulturës rajonale shqiptare. Përmasat e saj janë 94 x 54 cm në një format drejtkëndëshi. Autori i kësaj ikone është anonim. Ikona "DEISIS" vjen nga një zonë e cila bënte pjesë në Metropolinë e Beratit. Në këtë zonë ndodhen 11 kisha, ndërmjet tyre dhe "Shën Kolli"- Toshkëz të pikturuara nga piktorët grabovarë (Katrot) në shek. XVIII-XIX. Kisha e Toshkëzit është pikturuar nga Joan Katro dhe i biri Naumi. Në vitin 1761 kur është realizuar ikona "DEISIS" Metropolia e Beratit bënte pjesë në Patriarkanën e Ohrit pasi në vitin 1767 ajo u nda dhe hyri në Patriarkanën Ekumenike të Kostandinopojës. Sapo shikon ikonën "DEISIS", impresioni i parë mbi anën kompozicionale të hapësirave ku vendosen personazhet bazohet mbi konceptin kubik të ndarjes së tyre. Kjo pasi dihet që ikonografët përdornin dhe zgjidhje të tjera kompozicionale që bazoheshin tek piramida dhe sfera. Ikona "DEISIS" na paraqitet në dy kuadrate simetrike të ndara nga boshti horizontal. (foto 2). Në kuadratin e sipërm shfaqet skena "DEISIS" në të gjithë sipërfaqen kjo për arsye të rëndësisë në ikonografi dhe hierarkisë që përfaqësojnë Krishti, Shën Mëria dhe Joan Pagëzori. Krishti ndodhet në qendër të kompozimit i ulur në fron në versionin Pantokrator në një pod të kuq, ngjyrë e cila personifikon ngjyrën perandorake duke dhënë mesazhin hyjnor dhe njerëzor, që përfaqëson Krishti si mbret në tokë dhe në qiell. Shikimi i Krishtit drejtohet jashtë ikonës duke transmetuar besimin hyjnor të njerëzimit. Ndërkohë që dy figurat e tjera të vendosura në mënyrë simetrike si shprehje e përsosmërisë qëndrojnë anash dhe sytë e tyre janë të drejtuara nga Krishti si dy personazhet më të afërt të Tij. Në figurën e Joan Pagëzorit konstatojmë një element simbolik të veçantë ku këmbët e tij duken si të zhytura në ujë që në këtë rast personifikon lumin Jordan ku Joani pagëzoi Krishtin. Kuadrati i poshtëm ndahet në dy hapësira të barabarta ku paraqiten figura shënjtorësh. Megjithë këtë ndarje kuadrati duket si një hapësirë e vetme

për shkak të lojës koloristike dhe ritmike që ka përdorur autori. Në këtë kuadrat prezantohen 16 figura nga 8 për çdo ndarje. Disa nga personazhet që kemi mundur të identifikojmë janë dhuruesit e kishës që mbajnë maketin në duar, një profet, kryeengjëllin Mikael i cili mban në dorë një mburojë me shenjën X (Hristos), një pjesa e etërve të Kishës ndërmjet të cilëve Shën Vasili. Pjësa tjetër është e paidentifikueshme për arsye të dëmtimeve të mëdha që kanë shkrimet. Boshti horizontal që ndan dy kuadratet kryesore përbëhet nga 8 figura bust nga të cilat dy martirë, që mbajnë dy kryqe të bardha dhe na paraqiten në dy skajet e këtij boshti dhe në qendër 6 shenjtorë, ku arrijmë të identifikojmë Konstandinin dhe Helenën, Shën Thanasin, Shën Gjergjin dhe Shën Jakovin.

Ikona "DEISIS" vjen para nesh e qëndrueshme në kohë pasi konstatohet një interpretim i lartë si në aspektin liturgjik ashtu dhe në atë artistik. Autori interpreton në mënyrë të përsosur bukurinë e botës shpirtërore duke e ndërthurur dhe unifikuar me një mjeshtri të lartë artistike brenda kornizave të artit Bizantin. Në interpretimin liturgjik vërehet një vendosje hierarkike duke respektuar rëndësinë e personazheve në raport me njëri-tjetrin. Duket qartë që hapësirën më të konsiderueshme dhe me figura me dimensione më të mëdha e prezantuese e zë skena "DEISIS" ku paraqiten tre personazhet primarë të besimit në ikonografinë Bizantine.

Më poshtë ikona vijon sipas skemës ku figurat trajtohen më të vogla dhe të shumta në numër si për të shprehur në mënyrë simbolike mbështetjen e gjerë të besimit. Po të heqim një paralele ndërmjet ekzekutimit të kësaj ikone, me dimensione të vogla dhe zhvillimit të një programi ikonografik në pikturën murale të kishave, shohim gati po të njëjtën renditje ikonografike ku në brezin e poshtëm qëndrojnë etërit e kishës, kryeëngjëjt etj., më lartë vazhdojnë dhuruesit e kishës, shenjtorë e akoma më lart martirë e profetë. Sipër tyre në pikën më të lartë të kishës qëndron figura e Krishtit dhe e personazheve të tjerë pranë Tij, duke treguar me këtë që Ai qëndron mbi gjithë të tjerët dhe zot i gjithësisë në pikën më të lartë pranë qiellit. Edhe në ikonën "DEISIS" Ai paraqitet lart personazheve të tjerë sekondare. Sigurisht në këtë ikonë autori nuk mund të përfshinte të gjithë skenat apo personazhet e programit ikonografik për arsye të dimensioneve të vogla të saj. Megjithatë ikona arrin të transmetojë mesazhin pasi në tërësinë e vet është funksionale si element përbërës i organizimit ikonografik të kishës.

Përsa i përket trajtimit artistik, vepra është e pasur në teknika ekzekutimi, pasuri koloristike dhe të paraqitjes artistike të elementeve në mënyrë dekorative. Figurat paraqiten në një plan duke mos dhënë elemente të perspektivës, e cila çon në lexueshmëri dydimensionale të pikturës. Pasuria koloristike në ikonën "DEISIS" pasqyron dhe transmeton pastërtinë dhe dritën e brendshme të imazhit hyjnor. Autori është njohës shumë i mirë i raporteve koloristike duke e përdorur në qëllimin emocional të veprës gjë e cila shprehet tek portretet. Njohja e raporteve koloristike duket dhe në ngjyrën e kuqe e cila bëhet tërheqëse nga raporti që ajo krijon me ngjyrat që ka pranë si jeshilja, bluja apo me sfondin e artë. Vepra ka ritmikë të pasur kompozicionale që duket tek palat e veshjeve dhe qëndrimi grafik i figurave. Dritëhijet e ngjyrave në raport me ngjyrat speciale janë sa të kursyera aq edhe të kërkuara njëkohësisht. Sfondi i artë në këtë ikonë ngjesh imazhin e figurave duke harmonizuar edhe më shumë ngjyrat. Përveç njohjes së mirë të ngjyrave dhe raporteve ndërmjet tyre autori shprehet mirë dhe në vizatimin e figurave duke ju përmbajtur rregullave kanonike e stilistike të artit

DO NOT COPY

DO NOT COPY

bizantin. Kjo duket qartë në paraqitjen përballë të portreteve, me mënyrën si vizatohen tiparet e portreteve ose edhe në trajtimin me elegancë dhe stilistike të veçantë të duarve dhe të këmbëve. Duke u nisur nga zona ku është gjendur, periudha në të cilën është realizuar vepra si dhe teknikat e ekzekutimit të përdorura mund të thuhet pa hezitim që autori është vazhdues i shkollës së Beratit me Onufrin, Nikolla Onufrin e Onufër Qipriotin dhe pararendës i pikturës së përfaqësuar nga piktorët grabovarë (Katrot).

Gjendja e konservimit, ndërhyrjet e mëparshme dhe teknikat e ekzekutimit e kanë shpëtuar.

Gjatë ekzaminimit të ikonës u konstatua që ajo nga ana tipologjike është vepër unike dhe përbëhet nga elemente të pandarë. Ikona shoqërohet nga një kornizë origjinale që është pjesë e ikonës. Ikona paraqitej mjaft e dëmtuar dhe në një pjesë të konsiderueshme me pelikulin piktorik dhe shtresën përgatitore të djegur. Një pjesë e sipërfaqes së pikturuar ishte me dëmtime të shumta deri në gropëzim të sipërfaqes. (foto 3) Në disa pjesë sidomos tek këndet e ikonës kishte edhe mungesë të krejt suportit të drurit. (foto 4) Evident ishte edhe sulmi që kishin kryer në kohë insektet ksilofage. Duke ekzaminuar me hollësi gjendjen e konservimit gjithashtu u vu re që e gjithë sipërfaqja e ikonës ishte e mbuluar nga depozitime sipërfaqësore (pluhura atmosferike) depozitime të qëndrueshme (tymra, vernik i alteruar, fiksativ i alteruar), abrasion të pelikulit piktorik, fryrje të pelikulit piktorik, (foto 5) lakuna sipëfaqësore të pelikulit piktorik dhe lakuna të thellësisë (pelikuli piktorik dhe shtresa përgatitore). Përsa i përket ndërhyrjeve të mëparshme restauruese u vu re prania e madhe e stukove me dyll dhe ripikturime me një prezencë të dukshme të ngjyrave jo origjinale. Me të njëjtin seriozitet dhe kujdes u krye dhe ekzaminimi i gjendjes së konservimit të pjesës së pasme. Pjesa e pasme prezantohet në një sipërfaqe të gdhendur. Stuktura e suportit është e punuar në një pjesë të vetme dhe ky suport është prej druri natyral arre. U vunë re vizatime me karbon dhe një lyerje e pjesshme me bojë jeshile në pjesën fundore të ikonës (foto 6). Teknikat e ekzekutimit dhe materialet e përdorura janë ato të zakonshme të përdorura nga ikonografët. Mbi suportin e drunjtë autori ka vënë shtresën përgatitore, sipër saj ka përdorur fletë ari në teknikën e aplikimit të misionit dhe ekzekutimin e pelikulit piktorik me tempera nëpërmjet kalimit nga ngjyrat e errëta deri te ato në dritë. Në realizimin e aureolave është përdorur teknika e ekzekutimit me stampë sipërfaqësore (punzonature), (foto 7). Gjithashtu u evidentuan dhe incizionet që autori ka përdorur për vizatimin e figurave.

Ikona ka qëndruar për një kohë të gjatë në fondin e IMK dhe tani gjendet në pavionin e artit mesjetar në Muzeun Historik Kombëtar. Në këto dy stacione të saj nuk mund të flitet për kushte të mira mikro-klimaterike të qëndrimit dhe ekspozimit. Në pavionin ku gjendet aktualisht ka luhatje të mëdha të temperaturës dhe mund të kemi problemin e kondensimit. Gjithashtu ndër burimet ngrohëse mund të përmendim trupat ngrohës dhe një dritë intensive natyrore dhe artificiale. Dhe të gjitha këto të shoqëruara në struktura mbajtëse pleksiglas të papërshtatshme, e varur në strukturën arkitektonike në mur.

Diagnostikimet shkencore jo dëmtuese

Para së të fillohej puna për restaurimin e ikonës u kryen një sërë testesh pastrimi paraprake, si dhe diagnostikimi jo dëmtues me anë të analizave të shtresës përgatitore dhe të pigmenteve me ED-XRF për njohjen e elementeve kimike, analizave të shtresës së vernikut, njohjen e teknikave të përdorura, diferencimin dhe individualizimin e ripiktu-

DO NOT COPY



foto 3



foto 4



foto 5



foto 6



foto 7

rimeve me UV (Ultraviolet), vëzhgimin diagnostik të ndarjes stratigrafike, fotografitë e ikonës me dritë anësore për mënyrat e ekzekutimit, si dhe hartimin e dokumentacionit grafik (shih dokumentacionin grafik) dhe fotografik para ndërhyrjes restauruese (përballë e mbrapa). Në fillim të ndërhyrjes restauruese lindi nevoja e njohjes sa më të mirë të veprës. Për këtë arsye u kryen diagnostikime jo dëmtuese për veprën.

DO NOT COPY



Testet paraprake



Teknika e ekzekutimit

DO NOT COPY



Gjendja e konservimit



Ndërhyrjet e mëparshme

Për të kuptuar teknikat e ekzekutimit, por dhe dëmtimet që kishte ikona në sipërfaqen e saj u kryen fotografitë me dritën anësore ku evidentuam inçizimet, stampimet në reliev dhe dëmtimet e shtresës përgatitore e të pelikulit piktorik. Për të evidentuar pjesët e ripikturuara shtresat e vernikut, sondazhet e kryera, abrazionet e ngjyrës në përgjithësi, ndërhyrjet e mëparshme u proçedua me anë të fotografimit me Floureshencën Ultraviolet. Nga ky diagnostikim kuptuam qartë pjesët e ndërhyrjeve të mëparshme dhe ripikturimet për të bërë kështu ndarjen me pigmentet origjinale, kjo për të qenë sa më të kujdesshëm në ndërhyrjen restauruese. Gjithashtu për arsye studimore, për të vërtetuar autenticitetin e veprës, si dhe ndryshimet që autori mund të ketë kryer në disenjon përgatitore ose ndryshimet në hedhjen e ngjyrave bazë pa shtresat e krijuara më vonë përdorëm Rifletografinë Infra të kuqe. Gjithashtu u krye dhe fotografimi me dritë normale për evidentimin e gjendjes konservuese.

Verifikimi dhe studimi i seksioneve stratigrafike kërkoi marrjen e dy kampioneve nga zona të

ndryshme të pikturës të paprekura nga ndërhyrjet e mëparshme restauruese. (Shih fotot) Kampioni i marrë në sfondin e artë në të majtë të fronit ku qëndron i ulur Krishti, dha një përshkrim të seksionit duke proçeduar nga poshtë dhe në shtresat më të brendshme duke u ngjitur lart në shtresat e jashtme. Në përgatitjen e bardhë e përbërë nga dy shtresa materialesh rezultoi një film i hollë ngjitësi me përbërje proteinash që duken më të erreta dhe blu në imazhin me UV(ultraviolet). Kjo përbën bazën për një shtresë argjendi që pastaj vjen me një film të hollë të ngjyrës portokalli, që nuk ngjason si bolo por si misione e ngjyrosur. Misioni i ngjyrosur është përdorur si bazë dhe njëkohësisht ngjitës për shtresën finale të arit që dukej e konsumuar Kampioni i marrë në veshjen blu të Shën Mërisë ka një përshkrim nga poshtë lart të seksionit. Edhe në këtë kampion përgatitja përbëhet nga dy shtresa. Shtresa e dytë ka floureshencë të verdhë, që bëri të mendonim për prezencën e një sasie të vogël të materialeve vajore në brendësi. Filmi i hollë i ngjyrës blu kompozohet nga një masë e bardhë që është e bardhë plumbi, brenda së cilës ka pjesë të vogla bluje. Përsa i përket elementeve përbërës të pigmenteve u përdorën analizat me metodën e ED-XRF metode jo dëmtuese për ikonën. Identifikimi i pigmenteve është i lidhur me veprat e artit dhe ka rëndësi të madhe për historinë e artit dhe për restaurimin e objekteve. Njohja e këtyre materialeve të përdorura hedh dritë mbi origjinën e pikturës, ndihmon në datimin e veprës në mënyrën se si ka punuar autori nëpërmjet tavalozës së tij të ngjyrave dhe si përfundim për të dhënë rezultate të rëndësishme në zgjedhjen e materialeve moderne, që përdoren në ndërhyrjet restauruese.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Kampioni i marrë në sfondin e artë



Pamje e ikonës me pikën ku është marrë prelievi



Pjesë të veçanta në prelievin makro fotografi



Seksioni stratigrafik

Kampioni i marrë në veshjen blu të Shën Mërise



Pamje e ikonës me pikën ku është marrë prelievi



Pjesë të veçanta në prelievin makro fotografi



Seksioni stratigrafik

DO NOT COPY

Në ikonën "DEISIS" u kryen 17 analiza në Floureshenza X duke prezantuar pigmente të ndryshme të veprës. Pikat e sondazheve të pigmenteve pasqyrohen në foton më poshtë. Analizat dhanë rezultatet e pasqyruara në tabelë. Nga këto analiza u konstatua që: Përgatitja është xheso dhe e bardhë plumbi. Ngjyrat e përdorura janë e bardha me bazë plumbi, e kuqe me bazë cinabrio, jeshilja me bazë toke si dhe pigmente me bazë bakri, bluja me bazë bakri, e verdha dhe ngjyra e mishit me bazë toke, kurse për pjesët e errëta, artisti ka përdorur terra d'ombra (dherat e errët). Fleta e arit është e përbërë nga ar dhe argjend. Në pjesën e pasme të



Pikate matjeve me Fluoreshenca X

Nº PIKAVE	BAZA E NGJYRES	ELEMENTET KIMIKE	PIGMENTET QE PARAQITEN
1	ARI	Ca, Fe, Au, Sr, Pb, Ag	Xheso, e bardhe plumbi, lidhja e arit me argjendit
2	BLU	Ca, Fe, Cu, Pb, Sr	Xheso, pigment me baze bakri, e bardhe plumbi
3	KUQE	Ca, Hg Pb, Sr	Xheso, cinabro, biacca
4	JESHILE	Ca, Fe, Cu, Hg, Pb, Sr	Xheso, pigment me baze hekuri (jeshile dhe oker toke), pigment me baze bakri, cinabro, biacca
5	BARDHE	Pb	Biacca (e bardhe plumbi)
6	VERDHE	Fe, Pb	Okra, biacca
7	NGJYRA E MISHIT	Ca, Fe, Pb, Sr	Xheso, okra, biacca
8	JESHILE	Ca, Fe, Cu, Pb, Sr	Xheso, pigment me baze hekuri (jeshile toke), pigment me baze bakri, biacca
9	E ERRET	Ca, Mn, Fe, Pb, Au, Sr, Ag	Xheso, e erret toke, biacca, lidhja e arit me argjendin
10	PREGATITJA	Ca, Fe, Pb, Sr	Xheso, okra, biacca
11	KUQE	Ca, Sr, Fe, Hg	Xheso, okra, cinabro
12	ARI	Ca, Fe, Sr, Au, Pb, Ag	Xheso, okra, biacca, lidhja e arit me argjendin
13	BLU	Ca, Fe, Cu, Pb, Sr	Xheso, okra, pigment me baze bakri, biacca
14	KUQE	Ca, Sr, Hg	Xheso, cinabro
15	KUQE	Ca, Sr, Hg	Xheso, cinabro
16	KUQE	Ca, Sr, Hg	Xheso, cinabro
17	BLU - JESHILE (RETRO)	Ca, Ba, Cr, Zn	Pigmente moderne me baze kromi, barite e bardhe zinku

DO NOT COPY

suportit është prezente prania e pigmenteve modern me bazë përbërësish kromi, barite dhe të bardhë zinku. Gjejmë rastin të falenderojmë për ndihmën në kryerjen e këtyre diagnostikimeve specialistët italianë Davide Busolari, Stefano Volpin dhe Stefano Ridolfi.

Testet paraprake të pastrimit

Testet paraprake të pastrimit për ndërhyrjen restauruese në ikonë filluan me Testin e Solubilitetit (tretshmërisë) Wolbers – Cremonesi për pastrimin e shtresës së vernikut. Ky test përbëhet nga përzierja e ligroinës, açetonit dhe ethanolit (alkoolit etilik). Ligroina përdoret në dy seri përzierjesh. Seria LA ka nëntë përzierje ligroine dhe aceton. Seria LE ka nëntë përzierje ligroine dhe ethanol. Seria AE ka tre përzierje të ligroinës dhe açetonit. Testi LA u aplikua në zona dhe pigmente të ndryshme si tek e kuqja, bluja, jeshilja por dhe në shtresën e artë. Testi fillon të reagojë ndërmjet fd77 dhe fd47. Përveç shtratit të vernikut duket që kishim praninë e ndonjë fiksativi ose përforcuesi të ngjyrës ndoshta vaj lini. Niveli optimal dukej se ishte ndërmjet përzierjeve LA 7 fd62 dhe LA 8 fd 57.

Duke konsideruar dhe prezencën e një fiksativi të alternuar poshtë shtresës së vernikut ne proçeduam në disa teste të tjera pastrimi të cilat do t'i shpjegojmë më poshtë.

1. Resin Soaps DCA-TEA ph 8. 5 dha rezultat të mirë, por jo shumë të kënaqshëm.
2. Solvent Gels fd 47 larje në white spirit i cili pati rezultat të mirë, por rezultoi pak agresiv.
3. Emulsione Grassa Basica dhe Emulsione Grassa Acida duke i neutralizuar me white spirit dhe ligroina të cilat funksionojnë së bashku.
4. Emulsione Cerosa me shplarje ligroine

DO NOT COPY



Testi paraprak i pastrimit Wolbers - Cremonesi me LA

LIGROINA dhe ACETON	% NE VOLUME cc	Fd
L ligroina La1	Puro 90 - 10	
La2	80 - 20	
La3	70 - 30	
La4	60 - 40	77
La5	50 - 50	72
La6	40 - 60	67
La7	30 - 70	62
La8	20 - 80	57
La9	10 - 90	52
10 Aceton		47



Test me Emulsione Grasa



Test me Solvents Gels



Test me Resin Soaps

DO NOT COPY

Ndërhyrja restauruese

Në përfundim të këtyre testeve vendosëm të vazhdojme pastrimin me solucion të lirë në mënyrë mjaft të kujdesshme selektive, të kontrolluar dhe graduale pasi solucioni nuk vepronte në mënyrë agresive. Kjo sepse edhe sipërfaqja e pikturës ishte mjaft e dëmtuar, e gropëzuar e me krakle dhe n.q. s do të përdornim Solvent Gelin, ai do të depërtonte thellë duke vazhduar procesin dhe ne nuk do të mund ta neutralizonim shpejt. Për heqjen e mbetjeve të lidhësit organik vendosëm aplikimin e Emulsione Grassa Basica. Heqja e mbetjeve organike të kollës ose dyllit u krye me anë të pastrimit mekanik me bisturi. Gjithashtu edhe heqja e stukaturave të vjetra me bazë dylli u vendos të kryhet me anë të pastrimit mekanik me bisturi duke i zbutur më parë me white spirit. White spirit duke qenë një solvent me bazë organike apolare vepron mirë në materialet e përdorura në ndërhyrjet e mëparshme si dylli e pikimet e qirinjve. Para se të fillonim pastrimin kryem ringjitjen e shtratit përgatitor dhe pelikulit piktorik aty ku kishte shkëputje me suportin. Në fillim në zonën e shkëputur u krye mbrojtja e shtresës së pikturës me velinaturë ku u proçedua me letër japoneze dhe Kluçel G 4% ne Ethanol. Pastaj duke injektuar me shumë kujdes me anë të shiringës Alkool+H2O si veikolant kryen procesin e hapjes së rrugëve për ngjitësin që në këtë rast ishte Plexisol P550 20% me açeton. Më pas u krye mikro aspirimi i depozitave sipërfaqësore jo të qëndrueshme me një penel të butë dhe aspirator në presion të ulët. Gjithashtu për heqjen e depozitimeve sipërfaqësore pak më të qëndrueshme, përdorëm një solucion solvent ujor Tween 20 2% në H2O duke pastruar me tampon pambuku sipërfaqen e pikturës. Të njëjtat proçedura u ndoqën edhe për shtresën e arit. Pasi u kryen të gjitha këto operacione të kujdesshme puna vazhdoi intensivisht për pastrimin e ikonës me solucion të lirë me LA fd 62 dhe LA fd 57, pasi siç e thamë edhe më lart vepron në mënyrë selektive dhe të ngadaltë. Kujdesi ishte maksimal që të mos prekej shtresa e ngjyrës dhe të ruhej patina origjinale që ikona ka krijuar në kohë. Rezultatet ishin befasuese sidomos në pjesën e djegur të ikonës ku dolën në dukje pjesë të mbuluara nga verniku dhe fiksativi i alteruar. Rikuperimi i një portreti ishte mjaft interesant (foto 8 - 9), ashtu si dhe pastrimi i të gjithë sipërfaqes në të njëjtin nivel e kontrolluar me anë të dritës Wood.

Ky pastrim uniform i jep veprës vlera të larta estetike duke krijuar një uniformitet visual. Gjatë ndërhyrjeve të mëparshme restauruese në ikonë ishin përdorur për mbushjen e lakunave stuko me bazë dylli në një sipërfaqe të konsiderueshme të saj, teknika këto të përdorura rëndom nga shkollat e lindjes të cilat padyshim kanë influencuar në ndërhyrjet konservuese – restauruese në Shqipëri. U vendos heqja e tyre duke i zbutur herë pas here me white spirit dhe me shumë kujdes me pastrim mekanik me bisturi. Në përfundim të këtij procesi u krijuan shumë lakuna të thellësisë që arrinin deri në suportin e drurit. Këto lakuna rezultuan të madhësive të ndryshme. Ato me sipërfaqe më të madhe ne vendosëm t'i lëmë në suport sipërfaqe dru dhe t'i integrojmë me velatura të ngjyrave aquarel. Përsa i përket lakunave me dimensione më të vogla ato u stukuan me Gesso di Bologna me Colla di Coniglio (1: 10vv). Në momentin kur këto stukatura u thanë, u trajtuan me bisturi dhe sfungjer gjerman për t'i sjellë në një sipëfaqe të njëjtë me pelikulin piktorik të ikonës. Për ta përgatitur veprën për ndërhyrjen e integrimit piktorik ne bëmë dhe një pastrim tjetër mjaft sipërfaqësor e të lehtë për heqjen e pluhurave të krijuara nga proçedimet e mësipërme. Ky pastrim u krye me tampon pambuku me white spirit.

DO NOT COPY



foto 8. Para restaurimit



foto 9. Pas restaurimit

Pra, tani ikona "DEISIS" paraqitej e pastruar, por me shumë abrazione të sipërfaqes piktorike dhe shumë stukime të bardha të shpërndara kudo. Për integrimin piktorik u përdorën ngjyra aquarel Winsor & Newton. Ndërhyrja në abrazionet e pelikulit piktorik konsistoi në uljen e toneve të çelta që e copëtonin pikturën në aspektin estetik e artistik. Ndërsa në pjesët e stukuara përdorëm teknikën e Tratexhios sipas shkollës së Romës. Kjo ndërhyrje rezultoi mbreslënëse duke sjellë një unifikim koloristik në tërësinë e ikonës ndërhyrje për të cilën dukej se kish patur shumë nevojë (shih fotot). Qëndrimi estetik mbi plotësimin e tërësisë së veprës për të integruar e rikuperuar pjesë të ndryshme sfondi ose figurash u krye duke diferencuar ndërhyrjet në plotësimin e imazhit aty ku format dhe vazhdimi i tyre ishin të qarta dhe lënien neutro aty ku nuk ishim të bindur për arsye të mungesës së plotë të një dokumentacioni të mëparshëm fotografik dhe grafik. Pas përfundimit të integrimit piktorik u krye dhënia e vernikut (faza e ndërmjetme) me anë të një peneli me rezinë akrilike ketonike (Vernice Tableax Surfin Gloss - Lefrange). Mënjëherë pas tharjes së vernikut u përdorën velatura të ngjyrave të vernikut për rifiniturat kromatike dhe në përfundim të këtij procesi piktura u vernikos përsëri me (Vernice Retouscher Surfin Gloss - Lefrange), por këtë radhë në formë spraiti. Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe trajtimit të pjesës së prapme (suportit te drurit). Suporti i drurit u pastrua fillimisht me mikro aspirim me presion të ulët duke u ndihmuar nga një penel i butë. Pas pastrimit të depozitimeve sipëfaqësore u krye edhe disifektimi

DO NOT COPY



i pjesës së pasme me anë të sistemit ANOSIA, që konsiston në heqjen e oksigjenit nga ikona duke sjellë kështu ngordhjen e insekteve ksilofage. Pastrimi i sipërfaqes së suportit të drurit vazhdoi me heqjen e depozitimeve më të qëndrueshme. Ky proces u krye duke aplikuar teknikën e kompresave, tepër të shpejta me letra klinex dhe ujë të ngrohtë sa për të zbutur papastërtitë në sipërfaqen e drurit (foto 10). Më pas në mënyrë më të kujdesshme dhe selektive u pastrua dhe me tampon pambuku të njomur pak me ujë të ngrohtë.

Ngjyra jeshile në pjesën fundore rezultoi mjaft rezistente dhe e inglobuar me suportin. Për këtë arsye vendosëm të ndërhyjmë me një përzierje Aceton + Ethanol AE fd 41. 5 duke u ndihmuar dhe nga bisturia. Procesi i pastrimit u krye pa dëmtuar disa vizatime me karbon, duke i trajtuar në këtë mënyrë si pjesë e historisë së kësaj ikone. Në fund u krye edhe konsolidimi i pjesëve më të degraduara duke aplikuar me penel Paraloid B72 2% në Dowanol. U përdor Dowanol dhe jo Açeton ose MEK për arsye të avullimit më të ngadaltë të tij duke i dhënë mundësi Paraloidit të depërtojë në thellësi

Ky proces u krye 3 – 4 herë sipas gjendjes së degradimit të drurit. Të gjitha ndërhyrjet gjatë restaurimit u shoqëruan me një dokumentacion të bollshëm e të hollësishëm grafik dhe fotografik përballë dhe prapa veprës. Edhe në fund kur ishte përfunduar ndërhyrja, u krye dokumentacioni fotografik final i cili pasqyron me së miri punën e kryer dhe diferencën me gjendjen fillestare kur ikona erdhi në laborator.

Ikona "DEISIS" gjendet tani e ekspozuar në pavionin e artit mesjetar në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë e restauruar me teknikat më të fundit të restaurimit bashkëkohor por këto ndërhyrje do të rezultonin të padobishme dhe të mangëta në rast së në muze nuk do të krijohen kushte të mira për ruajtjen e saj si p.sh. krijimi i një temperaturë konstante apo një ndriçim më estetik dhe brenda parametrave termik. Në fund të këtij procesi studimor dhe restaurues, shprehim shqetësimin tonë për gjendjen në të cilën ndodhen ikonat në fondin e Muzeut Historik Kombëtar dhe mendojmë që patjetër duhet të vazhdojë puna e nisur dhe me pjesën tjetër të ikonave si pjesë e çmuar e thesarit të monumenteve tona të artit. ■

DO NOT COPY



Para restaurimit



Gjatë restaurimit



Pas restaurimit



Para restaurimit



Gjatë restaurimit



Pas restaurimit



Para restaurimit



Gjatë restaurimit



Pas restaurimit

DO NOT COPY



foto nga puna restauruese



foto 10



Para restaurimit



Gjatë restaurimit



Pas restaurimit

Study and Restoring of DEISIS Icon

Gentian Vokopola and Adrian Çene

DO NOT COPY

During the year 2009, at the Laboratory of Conservation and Restoration Centre for the Culture Monuments, in the Institute of Culture Monuments,were restored a number of icons and between them was "DEISIS" Icon. This icon belong to the Medieveal Art Pavillion at the National Historic Museum, with the number 3688/MHK, and is taken from the Shen Koll Toshkez Church at Lushnja disrict.

The first conception when is observed the "DEISIS" icon on the supervision for compositional surface of the painting where are draw their subjects is based at the dividing concept, because the iconographs at their work of arts are based the cube, pyramid and sphere concept. "DEISIS" icon is composed at two symmetrical square separated by horizontal axle.

Main part of the painting at "DEISIS" icon is at the centre where is Christ sitting in Pantokrator version, but the two other personages Saint Maria and Johan Baptize are standing on both sides in a symmetrical way because they are the closest personages of him. The base square is divided in two equal parts where painted saint pictures are, alltogether 18.

Horizontal axle is composed by bust images. This icon stands during the times because has a high artistic interpretation in both aspects artistical and liturgical. Liturgical interpretation shows a hierarchy establishement by respecting importance of personages on their relations and also interprets in the most beatiful way the splendor of the spirit world by merge and unifies them in a most artistical virtuosity within the Byzantine Art concepts.

The icon according to the artistical treatments has lots of painting techniques, coloration and rhythms richness. The author is follower of the Berati School when are analyzed the place where is found, the realisation period, painting and used techniques, furthermore he is the pursuer of Onufri, Nikolla Onufri and Onufer Qiprioti, he is the predecessor of Grabovar painters represented by (Katrot).

"DEISIS" Icon according to the conservation statement was noticed that by a typological side is a unique masterwork. Icon on the most part of it was burned. There were some pocmarks at its surphace, the wodden pictureframe is missing, surphace static deposits, and separation of the pictorial layer and remain of many waxen types of stucco and all of these were as result of prevoius restoring intervention.

Several scientific diagnosticians like slippery UV fluorescence light, infra-red equipement were done before restoring intervention. There were done 17 analyses with ED-XRF to deteremine the colour cemical contend and the represented pigments. Various clean perparatory tests with WOLBERS-KREMONESI check were conducted to remove the

varnish layer, but the results give only LA 7 FD 62 and LA 8 fd57.

Icon was cleaned with solution because it has an effect on in selective and gradual way. Removal of old waxen stucooes was done in mechanically way with scalpel. Sticking was done with Plexisol P 550 20% in acetone. Waxen was done with gesso di Bologna and kola di konilio.

Trategio technique according to the Roman school was used for the pictorial integration structure at the entire icon and intervention was done to reduce tones for creating the uniformity at the icon on the aesthetically base.

Icon integration was done with aquarelle Winsor & Newton and after that for the chromatic treatment was a used varnish coating. The process ended with the varnishing of the painting surface with Retucher Gloss Lefrang trademark varnish. Special attention was dedicated at wooded picture frame and it was disinfection with ANOSIA system.

Cleaning of Icon surface was done with cotton tampons and fomentation, consolidation of the most degraded was done with Paraloid B 72 with 2% Dowanol.

Graphical and photographical documentation accompanied all interventions.

Result of entire restoration was regaining of the all missing values for this icon.

After this restoring and analytic process we express our concernments for the situation which are Icons at Historic National Museum Pavilion and we think that the work must continue certainly with the other remain part of Icons because they are part of our monument treasury. ■



Pas restaurimit



Pas restaurimit



Pas restaurimit

DO NOT COPY

DO NOT COPY

MOMENT RESTAURIMI NE KISHEN "SHËN TRIADHA" BERAT

ERVIN PANIDHA

DO NOT COPY

Qyteti i Beratit tashmë pjesë e fondit të pasurive trashëgimi botërore, shprehet dhe në arkitekturën e saj me një larmi ndikimesh, të cilat krijojnë padyshim një mozaik vlerash që vijnë deri sot dhe si pasojë e një vullneti komunitar të kthjellët dhe kozmopolit të qytetarëve të saj. fig. 1 fig. 2

Kalaja, është monumenti më antik, me një sipërfaqe 9. 6 ha, që ngrihet në një kodër prej 187 metra, e ribërë nga Mëhilli i Engjëll Komneno e pastaj, në vitin 400, nga venerianët. Ndodhet në pjesën e sipërme të qytetit dhe ka mure të larta rrethuese të ndara nga 24 kulla të formave dhe dimensioneve të ndryshme, të ndërtuara në pe-



fig 3

DO NOT COPY

riudha të ndryshme kohore. (fig.3)

Ndërmjet ndërtimeve më të rëndësishme midis shekullit VII-XV janë tri kisha bizantine të ruajtura mirë: kisha e Shën Mërisë, kisha e Vllahernës dhe kisha e Shën Triadhës. Qyteti ka qenë një qendër e rëndësishme kishtare. Ka një numër të madh kishash (42) të ndërtuara në brendësi të kështjellës. Objekti i cili përbën dhe temën e studimit dhe propozimeve është kisha e Shën Triadhës me vendndodhje në lagjen kala të Beratit.

Nga pikëpamja e vendndodhjes, kisha e Shën Triadhës pozicionohet në ekstremin jug-perëndimor të lagjes Kala, ngritur në shpatin e një kodre shkëmbore, rreth 40 m larg prej murit perëndimor dhe 30m larg prej murit jugor.(fig. 4, 5)



fig 5



fig 4

DO NOT COPY

Kisha e Shën Triadhës pas restaurimit (1972)

Kisha e Shën Triadhës është një kishë shumë e vogël në Berat. Si kishë flitet të jetë e shekullit të VII. Si emër Triadha = Trini, vjen nga greqishtja dhe thuhet që është ndryshuar kur Shën Kozmai (për të cilin mendohet se është varrosur diku andej rrotull në Vokopol) ka ardhur për të penguar kthimin nga Osmanët. Prandaj dhe para emrit Triadhë do të ketë pasur një emër tjetër, por dihet që shumë emërtime në kohën kur erdhi Shën Kozmai u ndryshuan dhe humbën. Ajo që ka karakteristike kjo Kishë, është se atje janë gjetur 7 PALË KODIKË të periudhave nga më të ndryshmet, dhe diku afër është gjetur dhe mbishkrimi M. K, pra MIHAL KOMNENI, një nga pasanikët dhe njerëzit më të shquar për kulturën e tyre që ka pasur Perandoria Bizantine në atë kohë. Thuhet që pala e shtatë e kodikëve është bërë në kohën e tij. (fig.6, 7, 8)

Kodikët kanë qenë pre e pushtimeve. Turqit, gjermanët, Serbët dhe Grekët po ashtu kanë dashur t'i





fig 6/ fig 7 Kodikë të zbuluar në kishat e Beratit



fig 8

marrin ato, gjithashtu dhe Italianët që erdhën arritën deri atje, kanë mbledhur gjithë pleqtë e Beratit dhe anëtarët e Sinodid dhe i morën me të mire për të arritur që t'i gjenin këto kodikë. Ato janë ruajtur me jetën e pleqve të Beratit ndër shekuj. Vetëm një person e dinte të vërtetën se ku ndodheshin dhe zakonisht para se të vdiste, ai ia kalonte një plaku tjetër. Të tjerët që ishin në këshill dinin me përafërsi ku ndodheshin, por jo vendin e caktuar.

Kur Fan Noli shpalli autoqefalinë, të gjithë kryepleqtë e Beratit dhe anëtarët e Sinodid patën një mbledhje që cilësohet si një nga takimet më emocionuese në historinë e kombit tonë. Aty për herë të parë ai i pa dhe kodikët e Kishës së Triadhës, që më pas iu dorëzuan pushtetit komunist. Një nga arsyet që kodikët u dorëzuan, ishte se pergamenët po fillonin të kalbeshin dhe nuk mund të rrinin më atje. Megjithatë kjo u cilësua si një nga gjestet më patriotike që ortodoksët shqiptarë kanë bërë ndonjëherë, ruajtja ndër shekuj dhe më pas dorëzimi i këtyre kodikëve. Në periudhën e regjimit komunist, çekët u autorizuan të bënin gërmime dhe më vonë, kodikët u çuan për restaurim në Kinë, ku më pas dhe u kthyen. (fig. 32, 33) Përsa i përket kishës dhe ndërhyrjeve restauruese në të, situata e sotme e saj është ajo e pas restaurimit të viteve 1970-1972, e kryer prej specialistëve të IMK-së, me drejtues teknik, ark. Aleksandër Meksi, të cilat kishin për qëllim ndërhyrjen dhe evidentimin e tipologjisë dhe stilistikës bizantine.

Ndërsa në ambientet e interierit puna restauruese u përqendrua në konsolidimin e përgjithshëm të tesutit (shtresës) piktorike të afreskut të saj, (atje ku kish mbetur) dhe hidroizolimin e plotë të saj.



fig 32



fig 33

DO NOT COPY



fig 9

Në ditët e sotme kjo kishë vjen më shumë si një vepër monumentale me karakter didaktik, pasi prej kohësh funksionet e saj religjioze janë pjesë e arshivës apo pjesë sporadike e këtyre ngjarjeve, gjatë harkut kohor të një viti (dy deri tri evente).

Aplikimi dhe pranimi i Beratit si pasuri e trashëgimisë botërore, ka shtuar interesin në njohjen, monitorimin dhe nevojën e ndërhyrjeve të mundshme restauruese në këtë sit.

Në këtë kontekst, ky sit përbën dhe një prej objekteve të përzgjedhura (qendra kombëtare e restaurimit & UNESCO) për studimin dhe hartimin e një projekti restaurues dhe vitalizues të këtij siti.

Projekti parashikon një shtrirje jo vetëm në planin e ngushtë të konservimit apo konsolidimit por, qëllimi i tij është dhe rijetëzimi i ambienteve të tij brenda dhe jashtë territorit.

E pamundur që të mbërrinim në një interpretim "a l'identique" të strukturës origjinale të ikonostasit (mungesa e plotë e materialit pamor, foto, skica, de-

DO NOT COPY

DO NOT COPY



fig 11



fig 10

taje, mungesa e artizanëve të trajnuar dhe njohës të liturgjisë dhe simbolikës ortodokse, sikundër dhe "zhveshja" thuajse e plotë nga aktiviteti normal liturgjik i këtij objekti) nuk e bënte praktikisht të mundur realizimin me sukses të një strukture të tillë, pa marrë në këtë rast në konsideratë dhe realizimin e dështuar të saj që as më pak e as më shumë do të injoronte dhe më shumë interesin e studiuesit dhe vizitorit. (fig. 10, 11) Për këtë qëllim u propozua ndërhyrja për realizimin e një strukture të re të ICONOSTASIT, tashmë të munguar të saj në një koncept "x'nuovo", koncept që për bazë i referohet riversibilitetit të strukturës, impaktit minimal të saj në sit, respektimit të ndjeshmërisë religjioze ortodokse, si dhe dëshmisë së zhvillimit material dhe botëkuptimor të kohës.

U propozuan disa variante zgjidhjesh, por vetëm dy raste u përzgjodhën për diskutim dhe njëri prej tyre u konsiderua dhe projekti final i ICONOSTASIT të kishës së Shën Triadhës: Ikonostasi skulpturor "me tuba". (fig. 12, 13, 14, 15)

DO NOT COPY



fig 12



fig 14



fig 13



fig 15

DO NOT COPY



fig 16



fig 17

Qëllimi i projektit, është adaptimi i ish-strukturës së ikonostasit në një fokus sa bashkëkohor aq dhe provokativ.

Struktura e dizenjuar synon mishërimin volumetrik të ikonostasit të munguar në një vështrim arkitektonik, por shprehur nëpërmjet një gjuhe me karakter të spikatur skulpturor dhe meditativ.

Simbolika e zgjedhur është e thjeshtë: shumatorja e vertikalitetit të tubave së bashku, tentojnë të krijojnë iluzionin e një orkestre me perceptim mistik që në një mënyrë naive çlirohet nga një induksion instiktiv i rregullit natyror, i cili lind prej tokës për të takuar qiellin..(parajsa) (fig.16,17) Elementët përbërës të kësaj strukture janë ngushtësisht të përzgjedhur për cilësitë e tyre fizike, shprehëse, praktike dhe ekonomike. Hekuri, druri, çeliku janë dhe aktorët protagonistë të hijes së saj.

Lamat e hekurit me spesor 10 mm dhe gjerësi variabël bashkohen sipas një plani horizontal (në përputhje me detajin) duke u lidhur ndërmjet tyre me saldim. Struktura e përftuar mbështetet mbi rregullatorë të nivelimit të terrenit, që do t'i mundësojnë kësaj të fundit të tarohet (nivelohet) mbi dyshemenë e presbiteriumit.

Mbi lamat e përbëra saldohen tubat primarë(6 copë) me seksion 100 mm me binarët që kanë qafuar zinxhirin lidhës të dy kolonave për të përftuar kështu shtangësinë (stabilitetin) e nevojshëm për të pasuar me saldimin në vertikalitet (në mënyrë të balancuar) të tubave deko.

Hapi i radhës është instalimi i mekanizmit rrëshqitës të portës, që sikundër e gjithë struktura është një shprehje radikale kompozicionale, por e bazuar në matricën e portës bizantine të ikonostasit. (fig. 18)

DO NOT COPY



fig 18



fig 19

Telajoja e brendshme e saj është e përbërë prej një plani të rrafshët të drurit (rrobull, frashër, gështenjë, lis) e kornizuar si finiturë nga një strukturë prej profili të hekurit për t'u zgjatuar në vertikalitet dhe lidhur me mekanizmin rrëshqitës në tirant (purgatori).

Binarët e hekurit në formë "ZETA" dhe "U" që qafojnë tirantin lidhës të kolonave supozohet të jenë të lidhura me saldim me tubot primarë dhe kështu të mund të kryejnë funksionin e tyre pa shkaktuar asnjë impakt në sjelljen strukturale të tirantit.

Hapi pasues është lyerja e tubove me bojë (të çertifikuar nga inst. Përgjegjëse në fushën e restaurimit) të artë (kod absolute). (fig. 19, 20) Projekti përfundimtar i ikonostasit është përpjekja e fundit për realizimin e një produkti i cili në përmbajtjen shpirtërore të tij sikundër dhe komponentët e zgjedhur përbërës të strukturës, të mund të plotësojë pritshmërinë dhe konceptin thellësisht konservator dhe racional të besimtarëve ortodoksë dhe nga pikëpamja strukturale të mund të ushtrojë impakt minimal në strukturën ku do të mbështetet apo fiksohet. (fig. 21, 22) Ideja bazë e tij starton duke konsideruar së pari përfshirjen e sa më pak tipave të materialeve.

Kështu në traditën e ndërtimit të ikonostasit prej



fig 20

mjeshtrave të kohës, ikonostasi klasik në tërësi përbëhet prej: strukturës bazë suportuese, e cila zakonisht përbëhet prej një varg kolonash prej druri të renditura në ritëm të rregullt të dekoruara përgjithësisht me gdhendje të motiveve floreale dhe të lidhura ndërmjet tyre me trarë druri përforcues të cilët gjithashtu dekoroheshin duke u gdhendur. E

DO NOT COPY



fig 21



fig 22

gjithë kjo strukturë mbështetej në dysheme dhe fiksohej në pilastrat ndarës të presbiteriumit me naosin. Me konsolidimin e kësaj strukture procedohej me vendosjen e telajove të drurit, të cilat punoheshin më parë apo pikturoheshin në vend me motive karakteristike liturgjike të besimit ortodoks. (fig. 23, 24)



fig 23



fig 24

DO NOT COPY



fig 25



fig 26

Mungesa e plotë lidhur me informacionet për destinacionin e ikonostasit origjinal, apo dhe rilevimit të munguar të tij, e kufizoi punën tonë në informacionin dhe referimin e kryer nga foto arkiva e Institutit të Monumenteve bërë gjatë ndërhyrjes së fundit restauruese të vitit 1970-71, nëpërmjet imazheve pjesore që tregonin prezencën e ikonostasit dhe llampadarit që zbriste vertikalisht me drejtim nga qendra e kupolës drejt dyshemesë së naosit.

Struktura e propozuar e ikonostasit të ri të kishës së Shën Triadhës përfshin përdorimin e drurit, çelikut dhe bakrit si materiale bazë.

Tërësia e saj krijon një ansambël në një plan (strukturë) të vetëm bazë, i cili nuk ndërpritet gjatë gjithë gjerësisë së saj. (fig. 25, 26) Lidhja e kësaj strukture me impiantin e ndriçimit mundëson dhe pajisjen me ndriçim të brezit të ikonave të ekspozuara, në panel.

Struktura ngrihet në këmbë bazuar në tri pika të stabilitetit,

- mbështetja në dysheme nëpërmjet këmbëve me rregullatorë të nivelit në vertikalitet ;
- mekanizmi i lidhjes së strukturës dhe konsolidimi i saj me pilastrat ;
- stabilizimi i strukturës nëpërmjet mekanizmit karikues kapur në skajet e tirantit lidhës të dy pilastrave.

Struktura suportuese bazë përbëhet tërësisht prej profileve të hekurit të lidhura ndërmjet tyre nëpër-

DO NOT COPY



fig 27



fig 28

mjet saldimit (kolonat dhe trarët lidhës). Kolonat në bazë janë të pajisura (salduar) me tapë, e cila është e forcuar dhe vjaskuar në mënyrë që të suportohet nga rregullatori në vertikalitet (i cili do të nivelojë atë, një herë që struktura është ngritur në këmbë). Kontakti i këtyre këmbëve me dyshemenë është i përqendruar, por i pamundur për të rezultuar me ndonjë frakturë të mundshme të dyshemesë.

Pasi struktura është ngritur në vertikalitet ajo lidhet me pilastrat (në lartësi 100 cm nga dyshemeja) nëpërmjet një mekanizmi të konceptuar posaçërisht dhe që tenton të ushtrojë një impakt sa më të papërfillshëm në dëm të veshjes së pilastrit dhe strukturës së saj.(fig. 27, 28) Mekanizmi përbëhet prej: dy cernierash, bërë prej çeliku me spesor jo më pak se 15 mm me gjatësi 30 cm dhe gjerësi 18 cm, faqet e brendshme të saj janë të veshura me dru me spesor 30 mm me rrjetë kubesh me një ritëm; 20 x 20 x 20 x20 x20 mm, në horizontalitet dhe vertikalitet, të cilat nga ana e tyre do të rezultojnë në kontakt mekanik me sipërfaqen e pilastrit. Kontakti skajor i kubeve të drurit, presupozohet të përftojë një efiçencë mbështetëse më rezultative dhe impakt të kufizuar në pilastër sikundër ventilimin. I vazhdueshëm në thellësi të sipërfaqes së brendshme të cernierës do krijojë kushte minimale për gjendje të diferencuar temperature, reaksioni të mundshëm mes materialeve apo përqëndrim të tensionit në një pikë të vetme të sipërfaqes. (fig. 29)

DO NOT COPY

Druri që propozohet për këtë rast duhet të jetë i butë (familje e bredhit, plepit) në mënyrë që gjatë karikimit të mekanizmit të mundësojë funksionim të diferencuar për çdo kub si një amortizator të diferencuar në mënyrë që të arrihet maksimalisht shpërndarja (distribuzioni) e sipërfaqes së kontaktit dhe suportimit të ngarkesës.

Zgjedhja e cernieres për kapjen në pilastra merr në konsideratë strukturën jo të rregullt të sipërfaqes së pilastrit dhe jo plotësisht ortogonale të këndeve të saj, përdorimi i cernieres presupozohet të kapërcejë këtë antikap duke pasur këtë fleksibilitet të rrotullimit të saj në kënd më të ngushtë apo të gjerë në drejtimin horizontal.

Tensionimi i cernierave realizohet nëpërmjet dy radhëve paralele kavosh çeliku me seksion 5 mm, që tensionohen në mënyrë të pavarur nëpërmjet regjistrave të karikimit, skajet e tyre përfundojnë me kavallota të cilat ankorohen në unaza metalike të salduara në strukturën me hekur të ikonostasit. Kavot pavarësisht tensionimit të pavarur ruajnë me pilastrin një largësi të lejueshme përgjatë gjithë perimetrit që siguron karikimin diferencial pa lejuar kontakt të detyruar të dorës (që tension nëpërmjet regjistrit) me sipërfaqen e pilastrit.

Gjithashtu struktura (në planin nga naosi te pilastri) nuk lejohet të ketë kontakt me pilastrin nëpërmjet një mekanizmi suplementar që funksionon pavarësisht nga ai i cernierave. Kështu nëpërmjet sustave në mes të këtij mekanizmi, tentohet shtytja reciproke në të dy kahet përkundrejt (pilastrit dhe strukturës së ikonostasit). Qëllimi i këtij mekanizmi synon mos kontaktin e strukturës mbështetëse me sipërfaqen e pilastrit pavarësisht forcës së ushtruar si rezultat i tensionimit të mekanizmit. (fig. 31)

Deri në këtë fazë objekti mbahet në vertikalitet. Për të arritur shtangësinë e strukturës së ikonostasit është e domosdoshme nxitja e një force që vepron horizontalisht me drejtim nga naosi. Kështu është konceptuar që nëpërmjet një mekanizmi të përbërë prej një qaforeje me lama metalike të salduar, të kapur në skajet e tirantit të mund të prodhojnë shtytje nëpërmjet karikuesave të pajisur me regjistrues drejt strukturës së ikonostasit deri në shtangësi dhe stabilizim të plotë të saj.

Me përfundimin e fazës së montimit të strukturës mbështetëse të ikonostasit, krijohet hapësira për montimin e paneleve përbërëse dhe dekoruese të ikonostasit.

Me montimin e lastrave (pllakave) të bakrit në strukturën mbështetëse, fillon dhe faza e dekorimit te ikonostasit, lastrat kanë një spesor të llogaritur prej 3 mm, dhe përgjatë gjatësive horizontale janë të kalandruara 90 gradë me qëllim mosdeformimin e saj. Është propozuar që lastrat e bakrit të mund të jenë të formuara mbase me simbolin e kryqit ortodoks në seri në konfiguracion të rregullt industrial. Përmasa e saj ruan një ritëm 2 x 2 x 2 x 2 x 2 x 2 cm. (fig.30)

Hapi pasues përbën dhe montimin në strukturë të sistemit të ndriçimit, i cili është konceptuar të jetë nëpërmjet tubave me gaz (neon) në seri. Vazhdimësia lineare e tyre do të sigurojë një fasho drite (me ngjyrë të ngrohtë) që do të bëjë të lexueshme në masë korrekte subjektin liturgjik të ikonave.

Me përfundimin e këtij operacioni montohen profilet metalike (inox) që do të shërbejnë si guidë për vendosjen në vend të ikonave. Guidat shoqërohen edhe nga një mekanizëm rregullator, i cili korrekton (nivelon) në vertikalitet kuotën e çdo ikone në mënyrë të pavarur.

Hapi pasues është montimi i lastrave horizontale

DO NOT COPY



fig 31



fig 29



fig 30

të drurit. Këto lastra me dimensione që variojnë në gjerësi prej 12-30 cm dhe gjerësi 35 mm përbëjnë dhe planin e fundit të montimit. Druri i propozuar është frashër, bredh, koto.

Realizimi i strukturës së Ikonostasit "final", në çdo rast parashikon një skenar të përkohshëm të ekzistencës së saj, në kuptim dhe dobi të evolucionit të pandalshëm material, teknologjik dhe mbi të gjitha atë shkencor, me qëllimin e vetëm dhe të shenjtë të konservimit të vlerave materiale dhe shpirtërore të trashëgimisë sonë. ■

SUMMARY

ERVIN PANIDHA

As regards the church and the restoratory interventions in it, the present situation is the post restauratory situation of the 1970-1972, done by the specialists of IMK , with ark. Aleksander Meksi as the technical director, whose scope was the intervention and evidencing of the bizantine style and tipology. The restoration work in the interiors was focused in the general consolidation of the pictoric layer of its fresco and it's full hidroisolation. Nowadays this church is considered more like a monumental art of didactic character, because since many years its religeous functions are part of the archive or taking place sporadically (once or twice per year). The application and acceptance of Berat as treasure of the world inheritance has increased the interest in knowing, monitoring and the need for possible restoratory interventions in this site. In this context, this site constitutes one of the chosen objects for studing and developing a restoration and revitalising project of this site. The project foresees its extension not only in the aspect of conservation or consolidation ,but its purpose is also the rivitalization of its interior and exterior space. Impossible to reach an interpretation a "l'identique" of the of iconostasi original structure (the total absence of the visual material , i.e. photo, manuscripts , details , and the absence of trained masters with knowledge in lithurgy and orthodhoks symbols, as well as the lack of lithurgical activity this object has), does not make possible realising sucessfully such structure, without taking into consideration that a non-proffesional realisation would furthermore cause the possible lost of interest of a researcher or visitor. For this purpose was proposed the intervention for realization of a new structure of ICONOSTASI which is now missing in a "x'nuovo" concept , which concept basically refers to the reversibility of the structure, its minimal impact on the site, respecting the orthodhoks religious sensibility , as well as the testimoniance of a material and conceptual development of the time being.

Several solution variants were proposed, but only two cases were chosen for discussion, one of which was considered the final project of ICONOSTASI of the Saint Trinity Church: Sculptural Iconostasi "with pipes" "The final"Iconostasi. Compositional description (sculptural iconostasii with pipes) The project purpose is adopting the former structure of iconostasi in a revolutionary as well as provocative focus. The designed structure intends to express the missing volumetry of iconostasi in an architectonic point of view but expressed through a language with sculptural and meditative character. The symbolism chosen is simple: the plurality of the pipes in vertical altogether gives the ilusion of an orchestra, with the mystic perception that in a naive way is released from an instictive induction of the natural rule, which is born from earth to meet the sky (the heavens) The elements composing this structure are closely chosen due to their physical, expressive, practical and economical features (qualities). Metal, Wood, steel are the protagonists of her beauty.

The steel width from 10 mm and variable width are

DO NOT COPY

DO NOT COPY

asssembled according to a horizontal plan (in accordance with the detail) connecting with each other by joist. The resulting structure is supported by regulators of level, which will allow the latter to livel (nivelohet) upon the presbiteriumit floor.

Upon steel joist primare(6 pieces) the primary pipes 100mm section with binary which embrace the connecting chain of the two colons to obtain the necesary stability to follow with vertical joist (in a balanced manner) of the deco pipes. The next step is installing the shifting mechanism of the door which is, as well as the whole structure, a radical compositional expression based on the matrix of the bysantine door of iconostasi. The internal layer is composed by a plane surface of wood shows as a finitures structure from steel profile to be streched in vertical and connected with a shifting mechanism in cable (purgatory). The steel beams in the shape of 'ZETA' and 'U' wich embraces the connecting cable of the columns are suposed to be connected with joist with the primary pipes so that they may perform their function without causing any impact in the structural behaviour of the steal cable. The next step is painting the pipes with gold paint (certified by the responsible Instututions in the restauration field) (absolute code). The final project of iconostasi is the final tentative of realizing a product which in its spiritual composition as well as in the components chosen for the structure, may fulfill the aspectatives and esentially conservative and rational of the orthodoks believers and from the structural point of view may have a minimal impact to the supporting structure where it will be fixed. The basic idea starts considering first of all involving a minimum of different kinds of materials. Ever since the construction of iconostasi by the masters of the time being, the clasic iconostasi in its entirely is composed by: the basic suporting structure, which is usually made of a plurality of wooden colons arranged in a regular rythm and generally decorated with floral motifs in wood and connectedbetween each other with supportive wooden beams which also were decorated by wood decorations. This whole structure laids upon the floor and was fixed on the dividing colomns of the presbiterium with naosin. After the consolidation of this structure it was proceeded with the putting of the wooden layer which were previously worked on or painted in place with characteristic lithurgical motifs of the orthodoks belief. The total absence of information regarding the destination of hte original iconostasi, or the missing rilevation of the same, limited our work in the information and reference made by the photo archive of the institute of monuments made during the last restoratory intervention during 1970-71, through partial images showing the presence of iconostasi and lampadar comming down vertically with direction from the center of the kupole down the floor of naos. The proposed structure of the new iconostasi of Saint Trinity Church includes using of wood, seel and coper as basic materials. Its entirety is asembled in a single plan (structure) which is not interrupted during its whole length. The connection of this structure with the of light net allows lightening the chain of ikons exposed, in panel. The structure raises based on three points of stability,

- suport on the ground through the foots with level regulators in verticality
- the connecting mechanism of the structure and its consolidation with pilastrat
- stabilizing the structure through the charging mechanism at the cabel spots tu the wood beam

The basic suporting base is made entarely of steel profiles connected with each other through joit (collomns and connecting beams). The contact of these feet with the floor is concentrated but imposssible to result with any possible fracture of the floor. After the structure is raised in verticallity it is connec-

ted with pilastrat (raising 100cm from the floor) through a mechanism concepted especially wich tents to have an inconsiderable impact for damaging the coating of the pilastrit and its structure. The mechanism is made of : two cernierash, made of steel with not les than 15mm me spesor and 30cm length and 18cm width, its internal elevation are coated with wood with 30mm of spesor with a net of cubes with a rythm of ; 20x20x20x20....x20mm, in horizontality and verticality. Which on their side will result in mechanical contact with the surface of collomns. The extremity contact of the wooden cubes is suposed to obtain a supporting eficense more resultative with limited impact on the pilaster as well as the continous ventilation in hte depth of the internal surface of the cernieres will create minimal conditions of diferentiated temperatures, reaction among materials or concentration of the tension in a single point of the surface. The wood proposed in this case must be soft so that during the charging of the mechanism it allows diferentiated functionality for each cube as a diferentiated suspension so that it is achieved maximal distribution of the contact surface and charge support. The choice of the joist for ancor at dhe colomns takes into consideration the irregular structure of the pilastri surface and not entirely ortogonal of its angles (corners), the usage of cerniere is suposed to overcame thi anticap having the fleksibility in turning in an angle in horizontal direction. Tensionimi i cernierave is realised through two lines of parallel steel cable with a section of 5mm, qe tensionohen indipendently through charging registers, cable regardless of the independent tension, keep an allowed distance with the pilastri along the whole perimeter allowing diferentiated charging without allowing hand contact. Until this phase the mechanism is maintained in verticality but necessary per shtangesi ne, ne lartesi.To achieve shtangesine e struktures se ikonostasit is neccesary the incenting a force acting horizontally with in the naos direction, it is so concepted that through a mechanism made out of a steel where may be produced a shtytje through the chargers equiped with registers towards the structure of iconostasi until reaching shtangesi and its full stabilization. After ending the mounting phase of the supporting structure of iconostasi, spaces are created for mounting the composing and decorating panels . After mounting the cooper layer into the supporting structure, starts the decoring phase of iconostasi, the layer have a spesor calculated to 3mm, and towards the horizontal lengths are 90 degree for purposes of non deformating it . It is proposed that the cooper lastrat are te foruara maybe with the orthodhoks cross symbol in series in regular industrial configuration. The space between is 2x2x2x2x2....x2cm.

The next step constitutes mounting in the structure of the illuminating system, which is concepted to be through gas pipes (neon) in serial. Their linear proceeding will provide an illuminated strip (in warm illumination) which will make correctly readable the lithurgic subject of the icons. Ending this operation the metallic profiles (inox) will be mounted which will serve as a guide for putting the icons in their places. The guides will be associated by a rregulatory mechanism which corrects vertically the livell of each icon indipendently. The next step is mounting the wooden horizontal lastra . These lastra with dimensions varying in a width of 12-30cm and length 35mm constituting the last mouting plan. In the realization of the structure of "final" iconostasi in any case is foreseen a temporary scenario of its existence, in the meaning and profit of the neverending material, technological and above all scentific evolution, with the sole and holy scope of conserving the material and spiritual values of our inheritance.■

DO NOT COPY

DO NOT COPY



DO NOT COPY

ni 500 lek

cover design elsi kongo